BASHKIA TIRANË

Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë

Studim Fizibiliteti

NËNTOR 2016

Open Procurement Albania

1. HYRJE 16
1.1. Përcaktimi i termave 16
1.2. Përshkrimi i përgjithshëm 17
2. PIKËNISJA E PROJEKTIT 20
2.1. Procesi i planifikimit kombëtar, rajonal, sektorial 21
2.2. Bashkërendimi me politikat kombëtare dhe sektoriale 23
2.3. Bashkërendimi me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës 24
2.4. Përparësitë e politikave 27
2.5. Përshkrim i përgjithshëm i gjendjes ekzistuese infrastrukturore 28
2.6. Objektivat e projektit 36
2.7. Përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti 37
3. SITUATA AKTUALE 41
3.1. Legjislacioni 41
3.1.1. Arsimi parauniversitar si shërbim publik 41
3.1.2. Administrimi i institucioneve arsimore parauniversitare 41
3.1.3. Planifikimi dhe ndërtimi i institucioneve arsimore parauniversitare 43
3.1.4. Financimi i institucioneve arsimore parauniversitare 49
3.2. Metodologjia 51
3.3. Analizë e thelluar e gjendjes ekzistuese 54
3.3.1. Arsimi 9-vjeçar 54
3.3.2. Arsimi i mesëm 88
3.4. Analiza e infrastrukturës arsimore ekzistuese dhe asaj të nevojshme mbi bazën e numrit të popullsisë 121
3.5. Nevoja për kopshte 122
3.6. Parashikimi i nevojave afatmesme dhe afatgjata për infrastruktura të reja arsimore 123
4. PROJEKTI TEKNIK 128
4.1. Vendodhja dhe trualli 128
4.1.1. Vendndodhja dhe alternativat e mundshme 128
4.1.2. Sipërfaqe totale që do zihet në mënyrë të përhershme 130
4.1.3. Statusi ligjor i trojeve që do zihen 142
4.2. Kushtet lokale 166
4.2.1. Përshtatshmëria topografike dhe gjeologjike e trojeve të përzgjedhura 166

Open Procurement Albania

4.2.2. Sizmiciteti 172
4.2.3. Gjendja e shërbimit me rrugë dhe infrastrukturë nëntokësore e trojeve të përzgjedhura 174
4.3. Përshkrimi arkitektonik, konstruktiv dhe funksional i projektit 194
4.3.1. Parametrat e projektimit 194
4.3.2. Punët kryesore civile që do realizohen 198
4.3.3. Metodat e ndërtimit 200
4.3.4. Teknologjitë dhe pajisjet që duhet të përdoren 205
4.3.5. Lista e standardeve teknike përkatëse që do merren parasysh gjatë zbatimit të projektit 206
4.3.6. Periudha e vlerësuar e ndërtimit 206
4.4. Kostot për zbatimin e projektit 206
4.4.1. Kosto projektimi dhe ndërtimi 206
4.4.2. Kosto mobilimi dhe laboratoresh 212
4.4.3. Kosto mirëmbajtje 214
4.4.4. Kosto të tjera 216
5. NDIKIMI MJEDISOR DHE SOCIAL 220
5.1 Ndikimi Mjedisor 220
5.1.1. Kuadri Ligjor 220
5.1.2. Pershkrim i Florës dhe Faunës në zonat e marra në studim 221
5.2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis në zonat e studiuara 222
5.2.1. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së ndërtimit 222
5.2.2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit 224
5.3. Masat për zbutjen e ndikimit në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë fazës së operimit 224
5.4. Ndikimi Social 225
5.4.1. Përfitimet sociale të arsimimit 225
5.4.2. Shpronësimi dhe kompensimi 226
6. ANALIZA EKONOMIKE DHE FINANCIARE 228
6.1. Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat 228
6.2. Supozimet kryesore 230
6.3. Analiza e kostove 231
6.3.1. Kostot e drejtpërdrejta të investimeve 233
6.3.2. Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes 239

Open Procurement Albania

6.4. Analiza e të ardhurave të PPP 242
6.4.1. Tarifa e përdorimit të shkollave 242
6.4.2. Burimi i Financimit 245
6.5. Analiza Financiare 247
6.6. Realizueshmëria ekonomike e projektit 248
6.6.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto) 248
6.6.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit) 249
6.6.3. Periudha e vetëshlyerjes 249
6.6.4. Përshtatshmria financiare 250
6.7. Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve 251
6.7.1. Analiza cilësore e risqeve 251
6.7.2. Analiza sasiore e risqeve 254
6.8. Analiza e ndjeshmërisë 257
7. Arsyetimi i Vendimit të PPP 258
7.1 Arsyetimi i Vendimit të Koncensionit/Partneritetit Publik Privat 258
7.2 Avantazhet e një Kontrate Koncesioni/Partneriteti Publik Privat 260
7.3 Alokimi i Risqeve 262
7.4 Rekomandime mbi ndarjen e zbatimit të projektit në Lote 263
7.4.1 Kapacitetet teknike e profesionale për ndërtime të objekteve arsimore 263
7.4.2 Kapacitetet financiare të operatorëve ekonomikë 265
7.4.3 Bashkimi i operatorëve dhe nënkontraktimi 266
8. Fizibiliteti i zbatimit të secilit Lot 267
8.1. Loti 1 269
8.1.1. Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 1 269
8.1.2. Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 1 269
8.1.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 1 273
8.1.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 1 278
8.1.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 1 279
8.2 Loti 2 308
8.2.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 2 308
8.2.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 2 308

Open Procurement Albania

8.2.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 2 312
8.2.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 2 317
8.2.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 2 318
8.3 Loti 3 347
8.3.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 3 347
8.3.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 3 348
8.3.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 3 352
8.3.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 3 356
8.3.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 3 357
8.4 Loti 4 386
8.4.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 4 386
8.4.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 4 387
8.4.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 4 391
8.4.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 4 395
8.4.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 4 395
9. Rezultatet e Studimit të Fizibilitetit 425

Open Procurement Albania

INDEKSI I TABELAVE

Tabela 1 - Standardi I MAS për nr. e nxënësve për klasë 42
Tabela 2 – Tipet e shkollave 44
Tabela 3- Standarde projektimi për shkollën e Tipit 1 45
Tabela 4 - Standarde projektimi për shkollën e Tipit 2 46
Tabela 5 - Standarde projektimi për shkollën e Tipit 3 47
Tabela 6 - Standarte projektimi për shkollën e Tipit 4 48
Tabela 7 - Standarti për numrin e nxënësve për klasë mësimore 51
Tabela 8 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit 9-vjeçar përkundrejt nxënësve frekuentues 55
Tabela 9 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit 9-vjeçar përkundrejt nxënësve banues në secilën NjA 56
Tabela 10 - Vendbanimi i nxënësve dhe Njësia Administrative ku frekuentojnë shkollën (Cikli 9-vjeçar) 59
Tabela 11 - Numri i shkollave të nevojshme 87
Tabela 12 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit të mesëm të lartë përkundrejt nxënësve frekuentues 88
Tabela 13 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit të mesëm të lartë përkundrejt nxënësve banues në secilën NjA 89
Tabela 14 - Vendbanimi i nxënësve dhe Njësia Administrative ku frekuentojnë shkollën (Cikli i mesëm i lartë) 92
Tabela 15 - Numri i shkollave të reja 120
Tabela 16 - Numri i shkollave të reja të nevojshme sipas standardit të popullsisë 121
Tabela 17 - Numri i kopshteve sipas viteve 122
Tabela 18 - Raporti fëmijë për kopësht 122
Tabela 19 - Popullsia e Tiranës sipas grupmoshave për vitin 2016 123
Tabela 20 - Tipet e shkollave 124
Tabela 21 - Shpërndarja e shkollave sipas tipologjisë 125
Tabela 22- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 143
Tabela 23 -Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 145
Tabela 24-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 147
Tabela 25-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 149
Tabela 26-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 151
Tabela 27-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 153
Tabela 28-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 155
Tabela 29-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 157
Tabela 30-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 159
Tabela 31-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 161
Tabela 32- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 163
Tabela 33-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 165
Tabela 34 - Numër nxënësish sipas tipeve të shkollës 195
Tabela 35 - Sipërfaqet e ambienteve për çdo shkollë sipas numrit të nxënësve për klasë Arsimi Bazë 196

Open Procurement Albania

Tabela 36 - Tipet e klasave dhe hapësirat e nevojshme - Arsim i Mesëm Cikël i lartë 197
Tabela 37 - Etapat e realizimit të objektit 206
Tabela 38 - Nr i shkollave të nevojshme për tu ndërtuar 207
Tabela 39 – Të dhëna të detajuara për shkollat e propozuara 208
Tabela 40 - Tipet e shkollave 209
Tabela 41 - Sipërfaqet e kopshteve sipas tipeve 209
Tabela 42 - Kostot e ndërtimit të kopshteve sipas tipologjisë 209
Tabela 43 - Kategoritë e punimeve me zërat përkatës 210
Tabela 44 - Kosto totale për ndërtimin e objekteve mësimore sipas tipologjisë 211
Tabela 45 - Kosto totale ndërtimi 212
Tabela 46 - Kostot e mobilimit sipas tipologjisë 212
Tabela 47 - Kostot e mobilimit sipas tipologjisë 213
Tabela 48 Kostot paraprake të laboratorëve sipas tipit 213
Tabela 49 Kostot e laboratorëve sipas tipit të shkollës 213
Tabela 50 - Zërat e mirëmbajtjes dhe kostot e tyre (LEKË) për një periudhë 1 vjeçare për klasë fizike 215
Tabela 51 - Kosto të tjera 217
Tabela 52 - LLogaritja e oponencës teknike 218
Tabela 53 - Oponenca teknike sipas tipologjisë së shkollave 218
Tabela 54 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë 232
Tabela 55 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjisë 232
Tabela 56 Tabela përmbledhëse e shpronësimeve 234
Tabela 57 Tabela përmbledhëse e kostove të ndërtimit 235
Tabela 59 Kostot e mobilimit të shkollave 236
Tabela 58 Tabela përbmbledhëse e kostove të tjera 236
Tabela 60 Kostot e mobilimit të ambienteve të kopështeve 237
Tabela 61 Kosto për pajisjet e laboratorëve 237
Tabela 62 Kosto për pajisjet e laboratorëve sipas tipologjisë së shkollave 238
Tabela 63 Kosto përmbledhëse për mobilim të shkollave, ambjenteve të kopështëve dhe laboratoreve 238
Tabela 64 Kostot direkte të investimit sipas zërave 239
Tabela 65 Kostoja vjetore e mirëmbajtjes për tip shkolle 239
Tabela 66 Kostoja 7 vjeçare e mirëmbajtjes 240
Tabela 67 Kostoja e detajuar e mirëmbajtjes për çdo shkollë 241
Tabela 68 Rezultatet e ankandeve për obligacionet 7 vjeçare fikse 243
Tabela 69 Tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit 243
Tabela 70 Shuma e kestit vjetor 244
Tabela 71 Vlera e përgjithshme e projektit 245
Tabela 72 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga koncesionari 245
Tabela 73 Parashikimi i të ardhurave nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore 245
Tabela 74 Tabele permbledhese e kostove dhe te ardhurave te projektit 247
Tabela 75 Fluksi i arkës së projektit 248
Tabela 76 Norma e brendshme e kthimit e projektit 249

Open Procurement Albania

Tabela 77 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve 256
Tabela 78 Analiza e ndjeshmërisë nëse kostot de marzhi i fitimit rriten dhe ulen me 5% dhe 10% 257
Tabela 79 Tabela përmbledhëse e alokimit të risqeve..... 262
Tabela 80 Kapacitetet teknike të nevojshme për ndërtimin e 17 shkollave njëkohësisht..... 264
Tabela 81 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekt 274
Tabela 82-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 276
Tabela 83 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti..... 278
Tabela 84 –Tipet e shkollave 278
Tabela 85 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 1 282
Tabela 86 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 1..... 283
Tabela 87 Tabelë përmbledhëse e shpronësimeve për Lotin 1 284
Tabela 88 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 1 285
Tabela 90 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit..... 286
Tabela 89 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 1 286
Tabela 91 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit..... 287
Tabela 92 Kosto për pajisjen e Laboratorëve 287
Tabela 93 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës 288
Tabela 94 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 1 288
Tabela 95 Kosto direkte investimi për Lotin 1 289
Tabela 96 Kosto vjetore mirëmbajtje për shkollat e Lotit 1 289
Tabela 97 Kosto mirëmbajtje 7 vjeçare për Lotin 1 290
Tabela 98 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 1 291
Tabela 99 Marzhi i fitimit..... 292
Tabela 100 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 1 293
Tabela 101 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 1..... 295
Tabela 102 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari..... 295
Tabela 103 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore 295
Tabela 104 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit 297
Tabela 105 Fluksi i arkës së projektit 298
Tabela 106 Norma e brendshme e kthimit e projektit..... 299
Tabela 107 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve 306
Tabela 108 Analiza e ndjeshmërisë 307
Tabela 109 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti..... 313
Tabela 110-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 315
Tabela 111 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti..... 316
Tabela 112 – Tipet e shkollave 317
Tabela 113 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 2 321
Tabela 114 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 2..... 321
Tabela 115 Tabelë përmbledhëse e shpronësimeve për Lotin 2 322
Tabela 116 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 2 323

Open Procurement Albania

Tabela 117 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 2 324
Tabela 118 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit 325
Tabela 119 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit 325
Tabela 120 Kosto për pajisjen e Laboratorëve 325
Tabela 121 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës 326
Tabela 122 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 2 327
Tabela 123 Kosto direkte investimi për Lotin 2 328
Tabela 124 Kosto vjetore mirëmbajtje për shkollat e Lotit 2 329
Tabela 125 Kosto mirëmbajtje 7 vjeçare për Lotin 2 329
Tabela 126 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 2 330
Tabela 127 Marzhi i fitimit 331
Tabela 128 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 2 332
Tabela 129 Shuma e kestit vjetor 333
Tabela 130 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 2 334
Tabela 131 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari 334
Tabela 132 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore 334
Tabela 133 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit 336
Tabela 134 Fluksi i arkës së projektit 337
Tabela 135 Norma e brendshme e ktimit e projektit 338
Tabela 136 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve 345
Tabela 137 Analiza e ndjeshmërisë 346
Tabela 138 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 353
Tabela 139 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 354
Tabela 140 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 356
Tabela 141 - Tipet e shkollave 357
Tabela 142 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 3 361
Tabela 143 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 3 361
Tabela 144 Tabelë përmbledhëse e shpronësimeve për Lotin 3 362
Tabela 145 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 3 363
Tabela 147 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit 364
Tabela 146 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 3 364
Tabela 148 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit 365
Tabela 149 Kosto për pajisjen e Laboratorëve 365
Tabela 150 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës 366
Tabela 151 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 3 366
Tabela 152 Kosto direkte investimi për Lotin 3 367
Tabela 153 Kosto vjetore mirëmbajtje për shkollat e Lotit 3 367
Tabela 154 Kosto mirëmbajtje 7 vjeçare për Lotin 3 368
Tabela 155 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 3 369
Tabela 156 Marzhi i fitimit 370
Tabela 157 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti 371

Open Procurement Albania

Tabela 158 Shuma e kestit vjetor **372**
Tabela 159 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 3 ..... **373**
Tabela 160 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga koçesionari **373**
Tabela 161 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore **373**
Tabela 162 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit **375**
Tabela 163 Fluksi i arkës së projektit **376**
Tabela 164 Norma e brendshme e kthimit e projektit **377**
Tabela 165 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve **384**
Tabela 166 Analiza e ndjeshmërisë **385**
Tabela 167 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti **392**
Tabela 168- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti **393**
Tabela 169 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti **394**
Tabela 170 – Tipet e shkollave **395**
Tabela 171 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 4 ..... **399**
Tabela 172 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 4 ..... **399**
Tabela 173 Tabelë përmbledhëse e shpronësimeve për Lotin 4 ..... **400**
Tabela 174 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 4 ..... **401**
Tabela 175 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 4 ..... **402**
Tabela 176 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit **402**
Tabela 177 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit **403**
Tabela 178 Kosto për pajisjen e Laboratorëve **403**
Tabela 179 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës **404**
Tabela 180 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 4 ..... **404**
Tabela 181 Kosto direkte investimi për Lotin 4 ..... **405**
Tabela 182 Kosto vjetore mirëmbajtje për shkollat e Lotit 4 ..... **405**
Tabela 183 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 4 ..... **407**
Tabela 184 Marzhi i fitimit **408**
Tabela 185 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet koçesionarit për Lotin 4 ..... **410**
Tabela 186 Shuma e kestit vjetor **411**
Tabela 187 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 4 ..... **412**
Tabela 188 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga koçesionari **412**
Tabela 189 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore **413**
Tabela 190 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit **414**
Tabela 191 Fluksi i arkës së projektit **415**
Tabela 192 Norma e brendshme e kthimit e projektit **416**
Tabela 193 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve **423**
Tabela 194 Analiza e ndjeshmërisë **424**

Open Procurement Albania

INDEKSI I FIGURAVE

Figura 1 - Shpenzimet kapitale për arsimin gjatë 10 viteve të fundit 23
Figura 2 Shtyllat kryesore të zhvillimit për Tiranën 25
Figura 3 - Pamje nga ambientet e disa shkollave në Medellin, Kolumbi..... 39
Figura 4 - Dhomat mësimore 49
Figura 5 - Madhësia mesatare e klasës në institucionet arsimore sipas nivelit të edukimit (2013)..... 52
Figura 6 – Ortofoto e sheshit 130
Figura 7 - Foto të sheshit 2/3 130
Figura 8- Pamje nga lumi i Lanës në afërsi të njërit prej shesheve të parashikuar për ndërtim shkolle (Sheshi 6/6, Yzberisht)..... 170
Figura 9 Foto të sheshit 9/1 270
Figura 10 Foto të sheshit 11/1 271
Figura 11 Foto të sheshit 11/2 273
Figura 12 Foto të sheshit 6/3 309
Figura 13 Foto nga sheshi 6/6 311
Figura 14 Foto nga sheshi 7/2 312
Figura 15 Foto të sheshit 2/6 349
Figura 16 Foto të sheshit 5/1 350
Figura 17 Foto të sheshit F3 351
Figura 18 – Ortofoto e sheshit 387
Figura 19 Foto të sheshit 2/3 388
Figura 20 Foto të sheshit D2 389
Figura 219 - Foto nga sheshi 8/1 390

Open Procurement Albania

INDEKSI I HARTAVE

Harta 1-Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare të propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të vitit 2013 të Bashkisë Tiranë 26
Harta 2 - Shpërndarja e shkollave të mesme të propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të vitit 2013 të Bashkisë Tiranë 26
Harta 3 - Nr. mesatar i nxënësve për klasë fizike sipas Njësive Administrative për shkollat 9-vjeçare .. 30
Harta 4 - Nr. mesatar i nxenesve për klase fizike sipas në zonën urbane dhe NjA përreth për shkollat 9-vjeçare 31
Harta 5 - Nr. mesatar i nxënësve për klasë fizike sipas Njësive Administrative për shkollat e mesme . 32
Harta 6 - Nr. mesatar i nxenesve për klase fizike sipas në zonën urbane dhe NjA përreth për shkollat e mesme 33
Harta 7 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-vjeçare 35
Harta 8 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme 35
Harta 9 -Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit frekuentojnë shkollën (Cikli 9-vjeçar) 57
Harta 10 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit banojnë (Cikli 9-vjeçar) 58
Harta 11 - Përqindja e nxënësve frekuentues të shkollave jo banor/ nxënësve banor të secilës NjA ... 60
Harta 12 - Mbipopullimi i shkollave dhe vendbanimi i nxënësve – cikli 9-vjeçar (Shenim: vlerat negative tregojnë numrin mbi kapacitet për secilën shkollë) 61
Harta 13 - Rrezet e mbulimi të territorit ne shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 1 62
Harta 14 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 2 63
Harta 15 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 3 64
Harta 16 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 4 65
Harta 17 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 5 66
Harta 18 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 6 67
Harta 19 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 7 68
Harta 20 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 8 69
Harta 21 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 9 70
Harta 22 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 10 71
Harta 23 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 11 72
Harta 24 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Kashar 73
Harta 25 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Farkë 74
Harta 26 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Dajt 75
Harta 27 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Vaqarr 76
Harta 28 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Ndroq 77
Harta 29 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Petrelë..... 78
Harta 30 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Pezë 79
Harta 31 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Baldushk..... 80
Harta 32 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Berzhitë 81
Harta 33 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Krrabë 82
Harta 34 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Shëngjergj 83
Harta 35 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Zall Bastar 84
Harta 36 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - Zall Herr 85

Open Procurement Albania

Harta 37 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit frekuentojnë shkollën (Cikli i mesëm i lartë) 91
Harta 38 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit banojnë (Cikli i mesëm i lartë) 91
Harta 39 - Përqindja e nxënësve frekuentues të shkollave jo banor/ nxënësve banor të secilës NjA ... 93
Harta 40 - Mbipopullimi i shkollave dhe vendbanimi i nxënësve – cikli i mesëm i lartë (Shenim: vlerat negative tregojnë numrin mbi kapacitet për secilën shkollë) 94
Harta 41 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 1 95
Harta 42 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 2 96
Harta 43 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 3 97
Harta 44- Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 4 98
Harta 45 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 5 99
Harta 46 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 6 100
Harta 47- Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 7 101
Harta 48 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 8 102
Harta 49 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 9 103
Harta 50 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 10 104
Harta 51 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - Nja 11 105
Harta 52 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Kashar 106
Harta 53 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Farkë..... 107
Harta 54 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Dajt 108
Harta 55 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Vaqarr 109
Harta 56 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Ndroq 110
Harta 57 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Pezë..... 111
Harta 58 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Baldushk..... 112
Harta 59 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Bërzhitë..... 113
Harta 60 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Krrabë 114
Harta 61 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Shëngjergj 115
Harta 62 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Zall Bastar..... 116
Harta 63 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Zall Herr..... 117
Harta 64 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Petrelë..... 118
Harta 65 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-veçare ekzistuese (kuqe) dhe të propozuara (kafe)..... 126
Harta 66 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme ekzistuese (gjelbër) dhe të propozuara (blu) 127
Harta 67 - Sheshet e përzgjedhura dhe sheshet alternative për vendosjen e shkollave të propozuara 129
Harta 68- Harta treguese e pronave..... 142
Harta 69-Harta treguese e pronave 144
Harta 70- Harta treguese e pronave..... 146
Harta 71-Harta treguese e pronave 148
Harta 72- Ortofoto e sheshit..... 150
Harta 73- Harta treguese e pronave..... 152
Harta 74- Harta treguese e pronave..... 154

Open Procurement Albania

Harta 75- Harta treguese e pronave **156**
Harta 76- Harta treguese e pronave **158**
Harta 77- Harta treguese e pronave **160**
Harta 78- Ortofoto e sheshit **162**
Harta 79- Harta treguese e pronave **164**
Harta 80 - Situata Hidro Gjeologjike (Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë 2014) **171**
Harta 81 - Situata Sizmike (Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë 2014) **173**
Harta 82 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **174**
Harta 83 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **175**
Harta 84 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **176**
Harta 85 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **176**
Harta 86 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **177**
Harta 87 -Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **178**
Harta 88 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **179**
Harta 89 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **180**
Harta 90 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **181**
Harta 91 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshit **182**
Harta 92 -Harta 80 Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **183**
Harta 93 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **184**
Harta 94 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **185**
Harta 95 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **186**
Harta 96 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **187**
Harta 97 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **187**
Harta 98 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **188**
Harta 99 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **188**
Harta 100 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **189**
Harta 101 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **190**
Harta 102 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **191**
Harta 103 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **192**
Harta 104 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin **193**
Harta 105 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin **194**
Harta 106 Ndarja e shkollave në lote **267**
Harta 107 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 1 ..... **269**
Harta 108 Ortofoto e sheshit **270**
Harta 109 Ortofoto e sheshit **271**
Harta 110 Ortofoto e sheshit **272**
Harta 111 Harta treguese e pronave **273**
Harta 112- Harta treguese e pronave **275**
Harta 113 Harta treguese e pronave **277**
Harta 114 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 2 ..... **308**
Harta 115 Ortofoto e sheshit **309**
Harta 116 Ortofoto e sheshit **310**
Harta 117 Ortofoto e sheshit **311**

Open Procurement Albania

Harta 118 Harta treguese e pronave **312**
Harta 119- Ortofoto e sheshit **314**
Harta 120 Harta treguese e pronave **316**
Harta 121 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 3 ..... **347**
Harta 122 Ortofoto e sheshit **348**
Harta 123 Ortofoto e sheshit **349**
Harta 124 Ortofoto te sheshit **350**
Harta 125 Harta treguese e pronave **352**
Harta 126 Harta treguese e pronave **353**
Harta 127 Harta treguese e pasurive **355**
Harta 128 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 4 ..... **386**
Harta 129 Ortofoto e sheshit **388**
Harta 130 Ortofoto e sheshit **389**
Harta 131 Harta treguese e pronave **391**
Harta 132 Ortofoto e sheshit **393**
Harta 133 Harta treguese e pronave **394**

Open Procurement Albania

1. HYRJE

1.1. Përcaktimi i termave

Termat e përdorura gjatë kësaj analize i referohen kryesisht "Udhëzuesit për projektimin e ndërtesave shkollore – Normat dhe Standardet", publikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe ligjit nr.69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" si mëposhtë:

Arsimi parauniversitar përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas "Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit", të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:

a. "Niveli me kodin 0", arsimi parashkollor;
b. "Niveli me kodin 1", arsimi fillor;
c. "Niveli me kodin 2", arsimi i mesëm i ulët;
d. "Niveli me kodin 3", arsimi i mesëm i lartë.

Arsimi bazë (themelor): Klasat nga 1 deri 9 (grup mosha 6-17 vjeç).

Arsimi bazë: Përfshin nivelin dhe arsimin e mesëm të ulët. Niveli klasat 1-6 (grup mosha 6-12) që iu përgjigjen "ndërtesave" të shkollës fillore.

Arsimi i mesëm i ulët: përfshinë klasat 6-9 (grup mosha 12-17) Ky nivel i përgjigjet ndërtesave shkollore të " Arsimit të mesëm të ulët".

Arsimi i mesëm i lartë: Klasat 10 deri në 12 (grup moshat 15 deri 21 vjeç) Ky nivel i përgjigjet "ndërtesave të shkollave të mesme të larta".

Dhomë mësimi e përgjithshme ose Klasë fizike: Hapësirë e projektuar dhe e pajisur për mësim të të gjitha lëndëve të nxënësve.

Institucion arsimor është kopshti ose shkolla.

Institucion arsimor plotësues është institucioni që pasuron përvojat mësimore dhe jetësore të nxënësve.

Klasë/ Klasë mësimore: Grup i nxënësve që mësojnë në nivelin e njëjtë shkollor. Në sistemin rotator klasa nuk korrespondon me dhomën e mësimit.

Kopësht është institucioni arsimor që ofron shërbim arsimor të nivelit me kodin 0.

Kurrikula është tërësia e dokumentacionit si: korniza kurrikulare, plani shkollor, programi mësimor, teksti dhe materiale të tjera të një lënde ose fushe të të nxënit dhe e tërë veprimtaria e organizuar në mjedisin e të mësuarit, që shërben për të siguruar një formim të caktuar të atyre që nxën.

Open Procurement Albania

Ministri është ministri që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.

Ministria është ministria që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.

Mësues është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin parauniversitar.

Nxënës është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.

Nxënës me aftësi të kufizuara është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

Program mësimor është dokumenti që përmban synimet e lëndës, kompetencat e saj specifike, objektivat e arritjeve të nxënësve, përmbajtjen kryesore, metodologjitë specifike të mësimdhënies, nxënies dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Shkollë është institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet me kodet 1, 2, 3.

Shkollë private është shkolla jopublike, e cila nuk themelohet, financohet dhe administrohet nga qeveria qendrore ose vendore.

Open Procurement Albania

1.2. Përshkrimi i përgjithshëm

Ky studim ka për qëllim identifikimin e nevojave afatmesme dhe afatgjata të Bashkisë së Tiranës për ndërtimin e objekteve të reja arsimore të ciklit parauniversitar si dhe përcaktimin e mënyrës më kosto-efektive për realizimin e këtyre infrastrukturave. Meqënëse Bashkia Tiranë po vlerëson mundësinë e zbatimit të katij projekti përmes një skeme të Partneritetit Publik Privat, siç parashikohet në ligjin Nr. 125/2013, "Për Konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat", Neni 18, është ngritur komisioni për dhënien e PPP-së, në vijim të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr.15742, datë 24.05.2016, për "Ngritjen e komisionit për ndjekjen e proçedurave të konçesionit/ partneritetit publik privat për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës".

Një nga detyrat e këtij komisioni, ka qënë hartimi i studimit të fizibilitetit për konçesionin/partneritetin publik privat, mbi bazën e të cilit do të përcaktohet procedura e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe do të hartohet dokumentacioni i tenderit.

Idenfikimi i këtyre nevojave vjen si rezultat i rritjes së konsiderueshme demografike që ka pësuar Bashkia e Tiranës gjatë viteve të fundit çka ka rezultuar në mbipopullimin e disa prej shkollave të kryeqytetit, kryesisht në zonat informale dhe boshatisjen e disa të tjerave, kryesisht në zonat periferike. Me reformën e re territoriale tashmë bashkisë së re i janë shtuar edhe 13 Njësi Administrative, ish-komuna kufitare me kryeqytetin, çka e ka rritur edhe më tej numrin e

popullsisë dhe territorit e administruar nga bashkia. Si rrjedhim, kjo rritje ka theksuar nevojën e shtimit dhe përmirësimit në mënyrë konstante të shërbimeve publike parësore, siç është edhe ai i arsimit.

Ky dokument është bazuar mbi një bazë të dhënash të azhornuar me situatën aktuale, përmes mbledhjes së informacionit në terren, shfrytëzimit të bazës së të dhënave ekzistuese në Bashkinë Tiranë, të dhënave të mbledhura nga Drejtoria Arsimore Rajonale dhe Ministria e Arsimit si dhe janë konsultuar studimet e mëparshme në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, për të krijuar një panoramë sa më të qartë të situatës. Duke u bazuar në të dhënat e marra, studimi është përpjekur të integrojë sëbashku në një kuadër ndërlidhës analizën e thelluar të gjendjes ekzistuese, parashikimin e nevojave aktuale dhe të ardhshme të bashkisë, kooridinimin e projektit me politikat kombëtare dhe sektoriale si dhe vlerësimin e metodës më efektive për financimin dhe zbatimin e objektit të studimit.

Fillimisht kapitulli i parë përcakton termat e përdorura në këtë studim si dhe një përshkrim të përgjithshëm të projektit.

Në kapitullin e dytë të dokumentit, paraqitet në mënyrë të përgjithshme situata aktuale e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës duke shpjeguar nevojën për realizimin e këtij projekti dhe objektivat që kërkohet të arrihen përmes tij. Më pas dokumenti vijon me objektivat e projektit bashkërendohen me objektivat e politikave kombëtare dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e politikave vendore me ato rajonale dhe qendrore. Në këtë fazë analizohen gjithashtu përfitimet strategjike dhe operacionale që pritet të vijnë nga projekti prej të cilave mendohet të përfitojnë në mënyrë direkte rreth 12,390 nxënës si dhe një pjesë e madhe e qytetarëve të bashkisë.

Open Parliament Albania

Kapitulli i tretë i studimit fillimisht parashtron legjislacionin ekzistues për përgjegjësitë dhe kompetencat e NJQV-ve në lidhje me arsimin parauniversitar si dhe me metodologjinë e përdorur për realizimin e këtij studimi. Kjo e fundit është bazuar mbi vlerësimin e disa treguesve, të cilët vijnë si referenca ligjore apo standarde të rekomanduara nga ministria e linjës të tilla si: Numri i nxënësve/dhomë mësimi të përgjithshme; Rrezja e mbulimit me shërbimin e arsimit parauniversitar; Numri i shkollave mbi bazë të numrit të popullsisë; Standarde të projektimit të shkollave të ciklit parauniversitar, etj. Krahasimi i këtyre treguesve me situatën aktuale në Bashkisë së Tiranës shpalos në mënyrë të theksuar mungesën e standarteve në arsimin parauniversitar në Tiranë dhe rëndësinë strategjike që ka ky projekt për arritjen e tyre. Mbi këtë racionale prezantohet analiza e thelluar të situatës aktuale duke evidentuar më me detaje mangësitë e infrastrukturës arsimore e Bashkisë së Tiranës, shoqëruar me parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave për infrastruktura të reja arsimore.

Kapitulli i katërt parashtron analizën teknike e projektit ku evidentohen zonat më të përshtatshme për ndërtimin e strukturave të reja arsimore. Identifikimi i këtyre është arritur duke marrë në konsideratë një sërë karakteristikash të tilla si sipërfaqja e territorit e mbuluar me rrezen e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sipërfaqja e trojeve dhe pronësia e tyre, përshtatshmëria tipologjike dhe gjeologjike e truallit, infrastruktura e zonës etj. Në këtë kapitull është prezantuar

gjithashtu parashikimi i kostove totale për zbatimin e projektit duke nisur nga kostot e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtes, kostot e mobilimit si dhe kosto të tjera të përgjithshme që duhet të konsiderohen.

Me saktësimin e nevojës për infrastruktura të reja arsimore dhe identifikimin e trojeve të mundshme për realizimin e tyre, studimi vijon në kapitullin e pestë me një analizë të impaktit mjedisor dhe social që do të sjellë ndërtimi i shkollave.

Kapitulli i gjashtë fokusohet në aspektet ekonomike dhe financiare të projektit. Në këtë kapitull vlerësohet modeli ekonomik i Partneritetit Publik Privat, duke marrë për referencë edhe praktikat më të mira në vendet e zhvilluara ku ky model ka përdorim më të gjerë. Kapitulli rimerr në shqyrtim analizën e kostove, vijuar me analizën e të ardhurave për financimin e projektit. Kapitulli vijon me Analizën financiare për periudhën 7 vjeçare të zbatimit të skemës së PPP, si dhe vlerëson realizueshmërinë ekonomike të projektit.Ky kapitull mbyllet me një analizë sasiore dhe cilësore të riskut dhe analizë të ndjeshmërisë.

Kapitulli i fundit i studimit konkludon në arsyet përse është vendosur të zgjidhet skema e PPP për realizimin e këtij projekti si dhe konkretisht cila metodë e PPP është evidentuar si më e përshtatshme nga pikëpamja teknike dhe financiare.

Open Procurement Albania

2. PIKËNISJA E PROJEKTIT

Në Bashkinë Tiranës gjenden gjithsej 191 shkolla publike, nga të cilat 17 janë shkolla të mesme të veçanta, 13 janë të mesme të bashkuara , 40 janë cikli I ulët dhe 121 janë 9-vjeçare . Në total, zhvillojnë mësimin 13963 nxësës në shkollat e mesme të vecanta, 4557 nxënës në shkollat e mesme të bashkuara, 56950 në ciklin 9-vjeçar dhe 795 nxënës në ciklin e ulët. Duke qenë se numri i nxënësve është më i lartë se kapaciteti maksimal i këtyre shkollave, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë të regjistruar më shumë nxënës se kapaciteti maksimal i tyre, çka i detyron ta zhvillojnë mësimin në klasa të mbipopulluara ose gjatë turnit të dytë. Nga llogaritjet e bëra për këtë studim fizibiliteti rezulton se 61 shkolla kanë më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal, nga të cilat 10 janë të mesme të vecanta, 2 janë të mesme të bashkuara dhe 49 janë 9-vjecare. 57 shkolla e zhvillojnë mësimin me dy turne nga të cilat 3 të mesme te vecanta, 3 të mesme të bashkuara, 1 cikël I ulët dhe 50 9-vjecare. Në total, në Bashkinë Tiranë janë 14 292 nxënës mbi kapacitetin maksimal të infrastrukturës arsimore dhe 14 919 nxënës që e zhvillojnë mësimin gjatë turnit të dytë.

Numri i pamjaftueshëm i shkollave në Bashkinë Tiranë ka bërë që gjatë viteve të përvijohen disa probleme të mprehta me të cilat përballet komuniteti

1. **Mësimi me dy turne**. Në Bashkinë Tiranë, 66% e shkollave 9 vjeçare në zonat urbane dhe 8% e shkollave 9 vjeçare në zonat peri-urbane dhe rurale e zhvillojne mësimin me dy turne. Ndersa 15% e shkollave të mesme në zonat urbane dhe 25% e shkollave të mesme në zonat peri-urbane dhe rurale e zhvillojnë mësimin me dy turne. Është vërtetuar nga studime të ndryshme se zhvillimi i mësimit me dy turne, është burim i një sërë problemesh, si: Përqëndrimi i dobët i fëmijëve gjatë mësimit të zhvilluar në oraret e mbasdites; Mundësia e limituar e prindërve për të shoqëruar fëmijët nëpër shkolla për shkak të përplasjes me oraret e punës; Mbipërdorimi i shkollave dhe amortizimi i shpejtë i tyre etj,.

- **Numri i lartë i nxënësve për klasë**, apo siç njhet ndryshe në literaturen ndërkombetare "madhësia e klasës"[1]. Sot në Tiranë, një numër i konsiderueshëm shkollash të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm kanë një madhësi klase që shkon mbi 30-35 nxënës për klasë kur mesatarja e madhësisë së klasës në vendet e OECD është nga 21-25 nxënës për arsimin parësor[2].

- **Vështirësia e aksesit në shkolla**. Zhvillimi i vrullshëm demografik i Tiranës dhe përqëndrimi i ndërtimeve të reja në territore perferike të pazhvilluara deri në fillim të viteve ´90, ka bërë që në disa Njësi Administrative të Tiranës të ketë zona me dëndësi

[1] Sipas përkufizimit të Organizatës për Bashkëpunimin e Zhvillimin Ekonomik (OECD- anglisht).

[2] Ky raport për arsimin parauniversitar (bëhet fjale për klasën 5-8) shkon në 24 nxenes për klasë dhe për shkollat e mesme rreth 25 nxenes për klasë. Klasat e vogla lejojnë mesuesit të fokusohen më shumë tek nevojat individuale të nxënësve dhe të zvogëlojnë kohën që nevojitet për tu marrë me ndërpreje të ndryshme. Sipas OECD klasat e vogla janë më të rekomandeshme për nivelin fillestar, se sa për nivelin e shkollave të mesme. (Shih OECD 'Education at a Glance' 2011 - Chapter D 'The Learning Environment and Organisation of Schools"

banimi urbane të pambuluara fare me institucione arsimore, duke e bërë të vështirë aksesin e nxënësve. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" rrezja e mbulimit me shërbimin parauniversitar në vijë ajrore duhet të jetë si më poshtë:

Për shkollat fillore dhe 9-vjeçare, rrezja e mbulimit në vijë ajrore:
- 500 - 600 metra në zona urbane
- 1000 – 1500 metra në zona rurale

Për shkollat e mesme, rrezja e mbulimit në vijë ajrore
- 1000 – 1500 metra në zona urbane
- 2000 – 4500 metra në zona rurale

Ky projekt synon zgjidhjen e problemeve të sipërpërmendura përmes ndërtimit të 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jënë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Më ndërtimin e këtyre shkollave të reja, në Tiranë nuk do të ketë më shkolla të mbushura mbi kapacitetin e tyre normal apo shkolla që e zhvillojnë mësimin me dy turne. Hartimi dhe zbatimi i këtij projekti është një element i rëndësishëm i programit politik të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për mandatin 2015-2019 dhe është në përputhje si me procesin e planifikimit kombëtar e sektorial ashtu edhe me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës.

Open Procurement Albania

2.1. Procesi i planifikimit kombëtar, rajonal, sektorial

Programi i ndërhyrjeve për zhvillimin e infrastrukturës së arsimit ka për qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve të arsimit parauniversitar në Bashkinë e Tiranës duke përmirësuar infrastrukturën fizike arsimore. Një nga sfidat kryesore që has sot arsimi parauniversitar në gjithë vendin është gjendja jo e mirë e infrastrukturës fizike të institucioneve arsimore. Kjo situatë është theksuar si një nga sfidat e sektorit të arsimit edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015 - 2020 (SKZHI) në të cilën theksohet se "*gjendja përgjithësisht e dobët e infrastrukturës fizike të ndërtesave shkollore pengon ofrimin e një arsimi cilësor në të gjitha nivelet"*[3]. Në Bashkinë e Tiranës ky problem është edhe më i mprehtë e nuk lidhet thjesht me kushtet bazë të godinave shkollore (si ndriçimi, ngrohja, hapësirat rekreative dhe sportive, etj.), por sidomos me shpërndarjen jo-efektive dhe aksesueshmërinë e dobët të objekteve shkollore, sidomos në zonat informale të kryeqytetit.

Duke nisur prej fillimit të viteve '90 e deri më sot, popullsia e Tiranës ka pësuar ndryshime radikale si pasojë e lëvizjeve të mëdha demografike. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it në vitin 1989, popullsia e bashkisë së vjetër të Tiranës ka qenë rreth 245 mijë banorë ndërsa sipas censusit të 2011-ës ajo thuajse ishte dyfishuar duke arritur në rreth 420 mijë. Tashmë, me

[3] Shih SKZHI II 2015-2020, fq. 129 "Gjendja aktuale e sistemit arsimor në përgjithësi në Shqipëri"

reformën e re territoriale, territorit të ri të Bashkisë Tiranë i janë shtuar edhe 13 ish-komuna, çka e ka trefishuar numrin e popullsisë rezidente duke e çuar në rreth 780 mijë banorë[4]. Por, përmirësimi i shërbimeve publike nuk ka mundur të ndjekë të njëjtin ritëm me rritjen e popullsisë dhe për këtë arsye shërbimet e tilla si ai i arsimit në qytetin e Tiranës vuajnë nga mbipopullimi. Adresimi i këtij problemi është kthyer në një nga prioritetet më kryesore dhe emergjente të Bashkisë së re të Tiranës.

Gjatë viteve të fundit, investimet në infrastrukturën arsimore parauniversitare të Tiranës kanë ardhur duke u rritur. Megjithatë, pavarësisht nevojës për shkolla të reja që diktohet nga rritja drastike e popullsisë së Tiranës dy dekadat e fundit, këto investime më së shumti janë fokusuar në rikonstruksionin e ambienteve shkollore ekzistuese për të përmirësuar kushtet e mësimit dhe arritjen e standardeve. Përmes programit të Qeverisë "Ndërtimi dhe Rehabilitimi i Shkollave"[5] me një financim të pjesshëm prej 12.4 milion € nga Banka e Këshillit të Europës, i cili filloi të zbatohet në vitin 2005, në kryeqytet janë ndërtuar 7 shkolla të reja (4 të ciklit të mesëm të ulët dhe 3 gjimnaze) si dhe janë rehabilituar ambientet e 12 shkollave të tjera (9 të ciklit të mesëm të ulët dhe 3 gjimnaze). Nga ky program u arrit përmirësimi i normave akademike dhe ambienteve fizike të shkollave prej të cilave përfituan rreth 17.000 nxënës dhe rreth 1.000 mësues.

Nga vetë të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në 10 vitet e fundit, siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, shpenzimet kapitale për investimet në arsim kanë qëne rreth 2 miliard lekë nga të cilat vetëm në vitin 2015 dhe tre mujorin e parë të vitit 2016 janë investuar rreth 460.1 milion lekë ose 23% e gjithë investimeve për 10 vite.

Procurement Albania

[4] Sipas Gjendjes Civile 2016.
[5] https://www.coe.int/t/dg4/epas/Source/Tirana/CEB-note-info_EN.pdf

Figura 1 - Shpenzimet kapitale për arsimin gjatë 10 viteve të fundit



2.2. Bashkërendimi me politikat kombëtare dhe sektoriale

Edhe pse deri tani janë bërë një sërë investimesh në shumë nga institucionet e arsimit parauniversitar në Tiranë, nevoja për përmirësimin e mëtejshëm dhe rritjen e kapaciteve me ndërtimin e objekteve të reja mbetet një domosdoshmëri.

Ky projekt bazohet në vizionin që ka Bashkia e Tiranës në drejtim të sektorit të arsimit i cili synon *të ofrojë një infrastrukturë moderne të institucioneve arsimore, por që bazohet në plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve në Tiranë, për të garantuar rritjen e cilësisë së mësimdhenies, sigurimit të standardeve dhe aksesit më të lartë nga të gjithë grupet e në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe kthimin e institucioneve arsimore në qendra të rëndësishmë komunitare.*

Ky vizion mbështetet edhe në vizionin e Qeverisë të shprehur si në kuadrin strategjik kombëtar, "**Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015–2020"** edhe në "**Strategjinë për Arsimin Parauniversitar 2014-2020"**, ku theksohet nevoja për të siguruar një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë nxënësit, edukimi i të cilëve përbën një nga investimet më thelbësore për zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Politikat e Bashkisë së Tiranës në këtë drejtim udhëhiqen pikerisht nga ky kuadër strategjik.

SKZHI[6] ka përcaktuar si një objektiv të rëndësishëm në politikat e Qeverisë lidhur me arsimin parauniversitar, **përmirësimin e shërbimit "Arsim cilësor për të gjithë" nëpërmjet, azhornimit dhe krijimit të infrastrukturës në kopshtet dhe shkollat e reja dhe ekzistuese, në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë aksesin për fëmijët me aftësi të kufizuar.**

Nga ana tjetër, **Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2014-2020** thekson se një nga sfidat e mëdha në këtë sektor është niveli jo i kënaqshëm i financimit të arsimit parauniversitar, kundrejt objektivave të miratuara në programin e Qeverisë, për të realizuar funksionet e përcaktuara me ligj. Për të adresuar këtë sfidë "***Mbështetja komunitare***: *si e mirë publike dhe vetjake, duhet të sigurohet* ***përmes mbështetjes financiare nga të gjitha burimet e mundshme të shoqërisë****,"* përcaktohet si një nga parimet udhëheqese të jetësimit të vizionit të strategjisë.

Pra, përveç financimit të këtij sektori nga fondet publike, si kontribute të qeverisë qendrore apo buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore, strategjia parashikon edhe mobilizimin e partneritetit publik privat dhe hartimin e politikave për nxitjen dhe tërheqjen e fondeve nga sektori privat[7].

Reforma administrative territoriale e rrit rolin e bashkive në drejtim të zbatimit të funksioneve të përbashkëta, siç është edhe sistemi i arsimit parauniversitar dhe vendos një objektiv shumë të rendësishëm për njësitë e qeverisjes vendore - atë të "*sigurimit të cilësisë së shërbimeve sipas standardeve dhe politikave kombëtare"*[8]. Në kuadrin e programit "shkollat si qendër komunitare" strategjia përcakton se bashkitë do të jenë autoriteti kryesor në zbatimin e këtij programi nëpërmjet instrumenteve dhe veprimtarive me institucionet arsimore.

2.3. Bashkërendimi me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës

Ky projekt bazohet dhe orientohet nga katër shtyllat kryesore të vizionit të ri të zhvillimit të Tiranës të përcaktuar në dokumentin e Planit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë së Tiranës, "Tirana 2030".

Open Procurement Albania

[6] Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014 -2020, Parimet Udheheqëse, fq 28

[7] Strategjia për Zhvillimin e Arsimin Parauniversitar 2014 -2020 Përsosja e Qeverisjes, e Udhëheqjes dhe e Menaxhimit të Kapaciteteve dhe Burimeve, fq 29

[8] Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Lokale 2015-2020, Funksionet e Perbashketa, fq 33

Figura 2 Shtyllat kryesore të zhvillimit për Tiranën

Këto shtylla udhëhiqen gjithashtu nga parimi i zhvillimit të qëndrueshëm të kryeqytetit i cili do të orientojë politikat e investimeve të bashkisë në mënyrë që ti përgjigjën vizionit të mësipërm për zhvillimin e Tiranës. Në kuadrin e arsimit parauniversitar, ky studim është në linjë me këtë vizion duke siguruar një infrastrukture arsimore lehtësisht të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe që i përgjigjet synimit të një qyteti policentrik dhe 'smart'.

Nevoja për ndërtimin e shkollave të reja të arsimit parauniversitar është përmendur si pikë e rëndësishme edhe në planet e mëparshme të zhvillimit të bashkisë së vjetër të Tiranës. Në Planin e Përgjithshëm Vendor të vitit 2013, disa zona u evidentuan si më problematiket e kryeqytetit, të cilat kishin mangësi në mbulimin e tyre me infrastrukturën e duhur arsimore parauniversitare. Këto zona janë kryesisht të shtrira në pjesët periferike të Tiranës dhe janë gjithashtu zona informale të cilat janë mbipopulluar me kalimin e viteve si pasojë e migrimit të brendshëm. Në PPV-në e 2013-ës u propozua ndërtimi i 25 shkollave të ciklit 9-vjeçar dhe 6 shkolla të ciklit të mesëm. Pjesa më e madhe e propozimeve për sheshet e ndërtimit shtrihej në pjesët veriore, perëndimore dhe lindore të kryeqyeqytetit të cilat janë dhe ato më problematiket. Propozimet e këtij plani kanë synuar kryesisht që të mbulojnë të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë me rrezet e shërbimit të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, por nuk është thelluar me një analizë të indikatorëve të tjerë si numri i nxënësve/klasë apo indikatorë të tjerë sektorial. Gjithashtu PPV-ja ka përcaktuar zonat ku duhet të parashikohen shkollat e reja por nuk ka ardhur me propozime konkrete në nivel trualli (parcele). Konkretisht, në këtë PPV janë parashikuar shkollat si mëposhtë:

- 3 shkolla 9-vjeçare në njësinë nr.1
- 2 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkolle të mesme në njësinë nr.2
- 1 shkollë 9-vjeçare në njësinë nr.3
- 2 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme në njësinë nr.4
- 2 shkolla 9-vjeçare në njësinë nr.5
- 4 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme në njësinë nr. 6
- 3 shkolla 9-vjeçare në njësinë nr.7,
- 2 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkolle të mesme në njësinë nr. 8
- 3 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkolle të mesme në njësinë nr. 9
- 3 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkolle të mesme në njësinë nr.11

Harta 1-Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare të propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të vitit 2013 të Bashkisë Tiranë



Harta 2 - Shpërndarja e shkollave të mesme të propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të vitit 2013 të Bashkisë Tiranë

Për periudhën 2015-2017, nga Fondi i Zhvillimit Rajonal janë parashikuar të financohen rreth 867 milion lekë, për objekte shkollore ku FZHR do të mbulojë rreth 59% të vlerës totale të investimeve dhe bashkia rreth 41% të saj ose rreth 357 milion lekë[9]. Kjo tregon që investimet në këtë sektor janë ende minimale në krahasim me nevojat e mëdha dhe urgjente të bashkisë për adresimin e situatës së mbipopullimit të shkollave dhe ofrimit të infrastrukturës arsimore në ato zona ku ka mangësi.

2.4. Përparësitë e politikave

Në programin politik të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin qeverisës 2015-2019, theksohet se "mbipopullimi i kopshteve dhe shkollave ka ndikuar në uljen e cilësisë dhe standardeve që ofrojnë këto institucione."[10] Një kopësht në kryeqytet u shërben mesatarisht 198 fëmijëve ndërsa një shkollë ka mesatarisht 819 nxënës, ndërkohë që në rang vendi ky raport është 44 fëmijë për kopësht dhe 276 nxënës për çdo shkollë. Ndërtimi i shkollave dhe kopshteve të reja, për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit dhe të mësimit me dy turne është një nga angazhimet më të rëndësishme të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Ky angazhim politik është reflektuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, ku theksohet se një nga prioritetet kryesore të kësaj PBA-je është eleminimi i mësimit me dy turne.[11] Për jetësimin e këtij prioriteti, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, u vendos edhe Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila do të paguhet nga të gjitha familjet, personat juridikë e fizikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Tiranë. Mbledhja e kësaj takse ka filluar që në vitin 2016 dhe parashikohet të mblidhet për 7 vjet. Në Relacionin që shoqëron këtë Vendim të Këshillit Bashkiak thuhet shprehimisht se të ardhurat e sigurara nga kjo taksë do të përdoren vetëm me synimin për t´i dhënë fund mësimit me dy turne, përmes ndërtimit të shkollave të reja dhe, nëse do ketë hapësirë fiskale edhe për rikonstruksionin e shkollave ekzistuese. Të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë parashikohet të jenë 630,000,000 lekë në vitin 2016, 690,000,000 lekë në vitin 2017 dhe 720,000,000 lekë në vitin 2018.

Megjithatë të ardhurat e mbledhura gjatë tre viteve të para të aplikimit të taksës, nuk janë të mjaftueshme për të realizuar ndërtimin e gjithë objekteve arsimore të nevojshme menjëherë. Ndërkohë që gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015 dhe vitit 2016, përmes nismave të ndryshme dhe fondeve të vetë Bashkisë Tiranë, janë rikonstruktuar tërësisht të gjitha çerdhet dhe një pjesë e mirë e kopshteve, për ndërtimin e shkollave të reja kostot janë shumë të larta dhe të papërballueshme për buxhetin e Bashkisë. Rrjedhimisht, për ndërtimin e shkollave të reja të nevojshme është menduar përdorimi i mënyrave alternative të financimit, si Partneriteti Publik Privat. Financimi përmes partneritetit publik privat mund të konsiderohet si alternativë, me

[9] Plani Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 i Bashkisë Tiranë

10 Kontrata me Tiranën, f. 26.

11 Bashkia e Tiranës, Programi Buxhetor Afatmesëm 2016-2018. Relacioni, Pjesa I, f. 5.

qëllim realizimin e infrastrukturave arsimore të nevojshme në një afat kohor sa më të shkurtër, duke financuar investimet përmes partnerëve privatë, ndërkohë që shlyerja e këtyre investimeve mund të bëhet në një hark kohor më të gjatë, duke shfrytëzuar të ardhurat që do të mbledhë bashkia përmes takësës së përkohëshme për infrastrukturën arsimore apo edhe të ardhurave të tjera të adresuara për sektorin e arsimit parauniversitar. Gjatë viteve të fundit ky partneritet shihet gjithmonë e më shumë si një nga mënyrat më efektive për ofrimin e atyre shërbimeve publike për të cilat qeveritë lokale si dhe ato qëndrore nuk mund ti përballojnë me resurset e tyre[12].

Disa aspekte të cilat identifikojnë rolin e rëndësishëm të partneritetit publik privat janë:

- sigurimi i kapitalit shtesë të nevojshëm;
- identifikimin më të mirë të nevojave dhe shfrytëzimin optimal të burimeve;
- sigurimin e vlerës së shtuar ndaj publikut dhe konsumatorit;
- sigurimin e aftësive alternative menaxheriale dhe zbatuese.

2.5. Përshkrim i përgjithshëm i gjendjes ekzistuese infrastrukturore

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, popullsia e qytetit të Tiranës në 25 vitet e fundit është dyfishuar si rezultat i migrimit të brendshëm nga zonat urbane dhe rurale të të gjithë Shqipërisë. Kjo shifër në realitet është akoma më e lartë, si rezultat i lëvizjeve të vazhdueshme dhe të pa raportuara të popullsisë. Zhvillimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar i qytetit gjatë këtyre viteve ka sjellë zgjerimin e tij, duke krijuar zona informale pothuajse në të gjithë hapsirën periferike të qytetit të Tiranës dhe rritur dendësinë e popullsisë në zonat urbane tradicionale të tij.

Me gjithë zhvillimin e madh dhe të vrullshëm të qytetit, realizimi i investimeve të mëdha në fushën e ndërtimit ka qenë i njëanshëm, kryesisht në fushën e banesave dhe të objekteve ekonomike. Ai nuk është shoqëruar me përmirësimin progresiv të infrastrukturës arsimore në përgjithësi duke sjellë mungesa të theksuara, si në qendrën urbane tradicionale, ashtu edhe në zonat e urbanizuara rishtazi në periferi të qytetit të Tiranës apo zonat rurale përreth saj.

Në këtë mënyrë, është krijuar një raport jo i drejtë midis funksioneve të zonave, sidomos midis atyre të qendrës dhe atyre periferike. Edhe shumica e ndërhyrjeve të realizuara në infrastrukturën arsimore që janë bërë gjatë viteve të fundit, kanë qenë të pjesëshme, janë shoqëruar në përgjithësi me ndërtimin e shtesave në godinat ekzistuese për të plotësuar ambientet, dhe rrallë herë kanë konsistuar në ndërtimin e institucioneve të reja arsimore. Për pasojë funksionimi aktual i objekteve arsimore rezulton i sforcuar.

Në shumicën e institucioneve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme të Bashkisë së Tiranës kushtet e mjediseve mësimore dhe ambienteve rekreative shfaqin një shkallë të lartë amortizimi, si pasojë

12 Ligji Nr. 125/2013 "PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT" Neni 4 " Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike private", pika dh) shkencë dhe arsim

e mungesës së ndërhyrjeve periodike për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre. Por çka është më e rëndësishme, kapaciteti i infrastrukturës arsimore, administrimi i tyre, shpërndarja në territor dhe elementë të tjerë që ndihmojnë në vlerësimin e ofrimit të këtij shërbimi paraqesin karakteristika të ndryshme në zonën urbane dhe në atë rurale të Bashkisë.

Në zonën urbane të Bashkisë Tiranë (Njësitë administrative 1-11), mbipopullimi i klasave dhe kryerja e mësimit me 2 turne mbetet një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve dhe bashkisë. Dëndësia e klasave në shumë raste nuk është optimale; me mesataren e cila varion nga 36.5 nxënës/klasë fizike në zonat urbane, në 18.8 nxënës/klasë fizike në zonat rurale. Raporti nxënës/klasë fizike i shkollave urbane e tejkalon maksimumin e parashikuar prej 30-35 nxënës/klasë në legjislacionin sektorial përkatës. Madje në disa shkolla kjo mesatare arrin deri në 65.8 nxënës/klasë fizike, duke detyruar administratorët e këtyre institucioneve ta organizojnë mësimdhenien me dy turne. Për më tepër, këto të dhëna tejkalojnë ndjeshëm mesataren e rekomandueshme të BE-së apo niveleve të shteteve fqinje siç raportohet nga OECD[13].

Në hartën më poshtë shohim numrin e nxënësve për klasë fizike për shkollat 9-vjeçare sipas Njësive Administrative. Njësitë më problematike sa i përket këtij raporti janë Njësia nr. 6 me raport 49.8 nxënës për klasë fizike, Njësia nr. 10 me 41.5 nxënës për klasë fizike, Njësia nr. 9 me 40.6 nxënës për klasë fizike, për të vazhduar me Njësitë nr. 2, nr. 5, nr. 8 dhe nr. 11 që kanë të gjitha një raport prej mbi 35 nxënës për klasë fizike. Në shumicën e rasteve, këto mesatare i referohen shkollave të cilat për shkak të këtij mbipopullimi e zhvillojnë mësimin me dy turne.

Open Procurement Albania

13 OECD 'Education at a Glance' 2011 - Chapter D 'The Learning Environment and Organisation of Schools

Harta 3 - Nr. mesatar i nxënësve për klasë fizike sipas Njësive Administrative për shkollat 9-vjeçare



Procurement Albania

Harta 4 - Nr. mesatar i nxenesve për klase fizike sipas në zonën urbane dhe NjA përreth për shkollat 9-vjeçare



Procurement Albania

Situata e mbipopullimit të shkollave paraqitet problematike edhe në lidhje me numrin e nxënësve për klasë fizike në shkollat e mesme. Njësitë Administrative që e vuajnë më shumë këtë problem janë Njësia nr. 2 me një raport prej 50 nxënësish për klasë fizike dhe njësia nr. 9 ku ky raport është 46.5 nxënës për klasë fizike. Edhe njësite e tjera administrative si, njësia nr. 7, 6, 5, 10 dhe Farka janë të prekura nga ky problem, ndonëse në një shkallë më të moderuar.

Harta 5 - Nr. mesatar i nxënësve për klasë fizike sipas Njësive Administrative për shkollat e mesme



Albania

Harta 6 - Nr. mesatar i nxenesve për klase fizike sipas në zonën urbane dhe NjA përreth për shkollat e mesme



Procurement Albania

Në Bashkinë Tiranë, në zonën urbane 66% e shkollave 9 vjeçare dhe 14.2% e shkollave të mesme zhvillojnë mësimin me dy turne. Konkretisht njësitë më problematike në këtë aspekt mbeten: **Njësia 2** (me 63 klasa mësimore të ciklit 9-vjeçar dhe 18 klasa mësimore të ciklit të mesëm që operojnë gjatë turnit të dytë); **Njësia 6** (me 72 klasa mësimore të ciklit 9-vjeçar që operojnë gjatë turnit të dytë) dhe; **Njësia 9** (me 50 dhe klasa mësimore të ciklit 9-vjeçar dhe 17 klasa mësimore të ciklit të mesëm që operojnë gjatë turnit të dytë).

Ndërsa në zonat peri-urbane dhe rurale, 2.5% e shkollave të ciklit të ulët, 19% e shkollave 9-vjeçare, 33.3% e shkollave të mesme (1 nga 3) dhe 23% e shkollave të mesme të bashkuara zhvillojnë mësimin turn i dytë, kryesisht në Njësitë Administrative Dajt, Farkë, Kashar dhe Vaqarr.

Deri diku problemin e mbipopullimit apo mësimit me 2 turne e kanë lehtësuar shtesat e ndërtuara gjatë viteve në godinat ekzistuese, por nga ana tjetër këto shtesa kanë reduktuar sipërfaqen e oborreve, ambienteve sportive të jashtme apo hapësirave të gjelbërta. Mbi 90% e shkollave të Tiranës evidentohet të kenë mangësi përsa i përket sipërfaqeve dhe cilësisë së ambienteve të jashtme (oborreve), gjë e cila ndikon në cilësinë e përgjithshme të performancës së nxënësve në shkollë. Përvec kësaj, në një numër të konsiderueshëm të godinave vihen re mungesa të elementëve të sigurisë së nxënësve, mbrojtjes nga zjarri, e rampave për personat me aftësi të kufizuar, çka evidenton edhe më tej problemin e gjithëpërfshirjes dhe aksesueshmërisë së

limituar të shkollave në Tiranë. Ndaj ndërhyrje të kësaj natyre, rezultojnë të kenë ndikim të limituar dhe afatshkurtër në zgjidhjen e problemeve të mbipopullimit të shkollave, duke e bërë të domosdoshme nevojën për të planifikuar dhe realizuar ndërhyrje në zgjidhje më afatgjata dhe të qëndrueshme.

Nga ana tjetër, situata në zonat rurale paraqitet ndryshe. Me përjashtim të disa rasteve, në zonat rurale pjesa më e madhe e shkollave nuk shfrytëzojnë maksimalisht kapacitetin e tyre si rezultat i numrit të ulët të nxënësve. Për këtë arsye, në shumë shkolla funksionojnë klasat kolektive, sipas udhëzimeve të MAS.

Në të dyja rastet, sidomos në zonat periferike urbane dhe në zonat rurale, ka lagje të banuara të cilat nuk mbulohen nga rrezja e shërbimit të institucioneve arsimore parauniversitare, siç përcaktohen në standardet e parashikuara në Rregulloren e Planifikimit të Territorit (VKM nr. 671). Sipas këtyre standardeve, rrezja e mbulimit duhet të jetë 500m për shkollat 9-vjeçare urbane, 1000m për shkollat 9-vjeçare rurale, 1000m për shkollat e mesme urbane dhe 2000m për shkollat e mesme rurale. Por, siç mund të shihet nga hartat më poshtë në shumë prej zonave të reja të banimit të Tiranës, pavarësisht se dëndësia e banimit është e lartë, infrastruktura arsimore mungon. Më problematike situata është në zonën e Unazës së Re dhe Yzberishtit, në Njësinë Administrative Kashar, në Zonën e Freskut në Njësinë Administrative Dajt, në zonën e Shkozës në Njësinë Administrative Nr. 1, në zonën e Saukut në Njësinë Administrative nr. 2, në pjesën e urbanizuar të Njësisë Administrative Farkë si edhe në një pjesë të madhe të Njësive Administrative nr. 8 dhe nr. 9.

Në të gjitha zonat e sipërpërmendura, largësia e shkollave nga qendrat e banuara është shumë herë më e madhe se sa standardi i lejuar. Rrjedhimisht, nxënësit e këtyre zonave detyrohen të shfrytëzojnë mjetet e transportit publik – në rast se ka në afërsi të tyre, të transportit privat ose të ecin për distanca relativisht të gjata, në kushtë atmosferike jo gjithmonë të favorshme.

Open Parliament Albania

Harta 7 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-vjeçare



Harta 8 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme



Në lidhje me cilësinë e përgjithshme fizike të institucioneve arsimore ekzistuese, një pjesë e tyre janë amortizuar, me kalimin e viteve dhe tashmë kanë nevoje për ndërhyrje të menjëhershme. Disa prej tyre kanë probleme me plotësimin e kushteve më bazë të mësimdhënies pasi gjendja e mureve të shkollës, tualeteve, çative etj, është emergjente. Një numër i madh i shkollave të cilat janë rikonstruktuar pas viteve 90 kanë një nevojë sërish për t'u rikonstruktuar nga fillimi pasi punimet mund të mos kenë qenë të plota, të mjaftueshme apo cilësore. Situata paraqitet disi më mirë për shkollat e rikonstruktuara pas vitit 2004 ku shumica prej tyre janë pajisur me sistemin e ngrohjes qëndrore edhe pse në mjaft prej tyre ky sistem ka dalë jashtë funksionit. Një pjesë e madhe e godinave shkollore ka probleme me sistemin e ndriçimit, kullimin e ujërave të bardha dhe të zeza dhe lagështirën e cila është e përhershme edhe në ato shkolla ku ngrohja qëndrore është funksionale. Ndonëse rikonstruksionet e pjesshme ose të plota të objekteve ekzistuese arsimore nuk janë objekt i këtij studimi, Bashkia Tiranë do të vazhdojë të planifikojë ndërhyrjet rehabilituese në këto objekte vit pas viti, përmes projekteve të veçanta me këtë fokus.

2.6. Objektivat e projektit

Arsimimi është një mjet i fuqishëm që i siguron njerëzve aftësitë për të konkuruar në tregun e punës si dhe për të krijuar mundësi më të mira jetese. Jo pa qëllim, në strategjitë e qeverisë shqiptare si "Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015–2020" dhe "Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2014-2020" edukimi i fëmijëve përbën një nga investimet thelbësore për zhvillimin e shoqërisë. E konsideruar si një e drejtë themelore, përgjegjësia për sigurimin e arsimimit i takon sektorit publik. Bashkia e Tiranës ka për qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve të arsimit parauniversitar duke përmirësuar infrastrukturën fizike arsimore, përmes rritjes së kapaciteteve të kësaj infrastrukture.

Open Procurement Albania

Nga analiza e gjendjes aktuale të infrastrukturave arsimore, në Bashkinë e Tiranës rezulton që arsimi parauniversitar përballet me probleme të mëdha. Nisur nga dinamikat e zhvillimit të qytetit dhe zonave suburbane, nevoja për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturave ekzistuese është bërë gjithmonë e më e domosdoshme. Ndër problemet që kërkojnë zgjidhje urgjente janë numri i madh i nxënësve për klasë, klasat me dy turne, aksesi i dobët si dhe kushtet jo të përshtatshme të godinave arsimore.

Objektivat që synon të arrijë ky projekt janë si më poshtë:

1. **Eliminimi i mësimit me dy turne** - Një pjesë e mirë e shkollave parauniversitare në Bashkinë Tiranë punojnë me dy turne. Me ndërtimin e shkollave të reja nxënësit do të kenë në dizpozicion hapësira shkollore që do të operojnë jo më mbi kapacitet;
2. **Normalizimi i raportit nxënës për klasë** – Objektivi është që mesatarisht të arrihet raporti 30 nxënës për klasë;
3. **Përmirësimi i aksesit –** Në disa zona të Tiranës të cilat vitet e fundit janë popullluar shumë mungojnë objektet arsimore dhe si rrjedhim nxënësit duhet të udhëtojnë në distanca shumë më të mëdha se sa parashikohet në standardet e miratuara. Ky projekt, duke i ndërtuar shkollat e reja në zona të pambuluara me institucione arimore, ka si objektiv përmirësimin e aksesit të nxënësve në përputhje me standardet.
4. **Përmirësim i kushteve mësimore** – Godinat e reja që do të ndërtohen do të jenë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si, palestra, laboratorë, mjedise rekreative apo dhe mensa;

5. **Përmirësim i cilësisë së mësimdhënies** - Me klasa më një numër më të vogël nxënësish, mësuesit do ta kenë më të lehtë të menaxhojnë procesin mësimor duke u kushtuar më shumë vemendje nxënësve dhe nxënësit, nga ana e tyre, do ta kenë më të lehtë të përqëndrohen gjatë zhvillimit të mësimit;
6. **Rivitalizim i zonave ku do të ndërtohen godinat shkollore** - Duke qenë se shkollat e reja do të ndërtohen në zonat periferike në të cilat mungojnë institucionet, ato do të kthehen në pika referimi dhe qendra të zhvillimit të aktiviteteve sociale, çka do të rivitalizojë zonat në fjalë, edhe me ndihmën e projekteve të tilla si "Shkolla si Qendër Komunitare".

2.7. Përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti

Rritja e kërkesës dhe nevojës për cilësi në arsim, ndeshet me kontraditën e ekzistencës së limituar të fondeve publike të nevojshme për realizimin e disa prej projekteve publike strategjike, sidomos ato që lidhen me investime kapitale. Pamundësia buxhetore për plotësimin e këtyre nevojave apo kërkesave ka bërë që partneritetet publike private të shihen si një burim i rëndësishëm për financimin e investimeve publike. Momentalisht, sektori i arsimit parauniversitar në gjithë Shqipërinë, por sidomos Bashkinë e Tiranës, ka nevoja shumë të mëdha për investime kapitale në drejtim të ndërtimit të godinave të reja shkollore dhe përmirësimit të kushteve të godinave ekzistuese. Duke qenë se kapitali i nevojshëm për t'u investuar në këtë drejtim është mjaft i madh krahasuar me mundësitë aktuale të Bashkisë së Tiranës, alternativat e financimit si PPP duhen vlerësuar si mundësi për zgjidhjen e disa problemeve emergjente.

Open Procurement Albania

Në këtë prizëm përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga ky projekt janë si më poshtë:

1. **Eleminimi i mësimit me dy turne.** Një nga qëllimet kryesore të projektit është shmangia e mësimit me dy turne. Mësimi gjatë turnit të dytë nuk është i rekomandueshëm pasi ul nivelin e përqëndrimit të nxënësve në mësim dhe, si rrjedhim, performancën e tyre në shkollë[14]. Eleminimi i turnit të dytë do sillte gjithashtu përfitime për mësuesit si dhe për prindërit të cilët e kanë më të vështirë shoqërimin e fëmijëve në shkollë për shkak të përplasjes me orarin e punës. Së fundmi, me eleminimin e turneve të dyta shmanget edhe mbipërdorimi i shkollave çka bën që procesi i amortizimit të shkollave të jetë më i ngadalshëm dhe të ulen edhe kostot e mirëmbajtjes. Me realizimin e këtij projekti do të përfitojnë në mënyrë direkte rreth 12,390 nxënës, të cilët aktualisht e zhvillojnë mësimin në turnin e dytë ose në klasa të tejmbushura.
2. **Godina të reja dhe cilësore të cilat përmbushin standardet e BE-së.** Nëpërmjet investimit në infrastrukturën arsimore parauniversitare, do mundësohet që shkollat e reja të projektohen që në fillim sipas standardeve të BE-së duke siguruar që çdo shkolle të përfshije elementet e mëposhtme:

[14] The Revieë of Economics and Statistics - "Hoë the time of day affects productivity: evidence from school schedules", March 2016.

- *Kushtet cilësore të godinave.* Projekti parashikon që godinat e shkollave të reja të jenë më të mirë-izoluara në krahasim me shkollat ekzistuese duke reduktuar në këtë mënyrë edhe kostot e ngrohjes/ftohjes së ambienteve. Gjithashtu ato duhet të përfshijnë një sistem cilësor ngrohjeje, ndriçimi, hidro-sanitar etj., kushte këto të cilat ndihmojnë në kryerjen e mësimit sipas standardeve të caktuara.
- *Sigurinë e nxënësve.* Çdo shkollë do të përmbushë standardet e sigurisë nga zjarri apo tërmetet, do të jetë e pajisur me dalje emergjence dhe me elemente të tjera sigurie sipas standardeve të nevojshme.
- *Ambiente të përshtatshme për kurikulat mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit.* Shkollat e reja duhet të jenë të pajisura me laboratore, salla IT, salla muzike, ambiente sportive etj., në bazë të kurikulave.
- *Akses i lehtë nga personat me aftësi të kufizuar.* Projekti ka si kusht themelor sigurimin e gjithë lehtësirave të nevojshmë për mundësimin e aksesit të ambienteve të shkollave nga personat me aftësi të kufizuar.
- *Shkolla tërheqëse dhe kreative.* Përveç elementëve të cilësisë dhe sigurisë projekti synon gjithashtu që shkollat të jenë më terheqese nga pikëpamja e projektimit për mundësuar në këtë mënyrë ambiente më stimuluese dhe shlodhëse, çka nga ana tjetër ndihmon në nxitjen e kreativitetit të nxenesve dhe rritjen e interesit të tyre gjatë procesit të nxënies. Së bashku me përfitimet në lidhje me performancën mësimore, shkollat tërheqëse ndikojnë gjithashtu pozitivisht në gjallerimin e zonës dhe komunitetit përreth tyre. Një shëmbull i mirë në këtë aspekt dhe më pranë realitetit të Tiranës vjen nga Projekti i suksesshëm i "Urbanizimit Social" të qytetit të Medellin në Kolumbi[15]. Në kuadër të këtij projekti gjatë 10 viteve të fundit në Medellin janë ndërtuar dhe rikonstruktuar një numër i konsiderueshëm shkollash tërheqëse dhe kreative. Qëllimi kryesor i projektit ka qenë luftimi i varfërisë në komunitete nëpërmjet edukimit cilësor të fëmijëve si dhe duke sjellë më shumë gjallëri dhe zhvillim në zonat përreth shkollave. Duke qenë se Bashkia e Tiranës ndeshet me thuajse të njëjtat sfida dhe objektiva, adoptimi i shembullit të Medellin mund të jetë një histori suksesi edhe për kryeqytetin Shqiptar.

Open Procurement Albania

[15] Calderon, C. (2012) - "Social Urbanism - Participatory urban upgrading in Medellin, Colombia", in Laërence, Yildiz & Kellett (ed.) "Requalifying the Built Environment: Challenges and Responses". Hogrefe Publishing, Göttingen

Figura 3 - Pamje nga ambientet e disa shkollave në Medellin, Kolumbi

Open Procurement Albania

3. **Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.** Me zgjidhjen e problemit të mbipopullimit dhe ofrimin kushteve të përshtatshme për kryerjen e mësimit, krijimin e laboratoreve e këndeve sportive, rritet edhe cilësia e mësimit nga njëra anë, por edhe performanca e nxënësve në shkollë, nga ana tjetër. Nga ky projekt do të bëhët e mundur që të gjithë nxënësit që sot zhvillojnë mësim në turnin e dytë apo në klasa të mbipopulluara të përfitojnë një mësimdhënie më cilësore.
4. **Sistem arsimor lehtësisht i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës.** Një ndër problemet kryesore të arsimit parauniversitar në Tiranë është edhe mungesa e shkollave në disa zona periferike të kryeqytetit. Nxënësit që banojnë në këto zona janë të detyruar të udhëtojnë për një kohë më të gjatë për të shkuar në shkollë, ç'ka shkakton vështirësi për ata vetë dhe familjarët e tyre. Në të njëjtën kohë, regjistrimi i këtyre nxënësve në shkollat e njësive të tjera është një ndër arsyet kryesore të mbipopullimit të shkollave. Për këtë arsye, një ndër përfitimet strategjike kryesore që do vijë nga ky projekt do jetë edhe ai i shpërndarjes dhe mbulimit më optimal me godina arsimore të atyre njësive të cilat vuajnë nga mangësia apo mbipopullimi i shkollave.
5. **Plotësimi i gjithë nevojave dhe kushteve për përfshirjen e nxenesve të territorit të bashkisë së Tiranës në arsimin parauniversitar.** Nëpërmjet këtij projekti, synohet që nxënësve t'u krijohen kushtet e duhura në mënyrë që të shmanget apo ulet niveli i braktisjes së arsimit të detyrueshëm i cili me ligj është përcaktuar deri në përfundim të ciklit 9-vjeçar. Gjatë 10 vjeçarit të fundit numri i nxënësve që kanë braktisur arsimin bazë në gjithë shqipërinë është thuajse përgjysmuar[16]. Nga rreth

[16] "Vjetari Statistikor për Arsimin: 2013 – 2014 dhe seri kohore" – Ministria e Arsimit dhe Sporteve

4200 nxënës që kanë braktisur shkollën në vitet 2004-2005 gjithsej numri është ulur në rreth 2200 nxënës për vitet 2013-2014. Megjithatë nivelet e braktisjes mbeten shqetësuese. Ndër arsyet kryesore të këtij fenomeni mund të veçohen: mungesa apo largësia e shkollave në disa zona të caktuara çka demotivon frekuentimin; mbipopullimi i klasave dhe pamundësisa e mësuesve për t'iu dedikuar mjaftueshëm nxënësve problematikë; mungesa e kushteve për nxënësit me aftësi të kufizuara, etj.

6. **Shkollat si qendra komunitare.** Shkollat e reja do të ndërtohen duke pasur ndërmend edhe shfrytëzimin e tyre si qendra komunitare pas mësimit. Projekti synon të krijojë ambientet dhe kushtet e përshtatshme për shfrytëzimin e hapësirave të shkollave për iniciativa të ndryshmë në dobi të komunitetit. Terrenet sportive, por edhe mjediset e tjera të shkollave mund të përdoren pas mësimit për aktivitete të ndryshme komunitare, si kurse profesionale, mbrëmje poetike, aktivitete artistike, etj.
7. **Rimëkembja e industrisë së ndërtimit.** Për vite me rradhe industria e ndërtimit ka qenë motorri i ekonomisë shqiptare. E përqëndruar kryesisht në Tiranë, kjo industri ka disa vite që është përballur me një stanjacion. Një investim publik i këtyre përmasave, do të ndihmojë shumë ekonominë e qytetit duke ndikuar ndjeshëm edhe në rritjen e punësimit.
8. **Rritja e numrit të të punësuarve nëpër shkolla.** Me zbatimin e këtij projekti parashikohet të hapen një numër i konsiderueshëm vëndesh pune të përkohshme dhe të përhershme. Të punësuarit e përkohshëm do jenë zbatuesit e projektit dhe ndërtuesit e godinave ndërsa të punësuarit e përhershëm do jenë pjestarët e stafit të shkollave.
9. **Rritja e vleres se pasurive të paluajtshme pranë shkollave.** Një ndër kriteret kryesore që e bejnë një zonë të caktuar më të preferuar nga familjet për të jetuar është edhe shkalla e mbulimit të asaj zonë me shërbime të ndryshme sociale. Një ndër këto shërbime është edhe ai i arsimit. Për këtë arsye, kërkesat për vendbanime pranë shkollave janë më të larta dhe si rrjedhim edhe vlera e pronave përreth është më e lartë[17].
10. **Rritja e numrit të bizneseve rreth e rrotull shkollave dhe zhvillimi i zonës.** Tendenca e komuniteteve përreth shkollave për t´u zgjeruar krijon një proces zinxhir zhvillimi pasi motivon rritjen e numrit të bizneseve në ato zona, ç'ka si rrjedhim sjell edhe zhvillimin e zonës.
11. **Rritja e sigurisë në zonën përreth shkollave.** Me ndërtimin e shkollave dhe gjallërimin e zonës prej bizneseve përreth tyre krijohet një ambient më i sigurt për komunitetin për shkak se lëvizja në atë zonë është më e madhe si dhe ka më shumë kamera sigurie përreth.
12. **Komuniteti përfiton në menyrë indirekte prej edukimit të të rinjeve të zonës**. Vitet e para të arsimimit përcaktojnë gjithë performancën e mëvonshme arsimore të një nxënësi e më pas edhe karrierën e tyre. Duke përmirësuar cilësinë e kopshteve dhe shkollave, krijohet mundësia që fëmijët ta nisin "me këmbën e mbarë" çka do të bëjë që ata të kenë një performancë më të mirë akademike, duke u rritur në qytetarë më të edukuar e profesionistë më të kualifikuar.

[17] Këame Oëusu-Edusei, Jr., Molly Espey and Huiyan Lin (2007). Does Close Count? School Proximity, School Quality, and Residential Property Values. Journal of Agricultural and Applied Economics.

Open Procurement Albania

3. SITUATA AKTUALE

3.1. Legjislacioni

3.1.1. Arsimi parauniversitar si shërbim publik

Roli i Njësisë së vetëqeverisjes vendore në fushën e arsimit ka qenë i parashikuar në Ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ishfuqizuar). Sipas nenit 11, ndër funsionet e përbashkëta të Bashkive dhe komunave me pushtetin qendror është dhe funksioni për arsimin parashkollor dhe parauniversitar.

Sot, Ligji nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" në lidhje me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike iu jep përgjegjësi në territorin e juridiksionit të tyre për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale[18].

Gjithashtu duke iu referuar legjislacionit për arsimin parashikohet se Njësitë vendore janë përgjegjëse për ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e objekteve të arsimit parauniversitar. Kjo specifikohet tek Ligji 69/2012, Neni 28, pika 2:

Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;

b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;

c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;

ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

Gjithashtu në ligjin nr. 69/2012, janë më të detajuara si kompetencat e Ministrisë, p.sh. përcaktimi i numrit të nxënësve për klasë (Neni 26, pika 2.d), ashtu dhe ato Njësisë Arsimore Vendore e cila bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikim, realizim dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore.

3.1.2. Administrimi i institucioneve arsimore parauniversitare

- <u>Hapja e institucionit arsimor publik</u>

Hapja e institucionit arsimor publik është procesi i ngritjes dhe funksionimit, për herë të parë, e njërit prej institucioneve arsimore parauniversitare publike siç janë objektet arsimore parauniversitare.

Kriteret për hapjen e tyre përcaktohen nga VKM nr. 662 datë 8.10.2014 e cila parashikon që nisma për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar publik mund të merret nga njësia

[18] Ligji 139/2015 **Për vetëqeverisjen vendore** Kreun VII, neni 23, pika 11

bazë e qeverisjes vendore. Propozimi për hapje i paraqitet Ministrit përgjegjës për arsimin. Neni 5 përcakton se dokumentat që duhet të shoqërojnë propozimin janë:

a) Argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së institucionit arsimor publik.
b) Të dhëna për kontributin e njësisë bazë të qeverisjes vendore.
c) Të dhëna për kontributin e komunitetit të institucionit arsimor publik ose të biznesit/partnerëve socialë, ku pritet të hapet institucioni arsimor.
ç) Të dhëna për përmbushjen e kritereve të parashikuara në pikën 7, të këtij vendimi.

Në këtë VKM parashikohen **dy skenarë** në lidhje me afatet kohore se kur duhet të paraqitet propozimi:
- 3 muaj para fillimit të vitit arsimor nëse do të hapet në një godinë ekzistuese;
- 1 vit para fillimit të vitit arsimor nëse do të hapet në një godinë të re.

Kriteret që duhet të plotësojë objekti, të përcaktuara në pikën 7, kanë të bëjnë me përmbushjen e standardeve të ndërtesës dhe mjediseve të saj, sipas legjislacionit në fuqi, me lidhjen e ndërtesës me rrjetet e furnizimit ujë, energji elektrike, telefoni dhe internet, si dhe me sisteme ngrohje, pajisjen e ndërtesës me mjetet mësimore, garantimin e numrit të nxënësve për klasë sipas parashikimeve ligjore, si dhe garantimin e kualifikimit të stafit mësimor dhe administrativ.

- Regjistrimi i nxënësve

Regjistrimi, si rregull, bëhet në kopshtin dhe në shkollën e përcaktuar nga ndarja territoriale e vendbanimit e vendosur nga pushteti vendor me propozim të Drejtorisë Arsimore. Mund të ndodhë regjistrimi jashtë ndarjes teritoriale vetëm nëse e lejojnë kushtet dhe kapaciteti i ambienteve. Për këtë duhet miratimi i Drejtorit të shkollës.

Ndërsa **Dispozita Normative 2013** për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Neni 14 mbi "Klasat mbi normë në shkollat e arsimit parauniversitar" parashikon që Drejtori i shkollës nuk regjistron nxënës nga zonat që nuk i përkasin shkollës kur krijohen klasa me numër nxënësish mbi normën e lejuar.

- Numri i nxënësve për klasë

Në lidhje me numrin e nxënësve që duhet të kenë klasat i referohemi udhëzimit të MAS nr. 21, datë 23.7.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar me Udhëzimit nr 44 [19], datë 16.10.2014.

Tabela 1 - Standardi I MAS për nr. e nxënësve për klasë

Arsimi	Klasat	Nr. i nxënësve
	Klasa përgatitore	25

[19] Në mbështetje të Nenit 26, pika d, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Arsimi bazë	Klasa e parë	26 -30
	Klasat II-IV	30-35
Arsimi i mesëm i ulët		30-35
Arsim i mesëm i lartë		30-35

Ndarja e klasave paralele:
Për Arsimin bazë ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:
- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës (31-60 nxënës për klasën e parë);
- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës (61-90 nxënës për klasën e parë);
- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës (91-120 nxënë s për klasën e parë);
- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës (121-150 nxënës për klasën e parë).

Për Arsimin e mesëm të ulët:
- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës;
- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës;
- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës;
- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës.".

Për Arsimin i mesëm të lartë:
Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:
- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës;
- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës;
- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës;
- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës.".

Open Procurement Albania

- Mirëmbajtja e institucioneve arsimore parauniversitare

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore parauniversitare sikundër e kemi përmendur dhe më sipër me ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" si dhe me ligjin nr. 139/ 2015 për "Vetqeverisjen Vendore".

3.1.3. Planifikimi dhe ndërtimi i institucioneve arsimore parauniversitare

Në lidhje me planifikimin dhe ndërtimin e institucioneve arsimore parauniversitare, Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit", Neni 21 parashikon se Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) ka si një ndër objektivat e veta rregullimin e vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturat publike e servitutet publike.

VKM Nr. 671/2015, Neni 54 kërkon që PPV të përmbajë tipologjinë, cilësinë, shpërndarjen në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve. Në vijim të kësaj specifike është Neni 83 i cili përcakton Standardet minimale të planifikimit për strukturat publike të arsimit si vijon:

- Për shkolla fillore dhe 9-vjeçare:
i) llogaritet një shkollë çdo 6,000 banorë;

ii) rrezja e shërbimit të shkollës në vijë ajrore është 500-600 metra në zona urbane dhe 1,000-1,500 metra në zona rurale;
iii) në varësi të numrit të klasave, një shkollë planifikohet sipas 20 m2-25 m2/nxënës;
iv) në varësi të numrit të klasave, parcela e shkollës është 1,500 m2-7,000 m2 dhe përmban të gjitha shërbimet e parashikuara nga ministria përkatëse dhe legjislacioni i posaçëm.

- Për shkolla të mesme:
i) llogaritet një shkollë për çdo 9,000 banorë;
ii) si rregull bazë 1.5 m2/banor;
iii) rrezja e shërbimit të shkollës në vijë ajrore është 1,000-1,500 metra në zona urbane dhe 2,000-4,500 metra në zona rurale;
iv) në varësi të numrit të klasave, një shkollë planifikohet sipas 20 m2-30 m2/nxënës;
v) në varësi të numrit të klasave, parcela e shkollës është 2000 m2-7000 m2 dhe përmban të gjitha shërbimet e parashikuara nga ministria përkatëse dhe legjislacioni i posaçëm;
vi) nëse shkolla e mesme ka konvikt me 100-400 vende, parcela është 4,000 m2-9,000 m2 dhe planifikohet sipas 25-35 m2/nxënës

- Hapësirat e brendshme

Në **shkresën e datës 27/08/2015,** me subjekt "Mbi zbatimin e Udhëzuesit "Për projektimin e ndërtimeve shkollore, normat dhe standardet", me Nr. Protokolli 6205 që Ministria e Arsimit i ka drejtuar Bashkisë u kërkohet të gjitha subjekteve fizikë/juridike si dhe entiteteve publike dhe private, të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, dizenjimit dhe ndërtimit të objekteve të reja shkollore, apo në rehabilitimin e objekteve ekzistuese, të hartojnë dhe të marrin në dorëzim projektet në përputhje me normat dhe standardet e parashikuara në Udhëzuesin për Projektimin e Ndërtesave Shkollore.

Sipas këtij udhëzuesi vlerësimi i nevojave për hapësira për mësimdhënie dhe mbështetje edukative vlerësohet në bazë të:

a) Kurrikulumit;
b) Fondit javor të orëve mësimore;
c) Përqindjes së shfrytëzimit dhe kapacitetit të dhomave

Dhomat/zyrat e administratës dhe të shërbimeve përcaktohen sipas:

a) numrit të shfrytëzuesve dhe funksioneve të tyre.

Numri i tualeteve dhe hapësirave të tjera sanitare përcaktohet në proporcion me kapacitetin e përgjithshëm të shkollës (për shembull, për një tualet llogaritet një mesatare prej 30 nxënës).

Tabela 2 – Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	9-vjeçar	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	9-vjeçar	30	30	900	7.32	6588

Tipi 3	Rural	9-vjeçar	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

Sipërfaqet e nevojshme për nxënës dhe totale për secilin tip shkolle të përzgjedhur, detajohen në tabelat e mëposhtme, sipas standardeve të referuara nga Udhëzuesi "Për projektimin e ndërtimeve shkollore, normat dhe standardet", miratuar nga MAS:

Tabela 3- Standarde projektimi për shkollën e Tipit 1

	SHKOLLA STANDARDE PËR ARSIMIN BAZË (20 Klasa)	**TIPI 1 Urbane**	
	Niveli arsimor	3	Nivele
	Numri i cikleve (paraleleve)	2	Cikle
	Numri i Klasave	20	Klasa
	Numri i nxënësve/klasë	30	Nxënës në klasë
	Numri total i nxënësve	600	Nxënës
Ref.	**Hapësirat**	**Sipërfaqe neto**	**Sipërfaqe bruto**
A.	**MËSIMDHËNJA DHE MBËSHTETJA PEDAGOGJIKE**		
		2 cikle	**Nxënës:**
1.0	**Niveli Parafillor**	**2 Klasa**	**60**
	Sipërfaqe Totale	**281.3**	**315.0**
	M2/ nxënës	**4.7**	**5.3**
		2 cikle	**Nxënës:**
2.0	**Niveli Fillor**	**10 klasa**	**300**
	Sipërfaqe Totale	**1237.68**	**1386.20**
	M2/ nxënës	**4.13**	**4.62**
		2 cikle	**Nxënës:**
3.0	**Niveli i mesëm i ulët**	**8 Klasa**	**240**
	Sipërfaqe Totale	**2044.06**	**2309.79**
	M2/ nxënës	**8.52**	**9.62**
B.	**HAPËSIRAT E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**279.21**	**315.51**
	M2/ nxënës	**0.47**	**0.53**
C.	**SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**539.57**	**609.71**
	M2/ nxënës	**0.90**	**1.02**
	GRAND TOTAL		
	Sipërfaqe Totale	**4,381.77**	**4,936.21**
	M2 / nxënës	**7.30**	**8.23**

Open Procurement Albania

Tabela 4 - Standarde projektimi për shkollën e Tipit 2

	SHKOLLA STANDARDE PËR ARSIMIN BAZIK (30 Klasa)	**TIPI 2 Urbane**	
	Niveli arsimor	3	Nivele
	Numri i cikleve (paraleleve)	3	Cikle
	Numri i Klasëve	30	Klasa
	Numri i nxënësve/klasë	30	Nxënës në klasë
	Numri total i nxënësve	900	Nxënës
Ref.	**Hapësirat**	**Sipërfaqe neto**	**Sipërfaqe bruto**
A.	**MËSIMDHËNJA DHE MBËSHTETJA PEDAGOGJIKE**		
		3 Cikle	**Nxënës:**
1.0	**Niveli Parafillor**	**3 klasa**	**90**
	Sipërfaqe Totale	**401.6**	**449.8**
	M2/ nxenes	**4.5**	**5.0**
		3 Cikle	**Nxënës:**
2.0	**Niveli Fillor**	**15 Klasa**	**450**
	Sipërfaqe Totale	**1812.18**	**2029.64**
	M2/ nxenes	**4.03**	**4.51**
		3 Cikle	**Nxënës:**
3.0	**Niveli i mesëm i ulët**	**12 Klasa**	**360**
	Sipërfaqe Totale	**2527.81**	**2856.43**
	M2 / nxënës	**7.02**	**7.93**
B.	**HAPËSIRAT E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**279.21**	**315.51**
	M2 / nxënës	**0.31**	**0.35**
C.	**SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**827.57**	**935.15**
	M2 / nxënës	**0.92**	**1.04**
	GRAND TOTAL		
	Sipërfaqe Totale	**5,848.34**	**6,586.48**
	M2 / nxënës	**6.50**	**7.32**

Open Procurement Albania

Tabela 5 - Standarde projektimi për shkollën e Tipit 3

	SHKOLLA STANDARDE PËR ARSIMIN BAZIK (20 Klasa)	**TIPI 3 Rurale**	
	Niveli arsimor	3	Nivele
	Numri i cikleve (paraleleve)	2	Cikle
	Numri i Klasëve	20	Klasa
	Numri i nxënësve/klasë	24	Nxënës në klasë
	Numri total i nxënësve	480	Nxënës
Ref.	**Hapësirat**	**Sipërfaqe neto**	**Sipërfaqe bruto**
A.	**MËSIMDHËNJA DHE MBËSHTETJA PEDAGOGJIKE**		
		2 cikle	**Nxënës:**
1.0	**Niveli Parafillor**	**2 klasa**	**48**
	Sipërfaqe Totale	**220.2**	**246.6**
	M2/ nxenes	**4.6**	**5.1**
		2 cikle	**Nxënës:**
2.0	**Niveli Fillor**	**10 klasa**	**240**
	Sipërfaqe Totale	**745.32**	**834.76**
	M2/ nxenes	**3.11**	**3.48**
		2 cikle	**Nxënës:**
3.0	**Niveli i mesëm i ulët**	**8 klasa**	**192**
	Sipërfaqe Totale	**1964.01**	**2.219.34**
	M2 / nxënës	**10.23**	**11.56**
B.	**HAPËSIRAT E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**238.62**	**269.64**
	M2 / nxënës	**0.50**	**0.56**
5.0	**SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**417.02**	**471.23**
	M2 / nxënës	**0.87**	**0.98**
	GRAND TOTAL		
	Sipërfaqe Totale	**3.585.17**	**4.041.58**
	M2 / nxënës	**7.47**	**8.42**

Open Procurement Albania

Tabela 6 - Standarte projektimi për shkollën e Tipit 4

	SHKOLLA STANDARDE PËR ARSIMIM E MESEM CIKLI LARTE	**Tipi 4 Urbane**	
	Niveli arsimor	1	Nivel
	Numri i cikleve (paraleleve)	7	Cikle
	Numri i Klasëve	21	Klasa
	Numri i nxënësve/klasë	30-36	Nxënës në klasë
	Numri total i nxënësve	630-756	Nxënës
Ref.	**Hapësirat**	**Sipërfaqe neto**	**Sipërfaqe bruto**
A.			
1	**Niveli i mesëm i lartë**		
	Sipërfaqe Totale	**3300.04**	**3729.05**
	M2 / nxënës		
2.0	**ADMINISTRATA**		
	Sipërfaqe Totale	**312.73**	**353.38**
	M2 / nxënës	**0.41**	**0.47**
3.0	**SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**		
	Sipërfaqe Totale	**632.94**	**715.22**
	M2 / nxënës	**0.84**	**0.95**
	GRAND TOTAL		
	Sipërfaqe Totale	**4245.71**	**4797.65**
	M2 / nxënës	**5.62**	**6.35**

Open Procurement Albania

- Madhësia e klasave

Gjithmonë mbi bazën e Udhëzuesit për projektimin e ndërtesave shkollore të Ministrisë së Arsimit sipërfaqet mesatare të dhomave mësimore radhiten prej 44 deri në 48 m2 për shkollat në zona me popullsi të dendësisë së ulët me klasë të nxënësve prej 24 vetave dhe prej 58 deri 65 m2 në zonat me popullsi të dendësisë së lartë me klasë të nxënësve prej 30-36 vetave (shihni tabelën 2.4 më lart). Këto dimensione janë llogaritur në bazë të kapaciteteve të kërkuara (24 dhe 30-36 nxënës), numrit dhe përmasave të bankave në rreshtat ballorë (3 banka të dyfishta) si dhe në rreshtat gjatësorë (shihni modelet e dhomave mësimore në figurën më poshtë).

Figura 4 - Dhomat mësimore

Open Procurement Albania

- Hapësirat e jashtme

Hapësirat e jashtme ndahen në tri kategori:

a) Hapësirat e caktuara për zona të rekreacionit (fushat e lojës) dhe zona për sport;
b) Zonat e qarkullimit përfshirë ato për automjete (rrugët dhe parkingu) dhe për këmbësorë (trotuaret dhe shtigjet);
c) Zonat e gjelbra dhe ato të mbjella me drunj, kaçube, shkurre, si dhe lëndinat.

Kërkesa minimale e sipërfaqes së tokës për çdo lloj shkolle llogaritet duke shtuar hapësirat e jashtme të nevojshme për sipërfaqet e ndërtuara të çdo ndërtese. Kjo sipërfaqe varet nga kapaciteti i shkollës, numri i kateve, dhe proporcioni i parallogaritur i tokës për sipërfaqe të mbjella dhe hapësira të qarkullimit.
VKM nr.671 "Për planifikimin e territorit" përcakton që për shkollat fillore dhe 9-vjeçare, madhësia e parcelës parashikohet 1500 m^2 - 7000 m^2, ndërsa për shkollat e mesme parcela parashikohet 2000 m^2 – 7000 m^2, duke përmbajtur të gjitha shërbimet e parashikuar nga MAS.

3.1.4. Financimi i institucioneve arsimore parauniversitare

3.1.4.1. Burimet financiare

Burimet për financimin e arsimit parauniversitar përcaktohen në ligjin Nr 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar", Neni 37 dhe ato janë:

a) Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore;
c) dhurimet e sponsorizimet;
ç) të ardhurat e përftuara nga institucionet arsimore;
d) të ardhura të tjera të ligjshme.

Financimi nga Buxheti i Shtetit planifikohet me formulën "për nxënës", sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike. Në Buxhetin e Shtetit, për njësitë bazë të qeverisjes vendore, caktohet një fond "për nxënës", i cili përdoret për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore publike, në përputhje me standardet e mirëmbajtjes për institucionet arsimore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Udhëzim Plotësues, Nr. 1, Datë 15.1.2016, Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016 pika 70 pohon se: Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar, në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit para-universitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Ministritë përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përgatisin dhe nxjerrin standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit të zbatueshme për ambientet e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo bashkie

Procurement Albania

Çdo bashki dhe komunë vendos nivelin e financimit që ajo akordon për mirëmbajtje dhe funksionim të ambienteve të arsimit parauniversitar nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit para-universitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo bashkie dhe komune.

3.1.4.2. Partneriteti Publik Privat

Një mënyrë për të realizuar ndërtimin e objekteve shkollore është dhe Partneriteti Publik Privat. Ky lloj partneriteti rregullohet me Ligjin 125/2012, "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar[20]. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/partneritete publike private. Neni 4, i këtij ligji parashikon fushat e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike dhe arsimi është një prej tyre (pika dh).

Sipas këtij ligji, partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues, domethënë partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, domethënë partnerit privat, ku partneri privat merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve dhe/ose veprimtaritë brenda fushës së kompetencave të tij. Me qëllim që të përmbushjen e këtyre

[20] Ligji është ndryshuar dy herë përmes Ligjit nr.88/2014 dhe Ligjit nr.7/2015

detyrimeve, partneri privat mund të marrë përsipër detyrimin që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë/të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe /ose të rindërtuar/të rinovuar rishtazi (Neni 8, pika 1/b/i).

3.2. Metodologjia

Analiza e thelluar e gjendjes ekzistuese dhe parashikimi i nevojave për infrastruktura arsimore për ciklin parauniversitar, është bazuar mbi vlerësimin e disa treguesve, të cilët janë kërkesa ligjore apo standarde të rekomanduara nga Ministria e Arsimit. Këto tregues kanë shërbyer për të matur kapacitetin maksimal që ofron infrastruktura arsimore ekzistuese dhe për të përcaktuar nevojën për infrastruktura të reja për të akomoduar nxënësit e Tiranës. Gjithashtu, përmes të njëjtëve tregues është analizuar edhe shpërndarja territoriale ekzistuese e këtyre institucioneve arsimore, duke përcaktuar territoret e pambuluara me shkolla e kopshte. Orientimi i ndërtimit të shkollave të reja në këto territore është bërë për të optimizuar distancën e infrastrukturave arsimore nga vendbanimi i nxënësve. Së fundi, në këtë studim janë marrë për bazë edhe disa standarde planifikimi dhe projektimi të infrastrukturave arsimore, që ndihmojnë në planifikimin e ndërhyrjeve të parashikuara.

- Numri i nxënësve/ dhomë mësimi të përgjithshme: Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 26, pika d, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, numri optimal i nxënësve për klasë mësimore është 30 ose brenda intervaleve të shprehura në tabelën e mëposhtme:

Open Procurement Albania

Tabela 7 - Standarti për numrin e nxënësve për klasë mësimore

Arsimi	Klasat	Nr i nxënësve
Arsimi bazë	Klasa përgatitore	25
	Klasa e parë	26 -30
	Klasat II-IV	30-35
Arsimi i mesëm i ulët		30-35
Arsim i mesëm i lartë		30-35

Ndërkohë sipas publikimeve të përvitshme të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), "Edukimi me një shikim – 2015"[21], madhësia mesatare e klasave në edukimin fillor dhe sekondar ishte 21 nxënës për klasë në vitin 2013, dhe në çdo rast klasat janë me më pak se 30 nxënës, përveç shteteve me përqendrim shumë të lartë popullsie si Kina, Korea, Japonia, Indonezia dhe Kili (Figura 3). Meqënëse trendet ndërkombëtare tregojnë për tendeca të zvogëlimit të numrit të nxënësve për dhomë mësimi të përgjithshme, duke e parë këtë tregues të lidhur ngushtë me cilësinë e zhvillimit të aktiviteteve mësimore, performancën e nxënësve dhe të mësuesve, ky studim synon të vlerësojë nevojën për ndërhyrje në infrastrukturat arsimore të bashkisë Tiranë *me qëllim arritjen e standardit prej maksimalisht 30 nxënësish për dhomë mësimi të përgjithshme*.

[21] "Education at a Glance" Publikuar në 24 Nëntor 2015

Figura 5 - Madhësia mesatare e klasës në institucionet arsimore sipas nivelit të edukimit (2013)



Përmes këtij indikatori është vlerësuar kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm, janë evidentuar rastet e mbipopullimit të këtyre infrastrukturave dhe është matur masa e mbipopullimit (numri i nxënësve që frekuentojnë shkollën mbi kapacitetin e saj të akomodimit prej 30 nxënësish/klasë fizike). Kësisoj, kapaciteti maksimal i infrastrukturave ekzistuese është përcaktuar duke shumëzuar numrin e klasave fizike me numrin 30, që është edhe numri maksimal i nxënësve për klasë. Në rast në këtë shkollë janë rregjistruar më shumë nxënës se kapaciteti maksimal i saj, shkolla është konsideruar e mbipopulluar. Për të matur masën e mbipopullimit, nga numri në total i nxënësve frekuentues të shkollës është zbritur numri i nxënësve sipas kapacitetit maksimal të shkollës, i llogaritur 30 nxënës/klasë fizike.

Po në të njëjtën mënyrë është përcaktuar numri i shkollave të nevojshme. Duke mbledhur numrin e nxënësve mbi kapacitet të një shkolle të caktuar me numrin e nxënësve mbi kapacitet të shkollave të tjera të së njëjtës njësive administrative përftojmë numrin total të nxënësve mbi kapacitet të njësisë në fjalë. Nëse ky numër është mjaftueshëm i lartë, atëhërë në njësinë në fjalë është parashikuar ndërtimi i një apo më shumë shkollave të reja (në varësi të numrit total të nxënësve mbi kapacitet që duhet të akomodohen në shkolla të reja si dhe tipologjive të parashikuara të shkollave).

Gjithashtu, metodologjia e studimit është adaptuar duke marrë parasysh fenomenin e mbipopullimit të disa shkollave si rezultat i frekuentimit të tyre edhe nga nxënës që vijnë nga jashtë njësisë administrative të cilës i shërben shkolla. Në Nenin 14, të Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, pika 1, thuhet shprehimisht "Drejtori i shkollës nuk regjistron nxënës nga zonat që nuk i përkasin shkollës kur a) krijohen klasa me numër nxënësish mbi normën e përcaktuar në udhëzimin e ministrit; b) nuk ka mësues të mjaftueshëm për hapjen e klasave të reja". Duke pasur parasysh këtë dispozitë normative, analiza e gjendjes ekzistuese në lidhje me këtë indikator është fokusuar mbi identifikimin e nevojës për infrastruktura të reja arsimore në secilën njësi administrative, <u>nëse secili nga nxënësit do frekuentonte një nga shkollat përkatëse brenda njësisë administrative ku</u>

banonsecili nga nxënësit do frekuentonte një nga shkollat përkatëse brenda njësisë administrative ku banon.

Shënim metodologjik: Të dhënat për analizimin e këtij indikatori janë mbledhur përmes një pyetësori të hartuar me qëllim mbledhjen e të dhënave drejtpërdrejt nga drejtorët e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Bashkisë Tiranë, posaçërisht për Studimin e Fizibilitetit (Aneks 1). Këto të dhëna janë përmbledhur dhe analizuar përmes përdorimit të disa softëare-ve (excel, GIS), me qëllim analizimin e gjendjes ekzistuese në mënyrë sa më koherente. Të dhënat në lidhje me numrin e nxënësve sipas prejardhjes janë mbledhur të disagreguara, dhe janë përdorur për të përllogaritur numrin total të nxënësve të cilët frekuentojnë arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm publik sipas secilës njësi administrative. Studimi është realizuar duke marrë parasysh numrin e nxënësve frekuentues të cikleve 9-vjecare dhe të mesme, **sipas vendbanimit të tyre.** Kjo do të thotë që, megjithëse një % e nxënësve rezultojnë si frekuentues të shkollave jashtë njësive ku ato banojnë, në përllogaritjen e nevojave, ky numër nxënësish është marrë në konsideratë në Njësinë Administrative ku ato banojnë, jo në Njësinë Administrative ku ato frekuentojnë shkollën.

- Rrezja e mbulimit me shërbimin e arsimit parauniversitar: Është tregues i cili vlerëson shpërndarjen e insfrastrukturave arsimore në territor dhe mbulimin e zonave të banuara me këtë shërbim. VKM nr.671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", përcakton standardet e mëposhtme për rrezen e mbulimit sipas llojit të shkollave dhe llojit të territorit[22]:

- Për shkollat fillore dhe 9-vjeçare, rrezja e mbulimit në vijë ajrore:
  - 500-600 metra në zona urbane
  - 1000-1500 metra në zona rurale

- Për shkollat e mesme, rrezja e mbulimit në vijë ajrore:
  - 1000-1500 metra në zona urbane
  - 2000-4500 metra në zona rurale

Në njësitë administrative ku në bazë të analizës së mbipopullimit të shkollave ekzistuese, ka rezultuar e nevojshmë ndërtimi i një apo më shumë shkollave të reja, këto shkolla të reja do të ndërtohen në zona të pambuluara nga rrezet e mbulimit të shkollave ekzistuese. Gjithashtu, në rastet e zonave ku analiza e mbipopullimit të shkollave ekzistuese nuk e ka nxjerrë të nevojshme ndërtimin e shkollave të reja, por në këto zona nuk ka objekte arsimore ekzistuese dhe nxënësit duhet të udhëtojnë me distanca të gjata, është vendosur gjithashtu të ndërtohen shkolla të reja.

- Numri i shkollave mbi bazë të numrit të popullsisë: Është tregues i cili ndihmon në planifikimin e infrastrukturave arsimore, duke marrë parasysh numrin e banorëve të cilëve këto infrastruktura i shërbejnë. Ky indikator përdoret më tepër gjatë proceseve të planifikimit të territorit, dhe ka për synim të orientojë institucionet publike drejt nevojave për ndërhyrje; nevoja të cilat duhet domosdoshmërisht të analizohen më në detaje sipas standardeve

[22] Neni 83, pika 1/c dhe 1/ç

Open Procurement Albania

sektoriale. VKM nr.671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", përcakton standardet e mëposhtme për numrin e shkollave mbi bazë të numrit të popullsisë[23]:

- Parashikohet 1 Shkollë 9-vjeçare çdo 6000 banorë
- Parashikohet 1 Shkollë e mesme çdo 9000 banorë

- **Standarde të projektimit të shkollave të ciklit parauniversitar:** Janë standarde të cilat janë referuar në studim, pas përcaktimit të nevojave për infrastruktura arsimore të reja, të cilat ndihmojnë në planifikimin paraprak të hapësirave dhe buxheteve financiare për realizimin e tyre. Këto standarde janë orientuese për qëllime planifikimi dhegjatë hartimit të projekteve arkitektonike dhe inxhinierike mund të variojnë mbi bazën e specifikimeve teknike konkrete të secilit projekt.

Me qëllim lehtësimin e planifikimit paraprak të hapësirave të jashtme dhe të brendshme përllogaritjet në këtë studim do të bëhen duke iu referuar parashikimeve të "Udhëzuesit për projektimin e ndërtesave shkollore – Normat dhe Standardet", si dhe të gjitha standardeve të referuara në kapitullin "Legjislacioni që rregullon objektin e fushës së investimit" të këtij studimi.

3.3. Analizë e thelluar e gjendjes ekzistuese

3.3.1. Arsimi 9-vjeçar

Gjatë hartimit të kësaj analize, janë marrë në shqyrtim 174 shkolla 9-vjeçare të përgjithshme në Bashkinë e Tiranës, duke përfshirë Shkollat e mesme të bashkuara[24], meqënëse kanë në përbërje të tyre klasa mësimore të ciklit 9-vjeçar, si dhe shkollat e vartësisë. Nga këto, 57 shkolla 9-vjeçare ndodhen në territorin urban të Bashkisë Tiranë (brenda kufirit të vjetër administrativ të Bashkisë Tiranë) ndërsa 117 ndodhen në territorin e Njësive Administrative që janë përfshirë në territorin e Bashkisë Tiranë pas Reformës Territoriale dhe Administrative, nga të cilat 13 janë shkolla të mesme të bashkuara, 64 janë shkolla 9-vjeçare dhe 40 janë shkolla të ciklit të ulët. Shkollat 9-vjeçare të marra në shqyrtim në këtë studim paraprak, nuk përfshijnë shkollat me kurikula të veçanta mësimore si shkolla Luigj Gurakuqi, Instituti për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe Instituti për nxënësit që nuk shikojnë, si raste institucionesh me specifika të veçanta.

Gjatë hartimit të kësaj analize, dy kanë qenë elementët kryesore të marra në konsideratë: Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore dhe shpërndarja e tyre në territor.

Analiza e kapacitetit ekzistues të infrastrukturave arsimore është hartuar duke trajtuar dy elemente kryesore. **Elementi i parë** i trajtuar ka të bëjë me kapacitetin ekzistues të infrastrukturave arsimore për t'i shërbyer nxënësve që frekuentojnë këto infrastruktura. Numri total i klasave të nevojshme për të plotësuar kapacitetin e infrastrukturave arsimore,

[23] Neni 83, pika 1/c dhe 1/ç
[24] Të dhëna më të detajuara gjendjen në Aneks 1 dhe Aneks 2

sipas frekuentimit aktual të tyre, është 300 klasa, të shpërndara kryesisht në njësitë më të mbipopulluara që janë Njësitë 2,5,6,9 dhe 11. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme si dhe në Aneks 2.

Tabela 8 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit 9-vjeçar përkundrejt nxënësve frekuentues

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	NR NX.	KLASA MËSIMORE	NX/KL	KLASA FIZIKE	KLASA TË PASHFRYTËZUARA	NX/KL FIZIKE	NX NËSE MES. ËSHTË 30 NX/KL	BILANCI PËR NX EKSTRA (sipas nx frekuentues)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx frekuentues)
1	NjA 1	4144	134	30.9	118	10	35.1	3540	-604	-20
2	NjA 2	5394	177	30.5	140	10	38.5	4200	-1194	-40
3	NjA 3	2439	81	30.1	77	4	31.7	2310	-129	-4
4	NjA 4	3178	107	29.7	121	8	26.3	3630	452	15
5	NjA 5	6259	203	30.8	174	2	36.0	5220	-1039	-35
6	NjA 6	5876	188	31.3	118	3	49.8	3540	-2336	-78
7	NjA 7	4366	148	29.5	146	9	29.9	4380	14	0
8	NjA 8	3893	122	31.9	103	3	37.8	3090	-803	-27
9	NjA 9	4992	163	30.6	123	4	40.6	3690	-1302	-43
10	NjA 10	2157	70	30.8	52	1	41.5	1560	-597	-20
11	NjA 11	5066	172	29.5	138	3	36.7	4140	-926	-31
	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	47764	1565	30.5	1310	57	36.5	39300	-8930	-298
12	NjA DAJT	2041	101	20.2	102	5	20.0	3060	1019	34
13	NjA FARKË	1268	65	19.5	62	0	20.5	1860	592	20
14	NjA VAQARR	1137	58	19.6	52	4	21.9	1560	423	14
15	NjA KASHAR	2987	122	24.5	113	0	26.4	3390	403	13
16	NjA NDROQ	1003	49	20.5	56	4	17.9	1680	677	23
17	NjA PETRELË	681	61	11.2	54	6	12.6	1620	939	31
18	NjA PEZË	711	67	10.6	42	0	16.9	1260	549	18
19	NjA BALDUSHK	769	43	17.9	48	2	16.0	1440	671	22
20	NjA BËRZHITË	815	57	14.3	59	0	13.8	1770	955	32
21	NjA KRRABË	456	25	18.2	26	1	17.5	780	324	11
22	NjA SHËNGJERGJ	331	22	15.0	39	0	8.5	1170	839	28
23	NjA ZALL BASTAR	761	74	10.3	77	2	9.9	2310	1549	52
24	NjA ZALL HERR	1944	75	25.9	62	9	31.4	1860	-84	-3

	ZONA RURALE TIRANË TOTAL	14904	819	18.2	792	33	18.8	23760	-84	-3
	TOTAL BASHKIA TIRANË	62668	2384	26.3	2102	90	29.8	2700	-9014	-300

Megjithatë, një tjetër fenomen që është vënë re gjatë kësaj analize, është mbipopullimi i disa shkollave si rezultat i frekuentimit të tyre edhe nga nxënës që vijnë nga jashtë njësisë administrative, të cilës supozohet t'i shërbejë kjo shkollë; që ka të bëjë me **çështjen e dytë të trajtuar** në kuadër të analizës së kapaciteteve ekzistuese. Në Nenin 14, të Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, pika 1, thuhet shprehimisht *"Drejtori i shkollës nuk regjistron nxënës nga zonat që nuk i përkasin shkollës kur a) krijohen klasa me numër nxënësish mbi normën e përcaktuar në udhëzimin e ministrit; b) nuk ka mësues të mjaftueshëm për hapjen e klasave të reja*". Megjithatë, ky fenomen vazhdon të përsëritet në disa raste. Për këtë arsye, siç shpjegohet më sipër në Metodologjinë e Studimit, analiza është fokusuar mbi identifikimin e nevojës për infrastruktura të reja arsimore në secilën njësi administrative, <u>nëse secili nga nxënësit do frekuentonte një nga shkollat përkatëse brenda njësisë administrative ku banon.</u>

Sipas kësaj qasje, numri total i klasave të nevojshme për të plotësuar kapacitetin e infrastrukturave arsimore <u>sipas numrit të nxënësve banues në secilën Njësi Administrative</u> për ciklin 9-vjeçar është 289, të cilat duhet të parashikohen kryesisht në Njësitë Administrative të mbipopulluara si Njësia 2, 5, 6 dhe 11. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme si dhe në Aneks 2.

Open Procurement Albania

Tabela 9 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit 9-vjeçar përkundrejt nxënësve banues në secilën NjA

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	NR NXËNËSISH	NXËNËS BANUES NË KËTË NJËSI	KLASA FIZIKE	KLASA TË PASHFRYTËZUARA	NX/KL FIZIKE	NX NËSE MES. ËSHTË 30 NX/KL	BILANCI PËR NX EKSTRA (sipas nx banues)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx banues)
1	NjA 1	4144	3637	118	10	35.1	3540	-97	-3
2	NjA 2	5394	6074	140	10	38.5	4200	-1874	-62
3	NjA 3	2439	2546	77	4	31.7	2310	-236	-8
4	NjA 4	3178	4194	121	8	26.3	3630	-564	-19
5	NjA 5	6259	6147	174	2	36.0	5220	-927	-31
6	NjA 6	5876	6494	118	3	49.8	3540	-2954	-98
7	NjA 7	4366	3905	146	9	29.9	4380	475	16
8	NjA 8	3893	2110	103	3	37.8	3090	980	33
9	NjA 9	4992	3864	123	4	40.6	3690	-174	-6
10	NjA 10	2157	1260	52	1	41.5	1560	300	10
11	NjA 11	5066	5881	138	3	36.7	4140	-1741	-58

	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	47764	46111	1310	57	36.5	39300	-8567	-286
12	NjA DAJT	2041	2433	102	5	20.0	3060	627	21
13	NjA FARKË	1268	1387	62	0	20.5	1860	473	16
14	NjA VAQARR	1137	1214	52	4	21.9	1560	346	12
15	NjA KASHAR	2987	3206	113	0	26.4	3390	184	6
16	NjA NDROQ	1003	1080	56	4	17.9	1680	600	20
17	NjA PETRELË	681	734	54	6	12.6	1620	886	30
18	NjA PEZË	711	667	42	0	16.9	1260	593	20
19	NjA BALDUSHK	769	778	48	2	16.0	1440	662	22
20	NjA BËRZHITË	815	831	59	0	13.8	1770	939	31
21	NjA KRRABË	456	456	26	1	17.5	780	324	11
22	NjA SHËNGJERGJ	331	343	39	0	8.5	1170	827	28
23	NjA ZALL BASTAR	761	777	77	2	9.9	2310	1533	51
24	NjA ZALL HERR	1944	1967	62	9	31.4	1860	-107	-4
	ZONA RURALE TIRANË TOTAL	14904	15872	792	33	18.8	23760	-107	-4
	TOTAL BASHKIA TIRANË	62668	61983	2102	90	29.8	2700	-8674	-289

Siç vërehet nga rezultatet e analizës së mësipërme, numri total i klasave të nevojshme në të dyja rastet është i ngjashëm , por shpërndarja e nevojës në territor ndryshon. Hartat e mëposhtme tregojnë ndryshimin e shpërndarjes së nevojës për klasa të reja në territor sipas dy qasjeve të analizës:

Open Procurement Albania

Harta 9 -Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit frekuentojnë shkollën (Cikli 9-vjeçar)



Harta 10 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit banojnë (Cikli 9-vjeçar)



Procurement Albania

Kjo do të thotë që nëse ndërhyrja me infrastruktura të reja arsimore do të bëhet duke marrë për bazë njësitë administrative të cilat presin fluks më të lartë nxënësish, të cilët shpesh janë banorë jashtë këtyre njësive, atëherë një numër i konsiderueshëm klasash të reja duhet të parashikohen në Njësitë Administrative 8 dhe 9. Ndërkohë këto njësi frekuentohen prej një numri të konsiderueshëm nxënësish që nuk janë banorë të tyre, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme. Nga ana tjetër, nëse ndërhyrja me infrastruktura të reja arsimore do të bëhet duke marrë parasysh njësitë administrative në të cilat banojnë më shumë nxënës të moshës frekuentuese të ciklit 9-vjeçar, atëherë ndërhyrja do të fokusohet akoma më shumë në njësi administrative të cilat nuk kanë mjaftueshëm infrastruktura arsimore ekzistuese dhe për pasojë nuk i shërbejnë dot numrit të nxënësve banues në to, si përshembull njësitë 2,6 dhe 11. Tabela e mëposhtme e tregon më qartë diferencën mës numrit të nxënësve banues dhe nxënësve frekuentues të shkollave në secilën Njësi Administrative.

Tabela 10 - Vendbanimi i nxënësve dhe Njësia Administrative ku frekuentojnë shkollën (Cikli 9-vjeçar)

VENDBANIMI I NXENESVE	NJESIA KU FREKUENTOJNE SHKOLLEN																									
NJESIA ADMINISTRATIVE	NJA1	NJA2	NJA3	NJA4	NJA5	NJA6	NJA7	NJA8	NJA9	NJA10	NJA11	NJA DAJT	NJA FAKRE	NJA VAQARR	NJA KASHAR	NJA NDROQ	NJA PEZE	NJA PETRELE	NJA BALDUSHK	NJA BERZHITE	NJA KRRABE	NJA SHENGJERGJ	NJA ZALL BASTAR	NJA ZALL HERR	TOTAL	TOTAL JASHTE NJESISE	%
NJESIA ADM 1	**3372**	83	61	1	32		11	31	5	22	3		14			1									3636	264	7.3%
NJESIA ADM 2	382	**5096**	93	5	96		14	278	40	36	8		24												6072	976	16.1%
NJESIA ADM 3	73		**2096**	17	18		17	292	24	5	3						1								2546	450	17.7%
NJESIA ADM 4	10	29	58	**3034**	19		14	941	66	15	6					1									4193	1159	27.6%
NJESIA ADM 5	15	10	23	3	**5521**	85	227	161	42	55	3					1									6146	625	10.2%
NJESIA ADM 6	8	3	5	29	251	**5571**	507	12	21	26	53		1	4			3								6494	708	10.9%
NJESIA ADM 7	1	9	13	5	94	36	**3197**	27	51	282	188		2												3905	708	18.1%
NJESIA ADM 8	10	4	17	5	16		6	**1539**	491	20	2														2110	571	27.1%
NJESIA ADM 9	12	4	11		41		55	184	**3426**	101	22		7			1									3864	438	11.3%
NJESIA ADM 10	1	7	10	1	37		16	26	107	**1044**	8														1257	213	16.9%
NJESIA ADM 11	12		4		21		162	91	628	302	**4662**														5882	1220	20.7%
NJA DAJT	179		42	67	1			91	10		2	**2024**													2416	392	16.2%
NJA FARKË	43	43	1		71		1	4	2	5	2		**1209**					9							1390	181	13.0%
NJA VAQARR		1			4	55	18	1						**1149**		5	1								1234	85	6.9%
NJA KASHAR	1		2		5		98	2	11	85	15				**2987**										3206	219	6.8%
NJA NDROQ						82	18									**667**	36								803	136	16.9%
NJA PEZE								4						3		40	**554**								601	47	7.8%
NJA PETRELE	3	33			2			3					2					**467**		15					525	58	11.0%
NJA BALDUSHK		2						7											**618**						627	9	1.4%
NJA BERZHITE	8	8	1		3			1												**747**	10				778	31	4.0%
NJA KRRABE	1	1			2			5													**441**				450	9	2.0%
NJA SHENGJERGJ	12							1														**331**			344	13	3.8%
NJA ZALL BASTAR	4			6			1	5			2												**762**		780	18	2.3%
NJA ZALL HERR	4			5					4	8													2	**994**	1017	21	2.1%
TOTAL	**4151**	**5333**	**2437**	**3178**	**6234**	**5829**	**4362**	**3706**	**4928**	**2006**	**4979**	**2024**	**1259**	**1156**	**2987**	**716**	**595**	**476**	**618**	**762**	**451**	**331**	**764**	**994**			
TOTAL NGA JASHTE NJESISE	779	237	341	144	713	258	1165	2167	1502	962	317	0	50	7	0	49	41	9	0	15	10	0	2	0			
%	18.8%	4.4%	14.0%	4.5%	11.4%	4.4%	26.7%	58.5%	30.5%	48.0%	6.4%	0.0%	4.0%	0.6%	0.0%	6.8%	6.9%	1.9%	0.0%	2.0%	2.2%	0.0%	0.3%	0.0%			

Open Procurement Albania

Fenomeni i mbipopullimit të shkollave si rezultat i frekuentimit të tyre edhe nga nxënës jo banor të njësisë administrative të cilës këto shkolla duhet t'i shërbejnë, paraqitet qartë në dy hartat e mëposhtme. Harta 11 tregon përqindjen e nxënësve frekuentues të shkollave të secilës Njësi Administrative të cilët nuk janë banorë të asaj njësie. Siç vërehet, njësitë 6, 8, 9 dhe 10 janë njësi në të cilat shkollat 9-vjeçare mbipopullohen nga nxënës që nuk janë banorë të këtyre njësive. I njëjti fenomen paraqitet edhe në Hartën 12. Kjo hartë tregon nivelin e mbipopullimit të shkollave 9-vjeçare, përmes madhësisë dhe ngjyrës së rrathëve (rrathët me ngjyrë të kuqe tregojnë shkollat më të mbipopulluara). Ndërkohë, kjo shtresë informacioni është mbivendosur me numrin e nxënësve banues në secilën Njësi Administrative. Siç vërehet edhe në hartë, një pjesë e shkollave të mbipopulluara gjenden në NjA të cilat nuk kanë numër shumë të lartë nxënësish banorë, si përshembull shkollat në njësitë 8, 9 dhe 10. Kjo ndodh pikërisht për shkakun e përmendur më lart – frekuentimi i shkollave nga nxënës banorë të njësive të tjera fqinje. Këta nxënës udhëtojnë çdo ditë drejt shkollave në fjalë nga vendbanimi i tyre, më shumë sesa standardi i parashikuar për ciklin 9-vjeçar që është 500m – 600m në vijë ajrore. Një ndërhyrje me infrastruktura të reja arsimore në këto Njësi Administrative nuk do ta zgjidhte këtë problem. Ndaj është parë e arsyeshme që parashikimet për infrastruktura të reja arsimore të bëhen duke marrë parasysh numrin e nxënësve banues në secilën Njësi Administrative si dhe shpërndarjen në territor të shkollave ekzistuese dhe rrezeve të mbulimit me shërbim përkatëse.

Harta 11 - Përqindja e nxënësve frekuentues të shkollave jo banor/ nxënësve banor të secilës NjA



Harta 12 - Mbipopullimi i shkollave dhe vendbanimi i nxënësve – cikli 9-vjeçar (Shenim: vlerat negative tregojnë numrin mbi kapacitet për secilën shkollë)



Njësia Administrative 1

Kjo njësi administrative ka gjithsej 3637 nxënës banues dhe 4144 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Si rezultat i numrit të lartë të nxënësve që banojnë në njësi të tjera dhe frekuentojnë shkollat në këtë njësi, shkollat "1 Maji" dhe "Ali Demi" janë të mbipopulluara, me rreth 330 dhe 572 nxënës mbi kapacitet respektivisht. Rreth 26% të nxënësve të shkollës "1 Maji" janë banorë të njësisë administrative 2. Nga ana tjetër, shkolla "Androkli Kostallari" paraqitet me numër nxënësish nën kapacitetin maksimal prej 30 nxënësish/ klasë fizike. Përsa i përket mbulueshmërisë me rreze shërbimi, ka zona të kësaj njësie që mbeten jashtë rrezes së mbulimit, siç paraqitet në hartën e mëposhtme:

Harta 13 - Rrezet e mbulimi të territorit ne shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 1



Njësia Administrative 2

Kjo njësi administrative ka gjithsej 6074 nxënës banues dhe 5394 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Si rezultat i numrit të lartë të nxënësve banorë në këtë njësi, shkollat "Mihal Grameno" dhe "Fan Noli" janë të mbipopulluara, me 620 dhe 550 nxënës mbi kapacitet respektivisht. Po ashtu të mbipopulluara janë edhe shkollat "M.Q. Ataturk" dhe "Mustafa Greblleshi", pavarësisht se më pak se shkollat e lartpërmendura. Rreth 380 nxënës të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e njësise administrative 1 dhe rreth 300 nxënës të tjerë të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e njësisë administrative 8, kryesisht shkollën "e Kuqe". Mbulueshmeria me rreze shërbimi paraqitet jo shumë e mirë, duke lënë jashtë disa zona rezidenciale, si zona pas qytetit studenti, siç paraqitet më poshtë:

Harta 14 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 2



Njësia Administrative 3

Kjo njësi administrative ka gjithsej 2546 nxënës banues dhe 2439 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Shkolla "Hasan Prishtina" ka rreth 380 nxënës mbi kapacitet, ndërkohë që shkollat "Xhezmi Delli" dhe "Niket Dardani" funksionojnë duke mos shfrytëzuar kapacitetin e plotë të ambienteve të tyre mësimore. Kjo do të thotë që përmes një balancimi më të mirë të shpërndarjes së nxënësve në shkollat ekzistuese të kësaj njësie, mund të zgjidhen problemet me mbipopullimin. Përsa i përket mbulimit me rreze shërbimi, kjo njësi paraqitet e mirëmbuluar:

Harta 15 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 3



Njësia Administrative 4

Kjo njësi administrative ka gjithsej 4194 nxënës banues dhe 3178 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Rreth 950 nxënës të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e njësisë 8, sidomos shkollat "Misto Mame" dhe "Skënder Çaçi", duke shkaktuar probleme me mbipopullimin e tyre. Ndërkohë në këtë njësi, është ndërmarrë iniciativa e ndërtimit të një kompleksi arsimor social të financuar përmes fondeve IPA.

Projekti IPA 2012 i vjen në ndihmë një komuniteti prej rreth 16.000 banorësh në Njësinë administrative 4 dhe 8, që jetojnë në një zonë kryesisht informale, dhe ku rreth 5% e saj është e komunitetit rom. Projekti konsiston në ndërtimin e:

Një Shkollë 9-vjeçare (Selaudin Bekteshi) e përbërë nga 20 klasa me nga 30 nxënës, pra në total 600 nxënës, si dhe me të gjitha facilitetet përkatëse, që nga laboratorët shkencor, deri tek palestra sportive.

Një kopësht - çerdhe, i përbërë nga 7 klasa, me nga 20 fëmije, pra në total 140 fëmijë, për 3 grupmosha të ndryshme, si dhe ofron të gjitha facilitetet e nevojshme, që nga këndet e lojrave, deri tek menca e ushqimit.

Një qendër Sociale me sipërfaqe rreth 900m2, që ju vjen të gjithë njerëzve në nevojë të këtij komuniteti

Me ndërtimin e këtij kompleksi arsimor dhe social, e gjithë njësia administrative do të mbulohet nga rrezet e shërbimit të arsimit 9-vjeçar

Harta 16 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 4



Njësia Administrative 5

Kjo njësi administrative ka gjithsej 6147 nxënës banues dhe 6259 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Si rezultat i numrit të lartë të nxënësve banorë në këtë njësi dhe frekuentues të shkollave në këtë njësi, shkollat "Edit Durham" dhe "Vasil Shanto" janë të mbipopulluara, me rreth 540 dhe 320 nxënës mbi kapacitet respektivisht. Po ashtu të mbipopulluara paraqiten edhe shkollat "Emin Duraku" dhe "Dëshmorët e Lirisë", pavarësisht se më pak se dy shkollat e lartpërmendura. Rreth 200 nxënës të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e njësise administrative 7. Mbulueshmeria me rreze shërbimi paraqitet si mëposhtë:

Harta 17 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 5



Njësia Administrative 6

Kjo njësi administrative ka gjithsej 6494 nxënës banues dhe 5876 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Pothuajse të gjitha shkollat e kësaj njësie administrative janë të mbipopulluara. Rreth 500 nxënës banorë të njësisë administrative 6 frekuentojnë shkollat tek njësia administrative 7, sidomos shkollën "Dhora Leka". Këto dinamika, mund të përfshijnë edhe nxënës banues në zonën rezidenciale të Yzberishtit dhe të regjistruar në gjendjen civile të njësisë administrative 6. Duke qenë njësi fqinje me zonën rezidenciale me dendësi relativisht të lartë të Yzberishtit, shkollat e njësisë administrative 6 janë të mbipopulluara si rezultat i të shërbyerit edhe të kësaj zonë rezidenciale jashtë kësaj njësie.

Në këtë njësi administrative, ka filluar ndërtimi i një shkolle të re 9-vjeçare, pranë ish-fabrikës tekstile. Parashikohet që shkolla të ketë 600-712 nxenes, 27 klasa me kapacitet mbajtes mesatarisht 25-30 nxënës.

Me ndërtimin e kësaj shkolle të re, njësia administrative do të ketë mbulimin e treguar në hartën e mëposhtme me rrezet e shërbimit shkollor 9-vjeçar:

Harta 18 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 6



Njësia Administrative 7

Kjo njësi administrative ka gjithsej 3905 nxënës banues dhe 4366 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Një pjesë e nxënësve frekuentues por jo banues të kësaj njësie, janë banorë në njësinë administrative 6 dhe në njësinë administrative Kashar, në zonën e Yzberishtit. Përveç shkollës "Pjetër Budi", e cila funksionon me rreth 190 nxënës mbi kapacitet, pjesa tjetër e shkollave nuk paraqiten të mbipopulluara. Rrezet e shërbimit të shkollave në këtë njësi paraqiten në hartën e mëposhtme:

Harta 19 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 7



Njësia Administrative 8

Kjo njësi administrative ka gjithsej 2110 nxënës banues dhe 3893 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Shkollat "Skënder Çaçi" dhe "Misto Mame" paraqiten të mbipopulluara, me 430 dhe 340 nxënës mbi kapacitet respektivisht. Ky mbipopullim shkaktohet kryesisht nga frekuentimi i këtyre shkollave edhe nga nxënës banues të njësive fqinje. Me ndërtimin e shkollës "Selaudin Bekteshi" në njësinë administrative 4, pritet që ulet numri i nxënësve frekuentues në shkollat e mbipopulluara. Rrezet e shërbimit të shkollave në këtë njësi paraqiten në hartën e mëposhtme:

Harta 20 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 8



Njësia Administrative 9

Kjo njësi administrative ka gjithsej 3864 nxënës banues dhe 4992 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Shkollat "Qazim Turdiu" dhe "Jeronim De Rada" paraqiten të mbipopulluara, me 460 dhe 570 nxënës mbi kapacitet respektivisht. Po ashtu, edhe shkollat "Servete Maçi" dhe "7 Marsi" kanë rreth 140 xnënës mbi kapacitet secila. Ky mbipopullim shkaktohet kryesisht nga frekuentimi i këtyre shkollave edhe nga nxënës banues të njësive fqinje, si p.sh rasti i shkollës "Servete Maçi", në të cilën mbi 70% të nxënësve banojnë jashtë njësisë 9. Rrezet e shërbimit të shkollave në këtë njësi paraqiten në hartën e mëposhtme:

Harta 21 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 9



Njësia Administrative 10

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1260 nxënës banues dhe 2157 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Të treja shkollat e kësaj njësie janë të mbipopulluara, duke veçuar shkollën "Avni Rustemi" me rreth 360 nxënës mbi kapacitet. Ky mbipopullim vjen si rezultat I frekuentimit të këtyre shkollave nga nxënës që nuk janë banorë të kësaj njësie. Njësia është e mbuluar totalisht me rrezet e shërbimit të shkollave 9-vjeçare ekzistuese.

Harta 22 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 10



Njësia Administrative 11

Kjo njësi administrative ka gjithsej 5881 nxënës banues dhe 5066 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Shkollat më të mbipopulluara të kësaj njësie janë "Isa Boletini" dhe "Kolë Jakova", me 480 dhe 420 nxënës mbi kapacitet respektivisht, ndjekur nga shkolla "Gjergj Fishta" me rreth 170 nxënës mbi kapacitet. Përveç kësaj, rreth 550 nxënës banorë të kësaj njësie frekuentojnë shkolla të njësisë 9 dhe rreth 250 nxënës frekuentojnë shkolla të njësisë 10. Rrezet e shërbimit të shkollave në këtë njësi paraqiten në hartën e mëposhtme:

Harta 23 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA 11



Njësia Administrative Kashar

Kjo njësi administrative ka gjithsej 3206 nxënës banues dhe 2987 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. Shkolla "Kasem Shima" ka rreth 150 nxënës mbi kapacitet. Siç vërehet edhe në hartën e mëposhtme, megjithëse për njësinë administrative Kashar është aplikuar rrezja e shërbimit të shkollave 9-vjeçare prej 1000m, siç parashikohet nga rregullorja e planifikimit në zonat rurale, zona rezidenciale e Yzberishtit nuk ka në afërsi të saj struktura arsimore të ciklit parauniversitar. Kjo zonë tashmë e urbanizuar dhe me tipare tipologjike urbane, shërbehet kryesisht nga shkollat e njësisë administrative 6, duke krijuar problem me mbipopullimin e shkollave në këtë njësi.

Harta 24 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Kashar



Njësia Administrative Farkë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1387 nxënës banues dhe 1268 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. Megjithëqë shkollat ekzistuese të kësaj njësie administrative nuk paraqesin probleme me mbipopullimin, zona e urbanizuar me dendësi relativisht të larta pranë kopështit botanik gjendet e distancuar nga infrastruktura ekzistuese arsimore. Njësoj si me Njësina Administrative Kashar, edhe për njësina Farkë është aplikuar rrezja e shërbimit të shkollave 9-vjeçare prej 1000m, siç parashikohet nga rregullorja e planifikimit në zonat rurale. Megjithatë, zona rezidenciale pranë kopështit botanik, si për nga tiparet tipologjike ashtu edhe nga dendësia, konsiderohet zonë urbane dhe duhet shërbyer me standarded e parashikuara prej 500m distancë nga shkollat 9-vjeçare më të afërta; standard i cili aktualisht nuk përmbushet.

Harta 25 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Farkë



Njësia Administrative Dajt

Kjo njësi administrative ka gjithsej 2433 nxënës banues dhe 2041 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. E vetmja shkollë që paraqitet e mbipopulluar është shkolla vartëse "17 Shkurti" në Qesarakë, me rreth 150 nxënës mbi kapacitet. Meqënëse numri i nxënësve mbi kapacitet përbën rreth 5 klasa fizike, kjo problematikë mund të zgjidhet përmes ndërhyrjeve rehabilituese në shkollat ekzistuese.

Harta 26 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Dajt



Njësia Administrative Vaqarr

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1214 nxënës banues dhe 1137 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. E vetmja shkollë që paraqitet e mbipopulluar është shkolla "Ibrahim Hima" (Gropaj), me rreth 95 nxënës mbi kapacitet. Duke ndjekur të njëjtën racionalë si me njësina administrative Dajt, meqënëse numri i nxënësve mbi kapacitet përbën rreth 3 klasa fizike, kjo problematikë mund të zgjidhet përmes ndërhyrjeve rehabilituese në shkollat ekzistuese.

Harta 27 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Vaqarr



Njësia Administrative Ndroq

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1080 nxënës banues dhe 1003 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 14.2 nxënës.

Harta 28 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Ndroq



Njësia Administrative Petrelë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 734 nxënës banues dhe 681 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 9 nxënës.

Harta 29 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Petrelë



Njësia Administrative Pezë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 667 nxënës banues dhe 711 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 15.3 nxënës.

Harta 30 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Pezë



Njësia Administrative Baldushk

Kjo njësi administrative ka gjithsej 778 nxënës banues dhe 769 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 20.6 nxënës.

Harta 31 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Baldushk



Njësia Administrative Bërzhitë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 831 nxënës banues dhe 815 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuara të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 13.6 nxënës..

Harta 32 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Berzhitë



Njësia Administrative Krrabë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 456 nxënës banues dhe 456 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 18 nxënës.

Harta 33 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Krrabë



Albania

Njësia Administrative Shëngjergj

Kjo njësi administrative ka gjithsej 343 nxënës banues dhe 331 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 8.5 nxënës

Harta 34 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Shëngjergj



Njësia Administrative Zall Bastar

Kjo njësi administrative ka gjithsej 777 nxënës banues dhe 761 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Asnjë nga shkollat ekzistuese në këtë njësi nuk paraqitet e mbipopulluar; përkundrazi mesatarja e numrit të nxënësve për klasë fizikë është 15.9 nxënës

Harta 35 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - NjA Zall Bastar



Albania

Njësia Administrative Zall Herr

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1967 nxënës banues dhe 1944 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare të kësaj njësie. Shkollat që paraqiten të mbipopulluar janë shkolla Dritas, me rreth 47 nxënës mbi kapacitet dhe shkolla Kasallë me rreth 100 nxënës mbi kapacitet.Meqënëse numri i nxënësve mbi kapacitet përbën rreth 2 klasa fizike, kjo problematikë mund të zgjidhet përmes ndërhyrjeve rehabilituese në shkollën ekzistuese, përmes një projekti tjetër të ardhëm me fokus rehabilitimin e infrastrukturave arsimore ekzistuese nga Bashkia Tiranë.

Harta 36 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9 vjeçare - Zall Herr



Konkluzione: Pas përcaktimit të numrit të nxënësve mbi kapacitetin maksimal të shkollave ekzistuese, është përllogaritur nevoja për shkolla të reja duke synuar pikërisht arritjen e standardit maksimal prej 30 nx/ klasë fizike. Sipas kësaj përllogaritjeje, janë të nevojshme 289 klasa të reja, të shpërndara në njësitë administrative sipas popullimit aktual me nxënës. Megjithatë, duke marrë në konsideratë edhe shkollat të cilat aktualisht janë në ndërtim e sipër (Shkolla 9-vjeçare në njësinë administrative 6, tek ish-kombinati tekstile dhe shkolla 9-vjecare në njësinë administrative 4, Selaudin Bekteshi), ky numër reduktohet në 243 klasa të reja të nevojshme. Të përkthyera në numër shkollash, për të plotësuar nevojën për 243 klasa të reja do të nevojiten 7 Shkolla[25] të reja. Këto shkolla të reja janë parashikuar në Njësitë Administrative ku numri i nxënësve banorë është mbi kapacitetin që kanë shkollat ekzistuese për t'i përballuar. Në disa Njësi Administrative, pavarësisht se rezulton nevoja për ndërtimin e disa shkollave të reja, numri I klasave të reja të nevojshme nuk është I mjaftueshëm për planifikimin e një shkolle të re. Në këto raste problemet me mbipopullimin kanë qënë më të pakta, dhe janë të zgjidhshme përmes ndërhyrjeve rikonstruktuese të ndërtesave ekzistuese.Përsa i përket rastit të Njësisë Administrative 6, paçka se nevoja për shtim kapaciteti rezulton në këtë njësi, kjo nevojë ka lindur kryesisht si pasojë e mungesës së shërbimeve arsimore të mjaftueshme në zonën rezidenciale të Yzberishtit, pjesë e Njësisë Administrative Kashar. Për këtë arsye, duke parë edhe mbulueshmërinë e dobët me rreze shërbimi të kësaj zonë, shkollat e nevojshme në Njësinë Administrative 6 do të parashikohen në Yzberisht.

Nga ana tjetër, duke vlerësuar shpërndarjen e infrastrukturës arsimore ekzistuese në territor, vërehen disa zona rezidenciale të konsiderueshme të pambuluara me rrezen e shërbimit të ciklit 9-vjeçar. Këto zona kryesisht shtrihen në pjesën veriore të Bashkisë Tiranë, më konkretisht në pjesën veriore të njësive 8 dhe 9. Pikërisht në këtë pjesë të qytetit, përmes disa dokumenteve të planifikimit të territorit (PPV 2013, projekti për zgjatimin e bulevardit nga Grimshaë Architects, dhe draft PPV 2016) parashikojnë zgjatimin e bulevardit të Tiranës dhe nxitjen e zhvillimit të qytetit në këtë drejtim. Kjo do të thotë që zona parashikohet të densifikohet dhe të ofrojë, përveç hapësirave rezidenciale dhe tregëtare, edhe hapësira rekreative, arsimore dhe sociale mbështetëse. Për këtë arsye, në secilën prej këtyre njësive janë identifikuar në vijim troje të përshtatshme për 2 shkolla 9-vjeçare.

Po ashtu, përmes analizimit të rrezeve të shërbimit të shkollave 9-vjeçare ekzistuese, është evidentuar që zona rezidenciale pranë kopështit botanik dhe liqenit të thatë, pjesë e NjA Farkë, e cila ka një densitet zhvillimi relativisht të lartë, mbetet e pambuluar mirë nga ky shërbim. Duke pasur parasysh dendësinë e kësaj zonë, është parashikuar edhe një shkolle tjetër 9-vjeçare në këtë zonë. Ky propozim është mbështetur gjithashtu edhe në parashikimet e instrumenteve të planifikimit të territorit të kësaj njësie, të cilat kanë qënë në fuqi deri në hartimin e draft-PPV 2016.

Në përfundim të kësaj analize të thelluar sasiore, cilësore dhe hartografike, rezulton se në Bashkinë e Tiranës është i nevojshëm **ndërtimi i 10 shkollave të reja 9-vjeçare** për të arritur cilësinë e shërbimit e cila specifikohet në objektivat e këtij studimi.

25 Madhësia e shkollave varion nga 20-30 klasa për shkollë. Në rastin konkret, përllogaritja e shkollave është bërë rast pas rasti, sipas numrit total të klasave të nevojshme për secilën Njësi Administrative

Tabela 11 - Numri i shkollave të nevojshme

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx banues)	SHKOLLA TË REJA PËR SHTIM KAPACITETI	SHKOLLA TË REJA PËR MBULIM ME RREZE SHËRBIMI
1	NjA 1	-3	0	0
2	NjA 2	-62	2	0
3	NjA 3	-8	0	0
4	NjA 4	0	0	0
5	NjA 5	-31	1	0
6	NjA 6 (Yzberisht)	-71	2	0
7	NjA 7	16	0	0
8	NjA 8	33	0	1
9	NjA 9	-6	0	1
10	NjA 10	10	0	0
11	NjA 11	-58	2	0
	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	-239	7	2
12	NjA DAJT	21	0	0
13	NjA FARKË	16	0	1
14	NjA VAQARR	12	0	0
15	NjA KASHAR	6	0	0
16	NjA NDROQ	20	0	0
17	NjA PETRELË	30	0	0
18	NjA PEZË	20	0	0
19	NjA BALDUSHK	22	0	0
20	NjA BËRZHITË	31	0	0
21	NjA KRRABË	11	0	0
22	NjA SHËNGJERGJ	28	0	0
23	NjA ZALL BASTAR	51	0	0
24	NjA ZALL HERR	-4	0	0
	ZONA RURALE TIRANË TOTAL	-4	0	1
	TOTAL BASHKIA TIRANË	-243	7	3

3.3.2. Arsimi i mesëm

Metodologjia e ndjekur për këtë analizë është e njëjtë me metodologjinë e shpjeguar më lart për nivelin arsimor 9-vjeçar. Gjatë hartimit të kësaj analize, janë marrë në shqyrtim 30 shkolla të mesme në Bashkinë e Tiranës, duke përfshirë Shkollat e mesme të bashkuara. Shkollat e mesme të marra në shqyrtim në këtë studim paraprak, nuk përfshijnë shkollat me kurikula të veçanta mësimore si shkollat e ndryshme profesionale.

Gjatë hartimit të kësaj analize, dy kanë qenë elementët kryesore të marra në konsideratë: Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore dhe shpërndarja e tyre në territor.

Njësoj si me shkollat e ciklit 9-vjeçar, analiza e kapacitetit ekzistues të infrastrukturave arsimore është hartuar duke trajtuar dy elemente kryesore. **Elementi i parë** i trajtuar ka të bëjë me kapacitetin ekzistues të infrastrukturave arsimore për t'i shërbyer nxënësve që frekuentojnë këto infrastruktura. Numri i klasave të nevojshme për të plotësuar kapacitetin e infrastrukturave arsimore sipas frekuentimit aktual të tyre është 81 i shpërndarë në njësitë e mbipopulluara që janë Njësitë 2, 5 dhe 9. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme si dhe në Aneks 2.

Tabela 12 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit të mesëm të lartë përkundrejt nxënësve frekuentues

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	NR NX.	KLASA MËSIMORE	NX/KL	KLASA FIZIKE	KLASA TË PA SHFRYTËZUARA	NX/KL FIZIKE	NX NËSE MES. ËSHTË 30 NX/KL	BILANCI PËR NX EKSTRA (sipas nx frekuentues)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx frekuentues)
1	NjA1	360	11	32.7	15	0	24.0	450	90	3
2	NjA2	2249	61	36.9	45	1	50.0	1350	-899	-30
3	NjA3	1048	33	31.8	35	2	29.9	1050	2	0
4	NjA4	392	16	24.5	26	10	15.1	780	388	13
5	NjA5	2229	66	33.8	64	0	34.8	1920	-309	-10
6	NjA6	1107	33	33.5	33	1	33.5	990	-117	-4
7	NjA7	604	18	33.6	16	0	37.8	480	-124	-4
8	NjA8	855	27	31.7	27	0	31.7	810	-45	-2
9	NjA9	2235	68	32.9	48	1	46.6	1440	-795	-27
10	NjA10	1201	39	30.8	39	0	30.8	1170	-31	-1
11	NjA11	575	19	30.3	23	3	25.0	690	115	4
	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	12855	391	32.9	371	18	34.6	11130	-2320	-77
12	NjA DAJT	320	15	21.3	15	2	21.3	450	130	4
13	NjA FARKË	605	25	24.2	18	0	33.6	540	-65	-2
14	NjA VAQARR	440	18	24.4	18	0	24.4	540	100	3
15	NjA KASHAR	1024	42	24.4	36	2	28.4	1080	56	2
16	NjA NDROQ	270	11	24.55	11	0	24.55	330	60	2

17	NjA PEZË	186	12	15.5	9	0	20.7	270	84	3
18	NjA PETRELË	302	10	30.2	11	0	27.45	330	28	1
19	NjA BALDUSHK	321	13	24.7	13	0	24.7	390	69	2
20	NjA BERZHITË	381	26	14.7	29	0	13.1	870	489	16
21	NjA KRRABË	370	18	20.6	19	1	19.5	570	200	7
22	NjA SHËNGJERGJ	198	11	18.0	15	0	13.2	450	252	8
23	NjA ZALL BASTAR	248	15	16.5	15	0	16.5	450	202	7
24	NjA ZALL HERR	1000	32	31.25	32	1	31.25	960	-40	-1
	ZONAT RURALE TIRANË TOTAL	5665	248	23	241	6	23.51	7230	-105	-4
	TOTAL BASHKIA TIRANË	18520	639	29	612	24	30.3	18360	-2425	-81

Njësoj si me shkollat e ciklit 9-vjeçar, edhe me ciklin e mesëm të lartë është vënë re fenomeni i mbipopullimit të disa shkollave si rezultat i frekuentimit të tyre edhe nga nxënës që vijnë nga jashtë njësisë administrative, të cilës supozohet t'i shërbejë kjo shkollë; që ka të bëjë me **çështjen e dytë të trajtuar** në kuadër të analizës së kapaciteteve ekzistuese. Në Nenin 14, të Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, pika 1, thuhet shprehimisht *"Drejtori i shkollës nuk regjistron nxënës nga zonat që nuk i përkasin shkollës kur a) krijohen klasa me numër nxënësish mbi normën e përcaktuar në udhëzimin e ministrit; b) nuk ka mësues të mjaftueshëm për hapjen e klasave të reja*". Megjithatë, ky fenomen vazhdon të përsëritet në disa raste. Për këtë arsye, siç shpjegohet më sipër në Metodologjinë e Studimit, analiza është fokusuar mbi identifikimin e nevojës për infrastruktura të reja arsimore në secilën njësi administrative, <u>nëse secili nga nxënësit do frekuentonte një nga shkollat përkatëse brenda njësisë administrative ku banon.</u>

Sipas kësaj qasje, numri total i klasave të nevojshme për të plotësuar kapacitetin e infrastrukturave arsimore për ciklin e mesëm të lartë është 96, i shpërndarë në Njësitë Administrative të mbipopulluara si Njësia 2, 6, 7 dhe 11. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme si dhe në Aneks 2.

Tabela 13 - Kapaciteti ekzistues i infrastrukturave arsimore të ciklit të mesëm të lartë përkundrejt nxënësve banues në secilën NjA

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	NR NXËNËSISH	KLASA FIZIKE	KL. TË PA SHFRYTËZUARA	NX/KL FIZIKE	NX NËSE MES. ËSHTË 30 NX/KL	BILANCI PËR NX EKSTRA (sipas nx banues)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx banues)
1	NjA1	360	15	0	24.0	450	-72	-2
2	NjA2	2249	45	1	50.0	1350	-971	-32

3	NjA3	1048	35	2	29.9	1050	222	7
4	NjA4	392	26	10	15.1	780	-36	-1
5	NjA5	2229	64	0	34.8	1920	575	19
6	NjA6	1107	33	1	33.5	990	-528	-18
7	NjA7	604	16	0	37.8	480	-532	-18
8	NjA8	855	27	0	31.7	810	280	9
9	NjA9	2235	48	1	46.6	1440	451	15
10	NjA10	1201	39	0	30.8	1170	788	26
11	NjA11	575	23	3	25.0	690	-587	-20
	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	12855	371	18	34.6	11130	-2726	-91
12	NjA DAJT	320	15	2	21.3	450	14	0
13	NjA FARKË	605	18	0	33.6	540	-106	-4
14	NjA VAQARR	440	18	0	24.4	540	30	1
15	NjA KASHAR	1024	36	2	28.4	1080	242	8
16	NjA NDROQ	270	11	0	24.55	330	128	4
17	NjA PEZË	186	9	0	20.7	270	61	2
18	NjA PETRELË	302	11	0	27.45	330	153	5
19	NjA BALDUSHK	321	13	0	24.7	390	65	2
20	NjA BERZHITË	381	29	0	13.1	870	432	14
21	NjA KRRABË	370	19	1	19.5	570	201	7
22	NjA SHËNGJERGJ	198	15	0	13.2	450	23	1
23	NjA ZALL BASTAR	248	15	0	16.5	450	163	5
24	NjA ZALL HERR	1000	32	1	31.25	960	-49	-2
	ZONAT RURALE TIRANË TOTAL	5665	241	6	23.51	7230	-155	-5
	TOTAL BASHKIA TIRANË	18520	612	24	30.26	18360	-2881	-96

Siç vërehet nga rezultatet e analizës së mësipërme, numri total i klasave të nevojshme në të dyja rastet është i ngjashëm , por shpërndarja e nevojës në territor ndryshon. Hartat 37 dhe 38 tregojnë ndryshimin e shpërndarjes së nevojës për klasa të reja në territor sipas dy qasjeve të analizës.

Kjo do të thotë që nëse ndërhyrja me infrastruktura të reja arsimore do të bëhet duke marrë për bazë njësitë administrative të cilat presin fluks më të lartë nxënësish, të cilët shpesh janë banorë jashtë këtyre njësive, atëherë një numër i konsiderueshëm klasash të reja duhet të parashikohen në Njësitë Administrative 2 dhe 9. Nga ana tjetër, nëse ndërhyrja me infrastruktura të reja arsimore do të bëhet duke marrë parasysh njësitë administrative në të cilat banojnë më shumë nxënës të moshës frekuentuese të ciklit të mesëm, atëherë ndërhyrja do të fokusohet akoma më shumë në njësi administrative të cilat nuk kanë mjaftueshëm infrastruktura arsimore ekzistuese dhe për pasojë nuk i shërbejnë dot numrit të nxënësve banues në to, si përshembull njësitë 2, 6, 7 dhe 11. Tabela 14 e tregon më qartë diferencën mës numrit të nxënësve banues dhe nxënësve frekuentues të shkollave në secilën Njësi Administrative.

Harta 37 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit frekuentojnë shkollën (Cikli i mesëm i lartë)



Harta 38 - Nevoja për klasa të reja sipas njësive ku nxënësit banojnë (Cikli i mesëm i lartë)



Tabela 14 - Vendbanimi i nxënësve dhe Njësia Administrative ku frekuentojnë shkollën (Cikli i mesëm i lartë)

VENDBANIMI I NXENESVE	NJESIA KU FREKUENTOJNE SHKOLLEN																										
NJESIA ADMINISTRATIVE	NJA1	NJA2	NJA3	NJA4	NJA5	NJA6	NJA7	NJA8	NJA9	NJA10	NJA11	NJA DAJT	NJA FAKRE	NJA VAQARR	NJA KASHAR	NJA NDROQ	NJA PEZE	NJA PETRELE	NJA BALDUSHK	NJA BERZHITE	NJA KRRABE	NJA SHENGJERGJ	NJA ZALL BASTAR	NJA ZALL HERR	TOTAL	TOTAL JASHTE NJESISE	%
NJESIA ADM 1	349	23	10		42	3			61	9			12		12										521	172	33.0%
NJESIA ADM 2		1980	20		119	1			157	10			18		15										2320	340	14.7%
NJESIA ADM 3		2	733		21	6			51	6					7		1								827	94	11.4%
NJESIA ADM 4			209	360	24	1			178	14	6				8										800	440	55.0%
NJESIA ADM 5		3			1217	8			73	23					21										1345	128	9.5%
NJESIA ADM 6		1			305	950			100	49	6			7	96		3								1517	567	37.4%
NJESIA ADM 7		1			255	7	422		150	167	5				5										1012	590	58.3%
NJESIA ADM 8		2			30	2		855	207	11					7										1114	259	23.2%
NJESIA ADM 9					36	2			532	401	6				13										990	458	46.3%
NJESIA ADM 10		1			71	1			126	177					6										382	205	53.7%
NJESIA ADM 11					38	2			361	317	542				18										1278	736	57.6%
NJA DAJT			42	31	12				18			320			13										436	116	26.6%
NJA FARKE		39			22				10				574		1										646	72	11.1%
NJA VAQARR						60								431	18		1								510	79	15.5%
NJA KASHAR					10	29			42	6	6				745										838	93	11.1%
NJA NDROQ						15									18		1								34		
NJA PEZE						15								2	11		180								208	28	13.5%
NJA PETRELE															4										4		
NJA BALDUSHK		1													3				321						325	4	1.2%
NJA BERZHITE					1					1					5					456	5				468	12	2.6%
NJA KRRABE																					369				369	0	0.0%
NJA SHENGJERGJ			31																			198			229	31	13.5%
NJA ZALL BASTAR									7														280		287	7	2.4%
NJA ZALL HERR									2	1	6														9		
TOTAL	**349**	**2053**	**1045**	**391**	**2203**	**1102**	**422**	**855**	**2075**	**1192**	**577**	**320**	**604**	**440**	**1026**	**0**	**186**	**0**	**321**	**456**	**374**	**198**	**280**	**0**			
TOTAL NGA JASHTE NJESISE	0	73	312	31	986	152	0	0	1543	1015	35	0	30	9	281	0	6	0	0	0	5	0	0	0			
%	0.0%	3.6%	29.9%	7.9%	44.8%	13.8%	0.0%	0.0%	74.4%	85.2%	6.1%	0.0%	5.0%	2.0%	27.4%		3.2%		0.0%	0.0%	1.3%	0.0%	0.0%				

Open Procurement Albania

Fenomeni i mbipopullimit të shkollave si rezultat i frekuentimit të tyre edhe nga nxënës jo banor të njësisë administrative të cilës këto shkolla duhet t'i shërbejnë, paraqitet qartë në dy hartat e mëposhtme. Harta 39 tregon përqindjen e nxënësve frekuentues të shkollave të secilës Njësi Administrative të cilët nuk janë banorë të asaj njësie. Siç vërehet, njësitë 3, 5, 9, 10 dhe Kashar janë njësi në të cilat shkollat e mesme mbipopullohen nga nxënës që nuk janë banorë të këtyre njësive. I njëjti fenomen paraqitet edhe në Hartën 40. Kjo hartë tregon nivelin e mbipopullimit të shkollave të mesme, përmes madhësisë dhe ngjyrës së rrathëve (rrathët me ngjyrë të kuqe tregojnë shkollat më të mbipopulluara). Ndërkohë, kjo shtresë informacioni është mbivendosur me numrin e nxënësve banues në secilën Njësi Administrative. Siç vërehet edhe në hartë, jo gjithmonë mbipopullimi i shkollave përkon me Njësitë Administrative me numër më të lartë nxënësish banues. Kjo ndodh pikërisht për shkakun e përmendur më lart – frekuentimi i shkollave nga nxënës banorë të njësive të tjera fqinje. Këta nxënës udhëtojnë çdo ditë drejt shkollave në fjalë nga vendbanimi i tyre, më shumë sesa standardi i parashikuar për ciklin e mesëm të lartë që është 1000 m në vijë ajrore për zonat urbane. Një ndërhyrje me infrastruktura të reja arsimore në këto Njësi Administrative nuk do ta zgjidhte këtë problem. Ndaj është parë e arsyeshme që parashikimet për infrastruktura të reja arsimore të bëhen duke marrë parasysh numrin e nxënësve banues në secilën Njësi Administrative si dhe shpërndarjen në territor të shkollave ekzistuese dhe rrezeve të mbulimit me shërbim përkatëse.

Harta 39 - Përqindja e nxënësve frekuentues të shkollave jo banor/ nxënësve banor të secilës NjA



Harta 40 - Mbipopullimi i shkollave dhe vendbanimi i nxënësve – cikli i mesëm i lartë (Shenim: vlerat negative tregojnë numrin mbi kapacitet për secilën shkollë)



Njësia Administrative 1

Kjo njësi administrative ka gjithsej 522 nxënës banues dhe 300 nxënës frekuentues të shkollës së mesme të kësaj njësie. Shkolla e mesme e vetme e kësaj njësie, "Avdulla Keta" ka një mesatare prej rreth 24 nxënës/ klasë fizikë. Rreth 100 nxënës banorë të kësaj njësie frekuentojne shkollat e njësive administrative 5 dhe 9 ("P.Nini Luarasi", "Besnik Sykja", "Sami Frashëri" dhe "Sinan Tafaj"). Përsa i përket mbulueshmërisë me rreze shërbimi, duhet thënë që ka zona të kësaj njësie që mbeten jashtë rrezes së mbulimit, siç paraqitet në hartën e mëposhtme:

Harta 41 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 1



Njësia Administrative 2

Kjo njësi administrative ka gjithsej 2321 nxënës banues dhe 2249 nxënës frekuentues të shkollave të mesme të kësaj njësie. Shkolla e mesme "Ismail Qemali" ka rreth 900 nxënës mbi kapacitetin e akomodimit, ndërkohë që shkolla e mesme "Sandër Prosi" ka frekuentueshmëri brenda kapaciteteve. Njësia ka mbulueshmëri me rreze shërbimi të mirë, siç paraqitet në hartën e mëposhtme:

Harta 42 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 2



Njësia Administrative 3

Kjo njësi administrative ka gjithsej 828 nxënës banues dhe 1048 nxënës frekuentues shkollës së mesme të kësaj njësie, "Andon Zako Çajupi" e cila ka frekuentueshmëri brenda kapaciteteve që ka për akomodimin e nxënësve. Përsa i përket mbulimit me rreze shërbimi, kjo njësi paraqitet e mirëmbuluar:

Harta 43 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 3



Njësia Administrative 4

Kjo njësi administrative ka gjithsej 815 nxënës banues dhe 392 nxënës frekuentues të shkollës së mesme të kësaj njësie, "Eqerem Çabej". Kjo shkollë shfrytëzohet në masën thuajse 50% të kapacitetit që ka për të akomoduar nxënës, ndërkohë që rreth 200 nxënës banues të kësaj njësie administrative frekuentojnë shkollat e mesme të njësisë administrative 9, sidomos shkollën "Sami Frashëri". Një pjesë e njësisë mbetet e pambuluar me rrezen e shërbimit të shkollës së mesme, siç paraqitet në vijim:

Harta 44- Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 4



Njësia Administrative 5

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1345 nxënës banues dhe 2229 nxënës frekuentues të shkollave të mesme të kësaj njësie. Shkolla e mesme "Petro Nini Luarasi" akomodon 300 nxënës mbi kapacitetin infrastrukturor që ajo, ndërkohë që shkolla e mesme "Besnik Sykja" funksionon normalisht me një mesatare prej 31 nxënës/klasë fizike. Njësia është e mirëmbuluar me rreze shërbimi:

Harta 45 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 5



Njësia Administrative 6

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1517 nxënës banues dhe 1107 nxënës frekuentues të shkollës së mesme "Myslym Keta", e cila aktualisht ka rreth 120 nxënës mbi kapacitetin akomodues. Ndërkohë, rreth 300 nxënës banorë të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e mesme në njësinë administrative 5, kryesisht shkollën "Besnik Sykja", dhe rreth 100 gjimnazistë të tjerë të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e mesme në njësinë administrative 9. Përsa i përket rrezes së mbulimit, zona rezidenciale përgjatë unazës së re mbetet e pambuluar nga kjo rreze, siç tregohet mëposhtë:

Harta 46 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 6



Njësia Administrative 7

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1012 nxënës banues dhe 604 nxënës frekuentues të shkollës së mesme "Arben Broci". Kjo shkollë ka aktualisht rreth 120 nxënës mbi kapacitet. Mbi 500 nxënës të kësaj njësie frekuentojnë shkollat e mesme të njësive administrative 5, 9 dhe 10. Siç vërehet edhe në hartën e mëposhtme, zona nuk është e gjitha e mirëmbuluar me rrezen e shërbimit të shkollës së mesme "Arben Broci":

Harta 47- Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 7



Njësia Administrative 8

Kjo njësi administrative ka gjithsej 529 nxënës banues dhe 855 nxënës frekuentues të shkollës së mesme "Partizani", e cila paraqitet lehtësisht e mbipopulluar. Rreth 200 nxënës banues të kësaj njësie frekuentojnë shkollat "Sami Frashëri" dhe "Sinan Tafaj" në njësinë 9. Pothuajse gjysma e territorit të njësisë administrative nuk mbulohet me rreze shërbimi të shkollës së mesme.

Harta 48 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 8

Njësia Administrative 9

Kjo njësi administrative ka gjithsej 989 nxënës banues dhe 2235 nxënës frekuentues të shkollave të mesme "Sami Frashëri" dhe "Sinan Tafaj". Shkolla "Sami Frashëri" ka rreth 700 nxënës mbi kapacitet ndërkohë që shkolla "Sinan Tafaj" ka rreth 100 nxënës mbi kapacitet. Më pak se 30% e nxënësve të këtyre shkollave janë banorë të njësisë administrative 9, çka risjell në vëmendje problematikat e krijuara nga mosrespektimi i dispozitave normative për frekuentimin e shkollave sipas zonave të banimit. Mbulueshmëria e njësisë me rreze shërbimi tregohet në hartën e mëposhtme:

Harta 49 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 9

Njësia Administrative 10

Kjo njësi administrative ka gjithsej 381 nxënës banues dhe 1201 nxënës frekuentues të shkollës "Qemal Stafa". Kjo shkollë nuk paraqitet e mbipopulluar dhe njësia shërbehet me rreze mbulimi, siç tregohet mëposhtë:

Harta 50 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA 10

Njësia Administrative 11

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1277 nxënës banues dhe 575 nxënës frekuentues të shkollës së mesme "Aleks Buda". Rreth 300 nxënës banorë të kësaj njësie janë frekuentues së shkollave të njësisë administrative 9. Po ashtu, mbulueshmëria e njësisë me rreze shërbimi nuk është optimale:

Harta 51 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - Nja 11



Njësia Administrative Kashar

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1024 nxënës banues dhe 837 nxënës frekuentues të shkollave të mesme të kësaj njësie. Shkolla "Myslym Shima" ka rreth 150 nxënës mbi kapacitet. Siç vërehet edhe në hartën e mëposhtme, megjithëse për njësinë administrative Kashar është aplikuar rrezja e shërbimit të shkollave të mesme prej 2000m, siç parashikohet nga rregullorja e planifikimit në zonat rurale, zona rezidenciale e Yzberishtit nuk ka në afërsi të saj struktura arsimore të mesme. Kjo zonë tashmë e urbanizuar dhe me tipare tipologjike urbane, shërbehet kryesisht nga shkollat e njësisë administrative 6, duke krijuar problem me mbipopullimin e shkollave në këtë njësi.

Harta 52 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Kashar



Njësia Administrative Farkë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 605 nxënës banues dhe 646 nxënës frekuentues të shkollës së mesme. Shkolla e mesme "Farkë", e cila funksionon bashkë me shkollën 9-vjeçare, paraqitet lehtësisht e mbipopulluar me rreth 65 nxënës mbi kapacitet. Mbulueshmëria e kësaj njësie me rreze shërbimi paraqitet mëposhtë:

Harta 53 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Farkë



Njësia Administrative Dajt

Kjo njësi administrative ka gjithsej 320 nxënës banues dhe 435 nxënës frekuentues të shkollës së mesme. Siç vërehet edhe në hartën e mëposhtme, megjithëse për njësinë administrative Dajt është aplikuar rrezja e shërbimit të shkollave të mesme prej 2000m, siç parashikohet nga rregullorja e planifikimit në zonat rurale, zona rezidenciale në Qesarakës nuk ka në afërsi të saj struktura arsimore të mesme. Kjo zonë tashmë e urbanizuar dhe me tipare tipologjike urbane, ndaj duhet vlerësuar me kujdes gjatë planifikimit të strukturave të reja arsimore

Harta 54 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Dajt



Njësia Administrative Vaqarr

Kjo njësi administrative ka gjithsej 440 nxënës banues dhe 509 nxënës frekuentues të shkollës së mesme. Kjo shkollë ka një mesatare prej 24.4 nxënës/klasë fizike dhe nuk paraqet problem me mbipopullimin. Kjo njësi mbulohet me rreze shërbimi si mëposhtë:

Harta 55 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Vaqarr



Njësia Administrative Ndroq

Kjo njësi administrative ka gjithsej 160 nxënës banues dhe 270 nxënës frekuentues të shkollës së mesme. Kjo shkollë ka një mesatare prej 24.5 nxënës/klasë fizike dhe nuk paraqet problem me mbipopullimin. Kjo njësi mbulohet me rreze shërbimi si mëposhtë:

Harta 56 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Ndroq



Njësia Administrative Pezë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 186 nxënës banues dhe 208 nxënës frekuentues të shkollës së mesme, e cila aktualisht ka një mesatare prej 20.7 nxënës/ klasë fizike.

Harta 57 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Pezë



Albania

Njësia Administrative Baldushk

Kjo njësi administrative ka gjithsej 321 nxënës banues dhe 324 nxënës frekuentues të shkollës së mesme, e cila aktualisht ka një mesatare prej 24.6 nxënës/ klasë fizike.

Harta 58 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Baldushk



Albania

Njësia Administrative Bërzhitë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 456 nxënës banues dhe 467 nxënës frekuentues të shkollave të mesme, Mersin Duqi dhe Kllojkë, të cilat nuk paraqesin probleme mbipopullimi.

Harta 59 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Bërzhitë



Njësia Administrative Krrabë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 374 nxënës banues dhe 369 nxënës frekuentues të shkollës së mesme, e cila aktualisht ka një mesatare prej 19.6 nxënës/ klasë fizike.

Harta 60 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Krrabë



Albania

Njësia Administrative Shëngjergj

Kjo njësi administrative ka gjithsej 198 nxënës banues dhe 229 nxënës frekuentues të shkollës së mesme, e cila aktualisht ka një mesatare prej 13.2 nxënës/ klasë fizike.

Harta 61 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Shëngjergj



Albania

Njësia Administrative Zall Bastar

Kjo njësi administrative ka gjithsej 280 nxënës banues dhe 286 nxënës frekuentues të shkollës së mesme, e cila aktualisht ka një mesatare prej 18.6 nxënës/ klasë fizike.

Harta 62 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Zall Bastar



Albania

Njësia Administrative Zall Herr

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1008 nxënës banues dhe 1000 nxënës frekuentues të dy shkollave të mesme të bashkuara. Shkolla e mesme e bashkuar Kasallë paraqitet e mbipopulluar, ndërsa shkolla M.K. Ataturk paraqitet me mesatare më pak se 30 nxënës/klasë.

Harta 63 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Zall Herr



Njësia Administrative Petrelë

Kjo njësi administrative ka gjithsej 177 nxënës banues dhe 302 nxënës frekuentues të dy shkollave të mesme të bashkuara. Shkolla e mesme Ibrahim Hasmema ka një mesatare nxënësish prej 30.2 nxënës. Mbulueshmëria me rreze shërbimi tregohet në hartën e mëposhtme:

Harta 64 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të Mesme - NjA Petrelë



Konkluzione: Pas përcaktimit të numrit të nxënësve mbi kapacitetin maksimal të shkollave ekzistuese, është përllogaritur nevoja për shkolla të reja duke synuar pikërisht arritjen e standardit maksimal prej 30 nx/ klasë fizike. Sipas kësaj përllogaritjeje, janë të nevojshme 96 klasa të reja, të shpërndara në njësitë administrative sipas popullimit aktual me nxënës. Të përkthyera në numër shkollash, për të plotësuar nevojën për 96 klasa të reja do të nevojiten 4 Shkolla[26] të reja. Këto shkolla të reja janë parashikuar në Njësitë Administrative ku numri i nxënësve banorë është mbi kapacitetin që kanë shkollat ekzistuese për t'i përballuar. Me të njëjtën racionale të ndjekur në analizën e nevojave për shkollat 9-vjeçare, përsa i përket rastit të Njësisë Administrative 6, paçka se nevoja për shtim kapaciteti rezulton në këtë njësi, kjo nevojë ka lindur kryesisht si pasojë e mungesës së shërbimeve arsimore të mjaftueshme në zonën rezidenciale të Yzberishtit, pjesë e Njësisë Administrative Kashar. Për këtë arsye, duke parë edhe mbulueshmërinë e dobët me rreze shërbimi të kësaj zonë, shkollat e nevojshme në Njësinë Administrative 6 do të parashikohen në Yzberisht.

26 Madhësia e shkollave varion nga 20-30 klasa për shkollë. Në rastin konkret, përllogaritja e shkollave është bërë rast pas rasti, sipas numrit total të klasave të nevojshme për secilën Njësi Administrative

Po ashtu siç shprehet në analizën e shkollave 9-vjeçare, edhe në rastin e shkollave të mesme vërehen disa zona rezidenciale të konsiderueshme të pambuluara me rrezen e shërbimit. Këto zona kryesisht shtrihen në pjesën veriore të Bashkisë Tiranë, më konkretisht në pjesën veriore të njësive 8 dhe 9. Pikërisht në këtë pjesë të qytetit, disa dokumenteve të planifikimit të territorit (PPV 2013, projekti për zgjatimin e bulevardit nga Grimshaë Architects, dhe draft PPV 2016) parashikojnë zgjatimin e bulevardit të Tiranës dhe nxitjen e zhvillimit të qytetit në këtë drejtim. Kjo do të thotë që zona parashikohet të densifikohet dhe të ofrojë, përveç hapësirave rezidenciale dhe tregëtare, edhe hapësira rekreative, arsimore dhe sociale mbështetëse. Për këtë arsye, në secilën prej këtyre njësive janë identifikuar në vijim troje të përshtatshme për 2 shkolla 9-vjeçare.

Po ashtu, përmes analizimit të rrezeve të shërbimit të shkollave të mesme ekzistuese, është evidentuar që zona rezidenciale "Fresku", pjesë e NjA Dajt, e cila ka një densitet zhvillimi relativisht të lartë, mbetet e pambuluar mirë nga ky shërbim. Duke pasur parasysh dendësinë e kësaj zonë, dhe tipologjinë tashmë urbane të saj, është vlerësuar i nevojshëm parashikimi i një shkolle të mesme në këtë zonë. Ky propozim është mbështetur gjithashtu edhe në parashikimet e instrumenteve të planifikimit të territorit të kësaj njësie, të cilat kanë qënë në fuqi deri në hartimin e draft-PPV 2016.

Në përfundim të kësaj analize të thelluar sasiore, cilësore dhe hartografike, rezulton se në Bashkinë e Tiranës është i nevojshëm ndërtimi i 7 shkollave të reja të mesme për të arritur cilësinë e shërbimit e cila specifikohet në objektivat e këtij studimi.

Open Procurement Albania

Tabela 15 - Numri i shkollave të reja

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE (NjA)	BILANCI KLASA TË TEPËRTA OSE TË MUNGUARA (sipas nx banues)	SHKOLLA TË REJA PËR SHTIM KAPACITETI	SHKOLLA TË REJA PËR MBULIM ME RREZE SHËRBIMI
1	NjA1	-2	0	0
2	NjA2	-32	1	0
3	NjA3	7	0	0
4	NjA4	-1	0	0
5	NjA5	19	0	0
6	NjA6	-18	1	0
7	NjA7	-18	1	0
8	NjA8	9	0	1
9	NjA9	15	0	1
10	NjA10	26	0	0
11	NjA11	-20	1	0
	ZONA URBANE TIRANË TOTAL	-91	4	2
12	NjA DAJT	0	0	1
13	NjA FARKË	-4	0	0
14	NjA VAQARR	1	0	0
15	NjA KASHAR	8	0	0
16	NjA NDROQ	4	0	0
17	NjA PEZË	2	0	0
18	NjA PETRELË	5	0	0
19	NjA BALDUSHK	2	0	0
20	NjA BERZHITË	14	0	0
21	NjA KRRABË	7	0	0
22	NjA SHËNGJERGJ	1	0	0
23	NjA ZALL BASTAR	5	0	0
24	NjA ZALL HERR	-2	0	0
	ZONAT RURALE TIRANË TOTAL	-5	0	1
	TOTAL BASHKIA TIRANË	-96	4	3

3.4. Analiza e infrastrukturës arsimore ekzistuese dhe asaj të nevojshme mbi bazën e numrit të popullsisë

Analiza ka vijuar edhe me përllogaritjen e nevojës për shkolla të reja duke iu referuar numrit të popullsisë sipas njësive administrative. Me referencë standardin prej 1 shkollë 9-vjeçare për 6000 banorë si dhe standardi prej 1 shkolle e mesme për 9000 banorë, përcaktuar në VKM nr. 671 "Për planifikimin e territorit" rezulton se Bashkia e Tiranës për vitin 2016 duhet të kishte edhe 54 shkolla 9-vjeçare dhe 64 shkolla të mesme të reja, përveç atyre ekzistuese.

Kjo analizë i referohet numrit aktual të popullsisë së Bashkisë Tiranë dhe projeksioneve për periudhën 2016 – 2031. Këto projeksione marrin për bazë popullsinë e vitit 2016, shpërndarjen sipas njësive administrative dhe sipas grupmoshave të marra nga gjendja civile. Për efekt të llogaritjeve, kësaj popullsie i janë aplikuar normat e ndryshimit të popullsisë së qarkut të Tiranës të marra nga "Projeksionet e Popullsisë 2011 – 2031".

Diferenca midis numrit që parashikojne standardet për planifikimin e territorit dhe numrit aktual të shkollave jep nevojën për shkolla të reja mbi bazën e popullsisë, për periudhën 2016 – 2031. Sipas standardit të numrit të shkollave për popullsi nevojitet që Bashkia e Tiranës të ndërtojë brenda vitit 2031 edhe 72 shkolla 9-vjeçare dhe 76 shkolla të mesme të reja. Në shumicën e rasteve, këto shkolla rezultojnë të nevojshme në zonën urbane ose periurbane. Megjithatë ka raste që rezulton i domodoshëm ndërtimi i një shkolle të re pavarësisht numrit të ulët të popullsisë në njësinë administrative përkatëse, pikërisht sepse standardi nuk parashikon një 'dysheme' popullsie për të cilën planifikohet infrastruktura arsimore.

Tabela 16 - Numri i shkollave të reja të nevojshme sipas standardit të popullsisë

	Viti	9-vjeçare	E mesme
Nr shkollash sipas popullsisë[27]	2016	54	64
	2021	7	4
	2026	5	5
	2031	6	3
Totali		**72**	**76**

Megjithatë, ky standard është vetëm orientues, për qëllime të planifikimit të territorit, dhe duhet të konsiderohet me rezerva. Duke qenë se përmbushja e standardit prej 30 nxënësve/klasë arrihet me ndërtimin e vetëm 10 shkollave 9-vjeçare dhe 7 shkollave të mesme, investimi për ndërtimin e 148 shkollave të reja do të përbënte një përdorim joefikas të financave publike. Po të mbahet parasysh së ndërtimi i 148 shkollave të reja kërkon një investim prej 48 miliardë lekë, një shumë rreth 10 herë më e lartë se buxheti faktik i vitit 2015 i Bashkisë Tiranë, rezulton se respektimi i këtij standardi është financiarisht i pamundur. Sidoqoftë, një pjesë e këtyre infrastrukturave të nevojshme mund të planifikohet të realizohen në afate kohore afatmesme dhe afatgjata; siç sugjeron edhe Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (draft), i cili parashikon nevojat afatgjata deri në vitin 2030.

[27] Shih Aneks 3 për të dhëna më të detajuara

3.5. Nevoja për kopshte

Problemi i mungesës së ambienteve, e si rrjedhim edhe mbipopullimi, nuk ka prekur vetëm shkollat e Tiranës, por edhe institucionet arsimore parashkollore si kopshtet. Ky problem është evident edhe për instucionet qendrore arsimore, si Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë, e cila nëpërmjet shkresës Nr. Prot. 3051, datë 05.08.2016 drejtuar Bashkisë Tiranë, evidenton mbipopullimin e kopshteve dhe kërkon zgjerimin e kapaciteteve apo ndërtimin e kopshteve të reja, sidomos në zonat me numër të madh popullsie apo që janë në zgjerim.

Duke u bazuar në këtë kërkesë, por edhe duke marrë parasysh kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve të Bashkisë Tiranë për shtim të ambienteve të kopshteve, është parë e nevojshme vlerësimi i mundësisë së integrimit të ambienteve të kopështeve në strukturat e parashikuar për arsimin 9-vjeçar.

Ndonëse popullsia e Tiranës ka ardhur gjithnjë e në rritje, numri i kopshteve publike, nga viti 2006 deri në vitin 2016 ka mbetur thuajse i pandryshuar. Aktualisht në Tiranë gjenden 43 kopshte. Sipas të dhënave nga DAR Tiranë, kapaciteti total i këtyre kopshteve është 5645 fëmijë, ndërkohë që në vitin 2015 kopshtet janë frekuentuar nga 7051 fëmijë. Një diferencë që tregon qartë mbipopullimin e kopshteve të Tiranës tej kapacitetit normal të tyre.

Tabela 17 - Numri i kopshteve sipas viteve

	Viti Akademik	'06-'07	'07-'08	'08-'09	'09-'10	'10-'11	'11-'12	'12-'13	'13-'14	'14-'15	'15-'16
Nr. Kopshte	Publike	44	44	44	44	45	43	42	43	43	43
	Jo publike	17	16	18	19	7	19	51	45	47	46

Open Procurement Albania

Sipas Udhëzimit Nr. 21, datë 23.7.2010 të Ministrisë së Arsimit, grupet e fëmijëve në kopshte në qytet formohen me jo më pak se 25 fëmijë. Nëse do të shohim raportin fëmijë për kopësht do të vemë re se kopshtet publike kanë mesatarisht 152 fëmijë për kopësht. Duke u bazuar në të dhënat e mëposhtme, rezulton qartazi se kopshtet e qytetit të Tiranës janë të mbipopulluar me një raport mesatar prej 50 fëmijë për grup, dyfishi i normës së lejuar.

Tabela 18 - Raporti fëmijë për kopësht

		Mesatare për periudhën '06-'16			
		Nr Kopshtesh	Nr. Fëmijësh	Raporti femijë për kopësht	Raporti fëmijë për grup (3 grupe)
Kopshte	Publike	44	6614	152	51
	Jo publike	29	902	32	11

Nga ana tjetër, për të përballuar nevojën në rritje për kopshte, vihet re një rritje konstante e numrit të kopshteve private. Në këtë mënyrë, numri i kopshteve private në Tiranë është rritur nga 17 në vitin 2006 në 46 në vitin 2016, një rritje prej 170%. Por, megjithë këtë rritje të numrit të kopshteve private, kapaciteti total i institucioneve arsimore parashkollore në Tiranë

(duke kombinuar kopshtet publike dhe private) është shumë herë më i ulët se nevojat e qytetit.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për vitin 2016, numri i fëmijëve të grup-moshës 3-5 vjeç është 27673. Ndërkohë, kapaciteti total i kopshteve publike e private të Tiranës, sipas Tabelës 2, është rreth 7500-8000 fëmijë. Nga kjo analizë rezulton se akualisht janë rreth 20 mijë fëmijë në Tiranë, që ndonëse janë në moshë e kanë të drejtën për të frekuentuar kopshtet, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë për shkak të mungesës së kapaciteteve në kopshtet ekzistuese.

Tabela 19 - Popullsia e Tiranës sipas grupmoshave për vitin 2016

Grup-mosha	0 - 2	3 – 4	5	6 – 15	16 – 18	19+	Total
Popullsia	16 807	18 544	9 129	90 690	29 441	615 920	780 531

Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve e kalojnë kohën nën kujdesin e familjarëve të tyre, të cilët si rrjedhojë nuk kanë mundësinë t'u përkushtohen aktiviteteve ditore si puna. Por, mos frekuentimi i kopshteve është më problematike për vetë fëmijët, të cilët nuk përfitojnë nga zhvillimi kognitiv, emocional e social në kopësht duke e pasur edhe më të vështirë adaptimin kur fillojnë shkollën.

Nga analiza e mësipërme rezulton se ndërtimi i kopshteve të reja është një domosdoshmëri jo vetëm për të zgjidhur problemin e mbipopullimit, por edhe për të plotësuar nevojën e madhe të familjeve të Tiranës për këtë shërbim. Prandaj, në të gjitha shkollat 9 vjeçare që do të ndërtohen nga ky program është parashikuar ndërtimi i kopshteve të integruara, të cilët do të kenë hyrje dhe oborr të veçantë. Ndërtimi i kopshteve të integruara, nga njëra anë, zgjidh problemin e mprehtë të mungesës së infrastrukturëse parashkollore, dhe, nga ana tjetër, ka kosto ndërtimi shumë më të ulët sesa po të ndërtoheshin si objekte të veçanta.

Open Procurement Albania

3.6. Parashikimi i nevojave afatmesme dhe afatgjata për infrastruktura të reja arsimore

Pas përcaktimit të numrit të nxënësve mbi kapacitetin maksimal të shkollave ekzistuese, është përllogaritur nevoja për shkolla të reja duke synuar pikërisht arritjen e standardit maksimal prej 30 nx/ klasë fizike si dhe mbulimin e të gjithë territorit të banuar konsiderueshëm me rrezet e shërbimit të arsimit parauniversitar. Sipas përllogaritjejeve të bëra, siç është shprehur dhe më lart në analizën e thelluar të gjendjes ekzistuese, për arritjen e standardit të kapacitetit maksimal prej 30 nxënësish/klasë nevojiten 243 klasa të reja për ciklin 9-vjeçar dhe 96 klasa të reja për ciklin e mesëm të lartë. Për plotësimin e këtyre standardeve nevojiten 7 shkolla të reja 9-vjeçare dhe 4 shkolla të reja të ciklit të mesëm të lartë.

Nga ana tjetër, duke vlerësuar shpërndarjen e infrastrukturës arsimore ekzistuese në territor, vërehen disa zona rezidenciale të konsiderueshme të pambuluara me rrezen e shërbimit të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm. Duke marrë parasysh zonat e pambuluara me rrezet e shërbimit të arsimit parauniversitar, si dhe parashikimet e instrumenteve të planifikimit të territorit të hartuara më parë dhe draft Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, propozimi

përfshin edhe 3 shkolla 9-vjeçare dhe 3 shkolla të mesme të tjera, përveç atyre të lartpërmendura.

Pra në total janë parashikuar të ndërtohen 10 shkolla të ciklit 9-vjeçar, të cilat do të përfshijnë edhe ambiente për kopshte brenda tyre, dhe 7 shkolla të ciklit të mesëm të lartë. Në vijim të parashikimeve për secilën.

Këto nevoja për kapacitetet e reja të domosdoshme të infrastrukturës arsimore, u akomoduan në shkolla me numër klasash sipas standardeve të specifikuara nga MAS përmes udhëzuesit "Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor.

Duke u nisur nga nevojat për kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe për të rritur efiçencën e këtij investimi, gjatë studimit janë marrë parasysh edhe këto nevoja duke parashikuar integrimin e hapësirave për kopështe në ndërtesat e ciklit 9-vjeçar. Këto hapësira mund të integrohen në të njëjtën ndërtesë, por me hyrje dhe oborr të veçantë, si dhe duke siguruar të gjitha parametrat teknikë të përshtatshëm që garantojnë sigurinë e fëmijëve dhe mbarëvajtjen e proçeseve edukative dhe të përkujdesit të fëmijëve të këtyre grupmoshave.

Referuar programit mësimor dhe standardeve të vendosura nga Ministria Arsimit dhe Sportit tipet e klasave, përmasat e tyre, hapësirat e nevojshme për çdo nivel, për arsimin 9-vjeçar do të jenë sipas tabelave Nr. 1- Nr. 4 (Aneks 4).

Referuar programit mësimor dhe standardeve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, tipet e klasave, përmasat e tyre, hapësirat e nevojshme për çdo nivel, për arsimin e mesëm të lartë do të jenë sipas tabelës Nr. 5 (Aneks 4). Në varësi të zonës ku do të ndërtohet shkolla, ato ndahen në shkolla në zonat rurale dhe shkolla në zonat urbane. Siç është parashikuar, numri mesatar i nxënësve në zonat urbane do të jetë 30 nxënës/ klasë, ndërsa në zonat rurale, me dendësi më të ulët banimi, 24 nxënës/klasë. Meqënëse nevoja për institucione arsimore në Njësinë Administrative të Dajtit është parashikuar në zonë të urbanizuar, është vendosur që për këtë rast të ndiqen standardet e zonës urbane.

Mbi këtë bazë, në total evidentohen 4 tipe shkollash:

Tabela 20 - Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

Në bazë të parashikimeve, shpërndarja e shkollave të reja sipas tipologjive të sipër-përmendura tregohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 21 - Shpërndarja e shkollave sipas tipologjisë

	9-vjeçare			E mesme		
NJESIA ADMINISTRATIVE	**Shkolla të reja**	**Tipologjia e shkollës**	**Nr nxënësish**	**Shkolla të reja**	**Tipologjia e shkollës**	**Nr nxënësish**
NJESIA ADMINISTRATIVE 1	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 2	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 3	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 4	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 5	**1**	Tipi 2 - 30 klasa	900	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 6	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 7	**0**	0	0	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 8	**1**	Tipi 1 - 20 klasa	600	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 9	**1**	Tipi 1 - 20 klasa	600	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 10	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 11	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA DAJT	**0**	0	0	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA FARKE	**1**	Tipi 3 - 20 klasa	480	**0**	0	0
NJA VAQARR	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA KASHAR	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA NDROQ	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA PEZE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA PETRELE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA BALDUSHK	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA BERZHITE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA KRRABE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA SHENGJERGJ	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA ZALL BASTAR	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA ZALL HERR	**0**	0	0	**0**	0	0
TOTAL	**10**		**7980**	**7**		**4410**

Open Procurement Albania

Identifikimi i trojeve për ndërtimin e shkollave është bërë duke pasur parasysh tabelën e mësipërme si dhe sipërfaqet e banuara të cilat nuk mbulohen nga rrezet e shërbimit të shkollave ekzistuese në secilën njësi administrative. Siç është referuar dhe më sipër, rrezet e shërbimit të objekteve arsimore në zonat urbane, në vijë ajrore, është 500-600 m për ciklin 9-vjeçar dhe 1000-1500m për ciklin e mesëm të lartë, ndërsa në zonat rurale është 1000-1500m për ciklin 9-vjeçar dhe 2000-4500m për ciklin e mesëm të lartë.

Përcaktimi i terreneve për ndërtimin e shkollave është bazuar në mundësitë reale të qytetit, me disa kritere bazë si:

- Shfrytëzimi i sipërfaqeve të lira, megjithëse të pakta, me pronësi publike

- Krijimi i skemave të menaxhimit të pronave përmes marrëveshjeve shtet-privat
- Menaxhimi i zonave ekonomike (ish zonat industriale) të cilat kanë sipërfaqe të konsiderueshme për zhvillim dhe ndodhen kryesisht në periferi të qytetit, aty ku ndodhen dhe nevojat më të mëdha për infrastrukturë arsimore
- Në rastet kur nuk është i mundur identifikimi i trojeve publike, janë identifikuar troje private të cilat do të shpronësohen
- Në të gjitha rastet, identifikimi i trojeve me sipërfaqe 1500-7000 m^2, siç përcaktohet nga Rregullorja e Planifikimit të Territorit (VKM nr.671)

Hartat e mëposhtme tregojnë shpërndarjen e shkollave ekzistuese dhe atyre të propozuara, sipas kritereve të mësipërme, si dhe rrezet e mbulimit të territorit.

Harta 65 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-veçare ekzistuese (kuqe) dhe të propozuara (kafe)



Harta 66 - Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme ekzistuese (gjelbër) dhe të propozuara (blu)



Open Procurement Albania

4. PROJEKTI TEKNIK

4.1. Vendodhja dhe trualli

4.1.1. Vendndodhja dhe alternativat e mundshme

Harta e mëposhtme tregon vendndodhjet e përzgjedhura për shkollat e propozuara të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm të lartë. Në total janë identifikuar 12 sheshe ndërtimi, në disa prej të cilave do parashikohen dy shkolla (9-vjeçare dhe e mesme) si objekte të veçanta dhe me oborre të ndara. Po ashtu, në këtë hartë gjendjen të propozuara edhe disa vendndodhje alternative, përkundrejt trojeve të përzgjedhura. Nëse për arsye të ndryshme ligjore apo teknike, ndonjëri prej trojeve të përzgjedhura nuk mund të vihet në dispozicion të realizimit të investimit, harta e mëposhtme tregon disa troje me karakteristika të ngjashme si alternativa. Me ngjyrë të kuqe dhe me rreze shërbimi janë shënuar sheshet e preferuara. Ndërsa me kontur blu janë shënuar disa sheshe alternative, të cilat do të kihen parasysh në rast se gjatë zbatimit të projektit rezulton i pamundur për arsye ligjore ose teknike shfrytëzimi i njërit prej shesheve të preferuara. Gjatë përcaktimit të vendndodhjes së shkollave, janë marrë parasysh sa më poshtë:

a. Shkollat e reja duhet të mbulojnë me rrezen e tyre të shërbimit (shkollat 9-vjeçare:500m, shkollat e mesme: 1000m) zonat e banuara që mbeten të pambuluara në secilën njësi administrative ku ato parashikohen
b. Shkollat e reja duhet të parashikohen në tokë truall, preferencialisht me pronësi shtetërore, me sipërfaqe për shkollat 9-vjeçare: 1500 m2 – 7000 m2, ndërsa për shkollat e mesme: 2000m2 – 7000m2
c. Parcelat e përzgjedhura duhet të jenë e aksesueshme nga infrastruktura rrugore dhe të shërbyera me infrastrukturë nëntokësore, ose lehtësisht të lidhshme me rrjetet inxhinierike nëntokësore, si dhe të plotësojnë të gjitha standardet për përcaktimin e vendndodhjes së objekteve arsimore parauniversitare, sipas legjislacionit sektorial në fuqi
d. Përcaktimi i vendndodhjes së shkollave të reja duhet të jetë i harmonizuar me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor që po hartohet nga Bashkia Tiranë.

Open Procurement Albania

Harta 67 - Sheshet e përzgjedhura dhe sheshet alternative për vendosjen e shkollave të propozuara



4.1.2. Sipërfaqe totale që do zihet në mënyrë të përhershme

SHESHI 2/3

Figura 6 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i prepezuar nr.2/3 për shkelë 9-vjeçare ndeshet pranë Drejtorisë së Higjienës. Akseshet nga rruga Mihal Grameno.

TË DHENA TEKNIKE : Sheshi 2/3 : 4093.5 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshte një zonë ne prenesi të subjekteve private, e rrethuar.
- Ka pjerrësi të konsiderueshme
- Ndodhet ne zonë me intensitet të lartë.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme.
- Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore.

SHESHI 2/6

Figura 8 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA:

Sheshi i prcpczuar nr. **2/6** për ndërtimin e një shkcllë 9 vjeçare dhe një shkclle të mesme ndcdhet në pjesën jugcre të qytetit të Tiranës, në njësinë administrative nr 2. Akseschet nga rruga "e Elbasanit" dhe rruga " Haxhi Aliaj".

TË DHËNA TEKNIKE: **Sheshi 2/6 :** 5425 m^2.

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:

- Është në një zcnë relativisht të qetë dhe lehtësisht e aksesueshme.
- Është një zcnë në zhvillim e sipër, me ndërtesa të ulëta 2-3 katëshe.
- Infrastruktura rrugcre është e mirë.

Figura 9 – Foto të sheshit 2/6

Open Procurement Albania

SHESHI 5/1

Figura 10 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i prepezuar nr.5/1 për shkellë 9-vjeçare ndodhet pranë zonës së liqenit. Akseshet nga rruga Hasan Alla dhe Autostrada Tiranë-Elbasan.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 5/1 : 3481 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Ndodhet pranë kopshtit botanik, një zonë me intensitet të larte banimi.
- Akses i lehtë.

Open Procurement Albania

Figura 11 - Foto të sheshit 5/1

SHESHI 6/3

Figura 12 – Ortofoto e sheshit

VENDODHJA: Sheshi i prcpczuar nr.**6/3,** për shkcllë 9-vjeçare dhe të mesme, ndcdhet pranë Kcmbinatit të mishit Yzberisht. Akseschet nga rruga "3 Deshmcrët".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 6/3 : 9103.5 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Akses i lehte.
- Në këtë zcne nuk ka shkclla të mesme.
- Zcna rreth e rrctull është e sistemuar dhe e gjelbëruar, duke paraqitur një zcnë të mire fcrmuar dhe të përshtatshme për ndërtimin e një shkclle të re.

Open Procurement Albania

Figura 13 - Foto të sheshit 6/3

SHESHI 6/6

Figura 14 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i prcpczuar nr.6/6, për shkcllë 9-vjeçare, ndcdhet prane rrethrrctullimit te Dcganes..Akseschet nga rruga Tecdcr Kekc dhe ndcdhet ne afersi te lumit Lana.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi6/6 : 4930 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Është një zcnë ne prcnësi të subjekteve private, e rrethuar.
- Ndcdhet pranë qendrës së banuar të zcnës dhe me intensitet të lartë.
- Akses i lehtë nga dy rrugë.
- Në këtë zcnë nuk ka shkclla të mesme.
- Prcblematike mund të jetë infrastruktura rrugcre.

Figura 15 - Foto nga sheshi 6/6

Open Procurement Albania

SHESHI 7/2

Figura 16 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i propozuar nr.7/2 ndodhet pranë Lumit Lana. Aksesohet nga rruga "Javer Malo" dhe " Stavri Themeli"

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 7/2 : 8482 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme, por kemi rritje të insitetit të banimit.
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Figura 17 - Foto nga sheshi 7/2

Open Procurement Albania

gura 18 – Ortofoto e sheshit

SHESHI 8/1

VENDODHJA : Sheshi i propozuar nr. **8.1** ndodhet pranë rrugës " 5 Maji" në njësinë 8.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 8.1: 17,520 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë e qetë relativisht.
- Aksesi në shesh është i lehte. Problematike mund te jete infrastruktura rrugore. Paraqet shumë aspekte pozitive, pasi ndodhet në një zonë me intensitet të lartë banimi.

Figura 19 - Foto nga sheshi 8/1

Open Procurement Albania

SHESHI 9/1

Figura 20 – Ortofoto e sheshit

VENDODHJA : Shesh i propozuar nr.9/1 ndodhet pranë lagjes "Don Bosko". Eshtë një zonë në zhvillim ku vërehen tipologji banimi shumë katëshe dhe banesa të ulëta një familjare informale.

TË DHENA TEKNIKE : Sheshi9/1:12,989 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë e qetë relativisht.
- Aksesi në shesh është i lehtë. Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore. Paraqet shumë aspekte pozitive, pasi ndodhet në një zonë me intensitet të lartë banimi.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mësme.
- Sheshi përfshin në territorin e tij një objekt të vjetër magazinimi, por shihet interesant për shkak të shtrirjes dhe sipërfaqes të madhe.

Figura 21 - Foto të sheshit 9/1

Open Procurement Albania

SHESHI 11/1

Figura 22 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr. 11/1 ndodhet brenda kompleksit universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky shesh kufizohet nga rruga "Taulantët" dhe bulevardi "Blu".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi11/1: Siperfaqe – 8,967 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :
- Eshtë një zonë e paprekur me gjelberim të ulët.
- Sheshi ka pjerrësi të konsiderueshme.
- Problematike është infrastruktura rrugore- Aksesi në shesh është i vështirë

Open Procurement Albania

Figura 23- Foto të sheshit 11/1

SHESHI 11/2

Figura 24 – Ortofoto te sheshit

VENDODHJA : Sheshi i propozuarnr. **11/2** ndodhet pranë rrethrrotullimit të Doganës. Aksesohet nga rruga Vangjel Noti.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 11/2: sip 14,102 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Ndodhet pranë qendrës se banuar të zonës.
- Akses i lehtë

Open Procurement Albania

Figura 25 - Foto të sheshit 11/2

SHESHI D2

Figura 26 – Ortofoto te sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr.D2 ndodhet pranë Lumit Lana . Aksesohet nga rruga "Dalip Troji".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi D2 : 14900 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Akses i vështirë
- Sheshi ndodhet pranë zonës së Kinostudios
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Open Procurement Albania

Figura 27 - Foto të sheshit D2

SHESHI F3

Figura 28 – Ortofoto te sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr.**F3**

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi F3 : 8340 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:

- Akses i vështirë
- Sheshi relativisht i pjerrët
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Open Procurement Albania

Figura 29 - Foto të sheshit F3

4.1.3. Statusi ligjor i trojeve që do zihen

Sheshi 2/3

Harta 68- Harta treguese e pronave



Tabela 22- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Shtet	Pasuri e okupuar	8190	6/471	13.50	66969			0.0
2	Nuk ka informacion	Ndërtesë	8190	6/246 - ND	0.00	66969		32113	0.0
3	Shtet	Sek.D kufiz. Ne administr.te trajtimit të studenteve	8190	6/678	1539.00	66969			0.0
4	Shtet	Sek.D kufiz. Ne administr.te trajtimit të studenteve	8190	6/679	2522.00	66969			0.0
5	Shtet		8190	6/473	19.00	66969			0.0
					4093.50				0.0

Open Procurement Albania

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8190 do të prekë gjithsej 4093.5 metra katrorë pronë, të përbërë nga 5 prona. 4 prej tyre janë pronë shtetërore, ndërsa për pasurinë nr. 6/246 ende nuk ka informacion për gjendjen ligjore, por në varësi të zonës është përcaktuar se çmimi i objektit do të jetë 32,113 për metër katror. 1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Sheshi 2/6

Harta 69-Harta treguese e pronave



Tabela 23 -Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet	Ndert.te paligjshëm	8190	12/289	855.00	66969			0.0
2	Truall Shtet		8190	12/290	4570.00	66969			0.0
					5425.00				0.0

Shkolla që do të ndërtohet në këtë zonë do të prekë gjithsej 5425 metra katrorë pronë, të përbërë nga 2 prona shtetërore. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 5/1

Harta 70- Harta treguese e pronave



Tabela 24-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Atësia	Mbiemër	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Shtet			8270	8/700	141.00	66969			9,442,629.0
2	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/935	358.00	66969			23,974,902.0
3	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/920	149.00	66969			9,978,381.0
4	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/922	82.50	66969			5,524,942.5
5	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/937	294.00	66969			19,688,886.0
6	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/923	74.00	66969			4,955,706.0
7	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/510	436.00	66969			29,198,484.0
8	Shtet			8270	8/667	77.00	66969			5,156,613.0
9	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/509	202.00	66969			13,527,738.0
10	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/224	519.00	66969			34,756,911.0
11	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/505	95.00	66969			6,362,055.0
12	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/511	285.00	66969			19,086,165.0
13	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/503	244.00	66969			16,340,436.0
14	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/507	74.00	66969			4,955,706.0
15	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/441	191.00	66969			12,791,079.0
16	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/925	47.50	66969			3,181,027.5
17	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/929	212.00	66969			14,197,428.0
						3481.00				218,921,661.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8270 do të prekë gjithsej 3481 metra katrorë pronë, të përbërë nga 17 prona, nga të cilat 16 prona private dhe 1 pronë shtetërore. Pasuria me nr. 8/667 është pronë shtetërore. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Sheshi 6/3

Harta 71-Harta treguese e pronave



Tabela 25-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/1	3465.50	448			1,552,544.0
2	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/2	3081.50	448			1,380,512.0
3	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/3	2556.50	448			1,145,312.0
					9103.50				4,078,368.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 3866 do të prekë gjithsej 9103 metra katrorë pronë, të përbërë nga 3 prona. Të tria këto prona janë toka bujqësore. Aktualisht nuk ka informacion për pronësinë e tyre. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 6/6

Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin 6/6 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Harta 72- Ortofoto e sheshit

Tabela 26-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				4930	4242			20,913,060
					4930				20,913,060

Open Procurement Albania

Sheshi 7/2

Harta 73- Harta treguese e pronave



Tabela 27-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	74 Bashkpronarë	Mungon lista	8220	8/676	8482.00	30783			261,101,406.0
					8482.00				261,101,406.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8220 do të prekë gjithsej 8482 metra katrorë pronë, të përbërë nga 1 pronë e vetme, me nr. 8/676, në pronësi të disa bashkëpronarëve. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 8/1

Harta 74- Harta treguese e pronave



Tabela 28-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet		8340	3/20	17.510	30158			0.0
2	Nuk ka informacion	Objekt	8340	3/152 - ND	10.00	30158			301,580.0
					17.520				301,580.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8340 do të prekë gjithsej 17,520 metra katrorë katrorë pronë, të përbërë nga 2 prona, nga të cilat 1 objekt pronë shtetërore, me nr. 3/20 dhe 1 tjetër pronë për të cilin ende nuk ka informacion me nr. 3/152. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 9/1

Harta 75- Harta treguese e pronave



Tabela 29-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet	Okupuar me 8 ndërtime	8330	4/165	10111.00	34068			0.0
2	Zoje Boka		8330	4/224	1145.00	34068			39,007,860.0
3	Truall Shtet	Okupuar nga Hamdi Boka	8330	4/445	749.00	34068			0.0
4	Zoje Boka		8330	4/223	229.00	34068			7,801,572.0
5	Truall Shtet	Okupuar nga Hamdi Boka	8330	4/443	641.00	34068			0.0
6	Rruge Shtet		8330	4/430	114.00	34068			0.0
					12989.00				46,809,432.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8330 do të prekë gjithsej 12,989 metra katrorë pronë, të përbërë nga 6 prona, nga të cilat 4 objekt pronë shtetërore dhe 2 objekte pronë private. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 11/1

Harta 76- Harta treguese e pronave



Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin 11/1 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Tabela 30-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				8,967	22,985			206,106,495
					8,967				206,106,495

Open Procurement Albania

Sheshi 11/2

Harta 77- Harta treguese e pronave



Tabela 31-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Ministria Mbrojtjes		8310	12/16	14102.00	31219			0.0
					14102.00				0.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8310 do të prekë gjithsej 14,102 metra katrorë pronë, të përbërë nga 1 pronë me nr. 12/16, e cila aktualisht është në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi D2

Harta 78- Ortofoto e sheshit

Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin D2 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Tabela 32- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				14,900	3,560			53,044,000
					14,900				53,044,000

Open Procurement Albania

Sheshi F3

Harta 79- Harta treguese e pronave



Tabela 33-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Shtet Rruge		3292	350	822.00	448			0.0
2	Harta e Paqarte	Nuk ka nr.pasurie	3292		1675.00	448			750,400.0
3	Isuf Alla	Ullishte	3292	141/2	4554.00	448			2,040,192.0
4	Harta e Paqarte		3292	141/3	1289.00	448			577,472.0
					8340.00				3,368,064.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8292 do të prekë gjithsej 8,340 metra katrorë pronë, të përbërë nga 4 prona, nga të cilat 8 objekte në pronësi private, 1 objekt, me nr. 12/16 në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe 1 objekt tjetër për të cilin ende nuk ka informacion. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

4.2. Kushtet lokale

4.2.1. Përshtatshmëria topografike dhe gjeologjike e trojeve të përzgjedhura

Qyteti i Tiranës shtrihet në fushën me të njejtin emër me zgjatje nga rrëza e malit të Dajtit në lindje e deri në rrezë të kodrave të Sharrës në perëndim. Gjatësia është rreth 12 km ndërsa gjërësia rreth 5 km. Qyteti ndodhet i rrethuar nga Mali i Dajtit (1600 m m.n.d.) në lindje, kodrat e Saukut, Vaqarrit dhe Kërrabes në jug-lindje jug e jug-perëndim (me lartesi mesatare deri në 400 m m.n.d.) dhe nga një hapsirë fushore qe vazhdon në veriperëndim deri në Fushë Krujë e Lezhë. Pas viteve "90 Qyteti është zgjeruar me rreth 20 km2 në të gjitha drejtimet. Në mënyrë më specifike pjesët më të zgjeruara janë në lindje në rreze të Malit të Dajtit, në jugperëndim në Selitë dhene perëndim në zonën efushës së aviacionit dhe Laprakë. Koridori gjeografik më i rëndësishëm është ai në drejtim të perëndimit dhe veriut, me Durresin dhe Fushë Krujën respektivisht. Sistemi kodrinor, në perëndim formohet nga vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut, me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave ajrore detare deri në Tiranë.

Me zgjerimin e qytetit, zona midis Lanës dhe Lumit të Tiranës tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Një pjesë e urbanizimit po ndodh në zonat me sensivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik në lindje dhe në jug perëndim, të tilla si zonat e Farkës dhe Dajtit.

Open Procurement Albania

KLIMA

Temparatura e ajrit - Persa i perket luhatjes brenda vitit të temperatures se ajrit, kemi të bejme me një regjim tipik ku temperatura minimale vrojtohet në muajin janar, 6.9ºC, ndersa temperatura maksimale vrojtohet në muajt korrik dhe gusht 23.8ºC. Rrendesi paraqet gjithashtu edhe numri i diteve me temperature nën -10ºC, të cilat quhen dite të akullta. Në zonat tek të cilat do të shtrihen objektet e studimit, temperaturat nën -10ºC janë teper të rralla. Dite të ftohta ndodhin gjatë periudhes se ftohte të vitit (nentor-mars) ku me të muajt dhjetor dhe janar janë muajt më të vështirë, ndersa ditet me temperature nën -5ºC janë shumë të rralla. Persa i perket temperaturave të ajrit, zona në studim karakterizohet nga një klime e bute mesdhetare.

Mjegulla - Mesatarja vjetore me e madhe në Tirane është 10.5 dite me mjegull. Kjo është edhe me e madhja në të gjithe Ultesiren Bregdetare, ku në Shkoder është 6.1 dite dhe në Vlore 1.5 dite mjegull në vit. Rezulton se në të gjithe zonën e studimit mjegulla zhvillohet pas mesit të nates, rreth ores 2 ose 3 dhe vazhdon deri në oren 9-10 të mengjesit. Por nuk perjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet në oret e mbremjes. Si rregull, në muajt e periudhes se ngrohte të vitit, mjegulla zhvillohet rralle dhe në qoftë se ka raste qe zhvillohet nuk zgjat shumë kohë, p.sh. në Tirane kohëzgjatje mesatare e mjegulles është 2 ore e 24 minuta.

Rreshjet atmostferike - Faktoret qe ndikojne në karakteristikat e rreshjeve atmosferike janë në pozicionin gjeografik, afërsia me detin dhe orografia. Zonat ku do të ndërtohen objektet e studimit shtrihen në pjesen qëndrore të vendit, në Ultesiren bregdetare prane detit Adriatik me një reliev të ulet fushor dhe kodra qe e rrethojne nga perendimi dhe e mbrojne nga ererat bregdetare. Sasia e rreshjeve vjetore është rreth 1200 mm. Sasia me e madhe e reshjeve të regjistruara ka qënë 1770 mm dhe me e vogla 770 mm në vit. Në krahasim me vleren mesatare të territorit Shqiptar (140mm), kjo zonë është me e ulet në sasine e reshjeve atmosferike.

Bora - në Shqipëri, në periudhen e ftohte të vitit, një sasi e konsiderueshme e rreshjeve vjen në formën bores. Këto reshje janë më të theksuara në zonën malore ku bora është një dukuri e zakonshme. Në zonën në studim bora vrojtohet si fenomen i rralle dhe mund të konsiderohet si dukuri e jashtëzakonshme. Numri me i madh i diteve me bore në zonën në studim është rreth 3 dite në vit. Muaji janar ka numrin me të madh të diteve me bore, duke u ndjekur nga shkurti dhe dhjetori.

Lagështia e ajrit - Vlerat me të larta i takojne muajve nëntor, dhjetor dhe janar. Nderkaq vlerat me të uleta të lageshtires relative vrojtohen në muajt korrik dhe gusht, pikerisht kur mbi rajonet e Mesdheut verehet një qendrueshmeri anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lageshtires relative është e kundert me ate të temperatures se ajrit. Në oret e para të mengjesit realizohen vlerat me të larta kurse në oret e mesdites (para ose pas mesdites) vlerat me të uleta.

Era - Shpejtësia e eres në territorin e zonës në studim është në vartesi të periudhes se vitit. Vlerat me të medha të tyre vrojtohen në stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare është e theksuar. Në këtë stine, shpejtesite mesatare luhaten rreth 1.6 m/s.

Stuhite - Stuhite qe për vendin tonë janë të shumta dhe ndodhin në të gjithe stinet e vitit, shpesh shoqerohen me bresher. Më shumë dite me bresher ka në muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe në gjysmen e pare të pranveres. Numri me i madh i diteve me bresher vrojtohet në rrethin e Tiranes dhe Kamez. Tirana gjatë vitit ka rreth 8 dite me bresher. Në përgjithësi, zgjatja e breshrit është nga 3 deri 5 minuta. Në zonën studim, bresheri vrojtohet në çdo kohë të vitit por më shumë në periudhen e ftohte të vitit. Gjatë muajit Janar vrojtohet mesatarisht pothuajse një dite me bresheri. Në periudhen e ngrohte të vitit numri i diteve me bresher është i paket. Stuhite në zonën në studim mund të ndodhin në çdo muaj çka tregon karakterin mesdhetar që ka klima e zonës.

TOPOGRAFIA

Zonat e zgjedhura për ndërtimin e objekteve arsimore kanë karakteristikat e mëposhtme topografike:

Sheshi 2/3 është i ndodhur në pjesën jugore të Tiranës. Ky shesh gjendet në shpatin e kodrave ku është i lokalizuar edhe Qyteti Studenti dhe karakterizohet nga një pjerrësi e konsiderueshme.

Open Procurement Albania

Sheshi 2/6 ndodhet në jug të Tiranës, në rrugën e Elbasanit, fare pranë rrethrrotullimit të Saukut dhe karakterizohet nga një sipërfaqe e sheshtë.

Sheshi 5/1 gjendet pranë Rrugës "Hasan Alla", në një zonë të urbanizuar të Njësisë Administrative nr. 5 dhe ka një sipërfaqe të sheshtë.

Sheshi 6/3 ndodhet në pjesën perëndimore të Tiranës, pranë Rrugës "Teodor Keko". Ai ka një sipërfaqe të sheshtë,

Sheshi 6/6 ndodhet në pjesën perëndimore të Tiranës, pranë Rrugës "Teodor Keko". Ai ka një sipërfaqe të sheshtë, e cila kufizohet nga blloqe dhe në njërën anë me skarpatet e lumit të Lanës.

Sheshi 7/2 ndodhet në Njësinë Administrative nr. 7, pranë Rrugëve "Javer Malo" dhe "Stavri Themeli". Sheshi ka një sipërfaqe të rrafshët të rrethuar nga disa formacione të lehta kodrinore dhe në njërën anë kufizohet me lumin e Lanës.

Sheshi 8/1 ndodhet në pjesën veriore të Tiranës, në Njësinë Administrative nr. 8. Sipërfaqja e këtij sheshi nuk paraqet aspak pjerrësi dhe e gjithë zona nuk është e prekur nga formacionet kodrinore.

Sheshi 9/1 ndodhet në Njësinë Administrative Nr. 9, pranë rrugës "Don Bosko", dhe karakterizohet nga një sipërfaqe e sheshtë.

Sheshi 11/1 ndodhet në Njësinë Administrative nr. 11, pranë Univeristetit Bujqësor të Tiranës. Relievi ku është vendosur ky shesh karakterizohet nga formacione kodrinore me pjerrësi të ulët.

Sheshi 11/2 ndodhet pranë rrethrrotullimit të Doganës, në Njësinë Admimistrative nr. 11. Ky shesh karakterizohet nga një sipërfaqe e sheshtë e vendosur në një zonë të urbanizuar.

Sheshi D2 gjendet në lindje të Tiranës, në Njësinë Administrative Dajt. Sheshi karakterizohet nga një pjerrësi e lehtë dhe është i vendosur në kodrat para malit të Dajtit.

Sheshi F3 ndodhet pranë Kopështit Zoologjik, në Njësinë Administrative Farkë. I vendosur në kodrat e Farkës, ky shesh ka një pjerrësi të konsiderueshme.

GJEOLOGJIA

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore. Ujrat nëntokësore gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoren si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë. Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe. Në Tiranë aktualisht nuk ka aktivitete mineral-nxjerrëse.

Open Procurement Albania

Në zonën e BT formacionet gjeologjike siperfaqësore përfaqësohen nga depozitime të formacionit rrënjësor, të cilat përbëhen nga depozitime të konsoliduara të Miocenit të sipërm, por që mbulohen me trashësi prej disa dhjetra metrash prej atyre të kuateranrit ende të pakonsoliduara.

GJEOMORFOLOGJIA

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike të zonave jemi bazuar në studimet ekzistuese dhe në informacionet e reja qe kemi marrë nga studimi aktual. Bazuar në këto të dhena po bejme përshkrimin e fenomeneve gjeologjike qe janë të pranishmene formacionet gjeologjike të kësaj zonë.

Fenomenet me të dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen janë:

1. **Fenomeni i perajrimit** është i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite.Këta shkembinj janë depozitime të reja dhe me cimentim të dobet argjilor.Nën veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj të bute në dhera. Ky fenomen takohet me teper në pjesen kodrinore të zonës pra në sheshin e studjuar.

2. **Fenomeni e erozionit** ky fenomen është i dukshen në formacionet e perajruara të Neogjenit dhe në mbulesen deluvialo eluviale. Rrymat e ujit në momentin e reshjeve masive gerryejne mbulesen deluvialo eluviale dhe pjesen e perajruar të formacionit rrenjesor. Rekomandojme qe të tregohet vemendje qe sheshi i ndërtimit dhe objektet të mbrohen nga gerryerja e rrymave të ujrave siperfaqesore qe krijohen në rastet e reshjeve, ujrat teknologjike qe do të krijohen në momentin e shfrytezimit të ketij objekti residential.

3. **Fenomeni i levizjes së mbulesave deluvialo eluviale në drejtim të renies së relievit këto** depozitime perbehen nga shtresa suargjilash dhe argjilash me permbajtje lendesh oganike dhe copa nga shkembi rrenjesor. Mbulesa deluvialo-eluviale është vendosur mbi formacionin rrenjesor. Sheshet që ndodhen në zona kodrinore dhe të pjerreta kanë probleme për qendrueshmerin e shpateve. Gjatë ndërtimit dhe shfrytezimit të objektit duhet të merren masa për të ruajtur stabilitetin e shpati.

HIDOROLOGJIA

Sheshet e përzgjedhura për ndërtimin e objekteve shkollore ndodhen kryesisht në zona urbane të cilat nuk përshkohen nga rrjete përrenjsh apo lumenjsh. Përjashtim përbëjnë vetëm sheshet 6/6 dhe 7/2, të cilët kufizohen me lumin e Lanës.

Lumi i Lanës është një lumë me rrjedhë të përhershme e prurje të vogël. Megjithëse ka një regjim të rregullt të rrjedhjes, në varësi të rreshjeve, ky lumë merr karakteristika të një rrjedhje të çrregullt duke i shtuar prurjet dhe duke dalë nga shtrati. Sidoqoftë, kjo gjë nuk paraqet rrezikshmëri pasi është një fenomen që ndodh shumë rrallë e nuk shkakton erozion apo përmbytje.

Open Procurement Albania

Figura 8- Pamje nga lumi i Lanës në afërsi të njërit prej shesheve të parashikuar për ndërtim shkolle (Sheshi 6/6, Yzberisht)

Open Procurement Albania

rta 80 - Situata Hidro Gjeologjike (Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë 2014)



4.2.2. Sizmiciteti

Nga pikëpamja gjeologjike qyteti i Tiranës zë vend në sinklinalin molasik të Tiranës, midis kundërhypjes aktive që kufizon nga perëndimi sinklinalin e Tiranës dhe Mbihypjes aktive që komplikon krahun e përmbysur të antiklinalit të Dajtit [Aliaj,1988].

Nga zona e shkëputjeve aktive të Tiranës janë gjeneruar shumë tërmete, ndër më të fuqishmit janë: në vitin 1617 me I0= 8 ballë (MSK-64) në Krujë, në vitin 1852 me I0= 8 ballë (MSK64) në Kepin e Rodonit, në vitin 1860 me I0= 8 balle (MSK-64) në Urën e Beshirit, në vitin 1934 me Ms= 5.6 në Ndroq, në 19.8.1970 me Ms= 5.5 dhe I0= 7 balle (MSK-64) në zonën e Vrapit, në 16.9.1975 me Ms= 5.3 në Kepin e Rodonit, 22.11.1985 me Ms= 5.5 në Gjirin e Drinit dhe në 9.1.1988 me Ms= 5.4 në Tiranë.

Pra, rajoni i Tiranës është prekur nga tërmete historike me I0 = 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar nga tërmete me M = 5.3 - 5.6 [Aliaj, 1997]. Nga pikëpamja sizmotektonike rajoni i Tiranës mund të goditet në të ardhmen nga tërmete me M_{max} = 5.5 - 5.9 [Aliaj, 1997], ndërsa sipas hartës së tërmeteve maksimale të mundshem, qyteti i Tiranës përfshihet në zonën me M_{max} = 5.8 - 6.4 ose M_{max} = 6.1±0.3 [Koyiu, 1986].

Open Procurement Albania

Harta 81 - Situata Sizmike (Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë 2014)



4.2.3. Gjendja e shërbimit me rrugë dhe infrastrukturë nëntokësore e trojeve të përzgjedhura

Gjendja e shërbimit me rrugë, KUZ dhe ujësjellës

- **Njësia Administrative 2**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare dhe të mesme (Kodi 2/6)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 2, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore të ‘’Elbasanit’’dhe në afërsi të rrugës urbane dytësore ‘’Zihni Sinoimeri’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub160-PE.

Harta 82 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



Harta 83 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Procurement Albania

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare (Kodi 2/3)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 2, dhe lidhet me aksin e rrugës dytësore ‘‘Pjetër Budi’’dhe rrugën lokale ‘’Jorgjia Truja’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Veri-Tub75-PE, në Lindje-Tub90PE, në Jug-180PE dhe në Perendim-Tub110PE.

Harta 84 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



Harta 85 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin



- **Njësia Administrative 5**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare (Kodi 5/1)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 5, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane dytësore ‘’Liman Kaba’’dhe rrugën urbane dytësore ‘’Prokop Mima’’. Ky shesh nuk ka KUZ, dhe as lidhje me rrjetin e ujësjellësit.

Harta 86 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



open procurement albania

Harta 87 -Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Open Procurement Albania

- **Njësia Administrative Kashar**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare dhe të mesme (Kodi 6/3)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative Kashar, cila lidhet me aksin e rrugës lokale ‘‘Andrea Albani’’dhe rrugën lokale ‘’Kole Koçi’’. Ky shesh nuk ka KUZ ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub 160PE dhe në Veri- Tub 110PE.

Harta 88 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

en
curement
pania

Harta 89 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin



Procurement Albania

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare (Kodi 6/6)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 6, e cila lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore ‘’Teodor Keko’’ dhe rrugën urbane dytësore ‘’Menduh Zavalani’’. Ky shesh nuk ka KUZ ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub 125PE.

Harta 90 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

Harta 91 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshit

Procurement Albania

- **Njësia Administrative 7**

Sheshi i Shkollës së mesme (Kodi 7/2)

Kjo shkollë ndodhet në njësinë administrative 7, pranë Rrugëve "Javer Malo" dhe "Stavri Themeli". Ky shesh ka një Tub 1000 KUZ nga ana veriore. Përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub 110PE

Harta 92 -Harta 80 Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

Harta 93 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Open Procurement Albania

- **Njësia Administrative 8**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare dhe të mesme (Kodi 8/1)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 8, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore ‘’5 Maj’’ dhe kthehet majtas në rrugën urbane dytësore ‘’Dervish Luzha’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Veri-Tub 110PE.

Harta 94 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



Harta 95 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Open Procurement Albania

- **Njësia Administrative 9**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare dhe të mesme (Kodi 9/1)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 9, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore ‘’Don Bosko’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Karaj’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Gazmend Zajmi’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Perëndim-Tub 250Gize.

Harta 96 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

Harta 97 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Procurement Albania



- **Njësia Administrative 11**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare dhe të mesme (Kodi 11/1)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 11, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore ‘’Kastriotët’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Paisi Vodica’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Hamit Keçi’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përa i përket ujësjellësit ka në Lindje- Tub160PE, në Jug-Tub63PE dhe në Perendim- Tub75PE.

Harta 98 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



Procurement Albania

Harta 99 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare (Kodi 11/2)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 9, dhe lidhet me aksin e rrugës kryesore ‘’29 Nëntori’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Vangjel Noti’’, rrugës urbane dytësore ‘’Foto Stamo’’dhe rrugës urbane dytësore ‘’Gjergji Legisi’’. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub 150PE.

Harta 100 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin



Harta 101 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin



Open Procurement Albania

- **Njësia Administrative Farkë**

Sheshi i Shkollës 9 – vjeçare (Kodi F3)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative Farkë, dhe lidhet me rrugë lokale (Midis kopshtit botanik dhe liqenit të Thatë). Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub 250PE.

Harta 102 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

Harta 103 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

Open Procurement Albania

- **Njësia Administrative Dajt**

Sheshi i Shkollës së mesme (Kodi D2)

Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative Dajt, dhe ndodhet në rrugën më të afërt me rrugën ‘’Dalip Topi’’ dhe del për në Dajt por nuk ka akses të drejtpërdrejt rruge. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Veri-50PE.

Harta 104 - Situata në lidhje me rrjetin KUZ për sheshin

Harta 105 - Situata me rrjetin e ujësjellësit për sheshin

4.3. Përshkrimi arkitektonik, konstruktiv dhe funksional i projektit

4.3.1. Parametrat e projektimit

Për realizimin e projektit sipas tipologjisë së shkollës dhe vendit ku do të ndërtohet, refruar udhëzimit "Për Projektimin e Ndërtesave Shkollre" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhen pasur parasysh këto parametra kryesore:

- Për shkollat e arsimit bazë

a) Niveli arsimor, përfshin

- Niveli 0, Arsimi Parashkollor, 5-6 vjeç
- Niveli 1, Arsimi fillor, klasa 1- 6, 7 – 13 vjeç
- Niveli 2, Arsimi i mesëm i ulët, klasa 7 – 9, 14 – 16 vjeç.

b) Numri i cikleve (paraleleve)

Për rastin e marrë në studim kemi shkolla me 2 cikle dhe 3 cikle

c) Numri i Klasave

Në varësi të numrit të cikleve janë përcatuara dhe numrat e klasave të cilat janë me 20 klasa dhe 30 klasa

d) Numri i nxënësve/klasë

Për zonën urbane numri i nxënësve për klasë është marrë 30 nxënës/ klasë, ndërsa për zonat rurale 24 nxënës/ klasë.

e) Numri total i nxënësve

Në varësi të zonës së ndërtimit dhe numrit të cikleve, numri total i nxënësve në një shkollë varion nga 480 nxënës në zonat rurale, në 900 nxënës në zonat urbane.

Në mënyrë të përmbledhur për shkollat e arsimit bazë kemi:

Open Procurement Albania

Tabela 34 - Numër nxënësish sipas tipeve të shkollës

Tipi shkollës	Niveli arsimor	Numri cikleve	Numri klasave	Numri nxënës/ klase	Numri total i nxënësve
Arsimi Bazë (Zona Urbane)	3	3	30	30 (36)	900 (1080)
Arsimi Bazë (Zona Urbane)	3	2	20	30	600
Arsimi Bazë (Zona rurale)	3	2	20	24	480

Sipas standardeve të vendosura nga MAS, ndërtesa shkollore duhet të kenë hapësirat si më poshtë:

- Shkollat e arsimit fillor: Ndërtesa për nivelin e arsimit fillor përbëhet nga hapësirat e mësimit, siç janë dhomat mësimore, biblioteka, hapësira për qëllime të shumëfishta, salla e kompjuterëve dhe hapësirat përcjellëse, që përfshijnë zonat administrative dhe ato të shërbimeve (përcjellëse teknike). Përveç kësaj, niveli parafillor i arsimit duhet të ketë dhoma mësimore, hapësira për lojë dhe tarraca në ambient të hapur;

- Shkollat e arsimit të mesëm të ulët: Ndërtesa për nivelin e arsimit të mesëm të ulët përbëhet nga hapësirat kryesore të arsimit, siç janë dhomat mësimore, biblioteka, hapësira për qëllime të shumëfishta, laboratori i përgjithshëm për shkencë (biologji, kimi dhe fizikë), laborator të TIK dhe hapësirat përcjellëse që përfshijnë zonat administrative dhe ato të shërbimeve (përcjellëse teknike)

Duhen parashikuar dhe dhoma e mjekut, psikologut, ambienti i qeverise se nxënësve.

- Për shkollat e arsimit të mesëm të lartë

Në rastin tonë kemi marrë:

a) Niveli Arsimor
b) Arsimi i Mesëm i Lartë, klasa 10 – 12, mosha 17- 19 vjeç;
c) Numri i cikleve (paraleleve) 7
d) Numri i Klasave 21
e) Numri i nxënësve/klasë 30 (36)
f) Numri total i nxënësve 630 (756)

Ndërtesa për nivelin e arsimit të mesëm të lartë përbëhet nga hapësirat e njëjta si të nivelit të mesëm të ulët përveç numrit shtesë të lëndëve të specializuara. Mësimdhënia është e organizuar në katër drejtime kryesore ku përfshihet matematika dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit gjuhët, shkencat shoqërore dhe shkencat natyrore, palester. Duhen parashikuar gjithashtu dhe dhoma e mjekut, psikologut, ambienti i qeverise se nxënësve.

Të dhënat mbi sipëerfaqet e ambienteve të nevojshme për çdo shkollë në varësi të numrit të nxënësve për klasë jepen në tabelën e mëposhtme.

Open Procurement Albania

Tabela 35 - Sipërfaqet e ambienteve për çdo shkollë sipas numrit të nxënësve për klasë Arsimi Bazë

	Tabela 1: TIPET E KLASAVE DHE HAPESIRAT E NEVOJSHME - ARSIMI BAZIK				
Ref.	Hapësirat	Siperfaqe m2	Komentet	Siperfaqe m2	Komentet
A.	MËSIMDHËNJA DHE MBËSHTETJA PEDAGOGJIKE		Pwr klasa me 30 (36) nxenes		Pwr klasa me 24 nxenes
1.0	Niveli Parafillor				
1.1	Dhoma për parafillor	64,8	2.2 (1.80) M2/nxënës	45,6	1.90 M2/nxënës
1.2	Veranda	25,025		23,5	
1.3	Dhoma/hapësira e qetë	25		25	
1.4	Tualetet për parafillor	4		4	
1.5	Hapësirat për qarkullim	23% e sipërfaqes së përgjithshme (shuma 1.1 - 1.4)		23% e sipërfaqes së përgjithshme (shuma 1.1 - 1.4)	
2.0	Niveli Fillor				
2.1	Dhoma e mësimit	58,48	1.94 (1.62) M2/nxënës	45,56	1.90 M2/nxënës
2.2	Depo	10		10	
2.3	Laboratori për demonstrime (shkencat natyrore)	58,48	1.94 (1.62) M2/nxënës	51,35	2.14 M2/nxënës
2.4	Dhoma pergatitore per laborator	9,5		9,5	
2.5	Biblioteka	1.4 M2/ulës	20% nr. Total te nxenesve	1.4 M2/ulëse	20% nr. Total te nxenesve
2.6	Hapësira për shumë qëllime	0.5 M2/nx	Total	0.5 M2/nx	Total
2.7	Dhoma/Hapësira për mësimdhënës	2.5 M2/mësimdhënës		2.5 M2/mësimdhënës	
2.8	Tualete për nxënës (për njësi)	3,5		3,5	
2.9	Tualete për mësimdhënës (për njësi)	10		5	
2.10	Tualete për nxënës me aftësi të kufizuara	4,5		4,5	
2.11	Shkallët	20			
2.12	Hapësirat për qarkullim	23% e sipërfaqes së përgjithshme (shuma 2.1 - 2.11)		23% e sipërfaqes së përgjithshme (shuma 2.1 - 2.11)	
3.0	Niveli i mesëm i ulët				
3.1	Dhoma e zakonshme e mësimit	58,48	1.94 (1.62) M2/nxënës	45,56	1.90 M2/nxënës
3.2	Dhoma e specializuar e mësimit	58,48	Me dollap	52,36	Me dollap
3.3	Depoja (dhoma të specializuara)	25,0		25,0	
3.4	Laboratori i gjuhës	65,28		52,36	
3.5	Laboratori i fizikës	74,82	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash	53,6	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
3.6	Dhomë përgaditore (për 2 laboratorë)	35	në mes të 2 laboratorve, 1 bankë me lavaman	35	në mes të 2 laboratorve, 1 bankë me lavaman
3.7	Laboratori i kimisë	74,82	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash	53,6	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
3.8	Laboratori i biologjisë	74,82	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash	53,6	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
3.9	Dhoma përgaditore (1 laborator)	25		25	
3.10	Dhoma/hapësira e artit figurativ	75	Së bashku/ndahet me dhomën e muzikës	53,6	Së bashku/ndahet me dhomën e muzikës
3.11	Dhoma/hapësira e muzikës	0	Në Dhomën/hapësirën për art figurativ	0	Në Dhomën/hapësirën për art figurativ
3.12	Dhoma/hapësira e kompjuterëve	40	15 (18) kompjuterët	40	12 kompjuterët
3.13	Biblioteka.Dhoma e leximit (me nivelin fillor)	1.4 M2/ulës	20% nr. Total te nxenesve	1.4 M2/ulëse	20% nr. Total te nxenesve
3.14	Depo e librave	25		25	
3.15	Zyra/hapësira e bibliotekistit	16		16	
3.16	Hapësira për shumë qëllime (me nivelin fillor)	0.5 M2/nx	(total)	0.5 M2/nx	(total)
3.17	Salla e sporteve (me nivelin fillor)	8.0 M2/nx		8.0 M2/nx	
3.18	Blloqe me dusha-nga 4 kabina	16		16	
3.19	Zhveshtorja	20		20	
3.20	Dhoma/hapësira e mësimdhënësit të E.fizike	18		18	
3.21	Depo e pajisjeve sportive	20		20	
3.22	Holli hyrës	120		120	
3.23	Hapësirat për qarkullim dhe shkallët	21 deri 25% e sipërfaqes së përgjithshme neto (shuma 3.1 - 3.22)		21 deri 25% e sipërfaqes së përgjithshme neto (shuma 3.1 - 3.22)	
B.	HAPËSIRAT E PËRBASHKËTA				
4.0	Administrata				
4.1	Drejtori	25		25	
4.2	Zëvëndëdrejtori	16		16	
4.3	Kontabilisti	16		16	
4.4	Sekretaria/recepsioni	16		16	
4.5	Dhoma/Hapësira për mësimdhënës (niveli i mesëm i u	2,5 m2/mësues		2,5 m2/mësues	
4.6	Dhoma për komunitet	16		16	
4.7	Dhoma/Hapësira përorientim profesional	16		16	
4.8	Dhoma e pajisjeve/materialit shpenzues	10		10	
4.9	Arkiva	8		8	
4.10	Tualetet e Stafit	8		8	
4.11	Hapësirat për qarkullim / holli, recepsioni	21 deri 25% e sipëraqes së përgjithshme neto (shuma 4.1 - 4.10)		21 deri 25% e sipëraqes së përgjithshme neto (shuma 4.1 - 4.10)	
5.0	SHËRBIMET E PËRBASHKËTA				
5.1	Dhoma e mjekut	16		16	
5.2	Punëtoria për mirëmbajtje	18		18	
5.3	Kantina	1.1 M2/nxënës		1.1 M2/ nxënës	
5.4	Kuzhina	40		40	
5.5	Depo e ushqimit	8		8	
5.6	Depo për vegla dhe pajisje	12		12	
5.7	Tualetet për mësimdhënës dhe personel	8	2 cubicles (x 1 WC block)	8	2 cubicles (x 1 WC block)
5.8	Tualete për nxënës	14	4 cubicles (x 2 WC blocks)	14	4 cubicles (x 2 WC blocks)
5.9	Dhoma e rojtarit	10	afër hyrjes kryesore	10	afër hyrjes kryesore
5.10	Hapësirat e jashtme rekreative të mbuluara	0.6 M2/nxënës		0.6 M2/nxënës	
5.11	Hapësira për ngrohje (kaldaja)	25		25	
5.12	Depo për lëndë djegëse (opcionale)	30	Zëvendësohet me cisternë të naftës	30	Zëvendësohet me cisternë të naftës
5.13	Shtëpia e rojtarit (opcionale)	40		40	
5.14	Hapësirat për qarkullim / korridoret	21 to 25% e sipërfaqes së përgjithshme neto (shuma 5.1 - 5.13)		21 to 25% e sipërfaqes së përgjithshme neto (shuma 5.1 - 5.13)	

Tabela 36 - Tipet e klasave dhe hapësirat e nevojshme - Arsim i Mesëm Cikël i lartë

Tabela : TIPET E KLASAVE DHE HAPESIRAT E NEVOJSHME - ARSIMI I MESEM CIKLI LARTE

Pwr klasa me 30 (36) nxenes

Ref.	Hapësirat	Siperfaqe m2	Komentet
A.	**MËSIMDHËNJA DHE MBËSHTETJA PEDAGOGJIKE**		**Pwr klasa me 30 (36) nxenes**
1.1	Dhoma e zakonshme e mësimit	58,48	1.9 (1.62) M2/nxënës
1.2	Dhoma e specializuar e mësimit	62,28	
1.3	Depoja (dhoma te specializuara)	25,00	
1.4	Laboratori i fizikës	65,28	
1.5	Laboratori i gjuhës	68,80	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
1.6	Dhomë përgaditore (për 2 laboratorë)	35,00	në mes të 2 laboratorve, 1 bankë me lavaman
1.7	Laboratori i kimisë	68,80	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
1.8	Laboratori i biologjisë	68,80	1 bankë për demonstrim dhe 2 rende bankash anash
1.9	Dhoma përgaditore (1 laborator)	25,00	
1.10	Salla e artit dhe projektimit	68,80	
1.11	Salla e muzikes	0,00	Së bashku/ndahet me dhomën e muzikës
1.12	Salla e kompjuterëve	58,48	15 (18) kompjutera
1.13	Biblioteka.Dhoma e leximit	1.4 M2/ules	per 20% nr. Total te nxenesve
1.14	Depo e librave	25	
1.15	Zyra e bibliotekistit	16	
1.16	Salla qe perdoret per shume qellime	0.5 M2/nx	(total)
1.17	Salla e sporteve	8.0 M2/nx	
1.18	Blloqe me dusha- 4 kabina secila	16	
1.19	Zhveshtorja	20	
1.20	Zyra e mësimdhënësit të sportit	18	
1.21	Depo e pajisjeve sportive	20	
1.22	Koridori hyrës	120	
1.23	Hapësirat për qarkullim dhe shkallët	21 deri 25% e sipëraqes së përgjithshme neto (shuma 1.1 - 1.22)	
2.0	**Administrata**		
2,1	Drejtori	25	
2,2	Zëvëndëdrejtori	16	
2,3	Kontabilisti	16	
2,4	Tavolina e sekretarit/recepsionit	16	
2,5	Salla e arsimtarëve	2.5 m2/mësues	
2,6	Dhoma për organizimie të komunitetit	16	
2,7	Orientimi prfesional	16	
2,8	Depoja e pajisjeve/materialit shpenzues	10	
2,9	Arkivat	8	
2,10	Tualetet e stafit administrativ	8	2 Kabina
2,11	zona për qarkullim / holli, recepsioni	21 deri 25% e sipëraqes së përgjithshme neto (shuma 2.1 - 2.10)	
3	**SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**		
3.1	Dhoma e mjekut	16	
3.2	Punëtoria për mirëmbajtje	18	
3.3	Kantina	1.1 M2/student	
3.4	Kuzhina	40	
3.5	Depo e ushqimit	8	
3.6	Depo për mjete dhe pajisje	10	
3.7	Tualetet për mësimdhënës dhe personel	8	4 kabina (x1 ëC blok)
3.8	Blloku tualeteve për nxënës	44	13 kabina (x2 ëC blloqe)
3.9	Dhoma e rojes	10	afër hyrjes kryesore
3.10	Hapësirat e jashtme rekreative të mbuluara	0.6 M2/nxënës	
3.11	Hapësira për ngrohjen qendrore (kaldaja)	35	
3.12	Depoja per thëngjill (opcionale)	30	Zëvendësohet me cisternë të naftës
3.13	Shtëpia e rojtarit (opcionale)	40	
3.14	Hapësirat për qarkullim / korridoret	21 deri 25% e sipëraqes së përgjithshme neto (shuma 3.1 - 3.13)	

pcn Procurement Albania

- **Për kopshtet**

Bazuar në standardet e miratuara të MAS rekomandohet;

Kopshti duhet të akomodojë deri në 100 fëmijë, në varësi të grupeve dhe të hapësirave fizike që ka godina e kopshtit(1-2 ose disa grupe). Rekomandohet që kopshti të mos projektohet për më shumë se 125 fëmijë.

- Grupi i parë (fëmijë 3-vjeçar) duhet të ketë 15 fëmijë;
- Grupi i dytë (fëmijë 4-vjeçar) duhet të ketë 20 fëmijë;
- Grupi i tretë (fëmijë 5-vjeçar) duhet të ketë 25-30 fëmijë.

Në kopsht duhet të jetë blloku (grupi) i kopshtit, dhoma e stafit, kuzhina dhe sipas rastit lavanteria. Blloku (grupi) i kopshtit me dhe pa ushqim duhet të ketë:

- Pranim-gardërobën;
- Dhomën e grupit;
- Dhomën e fjetjes;
- Verandën dhe Nyjet hidro-sanitare.

Mjediset e jashtme duhet të përmbajnë:

- Këndin e ujit dhe rërës;
- Këndin e gjallë;
- Këndin e teatrit;
- Kënde lojrash të jashtme,
- Mjedise të gjelbëruara dhe stola, tenda dielli etj.

Open Procurement Albania

Përsa i përket ndarjes funksionale dhe llojit të funksioneve duhet t`i referoheni:
Standardeve e normave dhe kritereve të projektimit për kopshte/ çerdhe të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, (kapitulli ”Kopshtet e fëmijëve”);
Rregullores Higjiene-Sanitare për ndërtimin dhe funksionimin e kopshteve të fëmijëve, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit Nr. 105 datë 17.05.1995 si dhe nr. 2370 datë 09.06.1998;
Gjatë projektit të shfrytëzohen “Standardet e normave dhe kritereve të projektimit për kopesht, kopshte/çerdhe të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4.3.2. Punët kryesore civile që do realizohen

Për ndërtimin e objekteve arsimore (shkollë 9 –vjeçare dhe të mesme), si dhe atyre parashkollore (kopshte) punimet civile që do të realizohen janë si më poshtë:

a) Punime dheu

Punime gërmimi për realizimin e themeleve dhe strukturave të tjera nëntokësore, sistemime të ambienteve të jashtm.

b) Punime betoni dhe b/a

Punime për realizimin e themeleve, strukturave b/a (kolona, trare, soleta, shkallë, etj) dhe punime të tjera plotësuese.

c) Punime për konstruksione metalike

Punimet me konstruksione metalike janë të përshtatshme për ndërtimin e palestrave dhe shkallëve të emergjencës, streha dhe dalje të ndryshme dekorative.

Gjithashtu në formën e konstruksioneve metalike të thjeshta përdoren dhe në rrethimet e terreneve sportive dhe oborret e godinave.

d) Punime hekur betoni

Punime për furnizimin dhe vendosjen e hekurit në strukturat b/a.

e) Punime murature tulle

Punime për realizimin e muraturës ndarëse dhe mbajtëse, si dhe të ambienteve rrethues.

f) Punime hidroizolimi

Punime për hidroizolim e themeleve, tarracës, nyjeve hidrosanitare dhe ambienteve të tjera ku është e nevojshme kjo ndëryhrje sipas kushteve teknike të zbatimit.

g) Punime shtresash

Punime për realizimin e shtresave të brendshme (dyshemesë, taracës) si dhe shtresave për realizimin e ambienteve të jashtme.

h) Punime tavani dhe suvatimi

Punime për realizimin e suvatimeve të brendshme dhe të jashtme, tavanit.

i) Punime për veshje me pllaka

Realimi me veshje me pllaka i nyjeve sanitare, ambienteve të guzhinës, etj

j) Punime dyer dhe dritare

Furnizimi dhe vendosja e dyer të jashtme dhe të brendshme, si dhe dritareve në objekt

k) Punime bojatisje

Punime bojatisje të brendshme dhe të jashtme.

l) Punime të ndryshme dhe prishje

Punime të ndryshme për realizimin e sipërfaqeve të jashtme dhe prishja e objekteve ekzistuese (nëse ka)

m) Punime skelerie dhe kallëpi

Punime skelerie dhe kallëpesh për realimin e strukturave të b/a dhe muraturës

n) Punime elektrike

Realizimi i instalimeve elektrike të brendshme dhe të jashtme,

o) Punime hidro sanitare

Punime për realizimin e nyjeve hidrosanitare dhe vendosjen e pajsjeve përkatëse.

p) Punime ngrohje dhe termoizolimi

Punime për realizimin e sistemit të ngrojes dhe vendosjen e pajisjeve përkatëse (kaldajës me pajisjet përkatëse, radiatorëve), etj

q) Punime kanalizimi (drenazhimi, KUZ dhe KUSh)

Këto punime përfshijnë punimet për rrjetin e brendshëm të shkarkimit të ujrave, kanalizimeve në rrjetin e jashtëm, rrjetin e ujsjellësi, sistemin e drenazhimit për objektin dhe shesheve.

r) Punime për instalimet teknologjike

Piunimet në këtë zë përfshijnë sistemin e vëzhgimit dhe monitorimit, linjat e internet telefonisë, pajsijeve teknologjike të nevojshme për programin mësimor.

Open Procurement Albania

4.3.3. Metodat e ndërtimit

Në objektet arsimore, metodat e ndërtimit dhe materialet e përdorura në to duhet të plotësojnë karakteristikat kryesore si më poshtë:

a) rezistencë dhe qëndrueshmëri mekanike;

b) siguri në rast zjarri;

c) higjiena, shëndeti dhe mjedisi;

ç) siguri në përdorim;

d) mbrojtje nga zhurmat;

dh)kursimi i energjisë dhe ruajtja e ngrohtësisë.

Metodat e e ndërtimit më të përshtatshmet të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të projekteve për objektet arsimore sipas kategorive, janë:

Gërmime për baza dhe themele

Gërmim dheu për themele ose për punime nëntokësore, deri në thellësine 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të tharë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj,) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m3, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj..

Mbushjet

Shtresë me gurë dhe copa tulle të zgjedhura, në shtresa të ngjeshura mirë, të pastruara nga pluhuri, suvaja dhe materialet organike, që rezultojne nga prishjet e përshkruara në artikujt e mësipërm. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

Përdorimi i materialit të gërmuar:

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdorën për rimbushje. Çdo material i tepërt do të jetë në dipspozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

Mbushja rreth strukturave

Materiali duhet vendosur në mënyrë simultane në të dyja anët e mbajtëses mur apo shtyllë. Mbushjet e mëvonshme të nxirren nga një material i aprovuar nga Supervizori, duke hedhur me shtresa me trashësi 150 mm me ngjeshje.

- **Themele standarde**

Themele betoni

Themelet të kryera prej betoni Marka 100 të dozuar për m3 dhe të pastruar në shtresa të trasha të vibruar mirë, me dimensione dhe formë të treguar në vizatimet përkatëse, duke përfshirë kallëpet, formën e punës, mbështetjen dhe të gjitha kërkesat për të kompletuar punën me cilësi.

Themele dhe bazamente ndërtesash prej butobetoni

Open Procurement Albania

Themele dhe bazamente ndërtesash prej butobetoni i formuar me beton dhe gurëgëlqeror më e vogël se 20 cm në raporte për m3: beton M 100, 0.77 m3 dhe gurë 0.37 m3, me dozim të betonit për m3 si tek betonët, duke përfshirë kallëpet, përforcimet dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e themeleve dhe realizimin e tyre.

Plinta për kolona

Plinta, të realizuara dhe të armuara në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, me beton M 200, të hedhur në vepër në shtresa të holla dhe të vibruara mirë, me dozim sipas betonit me M 200 me inert, duke përfshirë hekurin e armaturës, kallëpet, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër dhe mjeshtëri për mbarimin e punës.

3.6 Punime ndihmesë për themelet

Hidroizolimi i plintave

Shtresë hidroizolimi për paretet vertikale të themeleve, e përbërë nga një shtresë emulsioni të bitumuar dhe dy shtresa bitumi M-3 me dozim 3.8 kg / m2, dhe e zbatuar në të nxehtë, duke përfshirë çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Hidroizolimi i themeleve në ndërtesat pa bodrum

Në ndërtesat pa bodrum bëhet hidroizolimi i rrafshit horizontal të sipërm të themeleve në kuotën e xokolaturës me llaç çimento rërë 1:2. Sipas rastit, llaçit i shtohet cerezit. Kjo shtresë hidroizoluese duhet të lidhet me shtresën hidroizoluese të dyshemesë dhe me hidroizolimin e faqes vertikale të jashtme të themelit, që ndodhet në zonën në mes të trotuarit dhe rrafshit të xokolaturës.

Hidroizolimi i themeleve në ndërtesat me bodrum

Në ndërtesat me bodrum bëhet:

- hidroizolimi i rrafshit horizontal të themeleve në kuotën e hidroizolimit të dyshemese së bodrumit
- hidroizolimi i faqes së jashtme të murit të themelit. Ky lidhet me hidroizolimin e rrafshit horizontal dhe ngrihet jo më pak se 10 cm mbi kuotën e trotuarit
-

Drenazhimi perimetral e sipërfaqësor

Drenazhimi perimetral bëhet përgjatë themeleve, por jo mbi to. Ky drenazhim përbëhet nga linja unazore me tuba shkarkimi dhe puseta kontrolli.

N.q.s nën dyshemenë e godinës gjendet një shtresë kapilare, atëherë duhet të bëhet një drenazhim unazor me tuba.

Në rastet kur duhet që drenazhimi të bëhet nën tabanin e themeleve, duhet që në këtë zonë tabani i themeleve të jetë më thelle.

Tubat do të shtrihen duke u nisur nga pika më e ulët, deri në pikën më të lartë në vijë të drejtë me pjerrësi, mbi një shtresë filtruese zhavori 15 cm të trashë dhe mbulohet rreth 25 cm me të njëjtin material filtrues. Gjithashtu, duhet patur parasysh që tabani I tubit të jetë minimumi 20 cm nën nivelin e dyshemesë, në mënyrë të tillë, që uji të largohet pa problem nga shtresa kapilare.

Përveç drenazhimit perimetral një rol të madh në largimin e ujit nga themelet luan edhe drenazhimi sipërfaqësor i cili realizohet si më poshtë.

Open Procurement Albania

Elemente dhe nën- elemente betoni

Arkitrare të derdhur në vend

Arkitrarët realizohen në të gjithë gjerësinë e muraturës me mbështetje min. 25 cm mbi shpatullat anësore, me lartësi të ndyshme në varësi të hapësirës së dritës, të armuar në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, të përgatitur nga beton M 200 dhe M 250, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës dhe çdo përforcim tjetër për mbarimin e punës.

Arkitrarë të parapërgatitur

Furnizim dhe vendosje në vepër e arkitrarëve të parafabrikuar, me gjerësi totale deri në 40 cm dhe seksione të ndryshueshme, të formuar nga beton m-200, të armuar në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, të vendosur në vepër me llaç çimento m-1:2, duke përfshirë armaturën e hekurit, punimet e armaturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Trarë të derdhur

Trarë betoni; të armuar në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, deri në lartësinë 4 m, i realizuar me betonin të dhënë në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibruara mirë, betoni m-200 me dozim sipas betonit marka 200 me inerte, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet përforcimet, hekurin e armaturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Breza betoni

Realizimi i brezit, në të gjithë gjerësinë e muraturës poshtë dhe lartësi prej 15 deri në 20 cm, i armuar sipas KTZ dhe STASH, i realizuar me betonin të prodhuar në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibruara mirë, beton M 150 deri të M 200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Kollona

Kollona betoni, të armuara në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, deri në lartësinë 4 m i realizuar me betonin të dhënë në vepër, i shtruar në shtresa të holla të vibruara mirë, betoni, betoni m-200 me dozim sipas betonit marka 200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Soleta të armuara tip SAP

Furnizim dhe vendosje në emër të soletës tip "SAP", e vënë mbi muraturën e niveluar më parë me llaç m-1:2, e ankoruar në një brez lidhës dhe sipas udhëzimeve të projektit, e armuar në mënyrë të rregullt, beton M 200 deri M 250, e hedhur në vepër me shtresa të holla të vibruara mirë, dhe sipas hapësirës së dritës së kampatës do të duhet një armaturë hekuri dhe soletëz shtesë, duke përfshirë kallëpet, puntelimet, përforçimet, skelat e shërbimit ose skeleritë si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Soleta të parapërgatitura

Solete beton/arme të parafabrikuar, në lartësi të ndyshueshme nga 11 cm deri në 16 cm, e vënë në vepër mbi brezin e niveluar mirë, duke përfshirë montimin e soletës dhe hedhjen përkatëse të betonit M 250 ose M 300.

Soletë b/a

Soletë monolite betoni të armuar në mënyrë të rregullt, realizuar në beton M 200 sipas projektit, e dhënë në vepër në shtresa të holla të vibruara mirë, duke përfshirë hekurin, kallëpet, puntelimet, përforcimet, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

Shkallë b/a të derdhura në vend

Shkallë për çdo kat, realizohen me rampa, me elementë të pjerrët të dhëmbëzuar, me shesh pushime përkatëse dhe trarë mbajtës. Bazamakët betonohen njëkohësisht me rampën. Marka e betonit M 200 deri në M 250, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, skelat e shërbimit, gërmimet për themelet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar punën.

Mbulesa në hyrjen kryesore

Pensilina në hyrje të ndërtesës, e realizuar me Soletë beton / arme monolite, e cila është një me pjesën e shtresës beton / arme të korpusit të ndërtesës dhe mund të betonohet në formë tra konsul ose e mbështetur në tra konsul. Marka e betonit M 200 deri në M 250. Punimet realizohen duke përfshirë kallëpet, përforcimet, skelat e shërbimit, gërmimet për themelet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar punën.

Struktura prej b/a

Pjesë godine me strukturë mbajtëse beton arme, ndërtuar e ndarë nga muratura, duke parashikuar një fugë teknike për gjatësi mbi 40 m. Struktura beton / arme duhet të formohet nga skelet me trarë, kollona, plinta, shkallë të lidhura ndërmjet tyre; dhe e realizuar: në mënyrë monolite me beton M 200 deri M 250. Këto struktura realizohen duke filluar që nga themelet.

Muret dhe ndarjet

Mur me tulla të plota 25 cm

Muraturë me tulla të plota mbajtëse në lartësi deri 3 m, rëalizohët më llaç bastard m-25, sipas pikës 5.1.1 me përmbajtje për m3: tulla të plota nr. 400, llaç bastard m3 0.25, çimento 400, për çdo trashësi muri, duke përfshirë çdo detaj dhe kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, parmakët, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe, sipërfaqja e xokulit duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi jo më të vogël se 2cm.

Mur me tulla të lehtësuara

Muraturë me tulla të lehtësuara, në lartësi deri 3 m, realizohen me Llaç bastard m-25 sipas pikës 1.2, me përmbajtje për m^3: tulla të lehtësuara nr. 205, Llaç bastard m3 0.29, çimento 400, për çdo trashësi, duke përfshirë çdo detaj dhe kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe,

sipërfaqja e xokollaturës duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi, jo më të vogël se 2 cm.

Mur ndarës 12 cm

Muraturë me tulla të plota me trashësi 12 cm dhe llaç bastard m-25 me përmbajtje për m³ : tulla të plota 424 copë, llaç 0.19 m³, çimento 400 dhe ujë.

Mur i brendshëm me tulla të plota

Muraturë me tulla të plota, me trashësi 25 cm realizohet me llaç bastard m- 25 me përmbajtje për m³: tulla të plota nr. 400, llaç 0,25 m³, çimento 400, 38 kg dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelave të shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe, sipërfaqja e xokolaturës duhet të jetë e niveluar me një Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashësi, jo më të vogël se 2 cm.

Mur i brendshëm me tulla me birra 11 cm

Muraturë me tulla me 6 brima, me trashësi 11 cm dhe llaç bastard m-25 me përmbajtje për m³: tulla me 6 vrima 177 copë, llaç 0,10 m³, çimento 400 dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelave e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe sipërfaqja e xokolaturës duhet të jetë e niveluar me një Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashësi jo më të vogël 2 cm.

Mur i brendshëm me tulla me birra 20 cm

Muraturë me tulla me 6 brima, me trashësi 20 cm realizuar me llaç bastard m-25 me përmbajtje për m³: tulla me 6 vrima 172 copë, llaç 0,12 m³, çimento 400 dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelave të shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe sipërfaqja e xokulit duhet të jetë e niveluar me një Shtrese Llaçi çimento 1:2 me trashësi, jo më të vogël se 2 cm.

Dopio mur me tulla

Njëlloj si në rastet e paraqitura më sipër, vetëm se këtu kemi dy rreshta mur tulle të vendosur ngjitur me njëri tjetrin dhe të lidhur ndërmjet tyre.

Dopio mur me tulla të lehtësuara

Njëlloj si në rastet e paraqitura më sipër, vetëm se këtu kemi dy rreshta mur tulle të lehtësuar të vendosur ngjitur me njëri tjetrin dhe të lidhur ndërmjet tyre.

Mure me blloqe betoni

Strukturat metalike

Në projektimin e konstruksioneve prej çeliku, duhen marrë parasysh kërkesat që pasqyrojnë veçoritë e punës së këtyre konstruksioneve, më anë të udhëzimeve përkatëse në mbështetje të këtyre kushteve teknike.

Open Procurement Albania

Soliditeti dhe qëndrueshmëria e konstruksioneve prej çeliku duhet të garantohet si gjatë proçesit të shfrytëzimit, ashtu edhe gjatë transportimit dhe montimit.

4.3.4. Teknologjitë dhe pajisjet që duhet të përdoren

Teknologjitë që do të përdoren do të konsistojnë për rritjen e efiçencës së përdorimit të energjisë.

Sistemi I ngrohjes qëndrore

Tubat e sistemit ngrohës mund të ndahen sipas materialit:

- Tuba prej hekuri
- Tuba prej hekuri të zinkuara
- Tuba bakri
- Tuba plastike

Radiatorët e ngrohjes qëndrore

- Alumini
- Çeliku

Termoizolimi i objektit:

- Sistem kapotë
- Mure me shtresa (mur + polisterol + mur)
- Termoizolimi i soletave (polisterol)
- Termoizolim i katit përdhe

Panelet diellore për ngrohjen e ujit sanitar

- Rrjeti i tubave dërgim-kthim
- Panelet diellore (fiksimi në tarracat e objekteve)
- Bolier qëndror

Open Procurement Albania

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit

- Paisjet e kontrollit
- Sinjalizuesit e tymit të duhanit.
- Zjarrpërgjuesit automatik
- Zilet e alarmit

Në rastet e rënies së zjarrit, format e shuarjes së zjarrit janë:

- Tipe të fiksuara
  - Hidrante brenda ndërtesës
  - Hidrante jashtë ndërtesës
  - Sisteme me sperkatje
- Tipe mobile
  - Bombula të ndryshme

Sistemi i veshgimit të kamerave:

- Rrjeti i instalimeve
- Kamerat

- Kontrollin qendror të kamerave

4.3.5. Lista e standardeve teknike përkatëse që do merren parasysh gjatë zbatimit të projektit

Përsa i i përket standardeve teknike të zbatimit , do ti referohemi VKM nr.68, datë 15.02.2001, lidhjes nr.2 "Kushtet Teknike të Zbatimit", si dhe EUROKODE-ve, për punimet dhe materialet që do të përdoren në zbatimin e projektit. (Aneksi nr. 5 bashkelidhur)

4.3.6. Periudha e vlerësuar e ndërtimit

Periudha e realizimit të ndërtimit do të llogaritet nga momenti që lidhet kontrata, e cila do të kalojë në fazat si më poshtë:

1.	Lidhja e kontratës	
2.	Projekt ideja	2 muaj
3.	Projekt zbatimi	4 muaj
4.	Miratimi i projektit të zbatimit (miratim në Institucion dhe oponenca)	1 muaj
5.	Miratimi i lejes së ndërtimit dhe lejeve të tjera përkatëse	1 muaj
6.	Zbatimi i ndërtimit	12 muaj

Nga momenti i lidhjes së kontratës brenda një afati 6 mujor, duhet të ketë përfunduar projekti i zbatimit për objektet.

Pas hartimit të projektit të zbatimitpër 1 muaj, do të bëhet miratimi i i tij dhe pajisja me lejet përkatëse.

Pas miratimit të projektit dhe pajisjes me lejet përkatëse për 1 vit duhet të realizohet ndërtimi i objektit.

Open Procurement Albania

Tabela 37 - Etapat e realizimit të objektit

Nr.	Etapat e relaizimit të objektit	MUAJ																			
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV	XV	XVI	XVII	XVIII	XIX	XX
1	Lidhja e kontratës																				
2	Projekt ideja																				
3	Projekt zbatimi																				
4	Miratimi i projektit të zbatimit (miratim në Institucion dhe oponenca)																				
5	Miratimi i lejes së ndërtimit dhe lejeve të tjera përkatëse																				
6	Zbatimi i ndërtimit																				

4.4. Kostot për zbatimin e projektit

4.4.1. Kosto projektimi dhe ndërtimi

Në vijim të nevojave për klasa të reja të evidentuara për secilën Njësi Administrative, kërkesat u akomoduan në shkolla me numër klasash sipas standardeve të specifikuara nga MAS përmes udhëzuesit "Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave

paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar sipas përcaktimeve të MAS.

Tabela 38 - Nr i shkollave të nevojshme për tu ndërtuar

	9-vjeçare			E mesme		
NJESIA ADMINISTRATIVE	**Shkolla të reja**	**Tipologjia e shkollës**	**Nr nxënësish**	**Shkolla të reja**	**Tipologjia e shkollës**	**Nr nxënësish**
NJESIA ADMINISTRATIVE 1	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 2	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 3	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 4	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 5	**1**	Tipi 2 - 30 klasa	900	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 6	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 7	**0**	0	0	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 8	**1**	Tipi 1 - 20 klasa	600	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 9	**1**	Tipi 1 - 20 klasa	600	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJESIA ADMINISTRATIVE 10	**0**	0	0	**0**	0	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 11	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA DAJT	**0**	0	0	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA FARKE	**1**	Tipi 3 - 20 klasa	480	**0**	0	0
NJA VAQARR	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA KASHAR	**2**	Tipi 2 - 30 klasa	1800	**1**	Tipi 4 - 21 klasa	630
NJA NDROQ	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA PEZE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA PETRELE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA BALDUSHK	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA BERZHITE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA KRRABE	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA SHENGJERGJ	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA ZALL BASTAR	**0**	0	0	**0**	0	0
NJA ZALL HERR	**0**	0	0	**0**	0	0
TOTAL	**10**		**7980**	**7**		**4410**

Open Procurement Albania

Duke u nisur nga nevojat për kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe për të rritur efiçencën e këtij investimi, gjatë studimit janë marrë parasysh edhe këto nevoja duke parashikuar integrimin e hapësirave për kopështe në ndërtesat e ciklit 9-vjeçar. Këto hapësira mund të integrohen në të njëjtën ndërtesë, por me hyrje dhe oborr të veçantë, si dhe duke siguruar të gjitha parametrat teknikë të përshtatshëm që garantojnë sigurinë e fëmijëve dhe mbarëvajtjen e proçeseve edukative dhe të përkujdesit të fëmijëve të këtyre grupmoshave.

Meqënëse tek Udhëzimi "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standardet) nuk ka të parashikuara standarde për projektimin e kopshteve, çdo kosto dhe hapësirë ndërtimi është bërë bazuar në projekte të ngjashme të ndërtuara në vitet e fundit nga Bashkia Tiranë, konkretisht;

1. Ndërtim i ri Kopështi në rrugën Selaudin Bekteshi
2. Ndërtim i ri Kopështi nr. 21
3. Ndërtim i ri Kopështi nr. 34

Tabela 39 – Të dhëna të detajuara për shkollat e propozuara

	SHKOLLA 9-VJEÇARE DHE KOPËSHTE							SHKOLLA TË MESME	
NJESIA ADMINISTRATIVE	SHKOLLA TE REJA	NR KLASASH 9-VJECARE/ SHKOLLË	KLASA PARASHOLLORE/ SHKOLLË (5-6 VJEC)	AMBJENTE KOPËSHTI/ SHKOLLË (4-5 VJEC)	AMBJENTE KOPËSHTI/ SHKOLLË (3-4 VJEC)	TOTAL KLASA/ SHKOLLE	TOTAL KLASA	SHKOLLA TE REJA	NR KL/ SHKOLLË
NJESIA ADMINISTRATIVE 1	**0**							**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 2	**3**	18	2	2	2	24	72	**1**	21
NJESIA ADMINISTRATIVE 3	**0**							**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 4	**1**	18	2	2	2	24	24	**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 5	**1**	27	3	3	3	36	36	**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 6	**3**	27	3	3	3	36	108	**1**	21
NJESIA ADMINISTRATIVE 7	**0**							**1**	21
NJESIA ADMINISTRATIVE 8	**0**							**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 9	**0**							**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 10	**0**							**0**	0
NJESIA ADMINISTRATIVE 11	**2**	27	3	3	3	36	72	**1**	21
NJA DAJT	**1**	18	2	2	2	24	24	**1**	21
NJA FARKE	**0**							**0**	0
NJA VAQARR	**0**							**0**	0
NJA KASHAR	**0**							**0**	0
NJA NDROQ	**0**							**0**	0
NJA PEZE	**0**							**0**	0
NJA PETRELE	**0**							**0**	0
NJA BALDUSHK	**0**							**0**	0
NJA BERZHITE	**1**	18	2	2	2	24	24	**0**	0
NJA KRRABE	**0**							**0**	0
NJA SHENGJERGJ	**0**							**0**	0
NJA ZALLBASTAR	**0**							**0**	0
NJA ZALLHERR	**0**							**0**	0
TOTAL	**12**						**360**	**5**	**105**

Open Procurement Albania

Referuar programit mësimor dhe standardeve të vendosura nga Ministria Arsimit dhe Sportit tipet e klasave, përmasat e tyre, hapësirat e nevojshme për çdo nivel, për arsimin 9-vjeçar do të jenë sipas tabelave Nr. 1- Nr. 4 .

Referuar programit mësimor dhe standardeve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, tipet e klasave, përmasat e tyre, hapësirat e nevojshme për çdo nivel, për arsimin e mesëm të lartë do të jenë sipas tabelës Nr. 5. Në varësi të zonës ku do të ndërtohet shkolla, ato ndahen në shkolla në zonat rurale dhe shkolla në zonat urbane. Siç është parashikuar, numri mesatar i nxënësve në zonat urbane do të jetë 30 nxënës/ klasë, ndërsa në zonat rurale, me dendësi më të ulët banimi, 24 nxënës/klasë. Meqënëse nevoja për institucione arsimore në Njësinë Administrative të Dajtit është parashikuar në zonë të urbanizuar, është vendosur që për këtë rast të ndiqen standardet e zonës urbane.

E njëjta llogjikë është ndjekur edhe për rastet e tjera të ngjashme për Njësitë Administrative që i janë bashkëngjitur Bashkisë Tiranë pas Reformës Territoriale Administrative.

Mbi këtë bazë, në total evidentohen 4 tipe shkollash:

Tabela 40 - Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

Kostoja e ndërtimit të kopësheve është përllogaritur sipas preventivave të projekteve të kopshteve të realizuara nga Bashkia Tiranë gjatë përiudhës 2012-2013-të. Në këtë çmim janë përfshirë kostot e ndërtimit të objektit arsimor së bashku me hapësirat e hapura në funksion të tij (oborrin).Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iu referuar Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 – 2013, është bërë indeksimi i çmimit për metër katror i dalë nga këto preventiva.

Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it "Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa), 1994-2015", ku për periudhën 2013 – 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55%.

Si përfundim çmimi mesatar së bashku me normën e rritjes llogaritet të jetë: 54,381 lekë/m2 pa TVSH.

Tabela 41 - Sipërfaqet e kopshteve sipas tipeve

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale (m^2)
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	9.1	874
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	9.1	1310
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	9.1	874

Tabela 42 - Kostot e ndërtimit të kopshteve sipas tipologjisë

Tipi	Cikli	Sip.totale	Kosto totale ndërtimi (lekë)
Tipi 1	Kopësht (3-5 vjeç)	874	47,528,848
Tipi 2	Kopësht (3-5 vjeç)	1310	71,238,892
Tipi 3	Kopësht (3-5 vjeç)	874	47,528,848

Kosto e ndërtimit

Përcaktimi i kostos së ndërtimit të shkollave i është referuar preventivave të hartuar për ndërtimet e reja të objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, me financim nga fondet publike dhe donatorë, si më poshtë:

- Ndërtim i ri shkolla 9 vjeçare në rrugën "Selaudin Bekteshi", financim nga Delegacioni i BE në Tiranë, në kuadër të IPA 2012;

- Ndërtim i ri shkollës 9 – vjeçare "Ahmet Gashi", financim nga fondet publike;
- Ndërtim i ri shkollës 9 – vjeçare tek "Ish Parku i Autobusave", financim nga fondet publike;
- Ndërtim i ri shkollës 9 – vjeçare "Ish Magazinat e Kombinatit tekstil", financim nga fondet publike;
- Ndërtim i ri shkollës së mesme " Hoxha Tahsin", financim nga fondet publike.

Sipas preventivëve të marrë në analizë për të 5 objektet, kategoritë e punimeve me zërat përkatës, që realizohen, janë:

Tabela 43 - Kategoritë e punimeve me zërat përkatës

Nr.	TITULLI
1	**PUNIME CIVILE**
1.1	DEMOLIM DHE PASTRIM I KANTJERIT
1.2	PUNIME GERMIMI DHE MBUSHJE
1.3	PUNIME BETONI
1.4	PUNIME KONSTRUKSIONI METALIKE
1.5	PUNIME HIDROIZOLIMI
1.6	PUNIME MURATURE
1.7	PUNIME TE CATISE
1.8	PUNIME SUVATIMI
1.9	PUNIME SHTRESASH DHE VESHJESH
1.10	DYER DHE DRITARE
1.11	PUNIME STRUKTURORE METALIKE
1.12	PUNIME METALIKE
1.13	DEKORACIONE DHE LYERJE
1.14	PUNIME JASHTE GODINES
1.15	TE NDRYSHME
2	**PUNIMET MEKANIKE**
2.1	SISTEME NGROHJE
2.2	SISTEM VENTILIMI
2.3	RRJETI I UJIT TE PIJSHEM
2.4	RRJETI I UJERAVE TE ZEZA DHE UJERAVE TE SHIUT
2.5	SISTEMI KUNDRA ZJARRIT
3	**PUNIMET ELEKTRIKE**
3.1	SISTEMI I GJENERATOREVE DHE UPS
3.2	SHPERNDARJA E ENERGJISE
3.3	INSTALIMI I KABLLOVE, KANALINA DHE KUTI SHPERNDARESE
3.4	PRIZA, CELESA DHE RRJETI I NDRICIMIT
3.5	SISTEMI I DETEKTIMIT TE ZJARRIT
3.6	SISTEMI I THIRRJES SE PUBLIKUT
3.7	RRJETI LOKAL (LAN)
3.8	SISTEMI I TELEVIZIONIT (IT)
3.9	SISTEMI I CCTV
3.10	SISTEMI I RRUFEPRITJES
	TOTALI
4	**Fondi Rezerv**
	TOTALI + Fondi Rezerve

Open Procurement Albania

Më specifikisht në sisteme ngrohje, përfshihen instalimi i rrjetit të nevojshëm për sistemin e ngrohjes, si dhe pajisjet përkatëse, Kaldaja me të gjithë aksesorët dhe pajisjet e nevojshme për funksionim, radiatorët, etj.

Sistemi i ventilimit është përdorur për palestrën e shkollës.

Sistemi i CCTV, thirrjes së publikut, detektimit të zjarrit, përfshin instalimin e rrjeteve të nevojshme, si dhe pajisjeve përkatëse.

Nga analiza e këtyre preventivëve, rezulton se pesha specifike që zë secila prej kategorive të punimeve, në koston e plotë të objektit, është si më poshtë:

- Punime Civile 76% (varion nga 71% në 80%)
- Punime Mekanike 10% (varion nga 9% në 12%)
- Punime Elektrike 10% (varion nga 6% në 13.5%)
- Fondi Rezerve 4% (varion nga 3% në 5%)

Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iu referuar Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 – 2013, është bërë indeksimi i çmimit për metër katror i dalë nga këto preventiva.

Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it "Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa), 1994-2015", ku për periudhën 2013 – 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55%.

Si rezultat i këtij indeksimi çmimi mesatar i ndërtimit është pranuar 46,332 lekë/m2 pa TVSH.

Mbështetur në këtë analizë, kostoja për ndërtimin e objekteve arsimore sipas tipologjive të sipër-përmendura është:

Open Procurement Albania

Tabela 44 - Kosto totale për ndërtimin e objekteve mësimore sipas tipologjisë

Tipi	Cikli	Sip.totale (m2)	Kosto totale ndërtimi me TVSH (lekë)
Tipi 1	Arsimi Bazë	4938,0	228,785,770
Tipi 2	Arsimi Bazë	6588,0	305,233,020
Tipi 3	Arsimi Bazë	4041.6	187,207,732
Tipi 4	I mesëm I lartë	4000.5	185,349,833

Kosto totale e ndërtimit e shkollave bashkë me kopshtet e integruara është sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 45 - Kosto totale ndërtimi

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Sip. kopësht	Sip. Arsimi Bazë	Sip. I mesëm i lartë	Kosto/ Shkolle (lek)	Kosto/ Kopësht (lek)	Kosto Totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë+Kopësht	874	4,938	0	228,785,770	47,528,848	276,314,618
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë+Kopësht	1310	6,588	0	305,233,020	71,238,892	376,471,912
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë+Kopësht	874	4,041.6	0	187,207,732	47,528,848	234,736,581
Tipi 4	Urban	I mesëm i Lart		0	4000.5	185,349,833	0	185,349,833

4.4.2. Kosto mobilimi dhe laboratoresh

Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara prej jush, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24.167 lekë pa TVSH. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve, kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj.

Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si mëposhtë:

Tabela 46 - Kostot e mobilimit sipas tipologjisë

Tipi shkollës	Nr. Klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Arsimi Bazë (Zona Urbane)	20	30	600	24.167	14.500.000
Arsimi Bazë (Zona Urbane)	30	30	900	24.167	21.750.000
Arsimi Bazë (Zona rurale)	20	24	480	24.167	11.600.000
Arsimi I Mesëm i Lartë	21	30	630	24.167	15.225.000

Në koston e mobilimit për arsimin bazë janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshmë, për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të më parshëm të indeksuara.

Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth 27.916 lek pa Tvsh

Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 47 - Kostot e mobilimit sipas tipologjisë

Tipi	Vendn dodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmij	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27.916	2.680.000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27.916	4.020.000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27.916	2.680.000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar kontratës blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 48 Kostot paraprake të laboratorëve sipas tipit

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator
1	Laborator Shkencat natyrore	186,998
2	Laborator Kimie	223,125
3	Laborator Fizike	1,183,602
4	Laborator Biologjie	632,467
5	Laborator IT	3,869,658
II	Shkolla e Mesme	-
1	Laborator Kimie	528,469
2	Laborator Fizike	1,294,500
3	Laborator Biologjie	651,657
4	Laborator IT	3,869,658

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Tabela 49 Kostot e laboratorëve sipas tipit të shkollës

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	Arsimi Bazik (Tipi 1)	6,095,850
2	Arsimi Bazik (Tipi 2)	7,279,450
3	Arsimi Bazik (Tipi 3)	5,743,950

4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e 17 shkollave është 602,378,267 lekë pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

4.4.3. Kosto mirëmbajtje

Për të përllogaritur koston e mirëmbajtjes së një objekti arsimor parauniversitar është marrë në studim një shkollë 9-vjeçare me sipërfaqe 3500 m^2. Nga llogaritjet e kryera, sipërfaqja mesatare e një klase fizike rezulton të jetë 36m^2. Në llogaritjen e kostos janë përfshirë të gjitha zërat e mirëmbajtjes që realizon Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Qytetit. Gjithashtu është marrë për bazë dhe historiku i preventivave të mirëmbajtjes (sëbashku me vlerën në lekë) që janë kryer për këtë objekt për një vit shkollor.

Tabela e mëposhtme paraqet të gjitha zërat e mirëmbajtjes dhe kostot e tyre në lekë për një periudhë një vjeçare dhe të përkthyera në kosto vjetore për një klasë fizike. Sipas tabelës, kostoja e shpenzimeve vjetore për një klasë me sipërfaqe mesatare 36 m^2 është 422,107 Lekë me TVSH ose 351,755 lek pa TVSh. E thënë ndryshe, kostoja e mirëmbajtjes llogaritet të jetë 11,725 lekë për m^2 me TVSh ose 9,770 lekë për m^2 pa TVSh .

Open Procurement Albania

Tabela 50 - Zërat e mirëmbajtjes dhe kostot e tyre (LEKË) për një periudhë 1 vjeçare për klasë fizike

Emërtimi i Punimeve/riparimeve	Njësia	Sasia totale	Çmimi për Njësi (leke)	Totali I Shpenzimev e Mujore	Totali shpenzimev e vjetore (këtu janë përllogaritur material+ punëtori)	Totali shpenzim eve vjetore/ klase fizike (mesatari sht me siperfaqje 36 m2)
Lyerje						
Boje Hidromat	Kg	577	90		38.298	
Boje Plastiko	Kg	1.166	187		160.806	
Boje Akriliko	Kg	970	545		389.879	
Boje vaji	Kg	13	440		4.219	
Stuko Lyerje e Brendshme	Kg	60	45		1.991	
Stuko Lyerje e Jashtme	Kg	30	60		664	
Astar	Kg	147	260		14.094	
Pigment	Kg	35	3.850		99.378	
Tretes	Kg	2	200		295	
Totali Lyerje I					**709.624**	**22.891**
*** Lyerjet e brendshme janë llogaritur për 1 here ne 2 vjet, banjot 1xvit dhe sipërfaqet fasada e jashtme është llogaritur 1 here ne 4 vjet**						
Riparim Suvatime	m2	314	670		210.380	
Hidroizolime	m2	420	1.232		517.440	
Totali II					**727.820**	**23.478**
Riparime dhe mirëmbajtje të Ndërtesës						
Mirëmbajtje Hidraulike					62.710	
Mirëmbajtje Elektrike					50.575	
Mirëmbajtje Muratori					47.617	
Mirëmbajtje Marangozi					61.723	
Totali III					**222.624**	**7.181**
Riparime Orendi Shkollore						
Riparim Karrige	cope	200	542		159.890	
Riparim Tavolina	cope	100	2.476		365.210	
Totali IV					**525.100**	**16.939**
Mirembajtja Strukturore						
Roje	punonjes	2	36.945	73.890	886.680	
Sanitare	punonjes	6	32.840	197.040	2.364.480	

Sekretare	punonjes	1	39.466	39.466	473.592	
Totali V			109.251	310.396	**3.724.752**	**120.153**
Riparime Pajisje PC (Totali VI)	Lekë				**800.000**	**25.806**
Mirembajtje instalime teknike (janë dhënë më lart)						
Materiale Pastrimi (Totali VII)	Lekë				**262.500**	**8.468**
Materiale të tjera:						
Lëndë Djegëse ngrohje dhe ujë ngrohtë gjithë vitin shkollor	Litër	16.000	162		2.592.000	
Mirëmbajtje impiante ngrohje-ftohje (kondicionerët)	Lekë				1.050.000	
Mirëmbajtje impiante ujë pijshëm dhe ngrohtë	Lekë				250.000	
MNZSH (mirëmbajtje sistemi detektim sinjalizim, rimbushje fikse etj)					40.000	
Totali VIII					**3.932.000**	**126.839**
Fondi rezerve 5 %	(në mirëmbajtje, blerje malli e lyerje nuk përdoret)					
Totali I+II+III+IV+V+VI+VII+VIII					**10.904.420**	**351.755**
T.V.Sh 20%					**2.180.884**	**70.351**
TOTALI					**13.085.304**	**422.107**

Open Procurement Albania

4.4.4. Kosto të tjera

Krahas kostos së ndërtimit të objekteve arsimore kemi dhe disa kosto e tarifa të tjera, për:

- Studim projektimin
- Mbikqyrjen e punimeve
- Kolaudimin
- Oponencën teknike
- Mbrojtjen ndaj zjarrit
- Lejen mjedisore
- Ndikimit në infrastrukturë

Për përcaktimin e tarifës së **studim projektimit, mbikqyrje dhe kolaudim**, i referohemi VKM 354, datë 11.05.2016 për "Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikqyrje dhe Kolaudim".

Për objektet arsimore, i refreohemi Kreu III, Seksioni I "Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre", ku kemi marrë grupin e IV tarifore dhe referuar tabelës 6, "Tabela shoqërueses e tarifave, neni 25 – Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjsë, si dhe strukturat në ambjentet e jashtme", sipas tipeve të objekteve arsimore dhe vlerave të tyre, kemi vlerat paraprake (me TVSh) sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 51 - Kosto të tjera

Tipi	Kosto Ndërtimit	Studim Projektim	Mbikëqyrje punimesh	Kolaudim
Tipi 1	276,314,618	4,481,127	3,140,921	110,526
Tipi 2	376,471,912	10,110,384	4,177,904	150,589
Tipi 3	234,736,581	6,638,188	2,703,942	93,917
Tipi 4	185,349,833	5,345,868	2,182,239	76,855

Studim projektimi kalon nëpër këto faza dhe secila prej fazave zë përqindjen, si më poshtë:

1. Analiza e detyrës së projektimit 3%
2. Projektideja paraprake 7%
3. Projektideja përfundimtare 11%
4. Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit 6%
5. Projekti i zbatimit 32%
6. Preventive përfundimtar 10%

   Totali **69%**

Ndërsa mbikqyrja e punimeve, kalon në këto faza:

1. Mbikqyrja 25%
2. Pergatitja e dokumentacionit Perfundimtar për kolaudimi 3%

   Total **28%**

Për përcaktimin e vlerës së Kolaudimit, i jemi referuar Kreu V "Shërbime për kolaudim", neni 62, i VKM 354, datë 11.05.2016.

Oponenca teknike

Llogaritja e oponencës teknike bëhet duke ju referuar VKM nr.1055 datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", ku në bazë të vlerës së objektit përcaktohen koeficientet sipas tabelës së mëposhtme:

Open Procurement Albania

Tabela 52 - LLogaritja e oponencës teknike

Kushtimi (milion lekë)	Tarifa (në %)
100	6.5
150	6.0
200	5.5
250	5.0
300	4.5
mbi 300	4.0

Oponenca teknike do të llogaritet mbi bazën e vlerës së projektit të zbatimit dhe preventivin e projektit të zbatimit, të cilat zënë 42% të vlerës së llogaritur të studim projektimit referuar VKM 354, datë 11.05.2016 për "Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikqyrje dhe Kolaudim".

Për tipet e shkollave të marra në analizë vlera e oponencës do të jetë si më poshtë:

Tabela 53 - Oponenca teknike sipas tipologjisë së shkollave

Tipi	Kosto Ndërtimit	Oponenca
Tipi 1	276,314,618	223,183
Tipi 2	376,471,912	250,675
Tipi 3	234,736,581	208,967
Tipi 4	185,349,833	184,846

Open Procurement Albania

- Mbrojtja ndaj zjarrit

Për tarifën që paguhet për mbrojtjen ndaj zjarrit, i referohemi VKM nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, Juridike e fizikë, vendas e të huaj". Për objekte me vlerë mbi 100.000.000 lek tarifa është 50.000 lek.

- Lejen mjedisore

Tarifa që paguhe për marrjen e lejes mjedisore, bëhet në bazë të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"dhe VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedist", për rastin në shqyrtim, ndërtim i ri është 30.000 mijë lek.

- Ndikimit në infrastrukturë

Taksa e e ndikimit në infrastrukturë përcaktohet në bazë të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit neni 46, pika 4, i cili përcakton se: "Autoriteti Vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastructure nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike". Pra për ndërtimin e shkollave kjo taksë vendore është 0.

Open Procurement Albania

5. NDIKIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

5.1 Ndikimi Mjedisor

Ky raport mjedisor ka të bëjë me parashikimin paraprak të efekteve negative dhe pozitive të parashikuara për ndërtimin e këtyre objekteve shkollore në qytetin e Tiranës.

Vlerësimi mjedisor i territorit të marrë në studim përqendrohet në evidentimin e parametrave fiziko-natyrorë, elmentëve që shfaqin rëndësi të veçantë natyrore për ruajtjen, si dhe në vlerësimin e ndikimit në mjedis të elementëve të rinj që do të sjellë ky projekt. Ky vlerësim do të ndihmojë në harmonizimin dhe sistemimin urbanistik të zonave në fjalë me qëllim arritjen e parametrave të kërkuara.

5.1.1. Kuadri Ligjor

Legjislacioni shqiptar për Mbrojtjen e Mjedisit paraqitet si më poshtë:

- Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligj nr. 8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar;
- Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar;
- Ligj nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar;
- Ligj nr. 10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar;
- Ligj nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- Ligj nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis";
- Ligj nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 04.01.2014, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afatave për zhvillimin e procedures së vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 30.04.2014, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore";
- Vendimi i Këshillit të Ministave nr. 803, datë 4.12. 2003, "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177 datë 31.03.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 20.12.2002, "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare";
- Vendim nr. 99, datë 18.02.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar;

Open Procurement Albania

- Rregullore nr. 1, datë 15.03.2006, "Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore".

5.1.2. Pershkrim i Florës dhe Faunës në zonat e marra në studim

Qyteti i Tiranës ndodhet në influencat e mikrobaseneve lumore (Lana, Lumi i Tiranës dhe Erzeni). Ato përmbajnë disa ekosisteme të cilët janë ekolgjikisht të ndryshme, të rëndësishme për habitate karakteristike dhe asocimet e tyre, por që aktualisht janë të cënuara nga shkarkimet e mbetjeve urbane të ngurta dhe të lëngëta.

Zonat ku është parashikuar ndërtimi i objekteve shkollore mund të ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë përbëhet nga sheshet që ndodhen në zona të urbanizuara, mbi të cilat janë ndërtuar objekte ekzistuese ose janë hedhur shtresa betoni. Në këtë grup bëjnë pjesë sheshet 2/3 dhe 2/6 në Njësinë Administrative nr. 2, , sheshi 9/1 në Njësinë Administrative nr. 9 dhe sheshi 11/2 në Njësinë Administrative nr. 11. Flora në këto sheshe paraqitet shumë e rrallë dhe fizionomia floristike përcaktohet nga barishtet dhe shkurretat mesdhetare, qofshin këto gjetherënëse apo me gjethe gjithnjë të blerta.

Grupi i dytë përbëhet sheshet që ndodhen në zonat të urbanizuara apo sub-urbane në të cilat bimësia është më e dëndur. Në këtë grup bëjnë pjesë sheshi 5/1 në Njësinë Administrative nr. 5, sheshi 6/6 në Njësinë Administrative nr. 6, sheshi 7/1 në Njësinë Administrative nr. 7, sheshi 8/1 në Njësinë Administrative nr. 8, sheshi 11/1 në Njësinë Administrative nr. 11, sheshi D2 në Njësinë Administrative Dajt dhe sheshi F3 në Njësinë Administrative Farkë.

Open Procurement Albania

Fizionomia flouristike e këtyre zonave varion nga barishtet e gjinisë *higrofile*, *heriofile* etj., tek shkurretat mesdhetare si *makia* apo shkurretat e gjinisë *salix* dhe në disa prej shesheve janë të pranishme edhe bimët drunore, të cilat janë shumë të rralla e kryesisht të kultivuara. Pranë shesheve 7/2 dhe 6/6, të cilët ndodhen pranë lumit të Lanës, ndeshet edhe bimësia e brigjeve, megjithëse skarpatet e Lanës janë të sistemuara e kjo bimësi paraqitet e rrallë.

Zonat ku janë parashikuar projektet, nga vendndodhja e tyre në zona urbane, kanë një faunë jo shumë të pasur, edhe pse karakterizohen nga një larmishmeri e habitatit shtazor. Më poshtë jepet një listë e plotë e specieve të kafsheve të verejtura në terren. Disa specie të vëzhguara të gjarpërinjve, zogjve, gjitarëve të vegjël dhe amfibëve përcaktohen në Direktivat e BE-së për Habitatet e Florës dhe Faunës, Shtojca II dhe IV dhe në Direktivat e BE për Zogjtë.

Gjitarët:
Lutra lutra (vidra e zakonshme)
Plecotus auritus (lakuriqi veshgjate)

Nyctalus noctula (lakuriqi i nates)

Zogjtë:
Hippolais olivetorum (çafka e ullirit)
Sylvia nisoria (çafke)

Zvarranikë:
Emys orbicularis (breshkë e moçalit)
Mauremys caspica (breshkë e moçalit)
Testudo hermanii (breshkë mesdhetare e tokes)
Natrix tesselata (gjarpër)
Lacerta trilineata (hardhucë e gjelbër me tre vija)
Lacerta viridis (hardhucë e gjelëer)
Podarcis taurica (hardhucë)

Amfibët:
Rana lessonae (bretkosë e vogël uji)
Hyla arborea (zhabë pemë)
Triturus cristatus (salamander)
Bufo viridis (zhabë e gjelbër).

Open Procurement Albania

5.2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis në zonat e studiuara

Vlerësimi i ndikimeve të prishtshme në mjedis përfshin dy faza të realizimit të projektit. Faza e parë ka të bëjë me ndikimet negative në mjedis gjatë ndërtimit të shkollave dhe faza e dytë lidhet me ndikimet negative në mjedis gjatë operimit të tyre.

5.2.1. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së ndërtimit

Toka

Ndërtimi i objekteve shkollore do të bëhët mbi sipërfaqe toke të cilat mund të ndahen në: sipërfaqe jo natyrale dukeqenë se mbi to ka ndërtime ekzistuese, troje të sistemuara e të shtruara me asfalt dhe sipërfaqe toke natyrale. Në këto raste, ndikimi më i madh në mjedis vjen nga ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës. Ky është një ndikim afatgjatë ose mbetës.

Përdorimi i tokës dhe peisazhi

Ndërtimi i shkollave do të ndryshojë plotësisht aspektet vizive të zonave të përzgjedhura. Duke u nisur nga fakti se objektet e reja shkollore do të ndërtohen në zona të populluara e të urbanizuara, mund të thuhet se ndërtimi i tyre integrohet më së miri me peisazhin e zonave.

Ujërat sipërfaqësorë

Pjesa dërrmuese e shesheve të përzgjedhura nuk përshkohen nga ujëra sipërfaqësorë dhe, rrejdhimisht, nuk mund të ketë ndikim negative mjedisor. Përjashtim përbejnë vetëm sheshet 6/6 dhe 7/2 të cilët ndodhen në afërsi të lumit të Lanës. Megjithatë, shtrati i lumit ndodhet jashtë rrethimeve të pritshme të kantierit të ndërtimit, e si rrjedhim mundësia e ndotjes së ujrave nga karburantët dhe lubrifikantët e makinerive të ndërtimit është shumë e vogël.

Ajri

Cilësia e ajrit mund të ndikohet nga zhurmat si rezultat i përdorimit të makinerive të rënda gërmuese, transportuese dhe autobetoniereve që do të përdoren gjatë ndërtimit të kësaj godine dhe nga prodhimi i pluhurave që mund të shoqërojnë ndërtimin që nga momenti i hapjes së themeleve dhe gjatë punimeve të mëvonshme. Objektet e reja shkollore do të ndërtohen pranë qendrave të banuara, ndaj pritet që ndikimi i tyre të jetë i nivelit të mesëm. Sidoqoftë të dyja këto ndikime janë të përkohëshme duke qene se lidhen me operacionet ndërtimore.

Biodiversiteti

Shkollat do të ndërtohen mbi sipërfaqe toke të shfrytëzuara ose të pashfrytëzuara të cilat janë pjesërisht të mbuluara me barishte dhe bimësi të rrallë. Kjo bimësi do të pastrohet si rezultat i ndërtimit, por ndikimi në mjedis do të jetë thuajse i parëndësishëm asnjë nga llojet përbërëse nuk vlerësohet si me rëndësi për biodiversitetin. Në lidhje me faunën, ndikimet do të jenë minimale pasi sheshet ndodhen në zona të urbanizuara të cilat nuk janë të populluara nga gjallesat shtazore.

Open Procurement Albania

Mbetjet dhe inertet

Si rezultat i gërmimeve, do të krijohen mbetje ndërtimore si dhera, mbeturina llaçi, tulla, gurë, inerte, gëlqere, armature etj. Nëse këto mbetje do të jenë të ripërdorshme atëherë ato do të përdoren për realizimin e mbushjeve. Në rastet kur do të jenë të të papërdorshme ato do të depozitohen nëpër vende të caktuara sipas kushteve të vëna nga Bashkia Tiranë.

Trafiku

Si rezultat i hyrjeve dhe daljeve të makinerive të tonazhit të rëndë në kantierin e ndërtimit, pranë këtyre kantiereve mund të krijohet trafik i përkohëshëm. Ky do të jetë, sidoqoftë, një ndikim i përkohëshëm vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

Mjedisi socio-ekonomik

Pjesa dërrmuese e zonave të përzgjedhura ndodhen pranë qendrave të banura e në zona të urbanizuara e rrjedhimisht ndikimet e sipër-përmendura do të prekin komunitetin. Sidoqoftë,

këto mbeten ndikime të përkohëshme vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

5.2.2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit

Ujërat

Operimi i objekteve shkollore nuk pritet që të ketë asnjë efekt ndotës mbi ujërat sipërfaqësorë apo nëntokësore.

Ajri

Funksionimi i shkollave të reja nuk do të ketë aspak ndikim mbi cilësinë e ajrit, me përjashtim të zhurmave të gjeneruara nga loja e fëmijëve në oborr, një ndikim ky që kufizohet brenda oborrit të shkollës.

Trafiku

Gjatë operimit të shkollave mund të gjenerohet trafik pranë hyrjeve të tyre. Megjithatë, ky do të jetë një fenomen i kufizuar para orës 8 të mëngjesit, kur edhe prindërit përcjellin fëmijët për në shkollë.

Mbetjet

Gjatë operimit të shkollës do të gjenderohen mbetje urbane. Menaxhimi i këtyre mbetjeve do të bëhët nga Bashkia e Tiranës në përputhje me planin e menaxhimit.

Mjedisi socio-ekonomik

Ndikimet në mjedisin socio-ekonomik do të jenë të një karakteri pozitiv. Së pari, fëmijët e zonave përreth shkollave do të mund të shkojnë në një shkollë afër banesës së tyre. Së dyti, shkollat e reja do të rivitalizojnë zonat ku do të ndërtohen e do të sjellin edhe zhvillimin ekonomik, duke qenë se përreth tyre do të ketë njësi ekonomike që do të ofrojnë shërbime të ndryshme.

5.3. Masat për zbutjen e ndikimit në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë fazës së operimit

Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshem të mjedisit janë pjesë e planit të organizimit të punës. Investitori do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedisin përreth zonës së ndërtimit.

Open Procurement Albania

Plani i Menaxhimit të Mjedisit do të ketë si synim zbatimin e standarteve mjdesiore si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së operimit. Ky plan mbështetet në norma e parime të njohura e pranuara për mbrojtjen e mbjedisit. Masat që do të përfshijë ky plan do të kenë si qëllim eleminimin e ndikimeve negative në mjedis të sipër-përmendura. Më konkretisht, këto masa do të përfshijnë:

- Rrethimi i sheshit të ndërtimit do të bëhet me llamarina në të gjithe perimetrin e tij, duke lënë një hyrje për në sheshin e ndërtimit;
- Transportimi i materialeve që nevojiten do të programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetesim në trafikun lokal. Do vendosen tabela orientuese për qarkullimin e automjeteve;
- Mbeturinat ndërtimore si dherat, mbeturina llaçi, tulla, gurë, inerte, gëlqere, armaturë dërrase etj. do të depozitohen në një vend të caktuar nga Bashkia e Tiranë dhe jo jashtë rrethimit të ndërtimit;
  Shkarkimet e lengeta si ujrat e bardha dhe ato të zeza do të behën nëper pusetat përkatëse;
- Në rast se do të zbulohen objekte me rëndësi të madhe arkeologjike apo kulturore atëherë do të duhet të bëhet dhe ndryshimi i projektit;
- Spërktatja me ujë për të kufizuar çlirimin e pluhurave në zonat pranë materialeve të ndërtimit;
- Mbulimin e sipërfaqeve me mbulues plastike gjatë magazinimit dhe transportimit të materialeve;
- Mbjelljen e pemëve pranë sheshit të ndërtimit;
- Pastrimi periodik i sheshit të ndërtimit dhe rrugës hyrëse;
- Perdorimin me efikasitet të makinerive moderne të ndërtimit për të minimizuar ndotjen;
- Rrjetat mbrojtëse për minimizimin e pluhurave do të përdoren në përfundim të karabinasë;
- Paisjet zhurmuese do të ndalohen të përdoren nga 22^{00}-6^{00} çdo ditë.

5.4. Ndikimi Social

Edukimi është një mjet i fuqishëm përmes të cilit individëve iu jepet mundësia të marrin pjesë aktivisht në shoqëri. Ndërtimi i objekteve të reja shkollore, jo vetëm që u jep mundësi nxënësve që ta zhvillojnë mësimin në mjedise me kushte të përshtatshme çka ndikon drejtpërsëdrejti në procesin e të nxënit, por sjell edhe zhvillimin e komuniteteve përreth tyre.

5.4.1. Përfitimet sociale të arsimimit

Arsimimi sjell përfitime të rëndësishme shoqërisë duke zgjeruar aftësitë, përmirësuar statusin social dhe, rrjedhimisht, duke krijuar më shumë mundësi punësimi apo rritje të ardhurash.

Ndërtimi i këtyre objekteve të reja shkollore do t'i japë fund njëherë e përgjithmonë problemit të mprehtë social të mbipopullimit të klasave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne. Po njësoj zgjidhet edhe problemi i largësisë së shkollave nga qendrat e banimit çka i detyronte fëmijët të kryenin udhëtime të gjata për në shkollë. Impakti social do të jetë i rëndësishëm edhe për prindërit apo familjarët e tjerë, të cilët për shkak të largësisë së shkollës apo edhe zhvillimit të mësimit pasdite, u është dashur të shoqërojnë fëmijët në orare të pa përputhshme me orarin e punës.

Mungesën e infrastrukturës arsimore e kanë vuajtur më së shumti familjet në nevojë që banojnë në zonat e zhvilluara rishtazi të kryeqytetit. Kjo mund të përbëjë edhe një nga arsyet kreyesore të braktisjes së shkollës në këto komunitete. Ndërtimi i shkollave të reja kryesisht në këto zona do të garantojë aksesin në arsim si një të drejtë themelore e do të japë një ndihmesë të paçmuar në integrimin social të banorëve të këtyre zonave.

Ndërtimi i këtyre shkollave do të ndikojë në gjithë komunitetin përreth. Të konceptuara si qendra komunitare, këto ambiente do të jenë në përdorim nga komuniteti dhe pas orarit zyrtar mësimor duke u kthyer kështu në shtysë për ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella midis pjestarëve të komunitetit. E gjithë zona do të jetë objekt i një procesi rivitalizimi që pjesërisht do të vijë nga aktiviteti i shkollave por dhe nga bizneset private që do të jenë të interesuara të hapin aktivitete të ndryshme si qendra studimi, librari, kancelari etj.

Indikatorët që jep Organizata Për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik ndër të tjera liston se arsimi ndikon dhe tek gjendja shëndetësore e individëve. Sipas saj persona me nivele të larta arsimi gëzojnë shëndet më të mirë .[28]

5.4.2. Shpronësimi dhe kompensimi

Ndërtimi i objekteve shkollore do të jetë një proces që gjatë implementimit mund të hasë edhe në rezistencën e komunitetit. Nga analiza e situatës aktuale rezultoi nevoja për ndërtimin e 17 shkollave. Këto do të ndërtohen në zonat si mëposhtë:

Njësia 2 – 3 Shkolla (2 sheshe)

Njësia 5 – 1 Shkollë (1 Shesh)

Njësia 7 – 1 Shkollë (1 Shesh)

Njësia 8 – 2 Shkolla (1 Shesh)

Njësia 9 – 2 Shkolla (1 Shesh)

Njësia 11 – 3 Shkolla (2 Sheshe)

Njësia Kashar (Yzberisht) – 3 Shkola (2 Sheshe)

[28] Education at a Glance 2014, OECD indicators, OECD Publishing, pg 172

Njësia Dajt – 1 Shkollë (1 Shesh)

Njësia Farkë – 1 Shkollë (1 Shesh)

Një ndër impaktet sociale të ndërtimit të godinave do të jetë pikërisht procesi I shpronësimit të pronave private për interesin publik. Mbi bazën e vendodhjeve të përcaktuata për ndërtimin e shkollave parashikohet shpronësimi i rreth 58, 547 m^2.

Ky proces do të realizohet mbi bazën e Ligjit Nr 8651 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", 22.12.1999.

Në rastin e ndërtimit të infrastruktura shkollore e drejta e shpronësimit dhe e marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private do të ushtrohet për një interes publik që nuk mund të realizohet ose të mbrohet në mënyrë tjetër, veçse për shkaqe dhe në respektim të proçedurave të përcaktuara shprehimisht në ligjin përkatës, në atë masë sa është e domosdoshme për realizimin e qëllimit të shpronësimit dhe në çdo rast kundrejt një shpërblimi të drejtë.[29]

Pikërisht, Neni 8, pika ç) i këtij ligji parashikon se ndër shkaqet e shpronësimit janë pikërisht realizimi i projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut.

Ndërsa në lidhje me kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes të masës së shpërblimit nga shpronësimet do I referohemi VKM nr.138/200 "Për Kriteret Teknike Të Vlerësimit Dhe Të Përllogaritjes Së Masës Së Shpërblimit Të Pasurive Pronë Private Që Shpronësohen, Të Pasurive Që Zhvlerësohen Dhe Të Të Drejtave Të Personave Të Tretë, Për Interes Publik".

Ky proces mund të shoqërohet me rezistencën nga ana e pronarëve të tokave dhe mund të sjellë vonesë në afatet e parashikuara për përfundimin e shkollave.

[29] Ligjit Nr 8651 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes public", 22.12.1999, Neni 2, pika 2.

6. ANALIZA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

Analiza ekonomike dhe financiare e këtij studimi fizibiliteti, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, ka si objektiv kryesor të saj që të përcaktojë vlerën e parasë së projektit si dhe të bëjë një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes si edhe të çdo të ardhure që pritet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së projektit.

6.1.Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

Ligji nr. 125/2013, ndryshuar me ligjin nr. 88/2014, rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private. Në këtë lloj marrëdhënieje, partneri privat merr përsipër që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë /të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtaz. Ndër fushat e zbatimit të këtij ligji është edhe arsimi.[30]

Nga analiza e të dhënave rezulton se për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit të shkollave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne, Bashkia Tiranë duhet të ndërtojë 17 shkolla të reja, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Kosto totale e ndërtimit dhe mobilimit të këtyre shkollave llogaritet në rreth 6.2 miliard lekë. Një shifër e tillë është financiarisht e papërballueshme për Bashkinë e Tiranës, buxheti total vjetor i së cilës është 10 miliard lekë, ndërsa investimet për ndërtimin e shkollave të reja gjatë viteve të fundit kanë qenë jo më shumë se 500 milion lekë.

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin "Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje" (PFNM), ose ndërkombëtarisht i njohur me termin "Design, Build, Finance & Operate (DBFO)", kontraktorët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për të gjithë

[30] Neni 4, pika dh), Ligji 125/2013

kohëzgjatjen e kontratës. Kontraktori, i cili mund të jetë një kompani e vetme apo një konsorcium është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e objektit për një periudhë të caktuar kohore, e cila propozohet të jetë 7 vjet. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre. Githashtu, integrimi i të gjitha kontratave të projektit në një të vetme redukton kostot e ndryshme transaksionale dhe rrit efiçencën e menaxhimit të projektit.

Më së shumti ky model PPP-je është përdorur për ndërtimin e projekteve infrastrukturore madhore të tilla si ndërtimi i autostradave, hidrocentraleve, impianteve të menaxhimit të mbetjeve, etj,. Kjo për shkak se përmasat e mëdha të projekteve të tilla kërkojnë fonde të konsiderueshme, organizim sa më efektiv të burimeve kapitale dhe njerëzore, cilësi të lartë projektimi dhe ndërtimi, siguri maksimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për këtë arsye modele të tilla si PFNM apo të ngjashme, janë parë si nga më të suksesshmet për të zhvilluar projekte që garantojnë realizueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e investimit të kryer. Megjithatë përdorimi i kësaj forme të PPP nuk është kufizuar vetëm tek projektet e mëdha të infrastrukturës publike të përmendura më sipër. Në shumë vende të OECD-së, por më gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar, kjo metodologji është përdorur gjithashtu për projekte të shërbimeve publike të tilla si ndërtimi i shkollave të reja.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj nga vende të ndryshme të cilat kanë zbatuar me sukses këtë model për projekte të infrastrukturës arsimore:

Kanada[31]**:** Programi "Alberta Schools Alternative Procurement". Në vitin 2007 krahina e Albertës në Kanada shpalli fazën e parë të programit i cili parashikonte ndërtimin e 18 godinave të reja shkollore (kopshte dhe shkolla 9-vjeçare) të cilat kanë përunduar ndërtimin në vitin 2010. Pas përfundimit të ndërtimeve, jetëgjatësia e kontratës e cila do vijojë me pjesën e mirëmbajtjes është përcaktuar rreth 30 vjet. Faza e dytë e programit përfshinte ndërtimin e 10 shkollave të tjera 9-vjeçare sipas të njëjtit model dhe 4 gjimnazeve nëpërmjet modelit të thjeshtë të kontratës Projektim-Ndërtim të cilat kanë përfunduar në vitin 2013.

[31] "Flexible and alternative approaches to providing school infrastructure in Alberta, Canada" – OECD, 2010

Greqi[32]: Programi "Macedonia Schools and Attica Schools". Duke përdorur mekanizmin DBFM operatorët privatë projektuan ndërtimin e 51 shkollave me një vlerë totale prej 269 milion Euro dhe me kontrata 25 vjeçare.

Mbretëri e Bashkuar[33]: Programi "Building Schools for the future". Ky program është një program afat-gjatë investimesh i cili po kontribuon në ndërtimin e një numri të konsiderueshëm shkollash në gjithë tërritorin e MB-së. Shumica e shkollave janë ndërtuar nëpërmjet skemës Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje, por në këtë rast shpesh herë është përfshirë edhe elementi i menaxhimit të shkollës nga subjekti privat për një periudhë të caktuar. Zakonisht kohëzgjatja totale e kontratës arrin deri në 30 vjet. Konsorciumi privat paguhet rregullisht nga fondet publike bazuar në performancën e tij gjatë periudhës së kontratës. Nëse konsorciumi nuk arrin performancën e synuar pagesa reduktohet. Në fund të periudhës së kontratës shkolla i kthehet qeverisë.

Zelandë e Re[34]: Projekti i Ministrisë së Arsimit të Zelandës së Re për ndërtimin e dy shkollave në Hobsonville, Auckland. Ky projekt parashikonte ndërtimin e një shkolle të re të ciklit të ulët dhe një shkolle të ciklit të mesëm të ulët në rajonin periferik të Hobsonville në qytetin Auckland. Sektori privat ishte pjesërisht përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objekteve, sëbashku me sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre si dhe menaxhimin e shërbimeve të përbashkëta. Ndërtimi i këtyre shkollave ka përfunduar me sukses në vitin 2014.

Nën këtë prizëm, projekti i ndërtimit të shkollave të reja të Tiranës e sheh të nevojshme aplikimin e të njëjtës qasje për përmirësimin e shërbimit arsimor në gjithë territorin e Bashkisë. Numri i madh i shkollave që do të ndërtohen, kufizimet financiare, koha e shkurtër e zbatimit të projektit si dhe nevoja për garantimin e cilësisë maksimale të ndërtesave theksojnë nevojën për ngritjen e një partneriteti public privat efektiv dhe të suksesshëm.

Open Procurement Albania

6.2.Supozimet kryesore

Për efekt të analizës ekonomike e financiare të këtij studimi fizibiliteti, janë bërë supozimet si më poshtë:

- Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për ndërtimin e objekteve arsimore dhe vënien në funksion të tyre, ndërsa Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për këtë qëllim.

[32] "The role and impact of public-private partnerships in education", Fq. 82 – Banka Botërore, Mars 2009 .http://www.ungei.org/resources/files/Role_Impact_PPP_Education.pdf
[33] Ibidem (dmth: marrë nga i njëjti dok i Bankës Botërore në referencën e mësipërme dhe në të njëjtën faqe)
[34] "Mayoral Position Paper on Public Private Partnerships" – Ernst and Young, Nëntor 2013.

- Objektet arsimore do të jenë të ndërtuara e funksionale maksimalisht 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Pas ndërtimit vënien në funksion të shkollave, koncesionari do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për një periudhë 7 vjeçare dhe për çdo problematikë për administrimin dhe reziqet e aseteve për këtë periudhe.
- Pas ndërtimit të objekteve, Bashkia Tiranë do t'i paguajë koncesionarit një shumë të caktuar vjetore deri në shlyerjen e plotë të shumës së investuar. Të ardhurat për këto pagesa do të sigurohen nga të ardhurat vjetore nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore dhe nga transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave.

6.3.Analiza e kostove

Bazuar në studimin teknik, është arritur në përfundimin se në total do të ndërtohen 17 shkolla, prej të cilave 10 shkolla 9 vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e reja do të projektohen e ndërtohen sipas modeleve në përputhje me standartet e specifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes udhëzuesit" Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar. Referuar standarteve të sipër-përmendura, janë përcaktuar 4 tipe kryesore shkollash, me të dhëna operacionale si më poshtë:

Tipi 1 i shkollave, është me 20 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,938 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 4 klasash, me nje sipërfaqe prej 874 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 5,812 m2. **Tipi 2** i shkollave, është përsëri 9 vjeçar, me 30 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 6,588 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 6 klasash, me nje sipërfaqe prej 1,310 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 7,898 m2. **Tipi 3** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat rurale me 20 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,041 m2. **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4001 m2.

Nga analiza sasiore e kryer dhe e shpjeguar më sipër nevojiten gjithsej 17 shkolla, nga të cilat 2 shkolla nga Tipi 1, 7 shkolla nga Tipi 2, 1 shkollë e Tipit 3 dhe 7 shkolla të mesme nga Tipi 4. Përkatësisht këto shkolla do të ndërtohen në njësitë administrative dhe me të dhënat si më poshtë:

Tabela 54 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	nxënës për klasë	Nxënës për shkolle	Sipërfaqe totale shkolla	Klasa kopështi	Nxënës për klasë kopështi	nxënës për kopësht	Sipërfaqe totale kopësht	Siperfaqe totale ndertimi
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
2	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
3	NJA 02	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
4	NJA 05	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
5	NJA 07	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
6	NJA 08	Tipi 1	9-vjeçar	20	30	600	4,938	4	24	96	874	5,812
7	NJA 08	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
8	NJA 09	TIPI 1	9-vjeçar	20	30	600	4,938	4	24	96	874	5,812
9	NJA 09	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
10	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
11	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
12	NJA 11	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
13	NJA Dajt	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
14	NJA Farke	Tipi 3	9-vjeçar	20	24	480	4,041	4	24	96	874	4,915
15	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
16	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
17	NJA Kasha	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
Totali				417		12,390	88,036	54	240	1,296	11,792	99,828

Duke i permbledhur sipas tipologjisë së shkollave, në total kemi këto të dhëna operacionale:

Open Procurement Albania

Tabela 55 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjisë

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Nr nxënës për klasë	Nxënës për shkollë	Nr klasa kopështi për shkollë	Nr nxënës për klasë kopështi	Nxënës për kopësht	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Total Nxënës në shkolla	Total Nxënës në Kopështe	Nr Total i nxënësve
Tipi 1	2	20	30	600	8	24	96	9,876	1,748	11,624	1,200	192	1,392
Tipi 2	7	30	30	900	42	24	144	46,116	9,170	55,286	6,300	1,008	7,308
Tipi 3	1	20	24	480	4	24	96	4,041	874	4,915	480	96	576
Tipi 4	7	21	30	630	-	-	-	28,004	-	28,004	4,410	-	4,410
Grand To	**17**	**91**				**72**	**336**	**88,036**	**11,792**	**99,828**	**12,390**	**1,296**	**13,686**

Për të analizuar sa më mirë vlerën e parasë së projektit, kemi bërë grupimin e shpenzimeve në 4 kategori kryesore, duke u bazuar dhe në standartet e kontabilitetit si dhe në kërkesat e VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", neni 7, paragrafi 3-6:

Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Per efekt te analizave meposhte te gjitha cmimet dhe vlerat do te jene pa TVSh, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

6.3.1. Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Gjatë analizës dhe në përputhje dhe me VKM të sipërcituar, u identifikuan këto kosto të drejtëpërdrejta të investimeve:

1. Kosto e Shpronësimit të Truallit;
2. Kosto e Ndërtimit;
3. Kosto e Studim Projektimit;
4. Kosto e Supervizimit;
5. Kosto e Kolaudimit;
6. Oponenca teknike;
7. Kosto për Mobilje dhe Orendi;
8. Kosto e pajisjeve të laboratorëve.

6.3.1.1.Kosto e shpronësimit të Truallit

Nga përcaktimi i gjurmës se ku do të ndërtohen këto shkolla, ka rezultuar se do të shpronësohen në nga privatët në total 58,547.50 m2, të cilat sipas përllogaritjeve nga të bëra, parashikohet që në total vlera e shpronësimit të shkojë në 814,242,252 lekë. Nga ana tjetër, për tokën shtet, do të ndiqen procedurat përkatëse për të marrë nën administrim pronat përkatëse.

Me daljen e VKM për këtë qëllim dhe plotësimin e dokumentave financiarë dhe ligjorë në përputhje me VKM dhe me aktet normative në fuqi, çdo i shpronësuar do të likujdohet nga Bashkia Tiranë me anë të fondit që do të përcaktohet për këtë qëllim.

Tabela 56 Tabela përmbledhëse e shpronësimeve

Nr rendor i tabeles	Adresa	Tipi	Sheshi	Shpronesimi ne Vlere	Siperfaqje ne m2 te shpronesuar	Cmimi mesatar per m2
4	NJA 05	Tipi 2	5/1	218,519,847	3,263	66,969
5	NJA 07	Tipi 4	7/2	261,101,406	8,482	30,783
6	NJA 08	Tipi 1	8/1	150,790	5	30,158
7	NJA 08	Tipi 4	8/1	150,790	5	30,158
8	NJA 09	Tipi 1	9/1	23,404,716	687	34,068
9	NJA 09	Tipi 4	9/1	23,404,716	687	34,068
11	NJA 11	Tipi 2	11/1	103,053,248	4,484	22,985
12	NJA 11	Tipi 4	11/1	103,053,248	4,484	22,985
13	NJA Dajt	Tipi 4	D2	53,044,000	14,900	3,560
14	NJA Farke	Tipi 3	F3	3,368,064	7,518	448
15	NJA Kashar	Tipi 2	6/6	20,913,060	4,930	4,242
16	NJA Kashar	Tipi 2	6/3	2,039,184	4,552	448
17	NJA Kashar	Tipi 4	6/3	2,039,184	4,552	448
Grand Total				**814,242,252**	**58,548**	**13,907**

6.3.1.2.Kosto e ndërtimit

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 228,785,770 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 276,314,618 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 305,233,020 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 71,238,892 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 376,471,912 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 187,207,732 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 234,736,581 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë dhe këto shkolla nuk kanë ambjente kopështi.

Open Procurement Albania

Tabela 57 Tabela përmbledhëse e kostove të ndërtimit

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopësh ti për shkollë	Sip ndërtim i shkolla	Sip ndërtim i kopështe	Tot Sipërfaq e ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
Tipi 1	2	20	4	9,876	1,748	11,624	46,332	54,381	228,785,770	47,528,848	276,314,618	552,629,237
Tipi 2	7	30	6	46,116	9,170	55,286	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	2,635,303,382
Tipi 3	1	20	4	4,041	874	4,915	46,332	54,381	187,207,732	47,528,848	234,736,581	234,736,581
Tipi 4	7	21	-	28,004	-	28,004	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	1,297,448,828
Grand To	**17**	**91**	**14**	**88,036**	**11,792**	**99,828**	**185,327**	**217,523**	**906,576,355**	**166,296,588**	**1,072,872,943**	**4,720,118,027**

Në total, do të ndërtohen 2 shkolla të tipit 1 me kosto ndërtimi 276,414,618 lekë për shkollë, 7 shkolla të tipit 2 me kosto ndërtimi 376,471,912 lekë për shkollë dhe 1 shkollë e Tipit 3 me kosto ndërtimi 234,736,581 lekë për shkollë dhe 7 shkolla të tipit 4 me kosto ndërtimi 185,349,833 lekë për shkollë. Rrjedhimisht, kostoja total e ndërtimit për këtë projekt shkon në 4,720,118,027 lekë. Kjo është një kosto që do të mbulohet nga koncensionari.

6.3.1.3.Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit

Bazuar dhe në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostot e tjera direkte të investimit janë:

- Studim projektimi;
- Mbikqyrja e punimeve;
- Kolaudimi;
- Oponenca teknike;
- Mbrojtja ndaj zjarrit;
- Leja mjedisore;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Open Procurement Albania

Duke marrë parasysh të dhënat e analizuara në kapitullin respektiv mbi kostot, rezulton se kostot e tjera të drejtpërdrejta të investimit janë si më poshtë vijon:

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Tot Sipërfaq e ndërtimi	Kosto Studim Projektim	Kosto Mbikqyrje	Kosto kolaudimi	Oponenca teknike	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
Tipi 1	2	11,624	8,962,254	6,281,842	221,052	446,366	100,000	60,000
Tipi 2	7	55,286	70,772,689	29,245,329	1,054,124	1,754,725	350,000	210,000
Tipi 3	1	4,915	6,638,188	2,703,942	93,917	208,967	50,000	30,000
Tipi 4	7	28,004	37,421,081	15,275,677	537,985	1,293,922	350,000	210,000
Grand To	**17**	**99,828**	**123,794,213**	**53,506,790**	**1,907,078**	**3,703,980**	**850,000**	**510,000**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0.

6.3.1.4.Kostot e mobilimit

Për të vënë në përdorim shkollat, nevojitet pajisja e secilës prej tyre me, pajisjet e nevojshme IT si edhe laboratoret e nevojshme. Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24,167 lekë. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tabela 59 Kostot e mobilimit të shkollave

Tipi shkollës	Nr. klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

Në koston e mobilimit për arsimin bazik janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth 27,916 lek. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 60 Kostot e mobilimit të ambienteve të kopështeve

Tipi	Vendnd odhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmijë	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana juaj, kontratë blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 61 Kosto për pajisjet e laboratorëve

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator
1	Laborator Shkencat natyrore	186,998
2	Laborator Kimie	223,125
3	Laborator Fizike	1,183,602
4	Laborator Biologjie	632,467
5	Laborator IT	3,869,658
II	Shkolla e Mesme	-
1	Laborator Kimie	528,469
2	Laborator Fizike	1,294,500
3	Laborator Biologjie	651,657
4	Laborator IT	3,869,658

Open Procurement Albania

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Tabela 62 Kosto për pajisjet e laboratorëve sipas tipologjisë së shkollave

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	**Arsimi Bazik (Tipi 1)**	6,095,850
2	**Arsimi Bazik (Tipi 2)**	7,279,450
3	**Arsimi Bazik (Tipi 3)**	5,743,950
4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e 17 shkollave është 502,378,267 lekë pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 63 Kosto përmbledhëse për mobilim të shkollave, ambjenteve të kopështëve dhe laboratoreve

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Kosto e mobilimit te shkollave	Kosto e mobilimit të kopështeve	Total Kosto Mobilimi	Kosto Laboratori	Total kosto pajisje, mobilje dhe orendi
Tipi 1	2	29,000,000	5,360,000	34,360,000	12,191,700	46,551,700
Tipi 2	7	152,250,000	28,140,000	180,390,000	50,956,150	231,346,150
Tipi 3	1	11,600,000	2,680,000	14,280,000	5,743,950	20,023,950
Tipi 4	7	106,575,000	-	106,575,000	97,881,467	204,456,467
Grand To	**17**	**299,425,000**	**36,180,000**	**335,605,000**	**166,773,267**	**502,378,267**

6.3.1.5.Kosto direkte e investimit

Në përfundim, kosto direkte e investimit të këtij projekti është **6,221,010,605 lekë**. Nga këto, **814,242,252** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga koçesionari është **5,406,768,353** lekë, ku kosto e ndërtimit është **4,720,118,027** lekë pa TVSH, Kosto e

Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **686,650,327** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Tabela 64 Kostot direkte të investimit sipas zërave

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**6,221,010,605**
A.1	**Kostot e Truallit**	**814,242,252**
A.2	Kostot e Projektimit	123,794,213
A.3	- Ndertim + instalime	4,720,118,027
A.4	- Oponenca teknike	3,703,980
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	510,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	850,000
A.8	- Kosto Supervizimi	53,506,790
A.9	- Kosto Kolaudimi	1,907,078
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	335,605,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	166,773,267

6.3.2. Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Bazuar dhe nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose 351,755 lekë pa TVSH. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 8,442,132 lekë për një shkollë të tipit 1, 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2, 8,442,132 lekë për një shkollë të tipit 3 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat është 165,676,838 lekë në vit. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Për më shumë detaje, shih tabelat më poshtë.

Tabela 65 Kostoja vjetore e mirëmbajtjes për tip shkolle

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtjes për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
Tipi 1	2	8,442,132	16,884,264
Tipi 2	7	12,663,198	88,642,385
Tipi 3	1	8,442,132	8,442,132
Tipi 4	7	7,386,865	51,708,058
Grand Total	**17**	**9,745,696**	**165,676,838**

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë 1,159,737,664 lekë pa tvsh. Nga të cilat, 763,592,363 lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve, dhe 396,145,301 lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një viti pa TVSH.

Open Procurement Albania

B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**1,159,737,664**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**763,592,363**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	176,556,240
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve	446,105,322
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi	55,846,898
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)	85,083,903
B.2	**Staf Mirembajtje**	**396,145,301**
B.2.1	Staf Roje	58,272,458
B.2.2	Staf Sanitare	251,473,857
B.2.3	Staf Sekretare	50,368,763

Open Procurement Albania

Tabela 67 Kostoja e detajuar e mirembajtjes per çdo shkolle

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	Lyerje per klase	Riparim suvatim + hidroizolim per klase	Riparime dhe mirembajtje e Nderteses	Riparime Orendi shkollore	Riparime Pajisje PC	Materiale Pastrimi	Lëndë djegëse për ngrohje dhe ujë të	Mirembajtje kondicionim, impiante uji dhe	Sherbim roje	Sherbim pastrimi	Sherbim sekretarie	Total kosto mirembajtjej e
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
2	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
3	NJA 02	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
4	NJA 05	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
5	NJA 07	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
6	NJA 08	Tipi 1	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
7	NJA 08	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
8	NJA 09	TIPI 1	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
9	NJA 09	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
10	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
11	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
12	NJA 11	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
13	NJA Dajt	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
14	NJA Farke	Tipi 3	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
15	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
16	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
17	NJA Kasha	Tipi 4	i mesëm i	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
																-
Totali i Mirembajtjes				**471**	**10,781,702**	**11,058,165**	**3,382,449**	**7,978,136**	**12,154,834**	**3,988,312**	**39,381,682**	**20,359,354**	**13,471,815**	**35,924,846**	**7,195,542**	**165,676,837**

6.4.Analiza e të ardhurave të PPP

6.4.1. Tarifa e përdorimit të shkollave

Tarifa e përdorimit të shkollave (në vazhdim "Tarifa"), duhet të përllogaritet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulimin e kostove të koncensionarit si dhe të garantojë një marzh minimal fitimi për koncensionarin, në mënyrë që nga njëra anë kjo PPP të jetë atraktive dhe njëkohësisht të jetë dhe zgjidhja më e mire ekonomike krahasuar me skenarë të tjerë të mundshëm. Tarifa paguhet për gjithë periudhën e mirëmbajtjes dhe administrimit të shkollave nga ana e koncensionarit, pra për 7 vite. Kjo tarifë në vetvete paguhet çdo vit nga Bashkia Tiranë përmes burimeve të financimit të detajuara si më poshtë. Përmes kësaj skeme, jo vetëm që sigurohet ndërtimi i 17 shkollave në kohë rekord, duke zgjidhur minimalisht çështjen e arsmimit me turne, dhe mbipopullimit të klasave, por duke qënë se të gjitha risqet për mirembajtjen dhe përdorimin me kujdes të asetit do të jenë në ngarkim të koncensionarit, dhe të lidhura dhe me pagesat, kjo do të bëjë që të kemi ndërtime cilësore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk përllogaritet marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se koncesionari vlerat e investuara për këtë qëllim, do të mbulohet në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë, si dhe për pjesën e mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme për këtë periudhë.

Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse[35], përkatësisht rezultet e obligacioneve 7 vjecare nga viti 2015 deri në 15.09.2016.

[35] http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise/rezultatet-e-ankandeve/2016

Tabela 68 Rezultatet e ankandeve për obligacionet 7 vjeçare fikse

ISIN	Dt.Ankandi	Ankandi	Muaji	Datë Emetimi	Datë Maturimi	Shuma e shpallur (fillestare)	Shuma e shpallur (nd. strukture)	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Prorata Konkurues	Prorata Jo Konkuruese	Yieldi Uniform i Pranuar
AL0017NF7Y23	13.09.2016	*7vjeçar/7years(fix)*	*Shtator*	15.09.2016	15.09.2023	*3,000,000*		*2,309,000*	*2,309,000*			*4.89%*
AL0016NF7Y23	01.06.2016	*7vjeçar/7years(fix)Rihapje*	*Qershor*	03.06.2016	16.03.2023	*2,000,000*		*3,141,400*	*2,000,000*	*4.40%*		*4.00%*
AL0016NF7Y23	11.03.2016	*7vjeçar/7years(fix)*	*Mars*	16.03.2016	16.03.2023	*3,000,000*		*8,247,000*	*2,999,900*	*76.48%*		*4.90%*
AL0015NF7Y22	14.12.2015	*7vjeçar-fiks*	*Dhjetor*	16.12.2015	16.12.2022	*2,500,000*		*5,288,600*	*2,500,000*	*67.70%*	*100.00%*	*6.79%*
AL0014NF7Y22	14.09.2015	*7vjeçar-fiks*	*Shtator*	16.09.2015	16.09.2022	*1,000,000*		*1,430,600*	*1,000,000*	*100.00%*	*100.00%*	*7.78%*
AL0013NF7Y22	12.06.2015	*7vjeçar-fiks*	*Qershor*	16.06.2015	16.06.2022	*3,000,000*		*2,953,500*	*2,953,500*	*100.00%*	*100.00%*	*7.80%*
AL0012NF7Y22	12.03.2015	*7vjeçar-fiks*	*Mars*	16.03.2015	16.03.2022	*2,500,000*		*2,815,800*	*2,500,000*	*80.98%*	*77.92%*	*7.81%*
										Yieldi Mesatar i pranuar		**6.28%**

Marzhi i fitimit do të jetë objekt tenderimi i konkurentëve në këtë PPP, por ndërkohë është i domosdoshëm për të kuptuar sa do të jetë vlera e përgjithshme e kësaj PPP. Marzhi i fitimit, do të llogaritet, për vlerën e mbetur të investimit direkt çdo vit, dhe mbi kostot vjetore të mirëmbatjes. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, sigurohet që skema e financimit të jetë atraktive për konkurentët e mundshëm, dhe, nga ana tjetër, kosto totale e projektit të mos dalë më e lartë sesa mënyrat tradicionale të financimit.

Bazuar në përllogaritjet e kryera, tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit me marzhin prej 6.28% do të ishte si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tabela 69 Tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	5,406,768,353										
2	1	5,406,768,353	6.28%	772,395,479	4,634,372,874	339,545,053	1,111,940,532	165,676,837	10,404,505	176,081,342	349,949,558	**1,288,021,874**
3	2	4,634,372,874	6.28%	772,395,479	3,861,977,395	291,038,616	1,063,434,096	165,676,837	10,404,505	176,081,342	301,443,122	**1,239,515,438**
4	3	3,861,977,395	6.28%	772,395,479	3,089,581,916	242,532,180	1,014,927,659	165,676,837	10,404,505	176,081,342	252,936,686	**1,191,009,002**
5	4	3,089,581,916	6.28%	772,395,479	2,317,186,437	194,025,744	966,421,223	165,676,837	10,404,505	176,081,342	204,430,250	**1,142,502,566**
6	5	2,317,186,437	6.28%	772,395,479	1,544,790,958	145,519,308	917,914,787	165,676,837	10,404,505	176,081,342	155,923,814	**1,093,996,130**
7	6	1,544,790,958	6.28%	772,395,479	772,395,479	97,012,872	869,408,351	165,676,837	10,404,505	176,081,342	107,417,378	**1,045,489,694**
8	7	772,395,479	6.28%	772,395,479	0	48,506,436	820,901,915	165,676,837	10,404,505	176,081,342	58,910,941	**996,983,257**
Grand total				**5,406,768,353**		**1,358,180,210**	**6,764,948,563**	**1,159,737,859**	**72,831,538**	**1,232,569,397**	**1,431,011,748**	**7,997,517,960**

Tabela 70 Shuma e kestit vjetor

Nr rendor	Viti	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	
2	1	**1,288,021,874**
3	2	**1,239,515,438**
4	3	**1,191,009,002**
5	4	**1,142,502,566**
6	5	**1,093,996,130**
7	6	**1,045,489,694**
8	7	**996,983,257**
Grand total		**7,997,517,960**

Për të garantuar suksesin ekonomik të skemës, është menduar që koncensionari të paguhet përmes tarifës vjetore zbritëse. Kjo mënyrë pagimi do të bëntë që koncesnionari të mos vendosej në vështirësi financiare të mëdha gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës së koncensionit. Kësisoj, vitin e parë tarifa do të jetë 1,288,021,874 lekë dhë pas çdo viti do të ulet gradualisht, deri në 996,983,257 lekë në vitin e fundit.

Open Procurement Albania

6.4.2. Burimi i Financimit

Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 8,811,760,212 lekë nga të cilat, 814,242,252 janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe 7,997,517,960 lekë është vlera e koncensionit, sipas detajimit të mëposhtëm.

Tabela 71 Vlera e përgjithshme e projektit

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**814,242,252**	**1**	**814,242,252**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**5,406,768,353**	**1**	**5,406,768,353**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	5,406,768,353	1	5,406,768,353
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**165,676,837**	**7**	**1,159,737,859**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	165,676,837	7	1,159,737,859
4	**Marzhi i Fitimit**	**1,431,011,748**	**1**	**1,431,011,748**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	1,431,011,748	1	1,431,011,748
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4+5)			**8,811,760,212**

Tabela 72 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	814,242,252	7,997,517,960	8,811,760,212
Totali	**814,242,252**	**7,997,517,960**	**8,811,760,212**

Open Procurement Albania

Këto shpenzime do të mbulohen përmes të ardhurave të Bashkisë, dhe Granteve të Kushtëzuara që Ministria financave do të japë për këtë projekt.

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për këtë projekt, do të gjenerohen nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila është vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për qytetin e Tiranës".

Tabela 73 Parashikimi i të ardhurave nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore

E m ë r t i m i	PLANI VITI 2016	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018
Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	**870 000 000**	**940 000 000**	**1 000 000 000**
Familjarët	320 000 000	340 000 000	350 000 000
Subjektet Tregtare	550 000 000	600 000 000	650 000 000

Të ardhurat nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore janë planifikuar të jenë 870 milionë lekë në vitin 2016, ndërkohë që këto të ardhura parashikohet të rriten në 940 milionë lekë në vitin 2017 dhe 1 miliard lekë në vitin 2018. Kjo taksë e përkohëshme është vendosur për një periudhë 7 vjeçare dhe për vitet 2019-2022, të ardhurat vjetore parashikohet të jenë rreth 1 miliard lek. Të ardhurat nga transferta specifike nga Ministria e Financave do të jenë në masën 700 milionë lek në vit. Në këtë mënyrë, fondi në dispozicion të Bashkisë Tiranë për kryerjen e pagesave periodike parashikohet të jetë rreth 1 miliard e 700 milion lekë në vit.

Open Procurement Albania

6.5.Analiza Financiare

Tabela 74 Tabele permbledhese e kostove dhe te ardhurave te projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**6,221,010,605**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**6,221,010,605**
A.1	**Kostot e Truallit**	**814,242,252**								**814,242,252**
A.2	Kostot e Projektimit	123,794,213								123,794,213
A.3	- Ndertim + instalime	4,720,118,027	-							4,720,118,027
A.4	- Oponenca teknike	3,703,980								3,703,980
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	510,000								510,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	850,000								850,000
A.8	- Kosto Supervizimi	53,506,790								53,506,790
A.9	- Kosto Kolaudimi	1,907,078								1,907,078
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	335,605,000	-	-	-	-	-	-	-	335,605,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	166,773,267								166,773,267
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**1,159,737,859**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**763,592,438**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	176,556,212
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	446,105,436
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	55,846,952
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	85,083,838
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**396,145,421**
B.2.1	Staf Roje		13,471,815	11,226,513	9,355,427	7,796,189	6,496,824	5,414,020	4,511,684	58,272,472
B.2.2	Staf Sanitare		35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	251,473,922
B.2.3	Staf Sekretare		7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	50,368,794
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**6,221,010,605**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**7,380,748,464**

C.	**Të Adhurat**	**814,242,252**	**1,288,021,874**	**1,239,515,438**	**1,191,009,002**	**1,142,502,566**	**1,093,996,130**	**1,045,489,694**	**996,983,257**	**8,811,760,212**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	814,242,252								**814,242,252**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		1,288,021,874	1,239,515,438	1,191,009,002	1,142,502,566	1,093,996,130	1,045,489,694	996,983,257	**7,997,517,960**
D	**Fitimi (humbja)**	(5,406,768,353)	1,122,345,037	1,073,838,601	1,025,332,165	976,825,729	928,319,293	879,812,857	831,306,420	**1,431,011,748**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(5,406,768,353)	(4,284,423,316)	(3,210,584,715)	(2,185,252,551)	(1,208,426,822)	(280,107,529)	599,705,327	1,431,011,748	**1,431,011,748**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(89,955,799)	(124,695,963)	**(214,651,762)**

Open Procurement Albania

Tabela 75 Fluksi i arkës së projektit

Fluksi i Arkës									
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Flukse dalese nga Investimet	- 6,221,010,605	-	-	-	-	-	-	-	- 6,221,010,605
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	-	- 165,676,837	- 165,676,837	- 165,676,837	- 165,676,837	- 165,676,837	- 165,676,837	- 165,676,837	- 1,159,737,859
Flukse dalese nga Taksat	-	-	-	-	-	-	- 89,955,799	- 124,695,963	- 214,651,762
Totali i flukseve dalese	**-6,221,010,605**	**- 165,676,837**	**- 165,676,837**	**- 165,676,837**	**- 165,676,837**	**- 165,676,837**	**- 255,632,636**	**- 290,372,800**	**- 7,595,400,226**
Flukse hyrese nga Operimet	**814,242,252**	**1,288,021,874**	**1,239,515,438**	**1,191,009,002**	**1,142,502,566**	**1,093,996,130**	**1,045,489,694**	**996,983,257**	**8,811,760,212**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-5,406,768,353**	**1,122,345,037**	**1,073,838,601**	**1,025,332,165**	**976,825,729**	**928,319,293**	**789,857,057**	**706,610,457**	**1,216,359,986**
Gjendja e arkes progresive	**-5,406,768,353**	**- 4,284,423,316**	**- 3,210,584,715**	**- 2,185,252,551**	**- 1,208,426,822**	**- 280,107,529**	**509,749,528**	**1,216,359,986**	**1,216,359,986**

6.6.Realizueshmëria ekonomike e projektit

6.6.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto)

Open Procurement Albania

NPV, si metoda standarte për vlerësimin e projekteve afatgjata përmes analizës së vlerës në kohë të parasë, paraqet shumën e fluksit të arkës së projektit (Cash Floë) të skontuar. Çdo investues, kur vendos ndërmarrjen e një investimi analizon të ardhurat e gjeneruara nga projekti krahasuar më të ardhurat e mundshme nëse paratë e investuara do të përdoreshin në një tjetër mënyrë. Përgjithësisht, këto analiza kryhen duke marrë për bazë normën e interesit në rast të investimit të parave, për shembull, në bono thesari apo obligacione qeveritare, të cilat kanë risk thuajse zero.

Formula klasike për llogaritjen e NPV-së, nëse investimi bëhet brenda një viti, është:

$$NPV = \sum_{t=1}^{T} \frac{C_t}{(1+r)^t} - C_0$$

ku:

C_0 - përfaqëson paranë e shpenëzuar për kryerjen e investimit fillestar;

C_t – përfaqëson të ardhurat nga investimi i kryer;

t – përfaqëson kohëzgjatjen e projektit;

r – përfaqëson normën e pritshme të skontimit.

Për të parë realizueshmërinë ekonomike të projektit, është testuar modeli financiar me disa norma të mundëshme skontimi. Nga kjo analizë, ka rezultuar se konçensionarët e mundshëm do të kenë interes në këtë projekt vetëm në rast se kosto e tyre oportune është më e ulët se 5.79%. Me fjalë të tjera, për çdo normë skontimi mbi 5.79% ky projekt nuk paraqet leverdisshmëri ekonomike nga ana e koncensionarit.

	NPV						
norma e skontimit e parashikuar	**5%**	**5.79%**		**6%**		**7%**
NPV	**137,555,411**	**170,329**	**-**	**35,061,391**	**-**	**195,783,160**

6.6.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit)

IRR-ja është një metodë që përdoret për të matur fitimin e investimeve të mundshme. IRR-ja është një normë skontimi që e bën vlerën aktuale neto (NPV) të të gjithë fluksit të arkës (cash floë) të një projekti të barabartë me zero. Sipas teorisë ekonomike, çdo projekt me një IRR më të madhe se kosto e tij kapitale është fitimprurës, e rrjedhimisht investitorët kanë interes të investojnë në të. Në bazë të analizës financiare, IRR-ja e këtij projekti është në masën 5.79%.

Open Procurement Albania

Tabela 76 Norma e brendshme e kthimit e projektit

				IRR					
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-5,406,768,353**	**1,122,345,037**	**1,073,838,601**	**1,025,332,165**	**976,825,729**	**928,319,293**	**789,857,057**	**706,610,457**	**1,216,359,986**

IRR **5.79%**

6.6.3. Periudha e vetëshlyerjes

Periudha e vetëshlyerjes paraqet kohën që nevojitet në mënyrë që një kapitali i investuar të kompensohet nga të ardhurat nga projekti. Përgjithësisht, periudha e vetëshlyerjes llogaritet duke pjesëtuar koston e investimit me të ardhurat vjetore. Por, duke qenë se në këtë projekt të ardhurat vjetore përbëhën nga këste zbritëse, periudha e vetëshlyerjes është vlerësuar duke analizuar fluksin e arkës për të përcaktuar vitin e fundit në të cilën ky fluks është negativ.

Periudha e Vetëshlyerjes		
Viti i fundit i gjendjes se arkes negative		5
Gjendja e arkes kumulative ne vitin e fundit negativ	-	280,107,529
Gjendja e arkes pozitive krijuar ne vitin vijues		789,857,057
PBP (periudha e veteshlyerjes)		5.35

Nga sa u përshkrua më sipër, periudha e vetëshlyerjes për këtë projekt arrihet në 5.35 vite. Megjithatë, duke parë që pagesat nga ana e Bashkisë Tiranë do të jenë vjetore, atëherë periudha e vetëshlyerjes nuk do të jetë 5.35 vite, por do të jetë 6 vite.

6.6.4. Përshtatshmria financiare

Sipas VKM nr, 575, datë 10.07.2013, neni 7, pika 10, përshtatmëria financiare e një projekti "tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar."

Në bazë të analizës financiare të mësipërme, ky projekt është ekonomikisht i realizueshëm dhe kjo realizueshmëri, në mënyrë të thuket, jepet nga vlerat e mëposhtme:

- NPV = 5.79% > 0
- IRR = 5.79% > se interesi i depozitave apo bonove të thesarit
- PBP = 6 vite < 7 vite (kohëzgjatja e konçensionit)

Open Procurement Albania

6.7.Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve

Analiza e risqeve ka si synim parësor të saj identifkimin dhe vlerësimin e gamës së risqeve që mund të ndikojnë projektin. Në këtë mënyrë, zhvillohet një strategji për menaxhimin e riskut në mënyrë që të garantohet realizimi i projektit me sukses. Në përputhje me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", më poshtë vijon një analizë e risqeve që prekin këtë projekt.

6.7.1. Analiza cilësore e risqeve

Risku i trojeve

Përshkrimi i riskut: Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e 17 shkollave do të jenë kryesisht me pronësi shtet, ndërsa trojet në pronësi private do të shpronësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pastaj do të vihen në dispozicion të konçensionarit. Rrjedhimisht, ky risk ka probablitet të ulët, thuajse zero, për të ndikuar mbi projektin. Përsa u përket lejeve të nevojshme, ky risk nuk ekziston pasi Bashkia Tiranë është vetë organi përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve. Së fundi, përsa u përket standarteve mjedisore, trojet e përzgjedhura janë parcela në ndodhura në zona ku nuk ndikohet asnjë standart mjedisor, ndaj edhe ky risk vlerësohet zero.

Menaxhimi i riskut: Ky risk vlerësohet me probabilitet zero dhe cilësohet si risk i mbajtur nga Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë do të kryejë të gjitha procedurat për shpronësimin e trojeve private jashtë kësaj skeme PPP-je dhe përpara kohës së përcaktuar për nisjen e punimeve. Në rast se ndonjë prej trojeve të përzgjedhura do të ketë konflikt pronësie çka do ta bënte shpronësimin të pamundur, pranë ZRPP është kërkuar informacion edhe për sheshe alternative, të cilat mund të përdoren. Përsa u përket kushteve gjeologjike dhe standarteve mjedisore, është kryer një studim mjedisor që është pjesë e këtij studimi fizibiliteti, i cili ka arritur në përfundimin se me ndërtimin e këtyre objekteve nuk preket asnjë standart mjedisor. Për më tepër, gjatë marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet edhe një studim mjedisor më i detajuar nga ana e konçensionarit.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë

Përshkrimi i riskut: Kostimi i ndërtimit dhe mobilimit të shkollave të reja është bazuar në një metodologji të shpjeguar gjërësisht më sipër, e cila merr për bazë koston e shkollave të ndërtuara nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit. Kësisoj, mundësia që kosto e ndërtimit të jetë më e lartë sesa kostoja e përllogaritur është thuajse zero. Ndërtimi dhe vënia në punë e shkollave varen në një shkallë të caktuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe plotësimi i parakushteve për marrjen e kësaj lejeje, si leja mjedisore, lidhja me rrjetin elektrik apo ujësjellësin, miratimi i projekteve për mbrojtjen nga zjarri, etj. Konçensionari ka detyrën të bëjë projektimin, të përgatisë dokumentacionin për pajisje me leje ndërtimi si edhe të ndërtojë objektet shkollore. Nga ky prizëm, risku i vonesave në paisje me leje ndërtimi, i vonesave në nisjen e punimeve e, rrjedhimishit, i vënies në punë është i mundshëm.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Konçensionari ka detyrimin të përgatisë dokumentat dhe të pajiset me leje ndërtimi. Në rast se konçensionari nuk do të përgatisë

projektin në kohë, do të neglizhojë aplikimin për leje ndërtimi duke mos aplikuar në kohë apo duke pasur mangësi në dokumentacion apo nuk do t'i kryejë punimet në kohë, atëherë ai do të mbajë përgjegjësi për mos nisjen e punimeve në afat dhe do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve që do të bëhën në kontratën konçensionare. Gjithashtu, meqenëse konçensionari është përgjegjës si për hartimin ashtu edhe për zbatimin e projektit, çdo vonesë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa vjen si rezultat i forcës madhore, do të jetë përgjegjësi e tij për të cilën do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve në kontratën konçensionare.

Risku i funksionimit

Përshkrimi i riskut: Mundësia që shkollat e reja të mos funksionojnë pasi të jenë ndërtuar lidhet me kryerjen e punimeve jo cilësore nga ana e koncensionarit, çka do ta bënte zhvillimin e mësimit në godinat e reja të pamundur. Ky risk ka probabilitet të ulët pasi kryerja e punimeve do të mbikqyret nga mbikqyrësi teknik dhe situacionet financiare do të mbikqyren nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket riskut që kostoja e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa pritej, probabiliteti është thuajse zero, pasi kostoja vjetore e mirëmbajtjes është llogaritur duke u bazuar në shpenzimet vjetore të Bashkisë Tiranë për mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, të cilat janë ndërtuar para shumë viteve. Sipas standarteve inxhinierike, kostoja e mirëmbajtjes së objekteve të sapondëruara është me e ulët se ajo e objekteve të ndërtuara kohë më parë.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtij risku është i ulët dhe ai cilësohet si një risk i transferuar tek koncensionari. Në rast se cilësia e ndërtimit do të jetë e tillë që do ta bëjë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të mbajë përgjegjësi dhe do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë derisa cilësia e punimeve të jetë në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Në rast se, për shkak të punimeve të kryera gjatë ndërtimit, gjatë periudhës 7 vjeçare të zgjatjes së kontratës, godinat shkollore do të shfaqin probleme që do ta bëjnë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë për ta bërë shkollën sërish funksionale. Në rast se kostoja e mirëmbajtjes do të rezultojë më e lartë se parashikimi, kjo do të vijë si pasojë e pasaktësive në projektim ose ndërtim. Rrjedhimisht, risku bie mbi konçensionarin, i cili ka përgjegjësinë të projektojë dhe ndërtojë shkollat.

Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare

Përshkrimi i riskut: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej apo të ardhurat e gjeneruara janë më të ulëta se sa parashikimi. Duke qenë se objektet që do të ndërtohen janë godina shkollore të cilat nuk mund të kenë përdorim të ndryshëm e nuk mund të gjenerojnë të ardhura, ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin në fjalë.

Menaxhimi i riskut: Mundësia që projekti të ndikohet nga ky risk është zero pasi ai nuk aplikohet mbi të.

Risqet ekonomike dhe financiare

Përshkrimi i riskut: Meqenëse ky projekt përfshin transaksione financiare të shtrira në kohë, ekziston mundësia që ai të ndikohet nga risqet ekonomike e financiare. Rritja e paparashikuar e

normave të interesit mund të rrisë kostot e financimit të projektit nga ana e koncensionarit. Nga ana tjetër, ndryshimet në kursin e këmbimit valutor mund të kënë ndikim përkeqësues në financat e koncencionarit në rast se të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë në monedha të ndryshme, për shembull koncensionari ka marrë kredi në Euro apo Dollarë për financimin e projektit, ndërkohë që Bashkia e Tiranë ia kryen pagesat vjetore në Lekë. Së fundi, duke qenë se ky projekt përfshin pagesa periodike për një periudhë 7 vjeçare, ekziston mundësia që të ardhurat e koncensionarit të preken nga inflacioni.

Menaxhimi i riskut: Duke qenë se Shqipëria konsiderohet një vend me një situatë makroekonomike të qendrueshme, probabiliteti që projekti të ndikohet nga ky risk mbetet i ulët. Risku i normave të interesit apo i normave të këmbimit valutor është një risk që bie mbi konçensionarin dhe duhet të llogariten në parashikimet e tij financiare. Risku i inflacionit është një risk që ndahet mes Bashkisë Tiranë dhe konçensionarit. Meqenë se politika e Bankës së Shqipërisë është mbajtja e inflacionit nën 3% dhe kohëzgjatja e projektit është vetëm 7 vjet, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, në përcaktimin e marzhit të fitimit si të lidhur me normën e interesit për obligacionet 7 vjeçare, Bashkia e Tiranës garanton për konçensionarin të njëjtën mbrojtje ndaj risqeve ekonomike e financiare që garanton edhe Qeveria e Shqipërisë për blerësit e obligacioneve.

Risqet e pronësisë së aseteve

Përshkrimi i riskut: Ky riskt lidhet me mundësinë që teknologjia të vjetërohet apo që vlera e aseteve të jetë e ndryshme në fund të kontratës. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtim godinash shkollore, të cilat do të mirëmbahen nga konçensionari për një periudhë 7 vjeçare, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të mirëmbajtjes jo cilësore, në fund të kontratës cilësia dhe vlera e aseteve të jetë më e ulët nga parashikimi.

Menaxhimi i riskut: Ky risk transferohet te konçensionari. Mirëmbajtja e godinave shkollore dhe mobiljeve e pajisjeve të tyre do të bëhet në përputhje me standartet në fuqi dhe do të mbikqyret nga autoriteti kontraktor. Në rast se konçensionari nuk do t'i mirëmbajë shkollat sipas përcaktimit të mësipërm, në kontratën e konçensionit do të parashikohen dispozita që e detyrojnë atë të shlyejë dëmin e shkaktuar. Në rast se në fund të kontratës, vlera e aseteve do të jetë e ndryshme nga sa është dakordësuar, në kontratën e koncensionit do të përcaktohen dispozita që do të detyrojnë koncensionarin të shlyjë dëmin.

Risku politik

Përshkrimi i riskut: Risku që vendimet politike të ndikojnë mbi projektin është evident. Duke qenë një projekt i nisur nga Bashkia e Tiranës, një organ i qeverisjes lokale, suksesi i këtij projekti varet nga dakordësia me qeverisjen qendrore. Gjithashtu, ekziston mundësia që si rezultat i zgjedhjeve lokale të ardhshme, një ndryshim i mundshëm në kreun e Bashkisë Tiranë mund të sjellë ndryshimin e prioriteteve, e për rrjedhojë bllokimin e projektit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi autoritetin kontraktor, Bashkinë Tiranë. Për të siguruar dakordësinë e institucioneve të qeverisjes qendrore, me miratimin e studimit të fizibilitetit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Financave dhe Ministria

e Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket riskut të ndikimit negativ të projektit si rezultat i ndryshimeve në drejtimin e Bashkisë Tiranë, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që pengojnë prishjen e kontratës për arsye jo të ligjshme nga ana e autoritetit kontraktor.

Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor

Përshkrimi i riskut: Ndryshimet e mundshme në kuadrin legjislativ mund ta ndikojnë projektin si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Duke qenë se projekti lidhet me ndërtimin e godinave shkollore, mundësia që ai të afektohet nga ndryshimet ligjore lidhet vetëm me standartet dhe manualet e ndërtimit. Ndaj, ky risk ka një probabilitet të ulët që të ndodhë. Përsa u përket ndryshimeve të ligjeve fiskale, ndikimi negativ apo pozitiv ndjehet vetëm në financat e konçensionarit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Në mënyrë që efektet e tij të jenë sa më minimale, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që e mbrojnë atë nga ndryshimet diskriminuese në ligj – gjithmonë, nëse diskriminimi provohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, konçensionari do të jetë i detyruar të zbatojë çdo ndryshim ligjor që vjen si rezultat i politikave të qeverisë.

Risku i forcës madhore

Përshkrimi i riskut: Risqet e forcës madhore si fatkeqësitë natyrore, trazirat civile apo luftërat bien si mbi konçensionarin ashtu edhe mbi autoritetin kontraktor. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria është antare e NATO dhe me perspektivën e qartë të integrimit në BE, probabiliteti i risqeve si luftërat apo trazirat është thuajse zero. Nga ana tjetër, probabiliteti që projekti të ndikohet nga tërmetet apo fatkeqësitë e tjera natyrore ka gjithashtu pak gjasa që të ndodhë, siç ka rezultuar edhe nga analiza e mësipërme e ndikimit mjedisor të projektit.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtyre risqeve është shumë i ulët dhe bie mbi të dyja palët. Në kontratën konçensionare do të parashikohen klauzolat e forcës madhore të cilat do garantojnë që të çdo ndikim negativ mbi projektin të ndahet ndërmjet palëve.

6.7.2. Analiza sasiore e risqeve

Kjo analizë synon të prioritizojë risqet që mund të ndikojnë projektin duke përllogaritur probabilitetin e tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi arritjen e objektivave të projektit. Vlerësimi sasior është bazuar në probabilitetin e ndodhjes të secilit risk dhe në ndikimin e mundshëm mbi koston dhe afatet e projektit.

Ndikimi i risqeve mbi koston e projektit është llogaritur duke u bazuar mbi peshën specifike që zë secili prej tyre në koston e projektit. Ndërsa, ndikimi mbi afatin e përfundimit të punimeve është përllogaritur duke u bazuar në afatet ligjore për kryerjen e procedurave të caktuara që mund të nevojitet të ndiqen për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Open Procurement Albania

Më poshtë vijon një analizë sasiore mbi ndikimin që mund të ketë secili risk në koston dhe afatet e realizimit të projektit.

Risku i trojeve. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 0-5%. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është zero pasi shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për ndërtimin e shkollave do të kryhet nga Bashkia e Tiranës me një fond të veçantë jashtë skemës financiare të këtij projekti. Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e shkollave janë prona shtetërore dhe prona private. Në rast se përdorimi i ndonjërit prej këtyre trojeve është i pamundur, do të përdoret një prej trojeve alternative të përzgjedhura për të cilat është marrë informacion edhe pranë ZRPP. Rrjedhimisht, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve lidhet me marrjen në dorëzim të pronës shtet, në rast se nuk është pronë e Bashkisë Tiranë, ose shpronësimin e pronave private. Ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur 3 – 6 muaj.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 5-10%. Kostimi i ndërtimit të shkollave është bërë në përputhje me manualet udhëzuese të MAS dhe në bazë të kostove të ndërtimit të shkollave nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit dhe çmimet janë indeksuar sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit të INSTAT. Ndaj, ndikimi maksimal që ky risk të ketë në kosto është më i vogël se 5%. Nga ana tjetër, afati i punimeve mund të mos respektohet si rezultat i mos marrjes në kohë të lejes së ndërtimit apo lejeve të tjera nga ana e koncensionarit apo edhe nga kryerja e punimeve më ngadalë sesa është parashikuar në kalendarin e punimeve. Në rast se projektimi vonohet apo nuk plotësohet dokumentacioni për pajisjen me lejet e nevojshme, ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur nga 3 deri në 12 muaj.

Risku i funksionimit. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur nga 0-5%. Duke qenë se ky projekt lidhet me ndërtimin e shkollave të reja, ekziston mundësia që cilësia e ndërtimit të jetë e ulët, çka do të bënte që të kërkoheshin punime shtesë përtej afatit të përcaktuar. Ndikimi i këtij risku në afatin e punimeve është përllogaritur nga 1 deri në 3 muaj, ndërsa ndikimi mbi koston totale të projektit është përllogaritur 5-10%. Ekziston edhe mundësia që kosto e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa është përllogaritur, por krahasuar me koston totale të projektit ndikimi i kësaj kostoje është thuajse i papërfillshëm.

Risku i kërkesës dhe risqet e tjera tregtare. Ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin dhe munësia që ai të ndikojë koston apo afatet e realizimit të tij është zero.

Risqet ekonomike dhe financiare. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i ulët, 0-5%, duke marrë në konsideratë se nuk kemi të bëjmë me një koncension afat-gjatë ku koncensionari i nxjerr të ardhurat nga operimi i objektit të koncensionit. Duke qenë se të ardhurat e koncensionarit janë të garantuara nga Bashkia Tiranë dhe të mbrojtura nga inflacioni, ndikimi i riskut mbi koston totale të projektit është i ulët, 5% - 10%. Nga ana tjetër, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve, nuk parashikohet më i lartë se 12 muaj.

Risqet e pronësisë së aseteve. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur 0 – 5%. Ndikimi i tij mbi koston totale të projektet lidhet me koston e mirëmbajtjes, në rast se kjo e fundit rezulton më e lartë se parashikimet dhe me amortizimin e godinave më shpejt se sa është parashikuar në kontratën e koncensionit. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është llogaritur të

Open Procurement Albania

jetë maksimimumi 5%. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku nuk i ndikon aspak afatet e realizimit të punimeve.

Risku politik. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i mesëm i ulët dhe është llogaritur 10 - 20%. Ndodhja e këtij risku mund të bllokojë punimet në mes ose mund të ndërpresë pagesat periodike për konçensionarin, duke rritur koston e financimit të projektit dhe duke vonuar realizimin e punimeve. Për këto arsye, ndikimi i mundshëm i këtij risku mbi kosto është përllogaritur 20 – 30% ndërsa ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve është përllogaritur nga 16 deri në 24 muaj.

Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor. Ky riskt ka një probabilitet ndodhjeje që varion nga 5 deri në 15%. Ndryshime të mundshme ligjore, si për shembull në standartet që duhet të ndjekë ndërtimi i shkollave të reja mund të rrisin ndjeshëm koston e projektit. Prandaj edhe impakti i mundshëm mbi kosto është llogaritur të jetë i mesëm, nga 20 deri në 40%. Gjithashtu, ndryshime të mundshme ligjore mund të çojnë në ribërjen e projekteve apo në vonesa të tjera, çka do të ndikonte negativitsh afatin e realizimit të punimeve. Ndaj, ndikimi mbi afatin e punimeve është llogaritur nga 12 deri në 16 muaj.

Risku i forcës madhore. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është shumë i ulët, nga 0 deri në 5%. Megjithatë, në rast të ndodhjes ndikimi mbi koston apo afatin e punimeve do të ishtë i mesëm i lartë. Kësisoj, ndikimi mbi koston është përllogaritur nga 30% deri në 50% ndërsa ndikimi mbi afatin e punimeve nga 12 deri në 24 muaj.

Open Procurement Albania

Tabela 77 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve

Nr.	Risku	Probabiliteti i ndodhjes	Ndikmi mbi kosto	Ndikimi mbi afatin e punimeve
1	Risku i trojeve	0% - 5%	0%	3 – 6 muaj
2	Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	5% - 10%	0% -5 %	3 – 12 muaj
3	Risku i funksionimit	0% - 5%	5% - 10%	1 – 3 muaj
4	Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	-	-	-
5	Risqet ekonomike dhe financiare	0% - 5%	5% - 10%	6 – 12 muaj
6	Risqet e pronësisë së aseteve	0% - 5%	0% - 1%	-
7	Risku Politik	10% - 20%	20% - 30%	16 – 24 muaj
8	Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	5% - 15%	20% - 40%	12 – 16 muaj
9	Risku i forcës madhore	0% - 5%	30% - 50%	12 – 24 muaj

Tabela 78 Analiza e ndjeshmërisë nëse kostot dhe marzhi i fitimit rriten dhe ulen me 5% dhe 10%

6.8. Analiza e ndjeshmërisë

Faktori kryesor që mund të ndryshojë gjatë procesit të tenderimit, është Marzhi i fitimit. Njëkohësisht, në varësi të projekteve që do të miratohen, detajimi i kostove përkatëse do të bëhet përkatësisht, bazuar mbi projektet faktike të miratuara. Kosto direkte do të përllogaritet bazuar në volume faktike të realizuara, të cilat në asnjë rast nuk mund të jenë më të larta sesa kosto e parashikuar e këtij projekti.

Gjithësesi për efekte të analizës së ndjeshmërisë, do të llogarisim sikur secila nga kostot ulet dhe rritet me 5% dhe 10% dhe marzhi i fitimit ulet dhe rritet përkatësisht me 5% dhe 10%:

	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 10%	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 5%	Modeli Baze	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 5%	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 10%
Norma e Sensitivitetit	10%	5%	0	-5%	-10%
Flukse dalese nga Investimet	- 7,267,445,188	- 6,937,106,771	- 6,606,768,353	- 6,276,429,936	-5,946,091,518
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	- 1,275,711,645	- 1,217,724,752	- 1,159,737,859	- 1,101,750,966	-1,043,764,073
Të Ardhurat	10,274,681,048	9,786,000,321	9,197,517,960	8,713,446,063	8,188,265,320
Fitimi Para taksave	1,731,524,215	1,631,168,798	1,431,011,748	1,335,265,161	1,198,409,729
Tatim Fitimi 15%	- 259,728,632	- 244,675,320	- 214,651,762	- 200,289,774	- 179,761,459
Fitimi neto	1,471,795,583	1,386,493,478	1,216,359,986	1,134,975,387	1,018,648,270
NPV me 5.79%	110,223,600	81,672,242	170,329	- 23,634,170	- 68,587,789
IRR	6.38%	6.25%	5.79%	5.64%	5.34%
Norma e Vetëshlyerjes	5.20	5.28	5.35	5.43	5.51

Open Procurement Albania

7. Arsyetimi i Vendimit të PPP

7.1 Arsyetimi i Vendimit të Koncensionit/Partneritetit Publik Privat

Në bazë të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", arsyetimi i vendimit kryhet duke përcaktuar vlerën e parasë dhe kostot totale neto të projektit në rast se kjo do të arrihej bazuar në një metodë të prokurimit tradicional. Për këtë qëllim përdoret Krahasuesi i Sektorit Publik (KSP) i cili mat pikërisht kostot e projektit në rast se ai do të financohej nga vetë autoriteti kontraktor përmes prokurimit tradicional.

Në ndryshim nga koncencionet/partneritetet publike private të zakonshme, ku koncensionarët ndërtojnë objekte të infrastrukturës publike me fondet e veta, i operojnë ato derisa të nxjerrin kostot e investimit plus fitimin dhe më pas ia transferojnë këtë objekt autoritetit kontraktor, ky koncension/partneritet publik privat ka një natyre tjetër. Duke qenë se objekti i koncensionit/partneritetit publik privat është ndërtimi i godinave shkollore, të ardhurat e tij nuk do të vijnë nga përdorimi i objektit të koncensionit, por nga transfertat vjetore që do t'i paguajë Bashkia Tiranë koncensionarit duke llogaritur një marzh fitimi prej 6,28%. Duke pasur parasysh edhe faktin se për zgjidhjen e problemeve të mbipopullimit dhe mësimit me dy turne dhe përmbushjen e standarteve të MAS, Bashkisë Tiranë i nevojiten 17 shkolla të reja, atëherë arsyetimi i vendimit merr trjatën e mundësive që ka Bashkia për financimin e ndërtimit të këtyre shkollave të reja përmes metodave tradicionale të prokurimit.

Në bazë të analizës ekonomike të kryer më sipër, kosto direkte e investimit për ndërtimin e 17 shkollave të reja është 7,743,692,163 lekë. Për ndërtimin këtyre shkollave përmes metodave tradicionale të prokurimit, Bashkia Tiranë mund të përdorë tre mënyra: i) prokurimin e drejtpërdrejt të menjëherëshëm të 17 shkollave të reja, ii) prokurimin e 17 shkollave të reja duke e shtrirë në një periudhë 3 vjeçare dhe iii) prokurimin e një apo disa shkollave në vit sipas mundësive të veta financiare.

i) Kosto direkte e investimit për ndërtimin e 17 shkollave të reja është 7,743,692,163 lekë. Duke patur parasysh se buxheti total faktik i vitit 2015 i Bashkisë Tiranë ka qenë 8,730,933,000 lekë (duke përfshirë edhe transfertën e kushtëzuar), është lehtësisht e kuptueshme se mundësitë financiare të Bashkisë për prokurimin e këtij projekti janë zero. Kosto e ndërtimit të këtij projekti është rreth 89% e buxhetit faktik të Bashkisë dhe në rast se do ta financonte atë, Bashkia jo vetëm që nuk do mund të ofronte asnjë shërbim tjetër, por nuk do të mund të mbulonte as pagat e punonjësve të saj.

ii) Sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), një projekt mund të prokurohet sipas metodave tradicionale edhe duke u shtrirë në një periudhë 3 vjeçare. Nëse Bashkia e Tiranës do të prokuronte ndërtimin e 17 shkollave të reja duke e shtrirë në 3 vjet, atëherë Bashkisë do t'i duhej të

Open Procurement Albania

shpenzonte 2,581,230,721 lekë çdo vit. Kjo shumë, krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2015, është sa 30% e buxhetit total dhe 51% më e lartë se totali i shpenzimeve kapitale për vitin 2015 të cilat kanë qenë 1,701,849,000 lekë. Pra, nëse Bashkia Tiranë do të zgjidhte këtë metodë prokurimi, jo vetëm që nuk do mund të kryente asnjë investim publik në sektorët e tjerë për 3 vjet, por do t'i duhej edhe të mbulonte diferencën prej 879,381,721 lekësh duke pakësuar shpenzimet operative apo shpenzimet e personelit. Edhe nëse do të përdoreshin për këtë synim të ardhurat nga Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore të cilat llogariten mesatarisht 940,000,000 lekë në vit, sërish Bashkia Tiranë do t'i duhej që çdo vit të mbulonte ne të ardhurat e veta diferencën mes 2,581,230721 lekë që nevojiten dhe 940,000,000 lekë që janë të ardhurat nga taska e përkohëshme. Kjo diferencë është 1,641,230,721 lëkë dhe sërish është thuajse e barabartë me totalin e shpenzimeve kapitale për vitin 2015. Pra, edhe nëse do të përdorte këtë mundësi Bashkia nuk do mund të kryente asnjë investim publik në sektorët e tjerë si shërbimet publike vendore, rrugët dhe transporti publik, strehimi dhe kujdesi social, etj., çka do të përkeqësonte ndjeshëm nivelin e jetesës së qytetarëve të Tiranës.

iii) Në rast se do të zgjidhej që të prokuroheshin një apo më shumë shkolla në vit, Bashkia Tiranë do mund të përdorte për të financuar këtë projekt fondin e investimeve në programin e arsimit parauniversitar dhe eduktimit dhe të ardhurat nga Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore. Investimet faktike mesatare të tre viteve të fundit në programin e arsimit parauniversitar kanë qenë 262,621,006 lekë. Është e rëndësishme të përmendet se përmes këtij programi buxhetor gjatë viteve të fundit vetëm 10% e fondit ka shkuar për ndërtimin e shkollave të reja, dhe pjesa dërrmuese e fondit ka shkuar për rikonstruksionin e çerdheve, kopshteve dhe shkollave. Kjo për arsye se niveli i amortizimit të objekteve arsimore është i lartë dhe nevojat kryesore kanë qenë dhe janë për rikonstruksionin e tyre në mënyrë që të mund të zhvillohej mësimi normalisht. Nëse shtojmë edhe faktin se si rezultat i reformës territoriale, Bashkia e Tiranës është përgjegjëse edhe për çerdhet, kopshtet dhe shkollat në zonat rurale të cilat vuajnë një nivel amortizimi akoma edhe më të lartë, mundësitë që përmes këtij programi buxhetor Bashkia të financojë ndërtimin e shkollave të reja në të ardhmen janë minimale. Rrjedhimisht, prokurimi i shkollave të reja do mund të financohej vetëm nga Taksa e përkohëshme e infrastrukturës arsimore. Të ardhurat mesatare vjetore të parashikuara nga kjo taksë janë 940,000,000 lekë në vit. Duke pasur parasysh se kjo taksë do të mblidhet vetëm për një periudhë 7 vjeçare, në total Bashkia do të mbledhë nga kjo taksë 6,580,000,000 lek. Në rast se do të zgjidhej kjo metodë prokurimi, Bashkia do mund të ndërtonte vetëm 14 shkolla të reja nga 17 që nevojiten. Dhe më e rëndësishmja, shkollat e reja do mund të prokurohen çdo vit nga dy, dhe duke pasur parasysh që punimet për një shkollë zgjasin mesatarisht 20 muaj, ndërtimi i 14 shkollave do përfundojë 9 vjet pas nisjes së punimeve.

Krahasuar me tre mundësitë për përdorimin e metodave tradicionale të prokurimit publik, kjo

Open Procurement Albania

skemë koncensioni/partneriteti publik privat paraqet avantazhe të theksuara dhe garanton realizimin e projektit në një periudhë shumë më të shkurtër kohore dhe me efiçencë të lartë të vlerës së parasë.

Dy mundësitë e para, prokurimi i menjëherëshëm i 17 shkollave të reja dhe prokurimi i tyre duke e shtrirë projektin në një periudhë 3 vjeçare, janë dukshëm përtej mundësive financiare të Bashkisë Tiranë. Pra, përmes këtyre dy metodave tradicionale të prokurimit, projekti është jofizibël dhe financiarisht i parealizueshëm. Mundësia e tretë e sipër-përmendur nuk e realizon plotësisht projektin pasi përmes saj mund të ndërtohen vetëm 14 nga 17 shkollat që nevojiten. Gjithashtu, edhe 14 shkollat që mund të ndërtohen, nuk ndërtohen menjëherë por përgjatë 9 viteve të ardhshme. Pra, kjo mundësi jo vetëm që ofron një zgjidhje të pjesëshme të problemit të mbipopullimit dhe të zhvillimit të mësimit me dy turne, por, ç'është më e rëndësishmja, nuk e shtyn në kohë këtë zgjidhje.

Në ndryshim nga tre mundësitë e prokurimit tradicional të projektit, me skemën e propozuar të koncensionit/partneritetit publik privat, projekti është jo vetëm i realizueshëm menjëherë dhe me fizibilitet, por edhe pa kosto shtesë për buxhetin e Bashkisë Tiranë duke qenë se ai nuk e prek fare fondin e investimeve për vitet e ardhshme. Përmes kësaj skeme, Bashkia Tiranë e zgjidh brenda dy viteve të ardhshme problemin e mbipopullimit dhe të zhvillimit të mësimit me dy turne.

Gjithashtu, një element shumë i rëndësishëm është edhe fakti se kostot financiare të kësaj skeme koncensioni/partneriteti publik privat nuk janë më të larta se sa kostot e qeverisë për të marrë hua. Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk është përllogaritur marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se vlerat e investuara për këtë qëllim nga koncensionari do të shlyhen në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë. Për këtë arsye si marzh fitimi është marrë si tavan norma mesatare e obligacioneve të qeverisë shqiptare për obligacionet 7 vjeçare fikse.

7.2 Avantazhet e një Kontrate Koncesioni/Partneriteti Publik Privat

Të gjitha projektet e mëdha infrastrukturore apo ato të ndërtimit të veprave të rëndësisë së veçantë kalojnë në disa faza të ndara zhvillimi, duke filluar me projektimin dhe ndërtimin, për të kaluar më pas tek menaxhimi dhe mirëmbajtja. Për realizimin e këtyre projekteve, përgjithësisht janë përdorur metodat tradicionale të prokurimit të cilat janë të ndara për secilën fazë, ku kontraktorët janë entitete të ndryshme me përgjegjësi dhe objektiva të ndryshme.

Kjo metodë prokurimi, gjerësisht e përdorur në projektet infrastrukturore të përmasave të vogla apo mesatare ka mjaft aspekte pozitive, por kur është fjala për projekte të mëdha, vendet e zhvilluara kanë kohë që zbatojnë metoda të reja e inovative të cilat duke kursyer kohë e para rrisin ndjeshëm efiçencën, çka ndikon drejtpërsëdrejti në fizibilitetin e projektit. Tenderimi individual për fazat e ndryshme të projekteve me natyrë komplekse shihet si një metodë jo shumë efektive sepse realizimi i tyre kërkon shumë kohë. Eksperienca tregon për

shumë raste kur pasi procedurat janë përfunduar, kushtet fillestare kanë ndryshuar, duke kërkuar kështu një ndryshim të projektit e nisjen e proçedurave të reja që e vonojnë edhe më shumë realizimin e projektit. Gjithashtu, zbatimi i proçedurave tradicionale të prokurimit për këto projekte nuk garanton gjithmonë vlerën e parasë pasi procedurat e shumta burokratike rrisin ndjeshëm kostot e projektit. Për këtë arsye, një ndarje e tillë shpesh përben pengesë për të siguruar realizueshmërinë në rradhë të parë dhe, më pas, qëndrueshmërinë e mëtejshme të projektit pas përfundimit të fazës së ndërtimit.

Nga ana tjetër, si rezultat i ndryshimeve në strukturën ekonomike globale për të garantuar konkurrueshmërinë, qeveritë lokale e qendrore kudo në botë po përballen me shtrëngesa buxhetore çka përkthehet në pamundësi për të financuar shërbimet që duhet të ofrojnë. Kjo ka bërë që qeveritë të zhvillojnë metoda inovative për financimin dhe realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore.

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin **Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje** (PFNM), koncensionarët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për një periudhë disa vjeçare të përcaktuar në kontratë. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre.

Në botimin e Bankës Botërore, "Roli dhe Impakti i Partneritetit Publik Privat në Edukim" pohohet se Partneriteti Publik Privat në ndërtimin e shkollave duhet të favorizohet, sepse:

- Së pari, i krijon mundësinë autoritetit kontraktues të tërheqë investimet private në ato sektorë ku burimet/fondet publike nuk janë të disponueshme;
- Së dyti, partneri privat si kusht kontraktual, mban përgjegjësi për infrastrukturën e ndërtuar;
- Së treti, nga perspektiva arsimore, Partneriteti Publik Privat e ndihmon autoritetin kontraktor të sigurojë infrastruktura shkollore të përshtatshme sipas parametrave të përcaktuar.

Ky lloj partneriteti lehtëson sektorin publik duke i mundësuar që në pamundësi fondesh të realizojë ndërtimin e strukturave shkollore menjëherë dhe pa humbur të drejtën e pronës. Dhe nëse partneriteti shtrihet dhe në fushën e mirëmbajtjes të godinave shkollore nga ana e koncensionarit kjo ka një impakt pozitiv tek procesi i arsimimit.

Mes avantazheve të tjera që sjell koncensioni/partneriteti publik privat mund të përmënden:

- Kapital shtesë i mundësuar;
- Optimizim i përdorimit të pronës publike, e cila me kalimin e viteve mund të tjetërsohet;
- Cilësi më e mirë projektimi dhe ndërtimi;
- Organizim konstruktiv dhe efektiv;
- Përdorimi i materialeve më cilësore të ndërtimit;
- Integrimi i teknologjive inovative;
- Kosto e përgjithshme e reduktuar (veçanërisht gjatë procesit të mirëmbajtjes);
- Transferim i riskut;
- Shmangia e proceseve gjyqësore që mund të vijnë për shkak të mosmarrëveshjeve mes palëve të kontraktuara për fazat e ndryshme të projektit;
- Përshpejtim i realizimit të projektit krahasuar me metodën tradicionale.

7.3 Alokimi i Risqeve

Sipas pikës 5 të nenit 8 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat" është e nevojshme që të kryhet alokimi i risqeve në përputhje me parimin që pala që mbart riskun është ajo e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe për të minimizuar efektet e tij. Sipas analizës cilësore dhe sasiore të risqeve të kryer më sipër, në kapitullin mbi analizën ekonomike dhe financiare të projektit, alokimi i risqeve është bërë sipas tabelës së mëposhtme.

Open Procurement Albania

Tabela 79 Tabela përmbledhëse e alokimit të risqeve

Lloji i riksut	Alokimi i riskut
Risku i trojeve	Risk i mbajtur
Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	Risk i transferuar
Risku i funksionimit	Risk i transferuar
Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	N/A
Risqet ekonomike dhe financiare	Risk i përbashkët
Risqet e pronësisë së aseteve	Risk i transferuar
Risku politik	Risk i mbajtur
Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	Risk i transferuar
Risku i forcës madhore	Risk i përbashkët

Pika 6 e nenit 8 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat" kërkon që alokimi i riskut të përdoret edhe si një mjet themelor për të cilësuar nëse koncensioni/partneriteti publik privat është klasifikuar si "brena" apo "jashtë" bilancit të autoritetit kontraktor në bazë të rregullave të Sistemit Europian të Llogarive ESA95, sipas mënyrës së kombinimit të alokimit të riskut të ndërtimit, riskut të disponueshmërisë dhe riskut të kërkesës.

Në Manualit ESA95 mbi Deficitin dhe Borxhin e Qeverive[36], në Pjesën IV mbi Qeratë, Liçencat dhe Koncensionet, thuhet se në koncensionet/partneritetet publike private ku autoriteti kontraktor kryen pagesa të rregullta ndaj koncensionarit (siç është rasti i këtij koncensioni/partneriteti publik privat) duhet të dallohen dy raste: rasti kur shumica e risqeve është mbajtur nga autoriteti kontraktor dhe rasti kur shumica e risqeve është transferuar tek koncensionari. Pika 6 e nenit 8 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 kërkon që në këtë analizë të merren në konsideratë vetëm tre risqe, risku i ndërtimit, risku i disponueshmërisë dhe risku i kërkesës. Nga analiza e risqeve e kryer më sipër, rezulton se risku i ndërtimit dhe risku i disponueshmërisë janë transferuar tek koncensionari, ndërsa risku i kërkesës nuk aplikohet mbi këtë koncension/partneritet publik privat.

Rrjedhimisht, në përputhje me ESA 95, "kur koncensionari është i ekspozuar ndaj shumicës së risqeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës, infrastruktura regjistrohet në pasqyrat financiare të koncensionarit". Pra, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, konecensionari do të jetë përgjegjës për infrastrukturën e ndërtuar dhe godinat shkollore do të jenë të regjistruar në pasqyrat e tij financiare. Pra, ky koncension/partneritet publik privat klasifikohet "jashtë" bilancit të autoritetit kontraktor.

Po sipas përcaktimeve të ESA95, kjo kontratë koncensioni/partneriteti publik privat klasifikohet si një kontratë qeraje operative dhe jo si një kontratë qeraje financiare. Vetëm pagesat e rregullta që autoriteti kontraktor do t'i bëjë koncensionarit do të kenë një impakt mbi aftësitë huadhënëse dhe huamarrëse të autoritetit kontraktor. Në përfundim të kontratës së koncensionit, kur infrastruktura arsimore e ndërtuar t'i transferohet autoritetit kontraktor, ajo do të regjistrohet në bilancin e tij si vlera e aktiveve të qëndrueshme bruto pa zbritur amortizimin.

Pra shkollat, regjistrohen në emër të Bashkisë Tiranë, jepen në administrim të koncensionarit për shtatë vite, dhe koncensionari, gjatë kësaj periudhe ia jep në përdorim këto shkolla Bashkisë Tiranë, duke garantuar përmes SLA, cilësinë e ndërtimit të shkollave në fazën 1, mirëadministrimin e aseteve dhe mirembajtjen e e zakonshme dhe të jashtëzakonshme gjatë kësaj periudhe, si dhe duke siguruar vënien në dispozicion të aseteve në dobi të komunitetit, për zhvillimin e mëtejshëm të artit, kulturës dhe sportit në komunitet

7.4 Rekomandime mbi ndarjen e zbatimit të projektit në Lote

Duke parë koston e lartë të projektit dhe volumin e madh të punimeve që nevojitet të kryhen, nga njëra anë, dhe detyrimin për përfundimin e punimeve brenda afateve të përvcaktuar, nga ana tjetër, është bërë edhe një analizë në lidhje me kapacitetet teknike dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë në treg për realizimin e këtij projekti.

7.4.1 Kapacitetet teknike e profesionale për ndërtime të objekteve arsimore

[36] http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5860213/KS-42-02-585-EN.PDF/34346b49-bc38-4063-a423-74590fdaf8bd

Për një ndërtesë shkolle + kopesht, sipas tipologjive të propozuara, koha e plotë që nevojitet për ndërtimin e saj është 14 muaj. Gjate kesaj periudhe përfshihen proçeset e punes si më poshtë:

- Organizimi i kantierit;
- Piketimi i themeleve, ndertimi i tyre;
- Ndertimi i struktures tra-kolonë-solete;
- Instalimet elektrike;
- Instalimet hidraulike;
- Instalimet e sistemit te ngrohjes;
- Instalimet e MKZ;
- Rifiniturat e brendshme;
- Rifiniturat e jashtme;
- Instalim të pajisjeve;
- Sistemimet e jashtme etj.

Gjate secilit nga proceset e punes eshte e domosdoshme te jete rezident nje prej inxhinierve te stafit të shoqërisë, si vijon:

- Inxhinier ndërtimi minimumi 2 (dy)
- Inxhinier mjedisi minimumi 1 (nje)
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1 (nje)
- Inxhinier topograf minimumi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik minimumi 1 (nje)
- Inxhinier mekanik minimumi 1 (nje)

Open Procurement Albania

Gjatë gjithë fazave të punimeve të ndërtmit është e domosdoshme ndjekja e punimeve nga një inxhinier ndërtimit rezident.
Përveç burimeve njerëzore dhe makinerive e mjeteve, vendodhja e sitit të ndertimit është shumë e rëndësishme për të bërë të mundur organizimin e punimeve.

Për të qënë efiçent gjatë ndërtimit të objektit dhe për shpërndarjen e punonjësve dhe makinerive, është e rendesishme qe vendodhja e 3- 4 shesheve ku do te ndertohen shkollat te jene me distanca te shkurtra nga njera tjetra ose brenda nje njesie administrative.

Duke marre në konsideratë sasinë e mjeteve që i duhen një operatori ekonomik për kryerjen me sukses të një objekti arsmor (shkollë 4 kate), do të kishim:

Tabela 80 Kapacitetet teknike të nevojshme për ndërtimin e 17 shkollave njëkohësisht

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona veteshkarkues (kapaciteti mbajtes minimumi 10 Ton/kamion)	Kapaciteti total mbajtes minimumi 100 ton	Pronësi ose me qera

Autobetoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
Motobetoniere	6 copë	Pronësi ose me qera
Skela	3000 m2	Pronësi ose me qera
Rrjete mbrojtese	3000 m2	Pronësi ose me qera
Vinc karrele	3 copë	Pronësi ose me qera
Makineri gërmimi	5 copë	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Auto-Vinc me aftesi mbajtese 8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	3 copë	Pronësi ose me qera
Mjete per prishje struktura betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per prishje struktura betoni	2 cope	Pronësi ose me qera

Mjetet e cituara, operatorët ekonomikë mund ti disponojnë apo marrim me qera dhe nuk përbëjnë kufizim për aftësinë e operatorëve për të përballuar më shumë se 4 objekte. Ajo që kufizon në rastin e mjeteve është se bashkë me to është e nevojshme shtim i stafit teknik në mbështetje të veprimtarisë së kryer me këto mjete.

Open Procurement Albania

7.4.2 Kapacitetet financiare të operatorëve ekonomikë

Gjithashtu, përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të paktën sa 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet

2. Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën sa dyfishi i fondit limit.

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 276,314,618 lekë. (2 shkolla)
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 376,471,912 lekë. (7 shkolla)
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 234,736,581 lekë. (1 shkolle)
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë (7 shkolla)

(Referuar Analizes ekonomike te bere nga Financa)

Kostoja totale per realizimin e 17 shkollave të parashikuara (ndertim, mobilim, laboratore, mirëmbajtje) është 4,720,118,027 lekë (ndërtimi) + 502,378,267 (kosto mobilim+laboratore) + 1,159,737,664 (kosto mirëmbajtje për 7 vite) = **6,382,233,958 lekë pa TVSh**

Në përmbushje të pikës së parë, Operatorët Ekonomik konkurues do duhej që të kishin në portfolion e tyre Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të paktën sa 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, dmth me vlerë 3,191,116,979 lekë.

Ndërsa në përmbushje të pikës së dytë, Operatorët Ekonomik konkurues do duhej që të kishin në portfolion e tyre Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën sa dyfishi i fondit limit, dmth me vlerë 12,764,467,916 lekë, ose më shumë se 51 shkolla të përmasave që propozon projekti.

Duke qënë që në Shqipëri nuk janë bërë më përpara investime të këtyre përmasave në fushën e arsimit, risku që të gjenden Operatorë Ekonomikë me eksperiencë në këtë fushë të përmasave financiare të sipërcituara është tepër i vogël; për të mos thënë inekzistent. Në çdo rast, edhe nëse do të kishte Operatorë Ekonomikë të cilët kanë kryer kontrata të ngjashme të përmasave të mësipërme, numri i tyre do të ishte tepër i limituar duke limituar kështu edhe konkurencën, gjë që dëmton procesin e prokurimit.

Përveç sa më sipër, skema e financimit përmes PPP parashikon që Operatori Ekonomik të shërbejë edhe si investitor përveçse si ndërtues. Ky element e vështirëson akoma më tepër gjetjen e Operatorëve Ekonomikë që kanë kapacitete për realizimin e këtij projekti si një i tërë.

<u>Ndaj rekomandohet që projekti të ndahet në minimalisht 4 Lote, për të rritur shanset që kërkesat e mësipërme të plotësohen.</u>

Open Procurement Albania

7.4.3 Bashkimi i operatorëve dhe nënkontraktimi

Referuar Ligjit Nr. 125/2013 Ndryshuar me Ligjin Nr.88/2014 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”

Neni 34 Nënkontraktimi 1. Autoriteti kontraktues mund: a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta. Operatorët ekonomik mund të marin me nënkontraktim minimalisht 30% të vlerës totale të kontratës.

Njëkohësisht, duke marrë në konsideratë Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin nr. 10309, datë 22.07.2010, Ligjin nr. 22/2012, Ligjin nr. 131/2012, dhe Ligjin nr. 182/2014 "Për prokurimin publik", neni 61, pika 2 Nenkontraktimet: operatori ekonomik nuk mundet të marë me nënkontraktim më shumë se 40 % të vlerës totale pasi në këto raste do të humbë thelbi i kontratës dhe thelbi i zbatimit të saj.

Sa më lart, edhe duke marrë parasysh rastet kur Operatorët Ekonomikë nënkontraktojnë 30%-40% të vlerës totale të projektit, sërish pjesa e mbeture projektit, pra minimalisht 60% e projektit, është tepër ambicioze për tu realizuar brenda afateve kohore nga një Operator Ekonomik i vetëm. Kufiri i sipërm i nënkontraktimeve limiton ndjeshëm kapacitetet teknike të operatorëve dhe mundësitë e tyre për zbatimin e 5 apo më shumë objekteve në një kohë. Ndaj me këtë arsyetim, propozohet që projektit të ndahet në minimalisht 4 lote, me jo më shumë se 5 objekte arsimore në secilin prej loteve.

8. Fizibiliteti i zbatimit të secilit Lot

Në vijim të studimit, si rezultat i analizës së kapaciteteve teknike dhe financiare të nevojshme për zbatimin e projektit si një i tërë, rezultoi si alternativë me e sigurtë ndarja e projektit në 4 Lote. Ndarja në Lote synon që të garantojë interes nga më shumë operator ekonomik për pjesëmarrje në këtë skemë, duke rritur kështu konkurencën, si dhe të lehtësojë zbatueshmërinë e projektit. Ndarja e shkollave në 4 Lote është bërë duke ndjekur dy kritere kryesore:

- Shkollat e përfshira në një lot duhet të jenë fizikisht afër me njëra tjetrën
- Lotet duhet të përmbajnë numër të përafërt shkollash dhe vlera financiare të përafërta

Nisur nga kjo, propozimi për ndarjen në Lote është siç tregohet në hartën e mëposhtme:

Harta 106 Ndarja e shkollave në lote



Open Procurement Albania

8.1. Loti 1

8.1.1. Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 1

Loti 1 përfshin 5 shkolla, nga të cilat 3 në Njësinë Administrative 11 dhe 2 në Njësinë Administrative 9. Shpërndarja e shkollave të përfshira në Lotin 1 tregohen në hartën e mëposhtme:

Harta 107 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 1

8.1.2. Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 1

SHESHI 9/1

Harta 108 Ortofoto e sheshit

VENDODHJA : Shesh i propozuar nr.**9/1** ndodhet pranë lagjes "Don Bosko". Eshtë një zonë në zhvillim ku vërehen tipologji banimi shumë katëshe dhe banesa të ulëta një familjare informale.

TË DHENA TEKNIKE: Sheshi 9/1: Sipërfaqe – 12989 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë e qetë relativisht.
- Aksesi në shesh është i lehtë. Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore. Paraqet shumë aspekte pozitive, pasi ndodhet në një zonë me intensitet të lartë banimi.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mësme.
- Sheshi përfshin në territorin e tij një objekt të vjetër magazinimi, por shihet interesant për shkak të shtrirjes dhe sipërfaqes të madhe.

Figura 9 Foto të sheshit 9/1

Open Procurement Albania

SHESHI 11/1

Harta 109 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr. 11/1 ndodhet brenda kompleksit universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky shesh kufizohet nga rruga "Taulantët" dhe bulevardi "Blu".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi11/1: Siperfaqe - 8,967 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë e paprekur me gjelberim të ulët.

- Sheshi ka pjerrësi të konsiderueshme.

- Problematike është infrastruktura rrugore

- Aksesi në shesh është i vështirë

Figura 10 Foto të sheshit 11/1

Open Procurement Albania

SHESHI 11/2

Harta 110 Ortofoto e sheshit

VENDODHJA : Sheshi i propozuarnr. **11/2** ndodhet pranë rrethrrotullimit të Doganës. Aksesohet nga rruga Vangjel Noti.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 11/2: sip 14,102 m2/

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Ndodhet pranë qendrës se banuar të zonës.
- Akses i lehtë

Figura 11 Foto të sheshit 11/2

8.1.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 1

Sheshi 9/1



Tabela 81 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekt

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet	Okupuar me 8 ndërtime	8330	4/165	10111.00	34068			0.0
2	Zoje Boka		8330	4/224	1145.00	34068			39,007,860.0
3	Truall Shtet	Okupuar nga Hamdi Boka	8330	4/445	749.00	34068			0.0
5	Zoje Boka		8330	4/223	229.00	34068			7,801,572.0
6	Truall Shtet	Okupuar nga Hamdi Boka	8330	4/443	641.00	34068			0.0
7	Rruge Shtet		8330	4/430	114.00	34068			0.0
					12989.00				46,809,432.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8330 do të prekë gjithsej 12,989 metra katrorë pronë, të përbërë nga 6 prona, nga të cilat 4 objekt pronë shtetërore dhe 2 objekte pronë private. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 11/1

Harta 112- Harta treguese e pronave



Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin 11/1 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Tabela 82-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				8,967	22,985			206,106,495
					8,967				206,106,495

Open Procurement Albania

Sheshi 11/2

Harta 113 Harta treguese e pronave



Tabela 83 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
7	Ministria Mbrojtjes		8310	12/16	14,102.00	31219			0.0
					14,102.00				0.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8310 do të prekë gjithsej 14,102 metra katrorë pronë, të përbërë nga 1 pronë me nr. 12/16, e cila aktualisht është në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

8.1.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 1

Në Lotin 1 është parashikuar ndërtimi i 5 shkollave, përkatësisht dy shkolla të reja në Njësinë Administrative 9 dhe tre në Njësinë Administrative 11 . Më konkretisht, në NJA 9 është parashikuar të ndërtohet një shkollë ciklit arsimor bazë të tipit 1 dhe një shkollë e ciklit arsimor të mesëm të lartë, pra e tipit 4. Ndërsa në NJA 11 janë parashikuar të ndërtohen dy shkolla të ciklit arsimor bazë të tipit 2 dhe një shkollë e tipit 4. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen më në detaj dallimet mes tipeve të shkollave sipas vendndodhjes, ciklit arsimor, nr. e klasave, nr. e nxënësve për klasë, etj,.

Tabela 84 –Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

Open Procurement Albania

8.1.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 1

8.1.5.1 Analiza ekonomike dhe financiare

Analiza ekonomike dhe financiare e këtij studimi fizibiliteti, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, ka si objektiv kryesor të saj që të përcaktojë vlerën e parasë së projektit si dhe të bëjë një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes si edhe të çdo të ardhure që pritet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së projektit.

1.1. Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

Ligji nr. 125/2013 rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private. Në këtë lloj marrëdhënieje, partneri privat merr përsipër që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë /të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtaz. Ndër fushat e zbatimit të këtij ligji është edhe arsimi.[37]

Nga analiza e të dhënave rezulton se për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit të shkollave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne, Bashkia Tiranë duhet të ndërtojë 17 shkolla të reja, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Kosto totale e ndërtimit dhe mobilimit të këtyre shkollave llogaritet në 7.6 miliard lekë. Një shifër e tillë është financiarisht e papërballueshme për Bashkinë e Tiranës, buxheti total vjetor i së cilës është 10 miliard lekë, ndërsa investimet për ndërtimin e shkollave të reja gjatë viteve të fundit kanë qenë jo më shumë se 500 milion lekë.

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin "Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje" (PFNM), ose ndërkombëtarisht i njohur me termin "Design, Build, Finance & Operate (DBFO)", kontraktorët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Kontraktori, i cili mund të jetë një kompani e vetme apo një

[37] Neni 4, pika dh), Ligji 125/2013

konsorcium është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e objektit për një periudhë të caktuar kohore, e cila propozohet të jetë 7 vjet. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre. Githashtu, integrimi i të gjitha kontratave të projektit në një të vetme redukton kostot e ndryshme transaksionale dhe rrit efiçencën e menaxhimit të projektit.
Më së shumti ky model PPP-je është përdorur për ndërtimin e projekteve infrastrukturore madhore të tilla si ndërtimi i autostradave, hidrocentraleve, impianteve të menaxhimit të mbetjeve, etj,. Kjo për shkak se përmasat e mëdha të projekteve të tilla kërkojnë fonde të konsiderueshme, organizim sa më efektiv të burimeve kapitale dhe njerëzore, cilësi të lartë projektimi dhe ndërtimi, siguri maksimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për këtë arsye modele të tilla si PFNM apo të ngjashme, janë parë si nga më të suksesshmet për të zhvilluar projekte që garantojnë realizueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e investimit të kryer. Megjithatë përdorimi i kësaj forme të PPP nuk është kufizuar vetëm tek projektet e mëdha të infrastrukturës publike të përmendura më sipër. Në shumë vende të OECD-së, por më gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar, kjo metodologji është përdorur gjithashtu për projekte të shërbimeve publike të tilla si ndërtimi i shkollave të reja.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj nga vende të ndryshme të cilat kanë zbatuar me sukses këtë model për projekte të infrastrukturës arsimore:

Kanada[38]**:** Programi "Alberta Schools Alternative Procurement". Në vitin 2007 krahina e Albertës në Kanada shpalli fazën e parë të programit i cili parashikonte ndërtimin e 18 godinave të reja shkollore (kopshte dhe shkolla 9-vjeçare) të cilat kanë përunduar ndërtimin në vitin 2010. Pas përfundimit të ndërtimeve, jetëgjatësia e kontratës e cila do vijojë me pjesën e mirëmbajtjes është përcaktuar rreth 30 vjet. Faza e dytë e programit përfshinte ndërtimin e 10 shkollave të tjera 9-vjeçare sipas të njëjtit model dhe 4 gjimnazeve nëpërmjet modelit të thjeshtë të kontratës Projektim-Ndërtim të cilat kanë përfunduar në vitin 2013.

Greqi[39]: Programi "Macedonia Schools and Attica Schools". Duke përdorur mekanizmin DBFM operatorët privatë projektuan ndërtimin e 51 shkollave me një vlerë totale prej 269 milion Euro dhe me kontrata 25 vjeçare.

[38] "Flexible and alternative approaches to providing school infrastructure in Alberta, Canada" – OECD, 2010
[39] "The role and impact of public-private partnerships in education", Fq. 82 – Banka Botërore, Mars 2009 .http://www.ungei.org/resources/files/Role_Impact_PPP_Education.pdf

Mbretëri e Bashkuar[40]: Programi "Building Schools for the future". Ky program është një program afat-gjatë investimesh i cili po kontribuon në ndërtimin e një numri të konsiderueshëm shkollash në gjithë tërritorin e MB-së. Shumica e shkollave janë ndërtuar nëpërmjet skemës Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje, por në këtë rast shpesh herë është përfshirë edhe elementi i menaxhimit të shkollës nga subjekti privat për një periudhë të caktuar. Zakonisht kohëzgjatja totale e kontratës arrin deri në 30 vjet. Konsorciumi privat paguhet rregullisht nga fondet publike bazuar në performancën e tij gjatë periudhës së kontratës. Nëse konsorciumi nuk arrin performancën e synuar pagesa reduktohet. Në fund të periudhës së kontratës shkolla i kthehet qeverisë.

Zelandë e Re[41]: Projekti i Ministrisë së Arsimit të Zelandës së Re për ndërtimin e dy shkollave në Hobsonville, Auckland. Ky projekt parashikonte ndërtimin e një shkolle të re të ciklit të ulët dhe një shkolle të ciklit të mesëm të ulët në rajonin periferik të Hobsonville në qytetin Auckland. Sektori privat ishte pjesërisht përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objekteve, sëbashku me sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre si dhe menaxhimin e shërbimeve të përbashkëta. Ndërtimi i këtyre shkollave ka përfunduar me sukses në vitin 2014.

Nën këtë prizëm, projekti i ndërtimit të shkollave të reja të Tiranës e sheh të nevojshme aplikimin e të njëjtës qasje për përmirësimin e shërbimit arsimor në gjithë territorin e Bashkisë. Numri i madh i shkollave që do të ndërtohen, kufizimet financiare, koha e shkurtër e zbatimit të projektit si dhe nevoja për garantimin e cilësisë maksimale të ndërtesave theksojnë nevojën për ngritjen e një partneriteti public privat efektiv dhe të suksesshëm.

Open Procurement Albania

1.2.Supozimet kryesore

Për efekt të analizës ekonomike e financiare të këtij studimi fizibiliteti, janë bërë supozimet si më poshtë:

- Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për ndërtimin e objekteve arsimore dhe vënien në funksion të tyre, ndërsa Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për këtë qëllim.
- Objektet arsimore do të jenë të ndërtuara e funksionale maksimalisht 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Pas ndërtimit vënien në funksion të shkollave, koncesionari do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për një periudhë 7 vjeçare dhe për çdo problematikë për administrimin dhe reziqet e aseteve për këtë periudhe.
- Pas ndërtimit të objekteve, Bashkia Tiranë do t'i paguajë koncesionarit një shumë të caktuar vjetore deri në shlyerjen e plotë të shumës së investuar. Të ardhurat për këto

[40] Ibidem (dmth: marrë nga i njëjti dok i Bankës Botërore në referencën e mësipërme dhe në të njëjtën faqe)
[41] "Mayoral Position Paper on Public Private Partnerships" – Ernst and Young, Nëntor 2013.

pagesa do të sigurohen nga të ardhurat vjetore nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore dhe nga transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave.

1.3.Analiza e kostove

Bazuar në studimin teknik, është arritur në përfundimin se në total do të ndërtohen 17 shkolla, prej të cilave 10 shkolla 9 vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e reja do të projektohen e ndërtohen sipas modeleve në përputhje me standartet e specifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes udhëzuesit" Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar. Referuar standarteve të sipër-përmendura, janë përcaktuar 4 tipe kryesore shkollash, me të dhëna operacionale si më poshtë:

Tipi 1 i shkollave, është me 20 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,938 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 4 klasash, me nje sipërfaqe prej 874 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 5,812 m2. **Tipi 2** i shkollave, është përsëri 9 vjeçar, me 30 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 6,588 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 6 klasash, me nje sipërfaqe prej 1,310 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 7,898 m2. **Tipi 3** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat rurale me 20 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,041 m2. **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4001 m2.

Nga analiza sasiore e kryer dhe e shpjeguar më sipër për Lotin 1 janë gjithsej 5 shkolla, nga të cilat 1 shkolla nga Tipi 1, 2 shkolla nga Tipi 2 dhe 2 shkolla të mesme nga tipi 4. Përkatësisht këto shkolla do të ndërtohen në njësitë administrative dhe me të dhënat si më poshtë:

Tabela 85 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 1

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkolli	nxënës për klasë	Nxënës për shkolle	Sipërfaqe totale shkolla	Klasa kopësh ti	Nxënës për klasë kopështi	nxënës për kopësht	Sipërfaqe totale kopësht	Siperfaqe totale ndertimi
1	NJA 09	TIPI 1	9-vjeçar	20	30	600	4,938	4	24	96	874	5,812
2	NJA 09	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	-	-	-	-	4,001
3	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
4	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
5	NJA 11	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	-	-	-	-	4,001
Totali				122		3,660	26,115	16	72	384	3,494	29,609

Duke i permbledhur sipas tipologjisë së shkollave, në total kemi këto të dhëna operacionale:

Tabela 86 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 1

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Nr nxënës për klasë	Nxënës për shkollë	Nr klasa kopështi për shkollë	Nr nxënës për klasë kopështi	Nxënës për kopësht	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Total Nxënës në shkolla	Total Nxënës në Kopështe	Nr Total i nxënësve
TIPI 1	1	20	30	600	4	24	96	4,938	874	5,812	600	96	696
Tipi 2	2	30	30	900	12	24	144	13,176	2,620	15,796	1,800	288	2,088
Tipi 4	2	21	30	630	-	-	-	8,001	-	8,001	1,260	-	1,260
Grand To	**5**	**71**				**48**	**240**	**26,115**	**3,494**	**29,609**	**3,660**	**384**	**4,044**

Për të analizuar sa më mirë vlerën e parasë së projektit, kemi bërë grupimin e shpenzimeve në 4 kategori kryesore, duke u bazuar dhe në standartet e kontabilitetit si dhe në kërkesat e VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, paragrafi 3-6:

Kostot e drejtpërdrejta të investimeve;

Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes;

Për efekt të analizave të mëposhtme të gjitha çmimet dhe vlerat do të jenë pa TVSH, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Open Procurement

1.3.1 Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Gjatë analizës dhe në përputhje dhe me VKM të sipërcituar, u identifikuan këto kosto të drejtëpërdrejta të investimeve:

9. Kosto e Shpronësimit të Truallit;
10. Kosto e Ndërtimit;
11. Kosto e Studim Projektimit;
12. Kosto e Supervizimit;
13. Kosto e Kolaudimit;
14. Oponenca teknike;
15. Kosto për Mobilje dhe Orendi;
16. Kosto e pajisjeve të laboratorëve.

1.3.1.1.Kosto e Shpronësimit të Truallit

bela 87 Tabelë përmbledhëse e shpronësimeve për Lotin 1

Nga përcaktimi i gjurmës se ku do të ndërtohen këto shkolla, ka rezultuar se do të shpronësohen në nga privatët në total 10,341 m2, të cilat sipas përllogaritjeve nga të bëra, parashikohet që në total vlera e shpronësimit të shkojë në 252,915,927 lekë. Nga ana tjetër, për tokën shtet, do të ndiqen procedurat përkatëse për të marrë nën administrim pronat përkatëse.

Me daljen e VKM për këtë qëllim dhe plotësimin e dokumentave financiarë dhe ligjorë në përputhje me VKM dhe me aktet normative në fuqi, çdo i shpronësuar do të likujdohet nga Bashkia Tiranë me anë të fondit që do të përcaktohet për këtë qëllim.

Nr rendor i tabeles	Adresa	Tipi	Sheshi	Shpronesimi ne Vlere	Siperfaqje ne m2 te shpronesuar	Cmimi mesatar per m2
1	NJA 09	TIPI 1	9/1	23,404,716	687	34,068
2	NJA 09	Tipi 4	9/1	23,404,716	687	34,068
4	NJA 11	Tipi 2	11/1	103,053,248	4,484	22,985
5	NJA 11	Tipi 4	11/1	103,053,248	4,484	22,985
Grand Total				**252,915,927**	**10,341**	**24,458**

1.3.1.2.Kostot e Ndërtimit

Procurement Albania

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 228,785,770 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 276,314,618 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 305,233,020 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 71,238,892 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 376,471,912 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 187,207,732 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 234,736,581 lekë.

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë dhe këto shkolla nuk kanë ambjente kopështi.

Tabela 88 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 1

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopështi për shkollë	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
TIPI 1	1	20	4	4,938	874	5,812	46,332	54,381	228,785,770	47,528,848	276,314,618	276,314,618
Tipi 2	2	30	6	13,176	2,620	15,796	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	752,943,823
Tipi 4	2	21	-	8,001	-	8,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	370,699,665
Grand To	**5**	**71**	**10**	**26,115**	**3,494**	**29,609**	**138,995**	**163,143**	**719,368,623**	**118,767,740**	**838,136,363**	**1,399,958,107**

Në total, do të ndërtohen 1 shkolla të tipit 1 me kosto ndërtimi 276,414,618 lekë për shkollë, 2 shkolla të tipit 2 me kosto ndërtimi 376,471,912 lekë për shkollë dhe 2 shkolla të tipit 4 me kosto ndërtimi 185,349,833 lekë për shkollë. Rrjedhimisht, kostoja total e ndërtimit për Lotin 1 shkon në 1,399,958,107 lekë. Kjo është një kosto që do të mbulohet nga koncensionari.

1.3.1.3. Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit

Open Procurement Albania

Bazuar dhe në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostot e tjera direkte të investimit janë:

- Studim projektimi;
- Mbikqyrja e punimeve;
- Kolaudimi;
- Oponenca teknike;
- Mbrojtja ndaj zjarrit;
- Leja mjedisore;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Duke marrë parasysh të dhënat e analizuara në kapitullin respektiv mbi kostot, rezulton se kostot e tjera të drejtpërdrejta të investimit janë si më poshtë vijon:

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Kosto Studim Projektim	Kosto Mbikqyrje	Kosto kolaudimi	Oponenca teknike	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
TIPI 1	1	5,812	4,481,127	3,140,921	110,526	223,183	50,000	30,000
Tipi 2	2	15,796	20,220,768	8,355,808	301,178	501,350	100,000	60,000
Tipi 4	2	8,001	10,691,738	4,364,479	153,710	369,692	100,000	60,000
Grand To	**5**	**29,609**	**35,393,633**	**15,861,208**	**565,414**	**1,094,225**	**250,000**	**150,000**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0.

1.3.1.4.Kosto e mobilimit

Për të vënë në përdorim shkollat, nevojitet pajisja e secilës prej tyre me, pajisjet e nevojshme IT si edhe laboratoret e nevojshme. Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24,167 lekë. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tabela 90 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit

Tipi shkollës	Nr. klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

Në koston e mobilimit për arsimin bazik janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve

Open Procurement Albania

për fëmijë është rreth 27,916 lek. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 91 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmijë	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana juaj, kontratë blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 92 Kosto për pajisjen e Laboratorëve

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator
1	Laborator Shkencat natyrore	186,998
2	Laborator Kimie	223,125
3	Laborator Fizike	1,183,602
4	Laborator Biologjie	632,467
5	Laborator IT	3,869,658
II	Shkolla e Mesme	-
1	Laborator Kimie	528,469
2	Laborator Fizike	1,294,500
3	Laborator Biologjie	651,657
4	Laborator IT	3,869,658

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tabela 93 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	**Arsimi Bazik (Tipi 1)**	6,095,850
2	**Arsimi Bazik (Tipi 2)**	7,279,450
3	**Arsimi Bazik (Tipi 3)**	5,743,950
4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e 5 shkollave është 147,790,883 lekë pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 94 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 1

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Kosto e mobilimit te shkollave	Kosto e mobilimit të kopështeve	Total Kosto Mobilimi	Kosto Laboratori	Total kosto pajisje, mobilje dhe orendi
TIPI 1	1	14,500,000	2,680,000	17,180,000	6,095,850	23,275,850
Tipi 2	2	43,500,000	8,040,000	51,540,000	14,558,900	66,098,900
Tipi 4	2	30,450,000	-	30,450,000	27,966,133	58,416,133
Grand To	**5**	**88,450,000**	**10,720,000**	**99,170,000**	**48,620,883**	**147,790,883**

1.3.1.5.Kosto direkte e Investimit

Në përfundim, kosto direkte e investimit të këtij projekti është **1,853,979,397 lekë**. Nga këto, **252,915,927** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga konçesionari është **1,601,063,470** lekë, ku kosto e ndërtimit është **1,399,958,107** lekë pa TVSH, Kosto e Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **201,105,364** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Tabela 95 Kosto direkte investimi për Lotin 1

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,853,979,397**
A.1	**Kostot e Truallit**	**252,915,927**
A.2	Kostot e Projektimit	35,393,633
A.3	- Ndertim + instalime	1,399,958,107
A.4	- Oponenca teknike	1,094,225
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	150,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	250,000
A.8	- Kosto Supervizimi	15,861,208
A.9	- Kosto Kolaudimi	565,414
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	99,170,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	48,620,883

Tabela 96 Kosto vjetore mirëmbajtje për shkollat e Lotit 1

1.3.2 Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Bazuar dhe nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose 351,755 lekë pa TVSH. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 8,442,132 lekë për një shkollë të tipit 1, 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat për Lotin 1 është **48,542,258** lekë në vit. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Për më shumë detaje, shih tabelat më poshtë.

Open Procurement Albania

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtjes për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
TIPI 1	1	8,442,132	8,442,132
Tipi 2	2	12,663,198	25,326,396
Tipi 4	2	7,386,865	14,773,731
Grand Total	**5**	**9,708,452**	**48,542,258**

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë **339,795,806** lekë pa tvsh. Nga të cilat, **223,727,721** lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve, dhe **116,068,085** lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një viti pa TVSH.

B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**339,795,806**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**223,727,721**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	51,729,846
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve	130,706,051
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi	16,362,801
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)	24,929,023
B.2	**Staf Mirembajtje**	**116,068,085**
B.2.1	Staf Roje	17,073,463
B.2.2	Staf Sanitare	73,680,257
B.2.3	Staf Sekretare	14,757,736

Open Procurement Albania

Tabela 98 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 1

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	Lyerje per klase	Riparim suvatim + hidroizolim per klase	Riparime dhe mirembajtje e Nderteses	Riparime Orendi shkollore	Riparime Pajisje PC	Materiale Pastrimi	Lëndë djegëse për ngrohje dhe ujë të ngrohtë	Mirembajtje kondicionim, impiante uji dhe MNZSH	Sherbim roje	Sherbim pastrimi	Sherbim sekretarie	Total kosto mirembajtjeje
1	NJA 09	TIPI 1	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
2	NJA 09	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
3	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
4	NJA 11	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
5	NJA 11	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
Totali i Mirembajtjes				**138**	**3,158,970**	**3,239,972**	**991,036**	**2,337,543**	**3,561,289**	**1,168,550**	**11,538,582**	**5,965,161**	**3,947,156**	**10,525,751**	**2,108,248**	**48,542,258**

Open Procurement Albania

1.4. Analiza e të ardhurave të PPP

1.4.1 Tarifa e përdorimit të shkollave

Tarifa e përdorimit të shkollave (në vazhdim "Tarifa"), duhet të përllogaritet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulimin e kostove të koncensionarit si dhe të garantojë një marzh minimal fitimi për koncensionarin, në mënyrë që nga njëra anë kjo PPP të jetë atraktive dhe njëkohësisht të jetë dhe zgjidhja më e mire ekonomike krahasuar me skenarë të tjerë të mundshëm. Tarifa paguhet për gjithë periudhën e mirëmbajtjes dhe administrimit të shkollave nga ana e koncensionarit, pra për 7 vite. Kjo tarifë në vetvete paguhet çdo vit nga Bashkia Tiranë përmes burimeve të financimit të detajuara si më poshtë. Përmes kësaj skeme, jo vetëm që sigurohet ndërtimi i 17 shkollave në kohë rekord, duke zgjidhur minimalisht çështjen e arsimimit me turne, dhe mbipopullimit të klasave, por duke qënë se të gjitha risqet për mirembajtjen dhe përdorimin me kujdes të asetit do të jenë në ngarkim të koncensionarit, dhe të lidhura dhe me pagesat, kjo do të bëjë që të kemi ndërtime cilësore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk përllogaritet marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se koncesionari vlerat e investuara për këtë qëllim, do të mbulohet në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë, si dhe për pjesën e mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme për këtë periudhë.

Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse[42], përkatësisht rezultet e obligacioneve 7 vjecare nga viti 2015 deri në 15.09.2016.

Tabela 99 Marzhi i fitimit

ISIN	Dt.Ankandi	Ankandi	Muaji	*Datë Emetimi*	*Datë Maturimi*	Shuma e shpallur (fillestare)	*Shuma e shpallur (nd. strukture)*	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Prorata Konkurues	Prorata Jo Konkuruese	Yieldi Uniform i Pranuar
AL0017NF7Y23	13.09.2016	*7vjeçar/7years(fix)*	*Shtator*	15.09.2016	15.09.2023	*3,000,000*		*2,309,000*	*2,309,000*			*4.89%*
AL0016NF7Y23	01.06.2016	*7vjeçar/7years(fix)Rihapje*	*Qershor*	03.06.2016	16.03.2023	*2,000,000*		*3,141,400*	*2,000,000*	*4.40%*		*4.00%*
AL0016NF7Y23	11.03.2016	*7vjeçar/7years(fix)*	*Mars*	16.03.2016	16.03.2023	*3,000,000*		*8,247,000*	*2,999,900*	*76.48%*		*4.90%*
AL0015NF7Y22	14.12.2015	*7vjeçar-fiks*	*Dhjetor*	16.12.2015	16.12.2022	*2,500,000*		*5,288,600*	*2,500,000*	*67.70%*	*100.00%*	*6.79%*
AL0014NF7Y22	14.09.2015	*7vjeçar-fiks*	*Shtator*	16.09.2015	16.09.2022	*1,000,000*		*1,430,600*	*1,000,000*	*100.00%*	*100.00%*	*7.78%*
AL0013NF7Y22	12.06.2015	*7vjeçar-fiks*	*Qershor*	16.06.2015	16.06.2022	*3,000,000*		*2,953,500*	*2,953,500*	*100.00%*	*100.00%*	*7.80%*
AL0012NF7Y22	12.03.2015	*7vjeçar-fiks*	*Mars*	16.03.2015	16.03.2022	*2,500,000*		*2,815,800*	*2,500,000*	*80.98%*	*77.92%*	*7.81%*
										Yieldi Mesatar i pranuar		**6.28%**

Marzhi i fitimit do të jetë objekt tenderimi i konkurentëve në këtë PPP, por ndërkohë është i domosdoshëm për të kuptuar sa do të jetë vlera e përgjithshme e kësaj PPP. Marzhi i fitimit, do të llogaritet, për vlerën e mbetur të investimit direkt çdo vit, dhe mbi kostot

[42] http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise/rezultatet-e-ankandeve/2016

vjetore të mirëmbatjes. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, sigurohet që skema e financimit të jetë atraktive për konkurentët e mundshëm, dhe, nga ana tjetër, kosto totale e projektit të mos dalë më e lartë sesa mënyrat tradicionale të financimit.

Bazuar në përllogaritjet e kryera, tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit me marzhin prej 6.28% do të ishte si më poshtë:

Tabela 100 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 1

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,601,063,470										
2	1	1,601,063,470	6.28%	228,723,353	1,372,340,118	100,546,786	329,270,139	48,542,258	3,048,454	51,590,712	103,595,240	**380,860,851**
3	2	1,372,340,118	6.28%	228,723,353	1,143,616,765	86,182,959	314,906,312	48,542,258	3,048,454	51,590,712	89,231,413	**366,497,024**
4	3	1,143,616,765	6.28%	228,723,353	914,893,412	71,819,133	300,542,486	48,542,258	3,048,454	51,590,712	74,867,587	**352,133,198**
5	4	914,893,412	6.28%	228,723,353	686,170,059	57,455,306	286,178,659	48,542,258	3,048,454	51,590,712	60,503,760	**337,769,371**
6	5	686,170,059	6.28%	228,723,353	457,446,706	43,091,480	271,814,833	48,542,258	3,048,454	51,590,712	46,139,933	**323,405,544**
7	6	457,446,706	6.28%	228,723,353	228,723,353	28,727,653	257,451,006	48,542,258	3,048,454	51,590,712	31,776,107	**309,041,718**
8	7	228,723,353	6.28%	228,723,353	(0)	14,363,827	243,087,179	48,542,258	3,048,454	51,590,712	17,412,280	**294,677,891**
Grand total				**1,601,063,470**		**402,187,144**	**2,003,250,614**	**339,795,806**	**21,339,177**	**361,134,983**	**423,526,320**	**2,364,385,597**

Procurement Albania

Pra gjatë shtatë viteve Bashkia Tiranë Do ti paguajë Koncensionarit, tarifat vjetore jo më shumë se:

Nr rendor	Viti	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	
2	1	**380,860,851**
3	2	**366,497,024**
4	3	**352,133,198**
5	4	**337,769,371**
6	5	**323,405,544**
7	6	**309,041,718**
8	7	**294,677,891**
Grand total		**2,364,385,597**

Open Procurement Albania

1.4.1 Burimi i Financimit.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti për Lotin 1 është **2,617,301,524** lekë nga të cilat, **252,915,927** janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe **2,364,385,597** lekë është vlera e koncensionit:

Tabela 101 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 1

Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
Kostoja e përgjithshme e shpronësimit	**252,915,927**	**1**	**252,915,927**
Kosto direkte e Investimit pa TVSH	**1,601,063,470**	**1**	**1,601,063,470**
Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,601,063,470	1	1,601,063,470
Kosto e mirembajtjes pa TVSH	**48,542,258**	**7**	**339,795,806**
Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	48,542,258	7	339,795,806
Marzhi i Fitimit	**423,526,320**	**1**	**423,526,320**
Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	423,526,320	1	423,526,320
Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4+5)			**2,617,301,524**

Tabela 102 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	252,915,927	2,364,385,597	2,617,301,524
Totali	**252,915,927**	**2,364,385,597**	**2,617,301,524**

Open Procurement Albania

Këto shpenzime do të mbulohen përmes të ardhurave të Bashkisë, dhe Granteve të Kushtëzuara që Ministria financave do të japë për këtë projekt.

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për këtë projekt, do të gjenerohen nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila është vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për qytetin e Tiranës".

Tabela 103 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore

E m ë r t i m i	PLANI VITI 2016	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018
Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	**870 000 000**	**940 000 000**	**1 000 000 000**
Familjarët	320 000 000	340 000 000	350 000 000
Subjektet Tregtare	550 000 000	600 000 000	650 000 000

Të ardhurat nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore janë planifikuar të jenë 870 milionë lekë në vitin 2016, ndërkohë që këto të ardhura parashikohet të rriten në 940 milionë lekë në vitin 2017 dhe 1 miliard lekë në vitin 2018. Kjo taksë e përkohëshme është vendosur për një periudhë 7 vjeçare dhe për vitet 2019-2022, të ardhurat vjetore parashikohet të jenë rreth 1 miliard lek. Të ardhurat nga transferta specifike nga Ministria e Financave do të jenë në masën 700 milionë lek në vit. Në këtë mënyrë, fondi në dispozicion të Bashkisë Tiranë për kryerjen e pagesave periodike parashikohet të jetë rreth 1 miliard e 700 milion lekë në vit.

Open Procurement Albania

1.5.Analiza Financiare

Tabela 104 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,853,979,397**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**1,853,979,397**
A.1	**Kostot e Truallit**	**252,915,927**								**252,915,927**
A.2	Kostot e Projektimit	35,393,633								35,393,633
A.3	- Ndertim + instalime	1,399,958,107	-							1,399,958,107
A.4	- Oponenca teknike	1,094,225								1,094,225
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	150,000								150,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	250,000								250,000
A.8	- Kosto Supervizimi	15,861,208								15,861,208
A.9	- Kosto Kolaudimi	565,414								565,414
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	99,170,000	-	-	-	-	-	-	-	99,170,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	48,620,883								48,620,883
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**339,795,806**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**31,961,103**	**31,961,103**	**31,961,103**	**31,961,103**	**31,961,103**	**31,961,103**	**31,961,103**	**223,727,721**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	7,389,978	7,389,978	7,389,978	7,389,978	7,389,978	7,389,978	7,389,978	51,729,846
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		18,672,293	18,672,293	18,672,293	18,672,293	18,672,293	18,672,293	18,672,293	130,706,051
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		2,337,543	2,337,543	2,337,543	2,337,543	2,337,543	2,337,543	2,337,543	16,362,801
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		3,561,289	3,561,289	3,561,289	3,561,289	3,561,289	3,561,289	3,561,289	24,929,023
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**16,581,155**	**16,581,155**	**16,581,155**	**16,581,155**	**16,581,155**	**16,581,155**	**16,581,155**	**116,068,085**
B.2.1	Staf Roje		3,947,156	3,289,297	2,741,081	2,284,234	1,903,528	1,586,273	1,321,895	17,073,463
B.2.2	Staf Sanitare		10,525,751	10,525,751	10,525,751	10,525,751	10,525,751	10,525,751	10,525,751	73,680,257
B.2.3	Staf Sekretare		2,108,248	2,108,248	2,108,248	2,108,248	2,108,248	2,108,248	2,108,248	14,757,736
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**1,853,979,397**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**48,542,258**	**2,193,775,203**

C.	**Të Adhurat**	**252,915,927**	**380,860,851**	**366,497,024**	**352,133,198**	**337,769,371**	**323,405,544**	**309,041,718**	**294,677,891**	**2,617,301,524**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	252,915,927								**252,915,927**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		380,860,851	366,497,024	352,133,198	337,769,371	323,405,544	309,041,718	294,677,891	**2,364,385,597**
D	**Fitimi (humbja)**	(1,601,063,470)	332,318,593	317,954,766	303,590,940	289,227,113	274,863,286	260,499,460	246,135,633	**423,526,320**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(1,601,063,470)	(1,268,744,878)	(950,790,112)	(647,199,172)	(357,972,059)	(83,108,773)	177,390,687	423,526,320	**423,526,320**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(26,608,603)	(36,920,345)	**(63,528,948)**

Open Procurement Albania

Tabela 105 Fluksi i arkës së projektit

Fluksi i Arkës									
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Flukse dalese nga Investimet	- 1,853,979,397	-	-	-	-	-	-	-	- 1,853,979,397
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	-	- 48,542,258	- 48,542,258	- 48,542,258	- 48,542,258	- 48,542,258	- 48,542,258	- 48,542,258	- 339,795,806
Flukse dalese nga Taksat	-	-	-	-	-	-	- 26,608,603	- 36,920,345	- 63,528,948
Totali i flukseve dalese	**-1,853,979,397**	**- 48,542,258**	**- 48,542,258**	**- 48,542,258**	**- 48,542,258**	**- 48,542,258**	**- 75,150,861**	**- 85,462,603**	**- 2,257,304,151**
Flukse hyrese nga Operimet	**252,915,927**	**380,860,851**	**366,497,024**	**352,133,198**	**337,769,371**	**323,405,544**	**309,041,718**	**294,677,891**	**2,617,301,524**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,601,063,470**	**332,318,593**	**317,954,766**	**303,590,940**	**289,227,113**	**274,863,286**	**233,890,857**	**209,215,288**	**359,997,372**
Gjendja e arkes progresive	**-1,601,063,470**	**- 1,268,744,878**	**- 950,790,112**	**- 647,199,172**	**- 357,972,059**	**- 83,108,773**	**150,782,084**	**359,997,372**	**359,997,372**

1.6.Realizueshmëria Ekonomike e Projektit

1.6.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto)

NPV, si metoda standarte për vlerësimin e projekteve afatgjata përmes analizës së vlerës në kohë të parasë, paraqet shumën e fluksit të arkës së projektit (Cash Floë) të skontuar. Çdo investues, kur vendos ndërmarrjen e një investimi analizon të ardhurat e gjeneruara nga projekti krahasuar më të ardhurat e mundshme nëse paratë e investuara do të përdoreshin në një tjetër mënyrë. Përgjithësisht, këto analiza kryhen duke marrë për bazë normën e interesit në rast të investimit të parave, për shembull, në bono thesari apo obligacione qeveritare, të cilat kanë risk thuajse zero.

Formula klasike për llogaritjen e NPV-së, nëse investimi bëhet brenda një viti, është:

$$NPV = \sum_{t=1}^{T} \frac{C_t}{(1+r)^t} - C_0$$

ku:

C_0 - përfaqëson paranë e shpenëzuar për kryerjen e investimit fillestar;

C_t – përfaqëson të ardhurat nga investimi i kryer;

t – përfaqëson kohëzgjatjen e projektit;

r – përfaqëson normën e pritshme të skontimit.

Open Procurement Albania

Për të parë realizueshmërinë ekonomike të projektit, është testuar modeli financiar me disa norma të mundëshme skontimi. Nga kjo analizë, ka rezultuar se konçensionarët e mundshëm do të kenë interes në këtë projekt vetëm në rast se kosto e tyre oportune është më e ulët se 5.79%. Me fjalë të tjera, për çdo normë skontimi mbi 5.79% ky projekt nuk paraqet leverdisshmëri ekonomike nga ana e koncensionarit.

	NPV						
norma e skontimit e parashikuar	**5%**		**5.79%**		**6%**		**7%**
NPV	**40,577,941**	**-**	**99,745**	**-**	**10,531,326**	**-**	**58,118,576**

1.6.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit)

IRR-ja është një metodë që përdoret për të matur fitimin e investimeve të mundshme. IRR-ja është një normë skontimi që e bën vlerën aktuale neto (NPV) të të gjithë fluksit të arkës (cash floë) të një projekti të barabartë me zero. Sipas teorisë ekonomike, çdo projekt me një IRR më të madhe se kosto e tij kapitale është fitimprurës, e rrjedhimisht investitorët kanë interes të investojnë në të. Në bazë të analizës financiare, IRR-ja e këtij projekti është në masën 5.79%.

Tabela 106 Norma e brendshme e kthimit e projektit

				IRR					
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,601,063,470**	**332,318,593**	**317,954,766**	**303,590,940**	**289,227,113**	**274,863,286**	**233,890,857**	**209,215,288**	**359,997,372**
IRR	**5.79%**								

1.6.3. Periudha e Vetëshlyerjes

Periudha e vetëshlyerjes paraqet kohën që nevojitet në mënyrë që një kapitali i investuar të kompensohet nga të ardhurat nga projekti. Përgjithësisht, periudha e vetëshlyerjes llogaritet duke pjesëtuar koston e investimit me të ardhurat vjetore. Por, duke qenë se në këtë projekt të ardhurat vjetore përbëhën nga këste zbritëse, periudha e vetëshlyerjes është vlerësuar duke analizuar fluksin e arkës për të përcaktuar vitin e fundit në të cilën ky fluks është negativ.

Open Procurement Albania

Periudha e Vetëshlyerjes		
Viti i fundit i gjendjes se arkes negative		5
Gjendja e arkes kumulative ne vitin e fundit negativ	-	83,108,773
Gjendja e arkes pozitive krijuar ne vitin vijues		233,890,857
PBP (periudha e veteshlyerjes)		5.36

Nga sa u përshkrua më sipër, periudha e vetëshlyerjes për këtë projekt arrihet në 5.36 vite. Megjithatë, duke parë që pagesat nga ana e Bashkisë Tiranë do të jenë vjetore, atëherë periudha e vetëshlyerjes nuk do të jetë 5.36 vite, por do të jetë 6 vite.

1.6.4. Përshtatshmëria financiare

Sipas VKM nr, 575, datë 10.07.2013, neni 7, pika 10, përshtatmëria financiare e një projekti "tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar."

Në bazë të analizës financiare të mësipërme, ky projekt është ekonomikisht i realizueshëm dhe kjo realizueshmëri, në mënyrë të thuket, jepet nga vlerat e mëposhtme:

- NPV = 5.79% > 0
- IRR = 5.79% > se interesi i depozitave apo bonove të thesarit
- PBP = 6 vite < 7 vite (kohëzgjatja e konçensionit)

Open Procurement Albania

1.7.Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve

Analiza e risqeve ka si synim parësor të saj identifkimin dhe vlerësimin e gamës së risqeve që mund të ndikojnë projektin. Në këtë mënyrë, zhvillohet një strategji për menaxhimin e riskut në mënyrë që të garantohet realizimi i projektit me sukses. Në përputhje me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", më poshtë vijon një analizë e risqeve që prekin këtë projekt.

1.7.1. Analiza cilësore e risqeve

Risku i trojeve

Përshkrimi i riskut: Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e 17 shkollave do të jenë kryesisht me pronësi shtet, ndërsa trojet në pronësi private do të shpronësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pastaj do të vihen në dispozicion të koncensionarit. Rrjedhimisht, ky risk ka probablitet të ulët, thuajse zero, për të ndikuar mbi projektin. Përsa u përket lejeve të nevojshme, ky risk nuk ekziston pasi Bashkia Tiranë është vetë organi përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve. Së fundi, përsa u përket standarteve mjedisore, trojet e përzgjedhura janë parcela në ndodhura në zona ku nuk ndikohet asnjë standart mjedisor, ndaj edhe ky risk vlerësohet zero.

Menaxhimi i riskut: Ky risk vlerësohet me probabilitet zero dhe cilësohet si risk i mbajtur nga Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë do të kryejë të gjitha procedurat për shpronësimin e trojeve private jashtë kësaj skeme PPP-je dhe përpara kohës së përcaktuar për nisjen e punimeve. Në rast se ndonjë prej trojeve të përzgjedhura do të ketë konflikt pronësie çka do ta bënte shpronësimin të pamundur, pranë ZRPP është kërkuar informacion edhe për sheshe alternative, të cilat mund të përdoren. Përsa u përket kushteve gjeologjike dhe standarteve mjedisore, është kryer një studim mjedisor që është pjesë e këtij studimi fizibiliteti, i cili ka arritur në përfundimin se me ndërtimin e këtyre objekteve nuk preket asnjë standart mjedisor. Për më tepër, gjatë marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet edhe një studim mjedisor më i detajuar nga ana e koncensionarit.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë

Përshkrimi i riskut: Kostimi i ndërtimit dhe mobilimit të shkollave të reja është bazuar në një metodologji të shpjeguar gjërësisht më sipër, e cila merr për bazë koston e shkollave të ndërtuara nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit. Kësisoj, mundësia që kosto e ndërtimit të jetë më e lartë sesa kostoja e përllogaritur është thuajse zero. Ndërtimi dhe vënia në punë e shkollave varen në një shkallë të caktuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe plotësimi i parakushteve për marrjen e kësaj lejeje, si leja mjedisore, lidhja me rrjetin elektrik apo ujësjellësin, miratimi i projekteve për mbrojtjen nga zjarri, etj. Koncensionari ka detyrën të bëjë projektimin, të përgatisë dokumentacionin për pajisje me leje ndërtimi si edhe të ndërtojë objektet shkollore. Nga ky prizëm, risku i vonesave në paisje me leje ndërtimi, i vonesave në nisjen e punimeve e, rrjedhimishit, i vënies në punë është i mundshëm.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi koncensionarin. Koncensionari ka detyrimin të përgatisë dokumentat dhe të pajiset me leje ndërtimi. Në rast se koncensionari nuk do të përgatisë projektin në kohë, do të neglizhojë aplikimin për leje ndërtimi duke mos aplikuar në kohë apo duke pasur mangësi në dokumentacion apo nuk do t'i kryejë punimet në kohë, atëherë ai do të mbajë përgjegjësi për mos nisjen e punimeve në afat dhe do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve që do të bëhën në kontratën koncensionare. Gjithashtu, meqenëse koncensionari është përgjegjës si për hartimin ashtu edhe për zbatimin e projektit, çdo vonesë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa vjen si rezultat i forcës madhore, do të jetë përgjegjësi e tij për të cilën do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve në kontratën koncensionare.

Risku i funksionimit

Përshkrimi i riskut: Mundësia që shkollat e reja të mos funksionojnë pasi të jenë ndërtuar lidhet me kryerjen e punimeve jo cilësore nga ana e koncensionarit, çka do ta bënte zhvillimin e mësimit në godinat e reja të pamundur. Ky risk ka probabilitet të ulët pasi kryerja e punimeve do të mbikqyret nga mbikqyrësi teknik dhe situacionet financiare do të mbikqyren nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket riskut që kostoja e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa pritej, probabiliteti është thuajse zero, pasi kostoja vjetore e mirëmbajtjes është llogaritur duke u bazuar në shpenzimet vjetore të Bashkisë Tiranë për mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, të cilat janë ndërtuar para shumë viteve. Sipas standarteve inxhinierike, kostoja e mirëmbajtjes së objekteve të sapondëruara është me e ulët se ajo e objekteve të ndërtuara kohë më parë.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtij risku është i ulët dhe ai cilësohet si një risk i transferuar tek koncensionari. Në rast se cilësia e ndërtimit do të jetë e tillë që do ta bëjë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të mbajë përgjegjësi dhe do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë derisa cilësia e punimeve të jetë në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Në rast se, për shkak të punimeve të kryera gjatë ndërtimit, gjatë peiudhës 7 vjeçare të zgjatjes së kontratës, godinat shkollore do të shfaqin probleme që do ta bëjnë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë për ta bërë shkollën sërish funksionale. Në rast se kostoja e mirëmbajtjes do të rezultojë më e lartë se parashikimi, kjo do të vijë si pasojë e pasaktësive në projektim ose ndërtim. Rrjedhimisht, risku bie mbi konçensionarin, i cili ka përgjegjësinë të projektojë dhe ndërtojë shkollat.

Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare

Përshkrimi i riskut: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej apo të ardhurat e gjeneruara janë më të ulëta se sa parashikimi. Duke qenë se objektet që do të ndërtohen janë godina shkollore të cilat nuk mund të kenë përdorim të ndryshëm e nuk mund të gjenerojnë të ardhura, ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin në fjalë.

Menaxhimi i riskut: Mundësia që projekti të ndikohet nga ky risk është zero pasi ai nuk aplikohet mbi të.

Risqet ekonomike dhe financiare

Përshkrimi i riskut: Meqenëse ky projekt përfshin transaksione financiare të shtrira në kohë, ekziston mundësia që ai të ndikohet nga risqet ekonomike e financiare. Rritja e paparashikuar e normave të interesit mund të rrisë kostot e financimit të projektit nga ana e koncensionarit. Nga ana tjetër, ndryshimet në kursin e këmbimit valutor mund të kënë ndikim përkeqësues në financat e koncencionarit në rast se të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë në monedha të ndryshme, për shembull koncensionari ka marrë kredi në Euro apo Dollarë për financimin e projektit, ndërkohë që Bashkia e Tiranë ia kryen pagesat vjetore në Lekë. Së fundi, duke qenë se ky

Open Procurement Albania

projekt përfshin pagesa periodike për një periudhë 7 vjeçare, ekziston mundësia që të ardhurat e koncensionarit të preken nga inflacioni.

Menaxhimi i riskut: Duke qenë se Shqipëria konsiderohet një vend me një situatë makroekonomike të qendrueshme, probabiliteti që projekti të ndikohet nga ky risk mbetet i ulët. Risku i normave të interesit apo i normave të këmbimit valutor është një risk që bie mbi konçensionarin dhe duhet të llogariten në parashikimet e tij financiare. Risku i inflacionit është një risk që ndahet mes Bashkisë Tiranë dhe konçensionarit. Meqenë se politika e Bankës së Shqipërisë është mbajtja e inflacionit nën 3% dhe kohëzgjatja e projektit është vetëm 7 vjet, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, në përcaktimin e marzhit të fitimit si të lidhur me normën e interesit për obligacionet 7 vjeçare, Bashkia e Tiranës garanton për konçensionarin të njëjtën mbrojtje ndaj risqeve ekonomike e financiare që garanton edhe Qeveria e Shqipërisë për blerësit e obligacioneve.

Risqet e pronësisë së aseteve

Përshkrimi i riskut: Ky riskt lidhet me mundësinë që teknologjia të vjetërohet apo që vlera e aseteve të jetë e ndryshme në fund të kontratës. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtim godinash shkollore, të cilat do të mirëmbahen nga konçensionari për një periudhë 7 vjeçare, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të mirëmbajtjes jo cilësore, në fund të kontratës cilësia dhe vlera e aseteve të jetë më e ulët nga parashikimi.

Menaxhimi i riskut: Ky risk transferohet te konçensionari. Mirëmbajtja e godinave shkollore dhe mobiljeve e pajisjeve të tyre do të bëhet në përputhje me standartet në fuqi dhe do të mbikqyret nga autoriteti kontraktor. Në rast se konçensionari nuk do t'i mirëmbajë shkollat sipas përcaktimit të mësipërm, në kontratën e konçensionit do të parashikohen dispozita që e detyrojnë atë të shlyejë dëmin e shkaktuar. Në rast se në fund të kontratës, vlera e aseteve do të jetë e ndryshme nga sa është dakordësuar, në kontratën e koncensionit do të përcaktohen dispozita që do të detyrojnë koncensionarin të shlyjë dëmin.

Risku politik

Përshkrimi i riskut: Risku që vendimet politike të ndikojnë mbi projektin është evident. Duke qenë një projekt i nisur nga Bashkia e Tiranës, një organ i qeverisjes lokale, suksesi i këtij projekti varet nga dakordësia me qeverisjen qendrore. Gjithashtu, ekziston mundësia që si rezultat i zgjedhjeve lokale të ardhshme, një ndryshim i mundshëm në kreun e Bashkisë Tiranë mund të sjellë ndryshimin e prioriteteve, e për rrjedhojë bllokimin e projektit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi autoritetin kontraktor, Bashkinë Tiranë. Për të siguruar dakordësinë e institucioneve të qeverisjes qendrore, me miratimin e studimit të fizibilitetit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të kërkohet edhe miratimi nga Ministria e

Open Procurement Albania

Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket riskut të ndikimit negativ të projektit si rezultat i ndryshimeve në drejtimin e Bashkisë Tiranë, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që pengojnë prishjen e kontratës për arsye jo të ligjshme nga ana e autoritetit kontraktor.

Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor

Përshkrimi i riskut: Ndryshimet e mundshme në kuadrin legjislativ mund ta ndikojnë projektin si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Duke qenë se projekti lidhet me ndërtimin e godinave shkollore, mundësia që ai të afektohet nga ndryshimet ligjore lidhet vetëm me standartet dhe manualet e ndërtimit. Ndaj, ky risk ka një probabilitet të ulët që të ndodhë. Përsa u përket ndryshimeve të ligjeve fiskale, ndikimi negativ apo pozitiv ndjehet vetëm në financat e konçensionarit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Në mënyrë që efektet e tij të jenë sa më minimale, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që e mbrojnë atë nga ndryshimet diskriminuese në ligj – gjithmonë, nëse diskriminimi provohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, konçensionari do të jetë i detyruar të zbatojë çdo ndryshim ligjor që vjen si rezultat i politikave të qeverisë.

Risku i forcës madhore

Përshkrimi i riskut: Risqet e forcës madhore si fatkeqësitë natyrore, trazirat civile apo luftërat bien si mbi konçensionarin ashtu edhe mbi autoritetin kontraktor. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria është antare e NATO dhe me perspektivën e qartë të integrimit në BE, probabiliteti i risqeve si luftërat apo trazirat është thuajse zero. Nga ana tjetër, probabiliteti që projekti të ndikohet nga tërmetet apo fatkeqësitë e tjera natyrore ka gjithashtu pak gjasa që të ndodhë, siç ka rezultuar edhe nga analiza e mësipërme e ndikimit mjedisor të projektit.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtyre risqeve është shumë i ulët dhe bie mbi të dyja palët. Në kontratën konçensionare do të parashikohen klauzolat e forcës madhore të cilat do garantojnë që të çdo ndikim negativ mbi projektin të ndahet ndërmjet palëve.

1.7.2. Analiza sasiore e risqeve

Kjo analizë synon të prioritizojë risqet që mund të ndikojnë projektin duke përllogaritur probabilitetin e tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi arritjen e objektivave të projektit. Vlerësimi sasior është bazuar në probabilitetin e ndodhjes të secilit risk dhe në ndikimin e mundshëm mbi koston dhe afatet e projektit.

Open Procurement Albania

Ndikimi i risqeve mbi koston e projektit është llogaritur duke u bazuar mbi peshën specifike që zë secili prej tyre në koston e projektit. Ndërsa, ndikimi mbi afatin e përfundimit të punimeve është përllogaritur duke u bazuar në afatet ligjore për kryerjen e procedurave të caktuara që mund të nevojitet të ndiqen për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Më poshtë vijon një analizë sasiore mbi ndikimin që mund të ketë secili risk në koston dhe afatet e realizimit të projektit.

Risku i trojeve. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 0-5%. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është zero pasi shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për ndërtimin e shkollave do të kryhet nga Bashkia e Tiranës me një fond të veçantë jashtë skemës financiare të këtij projekti. Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e shkollave janë prona shtetërore dhe prona private. Në rast se përdorimi i ndonjërit prej këtyre trojeve është i pamundur, do të përdoret një prej trojeve alternative të përzgjedhura për të cilat është marrë informacion edhe pranë ZRPP. Rrjedhimisht, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve lidhet me marrjen në dorëzim të pronës shtet, në rast se nuk është pronë e Bashkisë Tiranë, ose shpronësimin e pronave private. Ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur 3 – 6 muaj.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 5-10%. Kostimi i ndërtimit të shkollave është bërë në përputhje me manualet udhëzuese të MAS dhe në bazë të kostove të ndërtimit të shkollave nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit dhe çmimet janë indeksuar sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit të INSTAT. Ndaj, ndikimi maksimal që ky risk të ketë në kosto është më i vogël se 5%. Nga ana tjetër, afati i punimeve mund të mos respektohet si rezultat i mos marrjes në kohë të lejes së ndërtimit apo lejeve të tjera nga ana e konçensionarit apo edhe nga kryerja e punimeve më ngadalë sesa është parashikuar në kalendarin e punimeve. Në rast se projektimi vonohet apo nuk plotësohet dokumentacioni për pajisjen me lejet e nevojshme, ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur nga 3 deri në 12 muaj.

Risku i funksionimit. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur nga 0-5%. Duke qenë se ky projekt lidhet me ndërtimin e shkollave të reja, ekziston mundësia që cilësia e ndërtimit të jetë e ulët, çka do të bënte që të kërkoheshin punime shtesë përtej afatit të përcaktuar. Ndikimi i këtij risku në afatin e punimeve është përllogaritur nga 1 deri në 3 muaj, ndërsa ndikimi mbi koston totale të projektit është përllogaritur 5-10%. Ekziston edhe mundësia që kosto e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa është përllogaritur, por krahasuar me koston totale të projektit ndikimi i kësaj kostoje është thuajse i papërfillshëm.

Risku i kërkesës dhe risqet e tjera tregtare. Ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin dhe munësia që ai të ndikojë koston apo afatet e realizimit të tij është zero.

Risqet ekonomike dhe financiare. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i ulët, 0-5%, duke marrë në konsideratë se nuk kemi të bëjmë me një konçension afat-gjatë ku konçensionari i nxjerr të ardhurat nga operimi i objektit të konçensionit. Duke qenë se të

Open Procurement Albania

ardhurat e konçensionarit janë të garantuara nga Bashkia Tiranë dhe të mbrojtura nga inflacioni, ndikimi i riskut mbi koston totale të projektit është i ulët, 5% - 10%. Nga ana tjetër, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve, nuk parashikohet më i lartë se 12 muaj.

Risqet e pronësisë së aseteve. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur 0 – 5%. Ndikimi i tij mbi koston totale të projektet lidhet me koston e mirëmbajtjes, në rast se kjo e fundit rezulton më e lartë se parashikimet dhe me amortizimin e godinave më shpejt se sa është parashikuar në kontratën e koncensionit. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është llogaritur të jetë maksimimumi 5%. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku nuk i ndikon aspak afatet e realizimit të punimeve.

Risku politik. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i mesëm i ulët dhe është llogaritur 10 -20%. Ndodhja e këtij risku mund të bllokojë punimet në mes ose mund të ndërpresë pagesat periodike për konçensionarin, duke rritur koston e financimit të projektit dhe duke vonuar realizimin e punimeve. Për këto arsye, ndikimi i mundshëm i këtij risku mbi kosto është përllogaritur 20 – 30% ndërsa ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve është përllogaritur nga 16 deri në 24 muaj.

Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor. Ky riskt ka një probabilitet ndodhjeje që varion nga 5 deri në 15%. Ndryshime të mundshme ligjore, si për shembull në standartet që duhet të ndjekë ndërtimi i shkollave të reja mund të rrisin ndjeshëm koston e projektit. Prandaj edhe impakti i mundshëm mbi kosto është llogaritur të jetë i mesëm, nga 20 deri në 40%. Gjithashtu, ndryshime të mundshme ligjore mund të çojnë në ribërjen e projekteve apo në vonesa të tjera, çka do të ndikonte negativitsh afatin e realizimit të punimeve. Ndaj, ndikimi mbi afatin e punimeve është llogaritur nga 12 deri në 16 muaj.

Risku i forcës madhore. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është shumë i ulët, nga 0 deri në 5%. Megjithatë, në rast të ndodhjes ndikimi mbi koston apo afatin e punimeve do të ishte i mesëm i lartë. Kësisoj, ndikimi mbi koston është përllogaritur nga 30% deri në 50% ndërsa ndikimi mbi afatin e punimeve nga 12 deri në 24 muaj.

Open Procurement Albania

Tabela 107 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve

Nr.	Risku	Probabiliteti i ndodhjes	Ndikmi mbi kosto	Ndikimi mbi afatin e punimeve
1	Risku i trojeve	0% - 5%	0%	3 – 6 muaj
2	Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	5% - 10%	0% -5 %	3 – 12 muaj
3	Risku i funksionimit	0% - 5%	5% - 10%	1 – 3 muaj
4	Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	-	-	-
5	Risqet ekonomike dhe financiare	0% - 5%	5% - 10%	6 – 12 muaj

6	Risqet e pronësisë së aseteve	0% - 5%	0% - 1%	-
7	Risku Politik	10% - 20%	20% - 30%	16 – 24 muaj
8	Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	5% - 15%	20% - 40%	12 – 16 muaj
9	Risku i forcës madhore	0% - 5%	30% - 50%	12 – 24 muaj

1.8.Analiza e ndjeshmërisë

Faktori kryesor që mund të ndryshojë gjatë procesit të tenderimit, është Marzhi i fitimit. Njëkohësisht, në varësi të projekteve që do të miratohen, detajimi i kostove përkatëse do të bëhet përkatësisht, bazuar mbi projektet faktike të miratuara. Kosto direkte do të përllogaritet bazuar në volume faktike të realizuara, të cilat në asnjë rast nuk mund të jenë më të larta sesa kosto e parashikuar e këtij projekti.

Gjithësesi për efekte të analizës së ndjeshmërisë, do të llogarisim sikur secila nga kostot ulet dhe rritet me 5% dhe 10% dhe marzhi i fitimit ulet dhe rritet përkatësisht me 5% dhe 10%:

	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 10%	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 5%	Modeli Baze	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 5%	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 10%
Norma e Sensitivitetit	10%	5%	0	-5%	-10%
Flukse dalese nga Investimet	- 7,267,445,188	- 6,937,106,771	- 6,606,768,353	- 6,276,429,936	-5,946,091,518
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	- 1,275,711,645	- 1,217,724,752	- 1,159,737,859	- 1,101,750,966	-1,043,764,073
Të Ardhurat	10,274,681,048	9,786,000,321	9,197,517,960	8,713,446,063	8,188,265,320
Fitimi Para taksave	1,731,524,215	1,631,168,798	1,431,011,748	1,335,265,161	1,198,409,729
Tatim Fitimi 15%	- 259,728,632	- 244,675,320	- 214,651,762	- 200,289,774	- 179,761,459
Fitimi neto	1,471,795,583	1,386,493,478	1,216,359,986	1,134,975,387	1,018,648,270
NPV me 5.79%	110,223,600	81,672,242	170,329	- 23,634,170	- 68,587,789
IRR	6.38%	6.25%	5.79%	5.64%	5.34%
Norma e Vetëshlyerjes	5.20	5.28	5.35	5.43	5.51

Procurement Albania

8.2 Loti 2

8.2.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 2

Loti 2 përfshin 4 shkolla, nga të cilat 3 në Njësinë Kashar (Yzberisht), një në Njësinë Administrative 7. Shpërndarja e shkollave të përfshira në Lotin 2 tregohen në hartën e mëposhtme:

Harta 114 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 2

8.2.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 2

SHESHI 6/3

Harta 115 Ortofoto e sheshit

VENDODHJA: Sheshi i propozuar nr.**6/3,** për shkollë 9-vjeçare dhe të mesme, ndodhet pranë Kombinatit të mishit Yzberisht. Aksesohet nga rruga "3 Deshmorët".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 6/3 : 9103 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Akses i lehte.
- Në këtë zone nuk ka shkolla të mesme.
- Zona rreth e rrotull është e sistemuar dhe e gjelbëruar, duke paraqitur një zonë të mire formuar dhe të përshtatshme për ndërtimin e një shkolle të re.

Figura 12 Foto të sheshit 6/3

SHESHI 6/6

Harta 116 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i propozuar nr.6/6, për shkollë 9-vjeçare, ndodhet prane rrethrrotullimit te Doganes..Aksesohet nga rruga Teodor Keko dhe ndodhet ne afersi te lumit Lana.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi6/6 :4930 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Është një zonë ne pronësi të subjekteve private, e rrethuar.
- Ndodhet pranë qendrës së banuar të zonës dhe me intensitet të lartë.
- Akses i lehtë nga dy rrugë.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme.
- Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore.

Open Procurement Albania

Figura 13 Foto nga sheshi 6/6

SHESHI 7/2

Harta 117 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i propozuar nr.7/2 ndodhet pranë Lumit Lana. Aksesohet nga rruga "Javer Malo" dhe " Stavri Themeli"

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 7/2 : 8482 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme, por kemi rritje të insitetit të banimit.
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Figura 14 Foto nga sheshi 7/2

8.2.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 2

Sheshi 6/3

Harta 118 Harta treguese e pronave



Tabela 109 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi i Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/1	3465.50	448			1,552,544.0
2	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/2	3081.50	448			1,380,512.0
3	Nuk ka informacion	Pasuri Are	3866	369/3	2556.50	448			1,145,312.0
					9103.50				4,078,368.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 3866 do të prekë gjithsej 9103 metra katrorë pronë, të përbërë nga 3 prona. Të tria këto prona janë toka bujqësore. Aktualisht nuk ka informacion për pronësinë e tyre. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

Sheshi 6/6

Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin 6/6 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Harta 119- Ortofoto e sheshit

Procurement Albania

Tabela 110-Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				4930	4242			20,913,060
					4930				20,913,060

Open Procurement Albania

Sheshi 7/2

Harta 120 Harta treguese e pronave



Tabela 111 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasuri së	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	74 Bashkpronarë	Mungon lista	8220	8/676	8482.00	30783			261,101,406.0
					8482.00				261,101,406.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8220 do të prekë gjithsej 8482 metra katrorë pronë, të përbërë nga 1 pronë e vetme, me nr. 8/676, në pronësi të disa bashkëpronarëve. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

8.2.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 2

Në Lotin 2 është parashikuar ndërtimi i 4 shkollave gjithsej, përkatësisht tre shkolla të reja në Njësinë Administrative Kashar dhe një shkollë e re në Njësinë Administrative 7 . Më konkretisht, në NJA Kashar është parashikuar ndërtimi i dy shkollave të ciklit arsimor bazë të tipit 2 dhe një shkolle të ciklit arsimor të mesëm të lartë, pra e tipit 4. Ndërsa në NJA 7 është parashikuar ndërtimi i një shkolle të tipit 4, pra të ciklit të mesëm të ulët. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen më në detaj dallimet mes tipeve të shkollave sipas vendndodhjes, ciklit arsimor, nr e klasave dhe nxënësve për klasë, etj,.

Tabela 112 – Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

Open Procurement Albania

8.2.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 2

2 Analiza ekonomike dhe financiare

Analiza ekonomike dhe financiare e këtij studimi fizibiliteti, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, ka si objektiv kryesor të saj që të përcaktojë vlerën e parasë së projektit si dhe të bëjë një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes si edhe të çdo të ardhure që pritet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së projektit.

2.1 Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

Ligji nr. 125/2013 rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private. Në këtë lloj marrëdhënieje, partneri privat merr përsipër që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë /të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtaz. Ndër fushat e zbatimit të këtij ligji është edhe arsimi.[43]

Nga analiza e të dhënave rezulton se për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit të shkollave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne, Bashkia Tiranë duhet të ndërtojë 17 shkolla të reja, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Kosto totale e ndërtimit dhe mobilimit të këtyre shkollave llogaritet në 7.6 miliard lekë. Një shifër e tillë është financiarisht e papërballueshme për Bashkinë e Tiranës, buxheti total vjetor i së cilës është 10 miliard lekë, ndërsa investimet për ndërtimin e shkollave të reja gjatë viteve të fundit kanë qenë jo më shumë se 500 milion lekë.

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin "Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje" (PFNM), ose ndërkombëtarisht i njohur me termin "Design, Build, Finance & Operate (DBFO)", kontraktorët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Kontraktori, i cili mund të jetë një kompani e vetme apo një konsorcium është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e objektit për një periudhë të caktuar kohore, e cila propozohet të jetë 7 vjet. Pagesa pas përfundimit të

[43] Neni 4, pika dh), Ligji 125/2013

projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre. Githashtu, integrimi i të gjitha kontratave të projektit në një të vetme redukton kostot e ndryshme transaksionale dhe rrit efiçencën e menaxhimit të projektit.
Më së shumti ky model PPP-je është përdorur për ndërtimin e projekteve infrastrukturore madhore të tilla si ndërtimi i autostradave, hidrocentraleve, impianteve të menaxhimit të mbetjeve, etj,. Kjo për shkak se përmasat e mëdha të projekteve të tilla kërkojnë fonde të konsiderueshme, organizim sa më efektiv të burimeve kapitale dhe njerëzore, cilësi të lartë projektimi dhe ndërtimi, siguri maksimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për këtë arsye modele të tilla si PFNM apo të ngjashme, janë parë si nga më të suksesshmet për të zhvilluar projekte që garantojnë realizueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e investimit të kryer. Megjithatë përdorimi i kësaj forme të PPP nuk është kufizuar vetëm tek projektet e mëdha të infrastrukturës publike të përmendura më sipër. Në shumë vende të OECD-së, por më gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar, kjo metodologji është përdorur gjithashtu për projekte të shërbimeve publike të tilla si ndërtimi i shkollave të reja.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj nga vende të ndryshme të cilat kanë zbatuar me sukses këtë model për projekte të infrastrukturës arsimore:

Kanada[44]**:** Programi "Alberta Schools Alternative Procurement". Në vitin 2007 krahina e Albertës në Kanada shpalli fazën e parë të programit i cili parashikonte ndërtimin e 18 godinave të reja shkollore (kopshte dhe shkolla 9-vjeçare) të cilat kanë përunduar ndërtimin në vitin 2010. Pas përfundimit të ndërtimeve, jetëgjatësia e kontratës e cila do vijojë me pjesën e mirëmbajtjes është përcaktuar rreth 30 vjet. Faza e dytë e programit përfshinte ndërtimin e 10 shkollave të tjera 9-vjeçare sipas të njëjtit model dhe 4 gjimnazeve nëpërmjet modelit të thjeshtë të kontratës Projektim-Ndërtim të cilat kanë përfunduar në vitin 2013.

Greqi[45]: Programi "Macedonia Schools and Attica Schools". Duke përdorur mekanizmin DBFM operatorët privatë projektuan ndërtimin e 51 shkollave me një vlerë totale prej 269 milion Euro dhe me kontrata 25 vjeçare.

Mbretëri e Bashkuar[46]: Programi "Building Schools for the future". Ky program është një program afat-gjatë investimesh i cili po kontribuon në ndërtimin e një numri të konsiderueshëm shkollash në gjithë tërritorin e MB-së. Shumica e shkollave janë ndërtuar nëpërmjet skemës Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje, por në këtë rast shpesh herë është përfshirë edhe

[44] "Flexible and alternative approaches to providing school infrastructure in Alberta, Canada" – OECD, 2010
[45] "The role and impact of public-private partnerships in education", Fq. 82 – Banka Botërore, Mars 2009 .http://www.ungei.org/resources/files/Role_Impact_PPP_Education.pdf
[46] Ibidem (dmth: marrë nga i njëjti dok i Bankës Botërore në referencën e mësipërme dhe në të njëjtën faqe)

elementi i menaxhimit të shkollës nga subjekti privat për një periudhë të caktuar. Zakonisht kohëzgjatja totale e kontratës arrin deri në 30 vjet. Konsorciumi privat paguhet rregullisht nga fondet publike bazuar në performancën e tij gjatë periudhës së kontratës. Nëse konsorciumi nuk arrin performancën e synuar pagesa reduktohet. Në fund të periudhës së kontratës shkolla i kthehet qeverisë.

Zelandë e Re[47]: Projekti i Ministrisë së Arsimit të Zelandës së Re për ndërtimin e dy shkollave në Hobsonville, Auckland. Ky projekt parashikonte ndërtimin e një shkolle të re të ciklit të ulët dhe një shkolle të ciklit të mesëm të ulët në rajonin periferik të Hobsonville në qytetin Auckland. Sektori privat ishte pjesërisht përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objekteve, sëbashku me sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre si dhe menaxhimin e shërbimeve të përbashkëta. Ndërtimi i këtyre shkollave ka përfunduar me sukses në vitin 2014.

Nën këtë prizëm, projekti i ndërtimit të shkollave të reja të Tiranës e sheh të nevojshme aplikimin e të njëjtës qasje për përmirësimin e shërbimit arsimor në gjithë territorin e Bashkisë. Numri i madh i shkollave që do të ndërtohen, kufizimet financiare, koha e shkurtër e zbatimit të projektit si dhe nevoja për garantimin e cilësisë maksimale të ndërtesave theksojnë nevojën për ngritjen e një partneriteti public privat efektiv dhe të suksesshëm.

1.9.Supozimet kryesore

Për efekt të analizës ekonomike e financiare të këtij studimi fizibiliteti, janë bërë supozimet si më poshtë:

- Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për ndërtimin e objekteve arsimore dhe vënien në funksion të tyre, ndërsa Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për këtë qëllim.
- Objektet arsimore do të jenë të ndërtuara e funksionale maksimalisht 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Pas ndërtimit vënien në funksion të shkollave, koncesionari do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për një periudhë 7 vjeçare dhe për çdo problematikë për administrimin dhe reziqet e aseteve për këtë periudhe.
- Pas ndërtimit të objekteve, Bashkia Tiranë do t'i paguajë koncesionarit një shumë të caktuar vjetore deri në shlyerjen e plotë të shumës së investuar. Të ardhurat për këto pagesa do të sigurohen nga të ardhurat vjetore nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore dhe nga transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave.

1.10. Analiza e kostove

Bazuar në studimin teknik, është arritur në përfundimin se në total do të ndërtohen 17 shkolla, prej të cilave 10 shkolla 9 vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e reja do të projektohen e

[47] "Mayoral Position Paper on Public Private Partnerships" – Ernst and Young, Nëntor 2013.

ndërtohen sipas modeleve në përputhje me standartet e specifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes udhëzuesit" Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar. Referuar standarteve të sipër-përmendura, janë përcaktuar 4 tipe kryesore shkollash, me të dhëna operacionale si më poshtë:

Tipi 1 i shkollave, është me 20 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,938 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 4 klasash, me nje sipërfaqe prej 874 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 5,812 m2. **Tipi 2** i shkollave, është përsëri 9 vjeçar, me 30 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 6,588 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 6 klasash, me nje sipërfaqe prej 1,310 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 7,898 m2. **Tipi 3** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat rurale me 20 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,041 m2. **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4001 m2.

Nga analiza sasiore e kryer dhe e shpjeguar më sipër për **Loti 2** janë gjithsej **4 shkolla**, nga të cilat, 2 shkolla nga Tipi 2 dhe 2 shkolla të mesme nga tipi 4. Përkatësisht këto shkolla do të ndërtohen në njësitë administrative dhe me të dhënat si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tabela 113 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 2

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	nxënës për klasë	Nxënës për shkolle	Sipërfaqe totale shkolla	Klasa kopësh ti	Nxënës për klasë kopështi	nxënës për kopësht	Sipërfaqe totale kopësht	Siperfaqe totale ndertimi
1	NJA 07	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
2	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
3	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
4	NJA Kasha	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
Totali				102		3,060	21,177	12	48	288	2,620	23,797

Duke i permbledhur sipas tipologjisë së shkollave, në total kemi këto të dhëna operacionale:

Tabela 114 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 2

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Nr nxënës për klasë	Nxënës për shkollë	Nr klasa kopështi për shkollë	Nr nxënës për klasë kopështi	Nxënës për kopësht	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Total Nxënës në shkolla	Total Nxënës në Kopështe	Nr Total i nxënësve
Tipi 2	2	30	30	900	12	24	144	13,176	2,620	15,796	1,800	288	2,088
Tipi 4	2	21	30	630	-	-	-	8,001	-	8,001	1,260	-	1,260
Grand To	**4**	**51**				**24**	**144**	**21,177**	**2,620**	**23,797**	**3,060**	**288**	**3,348**

Për të analizuar sa më mirë vlerën e parasë së projektit, kemi bërë grupimin e shpenzimeve në 4 kategori kryesore, duke u bazuar dhe në standartet e kontabilitetit si dhe në kërkesat e VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, paragrafi 3-6:

- Kostot e drejtpërdrejta të investimeve;
- Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes;

Për efekt të analizave të mëposhtme të gjitha çmimet dhe vlerat do të jenë pa TVSH, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

1.10.1 Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Gjatë analizës dhe në përputhje dhe me VKM të sipërcituar, u identifikuan këto kosto të drejtëpërdrejta të investimeve:

17. Kosto e Shpronësimit të Truallit;
18. Kosto e Ndërtimit;
19. Kosto e Studim Projektimit;
20. Kosto e Supervizimit;
21. Kosto e Kolaudimit;
22. Oponenca teknike;
23. Kosto për Mobilje dhe Orendi;
24. Kosto e pajisjeve të laboratorëve.

1.10.1.1. Kosto e Shpronësimit të Truallit

Nr rendor i tabeles	Adresa	Tipi	Sheshi	Shpronesimi ne Vlere	Siperfaqje ne m2 te shpronesuar	Cmimi mesatar per m2
1	NJA 07	Tipi 4	7/2	261,101,406	8,482	30,783
2	NJA Kashar	Tipi 2	6/6	20,913,060	4,930	4,242
3	NJA Kashar	Tipi 2	6/3	2,039,184	4,552	448
4	NJA Kashar	Tipi 4	6/3	2,039,184	4,552	448
Grand Total				**286,092,834**	**22,516**	**12,706**

Nga përcaktimi i gjurmës se ku do të ndërtohen këto shkolla, ka rezultuar se do të shpronësohen në nga privatët në total **12,706 m2**, të cilat sipas përllogaritjeve nga të bëra, parashikohet që në total vlera e shpronësimit të shkojë në **286,092,834** lekë. Nga ana tjetër, për tokën shtet, do të ndiqen procedurat përkatëse për të marrë nën administrim pronat përkatëse.

Me daljen e VKM për këtë qëllim dhe plotësimin e dokumentave financiarë dhe ligjorë në përputhje me VKM dhe me aktet normative në fuqi, çdo i shpronësuar do të likujdohet nga Bashkia Tiranë me anë të fondit që do të përcaktohet për këtë qëllim.

1.10.1.2. Kostot e Ndërtimit

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 228,785,770 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 276,314,618 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 305,233,020 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 71,238,892 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 376,471,912 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 187,207,732 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 234,736,581 lekë.

Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë dhe këto shkolla nuk kanë ambjente kopështi.

Open Procurement Albania

Tabela 116 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 2

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopështi për shkollë	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
Tipi 2	2	30	6	13,176	2,620	15,796	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	752,943,823
Tipi 4	2	21	-	8,001	-	8,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	370,699,665
Grand To	**4**	**51**	**6**	**21,177**	**2,620**	**23,797**	**92,663**	**108,762**	**490,582,853**	**71,238,892**	**561,821,744**	**1,123,643,488**

Në total, do të ndërtohen **2 shkolla të tipit 2** me kosto ndërtimi 376,471,912 lekë për shkollë dhe **2 shkolla të tipit 4** me kosto ndërtimi 185,349,833 lekë për shkollë. Rrjedhimisht, kostoja total e ndërtimit për **Loti 2** shkon në **1,123,643,488** lekë. Kjo është një kosto që do të mbulohet nga koncensionari.

1.10.1.3. Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit

Bazuar dhe në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostot e tjera direkte të investimit janë:

- Studim projektimi;
- Mbikqyrja e punimeve;
- Kolaudimi;
- Oponenca teknike;
- Mbrojtja ndaj zjarrit;
- Leja mjedisore;

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Tot Sipërfaq e ndërtimi	Kosto Studim Projektim	Kosto Mbikqyrje	Kosto kolaudimi	Oponenca teknike	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
Tipi 2	2	15,796	20,220,768	8,355,808	301,178	501,350	100,000	60,000
Tipi 4	2	8,001	10,691,738	4,364,479	153,710	369,692	100,000	60,000
Grand To	**4**	**23,797**	**30,912,506**	**12,720,288**	**454,888**	**871,042**	**200,000**	**120,000**

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Albania

Duke marrë parasysh të dhënat e analizuara në kapitullin respektiv mbi kostot, rezulton se kostot e tjera të drejtpërdrejta të investimit janë si më poshtë vijon:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0.

1.10.1.4. Kosto e mobilimit

Për të vënë në përdorim shkollat, nevojitet pajisja e secilës prej tyre me, pajisjet e nevojshme IT si edhe laboratoret e nevojshme. Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24,167 lekë. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që

nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tabela 118 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit

Tipi shkollës	Nr. klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

Në koston e mobilimit për arsimin bazik janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth 27,916 lek. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 119 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmijë	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana juaj, kontratë blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 120 Kosto për pajisjen e Laboratorëve

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator

Open Procurement Albania

1	**Laborator Shkencat natyrore**	186,998
2	**Laborator Kimie**	223,125
3	**Laborator Fizike**	1,183,602
4	**Laborator Biologjie**	632,467
5	**Laborator IT**	3,869,658
II	**Shkolla e Mesme**	-
1	**Laborator Kimie**	528,469
2	**Laborator Fizike**	1,294,500
3	**Laborator Biologjie**	651,657
4	**Laborator IT**	3,869,658

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tabela 121 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	**Arsimi Bazik (Tipi 1)**	6,095,850
2	**Arsimi Bazik (Tipi 2)**	7,279,450
3	**Arsimi Bazik (Tipi 3)**	5,743,950
4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e **4 shkollave është 124,515,033 lekë** pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 122 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 2

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Kosto e mobilimit te shkollave	Kosto e mobilimit të kopështeve	Total Kosto Mobilimi	Kosto Laboratori	Total kosto pajisje, mobilje dhe orendi
Tipi 2	2	43,500,000	8,040,000	51,540,000	14,558,900	66,098,900
Tipi 4	2	30,450,000	-	30,450,000	27,966,133	58,416,133
Grand To	**4**	**73,950,000**	**8,040,000**	**81,990,000**	**42,525,033**	**124,515,033**

Open Procurement Albania

1.10.1.5. Kosto direkte e Investimit

Në përfundim, kosto direkte e investimit të këtij projekti është **1,579,530,079 lekë**. Nga këto, **286,092,834** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga konçesionari është **1,293,437,245** lekë, ku kosto e ndërtimit është **1,123,643,488** lekë pa TVSH, Kosto e Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **169,793,757** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Tabela 123 Kosto direkte investimi për Lotin 2

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,579,530,079**
A.1	**Kostot e Truallit**	**286,092,834**
A.2	Kostot e Projektimit	30,912,506
A.3	- Ndertim + instalime	1,123,643,488
A.4	- Oponenca teknike	871,042
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	12,720,288
A.9	- Kosto Kolaudimi	454,888
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	81,990,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	42,525,033

Open Procurement Albania

1.10.2 Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Bazuar dhe nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose 351,755 lekë pa TVSH. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat për **Loti 2** është **40,100,126** lekë në vit. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Për më shumë detaje, shih tabelat më poshtë.

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtje s për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
Tipi 2	2	12,663,198	25,326,396
Tipi 4	2	7,386,865	14,773,731
Grand Total	**4**	**10,025,032**	**40,100,126**

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë **280,700,882** lekë pa tvsh. Nga të cilat **184,818,550** lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve, dhe **95,882,332** lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një viti pa TVSH.

B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**280,700,882**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**184,818,550**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	42,733,348
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve	107,974,566
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi	13,517,098
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)	20,593,538
B.2	**Staf Mirembajtje**	**95,882,332**
B.2.1	Staf Roje	14,104,165
B.2.2	Staf Sanitare	60,866,302
B.2.3	Staf Sekretare	12,191,172

Open Procurement Albania

Tabela 126 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 2

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	Lyerje per klase	Riparim suvatim + hidroizolim per klase	Riparime dhe mirembajtje e Nderteses	Riparime Orendi shkollore	Riparime Pajisje PC	Materiale Pastrimi	Lëndë djegëse për ngrohje dhe ujë të ngrohtë	Mirembajtje kondicionim, impiante uji dhe MNZSH	Sherbim roje	Sherbim pastrimi	Sherbim sekretarie	Total kosto mirembajtjeje
1	NJA 07	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
2	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
3	NJA Kasha	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
4	NJA Kasha	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
Totali i Mirembajtjes				**114**	**2,609,584**	**2,676,498**	**818,682**	**1,931,014**	**2,941,934**	**965,324**	**9,531,872**	**4,927,742**	**3,260,694**	**8,695,186**	**1,741,596**	**40,100,126**

Open Procurement Albania

1.11. Analiza e të ardhurave të PPP

1.11.1. Tarifa e përdorimit të shkollave

Tarifa e përdorimit të shkollave (në vazhdim "Tarifa"), duhet të përllogaritet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulimin e kostove të koncensionarit si dhe të garantojë një marzh minimal fitimi për koncensionarin, në mënyrë që nga njëra anë kjo PPP të jetë atraktive dhe njëkohësisht të jetë dhe zgjidhja më e mire ekonomike krahasuar me skenarë të tjerë të mundshëm. Tarifa paguhet për gjithë periudhën e mirëmbajtjes dhe administrimit të shkollave nga ana e koncensionarit, pra për 7 vite. Kjo tarifë në vetvete paguhet çdo vit nga Bashkia Tiranë përmes burimeve të financimit të detajuara si më poshtë. Përmes kësaj skeme, jo vetëm që sigurohet ndërtimi i 17 shkollave në kohë rekord, duke zgjidhur minimalisht çështjen e arsmimit me turne, dhe mbipopullimit të klasave, por duke qënë se të gjitha risqet për mirembajtjen dhe përdorimin me kujdes të asetit do të jenë në ngarkim të koncensionarit, dhe të lidhura dhe me pagesat, kjo do të bëjë që të kemi ndërtime cilësore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk përllogaritet marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se koncesionari vlerat e investuara për këtë qëllim, do të mbulohet në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë, si dhe për pjesën e mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme për këtë periudhë.

Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse[48], përkatësisht rezultet e obligacioneve 7 vjecare nga viti 2015 deri në 15.09.2016.

Tabela 127 Marzhi i fitimit

ISIN	Dt.Ankandi	Ankandi	Muaji	*Datë Emetim*[1]	*Datë Maturim*[1]	Shuma e shpallur (fillestare)	*Shuma e shpallur (nd. strukture)*	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Prorata Konkurues	Prorata Jo Konkuruese	Yieldi Uniformi i Pranuar
AL0017NF7Y23	13.09.2016	***7vjeçar/7years(fix)***	*Shtator*	15.09.2016	15.09.2023	*3,000,000*		*2,309,000*	*2,309,000*			*4.89%*
AL0016NF7Y23	01.06.2016	***7vjeçar/7years(fix)Rihapje***	*Qershor*	03.06.2016	16.03.2023	*2,000,000*		*3,141,400*	*2,000,000*	*4.40%*		*4.00%*
AL0016NF7Y23	11.03.2016	***7vjeçar/7years(fix)***	*Mars*	16.03.2016	16.03.2023	*3,000,000*		*8,247,000*	*2,999,900*	*76.48%*		*4.90%*
AL0015NF7Y22	14.12.2015	***7vjeçar-fiks***	*Dhjetor*	16.12.2015	16.12.2022	*2,500,000*		*5,288,600*	*2,500,000*	*67.70%*	*100.00%*	*6.79%*
AL0014NF7Y22	14.09.2015	***7vjeçar-fiks***	*Shtator*	16.09.2015	16.09.2022	*1,000,000*		*1,430,600*	*1,000,000*	*100.00%*	*100.00%*	*7.78%*
AL0013NF7Y22	12.06.2015	***7vjeçar-fiks***	*Qershor*	16.06.2015	16.06.2022	*3,000,000*		*2,953,500*	*2,953,500*	*100.00%*	*100.00%*	*7.80%*
AL0012NF7Y22	12.03.2015	***7vjeçar-fiks***	*Mars*	16.03.2015	16.03.2022	*2,500,000*		*2,815,800*	*2,500,000*	*80.98%*	*77.92%*	*7.81%*
										Yieldi Mesatar i pranuar		**6.28%**

[48] http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise/rezultatet-e-ankandeve/2016

Marzhi i fitimit do të jetë objekt tenderimi i konkurentëve në këtë PPP, por ndërkohë është i domosdoshëm për të kuptuar sa do të jetë vlera e përgjithshme e kësaj PPP. Marzhi i fitimit, do të llogaritet, për vlerën e mbetur të investimit direkt çdo vit, dhe mbi kostot vjetore të mirëmbatjes. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, sigurohet që skema e financimit të jetë atraktive për konkurentët e mundshëm, dhe, nga ana tjetër, kosto totale e projektit të mos dalë më e lartë sesa mënyrat tradicionale të financimit.

Bazuar në përllogaritjet e kryera, tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit me marzhin prej 6.28% do të ishte si më poshtë:

Tabela 128 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 2

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,293,437,245										
2	1	1,293,437,245	6.28%	184,776,749	1,108,660,496	81,227,859	266,004,608	40,100,126	2,518,288	42,618,414	83,746,147	**308,623,022**
3	2	1,108,660,496	6.28%	184,776,749	923,883,747	69,623,879	254,400,628	40,100,126	2,518,288	42,618,414	72,142,167	**297,019,042**
4	3	923,883,747	6.28%	184,776,749	739,106,997	58,019,899	242,796,649	40,100,126	2,518,288	42,618,414	60,538,187	**285,415,063**
5	4	739,106,997	6.28%	184,776,749	554,330,248	46,415,919	231,192,669	40,100,126	2,518,288	42,618,414	48,934,207	**273,811,083**
6	5	554,330,248	6.28%	184,776,749	369,553,499	34,811,940	219,588,689	40,100,126	2,518,288	42,618,414	37,330,227	**262,207,103**
7	6	369,553,499	6.28%	184,776,749	184,776,749	23,207,960	207,984,709	40,100,126	2,518,288	42,618,414	25,726,248	**250,603,123**
8	7	184,776,749	6.28%	184,776,749	0	11,603,980	196,380,729	40,100,126	2,518,288	42,618,414	14,122,268	**238,999,143**
Grand total				**1,293,437,245**		**324,911,436**	**1,618,348,681**	**280,700,882**	**17,628,015**	**298,328,897**	**342,539,451**	**1,916,677,579**

Open Procurement Albania

Për të garantuar suksesin ekonomik të skemës, është menduar që koncensionari të paguhet përmes tarifave vjetore zbritëse. Kjo mënyrë pagimi do të bëntë që koncesnionari të mos vendosej në vështirësi financiare të mëdha gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës së koncensionit. Kësisoj, vitin e parë kësti do të jetë 308,623,022 lekë dhë pas çdo viti do të ulet gradualisht, deri në 1,916,677,579 lekë në vitin e fundit.

Tabela 129 Shuma e kestit vjetor

Nr rendor	Viti	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	
2	1	**308,623,022**
3	2	**297,019,042**
4	3	**285,415,063**
5	4	**273,811,083**
6	5	**262,207,103**
7	6	**250,603,123**
8	7	**238,999,143**
Grand total		**1,916,677,579**

Open Procurement Albania

1.11.2 Burimi i Financimit.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti për **Loti 2** është **2,202,770,413** lekë nga të cilat, **286,092,834** janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe **1,916,677,579** lekë është vlera e koncensionit:

Tabela 130 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 2

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**286,092,834**	**1**	**286,092,834**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**1,293,437,245**	**1**	**1,293,437,245**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,293,437,245	1	1,293,437,245
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**40,100,126**	**7**	**280,700,882**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	40,100,126	7	280,700,882
4	**Marzhi i Fitimit**	**342,539,451**	**1**	**342,539,451**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	342,539,451	1	342,539,451
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4+5)			**2,202,770,413**

Tabela 131 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga koncesionari

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	286,092,834	1,916,677,579	2,202,770,413
Totali	**286,092,834**	**1,916,677,579**	**2,202,770,413**

Open Procurement Albania

Këto shpenzime do të mbulohen përmes të ardhurave të Bashkisë, dhe Granteve të Kushtëzuara që Ministria financave do të japë për këtë projekt.

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për këtë projekt, do të gjenerohen nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila është vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për qytetin e Tiranës".

Tabela 132 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore

E m ë r t i m i	PLANI VITI 2016	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018
Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	**870 000 000**	**940 000 000**	**1 000 000 000**
Familjarët	320 000 000	340 000 000	350 000 000
Subjektet Tregtare	550 000 000	600 000 000	650 000 000

Të ardhurat nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore janë planifikuar të jenë 870 milionë lekë në vitin 2016, ndërkohë që këto të ardhura parashikohet të rriten në 940 milionë lekë në vitin 2017 dhe 1 miliard lekë në vitin 2018. Kjo taksë e përkohëshme është vendosur për një periudhë 7 vjeçare dhe për vitet 2019-2022, të ardhurat vjetore parashikohet të jenë rreth 1 miliard lek. Të ardhurat nga transferta specifike nga Ministria e Financave do të jenë në masën 700 milionë lek në vit. Në këtë mënyrë, fondi në dispozicion të Bashkisë Tiranë për kryerjen e pagesave periodike parashikohet të jetë rreth 1 miliard e 700 milion lekë në vit.

Open Procurement Albania

1.12. Analiza Financiare

Tabela 133 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,579,530,079**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**1,579,530,079**
A.1	**Kostot e Truallit**	**286,092,834**								**286,092,834**
A.2	Kostot e Projektimit	30,912,506								30,912,506
A.3	- Ndertim + instalime	1,123,643,488	-							1,123,643,488
A.4	- Oponenca teknike	871,042								871,042
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	120,000								120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000								200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	12,720,288								12,720,288
A.9	- Kosto Kolaudimi	454,888								454,888
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	81,990,000	-	-	-	-	-	-	-	81,990,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	42,525,033								42,525,033
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**280,700,882**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**26,402,650**	**26,402,650**	**26,402,650**	**26,402,650**	**26,402,650**	**26,402,650**	**26,402,650**	**184,818,550**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	6,104,764	6,104,764	6,104,764	6,104,764	6,104,764	6,104,764	6,104,764	42,733,348
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		15,424,938	15,424,938	15,424,938	15,424,938	15,424,938	15,424,938	15,424,938	107,974,566
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		1,931,014	1,931,014	1,931,014	1,931,014	1,931,014	1,931,014	1,931,014	13,517,098
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		2,941,934	2,941,934	2,941,934	2,941,934	2,941,934	2,941,934	2,941,934	20,593,538
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**13,697,476**	**13,697,476**	**13,697,476**	**13,697,476**	**13,697,476**	**13,697,476**	**13,697,476**	**95,882,332**
B.2.1	Staf Roje		3,260,694	2,717,245	2,264,371	1,886,976	1,572,480	1,310,400	1,092,000	14,104,165
B.2.2	Staf Sanitare		8,695,186	8,695,186	8,695,186	8,695,186	8,695,186	8,695,186	8,695,186	60,866,302
B.2.3	Staf Sekretare		1,741,596	1,741,596	1,741,596	1,741,596	1,741,596	1,741,596	1,741,596	12,191,172
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**1,579,530,079**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**40,100,126**	**1,860,230,961**

C.	**Të Adhurat**	**286,092,834**	**308,623,022**	**297,019,042**	**285,415,063**	**273,811,083**	**262,207,103**	**250,603,123**	**238,999,143**	**2,202,770,413**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	286,092,834								**286,092,834**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		308,623,022	297,019,042	285,415,063	273,811,083	262,207,103	250,603,123	238,999,143	**1,916,677,579**
D	**Fitimi (humbja)**	(1,293,437,245)	268,522,896	256,918,916	245,314,937	233,710,957	222,106,977	210,502,997	198,899,017	**342,539,451**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(1,293,437,245)	(1,024,914,349)	(767,995,433)	(522,680,496)	(288,969,539)	(66,862,563)	143,640,434	342,539,451	**342,539,451**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(21,546,065)	(29,834,853)	**(51,380,918)**

Open Procurement Albania

Tabela 134 Fluksi i arkës së projektit

Fluksi i Arkës									
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Flukse dalese nga Investimet	- 1,579,530,079	-	-	-	-	-	-	-	- 1,579,530,079
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	-	- 40,100,126	- 40,100,126	- 40,100,126	- 40,100,126	- 40,100,126	- 40,100,126	- 40,100,126	- 280,700,882
Flukse dalese nga Taksat	-	-	-	-	-	-	- 21,546,065	- 29,834,853	- 51,380,918
Totali i flukseve dalese	**-1,579,530,079**	**- 40,100,126**	**- 40,100,126**	**- 40,100,126**	**- 40,100,126**	**- 40,100,126**	**- 61,646,191**	**- 69,934,979**	**- 1,911,611,879**
Flukse hyrese nga Operimet	**286,092,834**	**308,623,022**	**297,019,042**	**285,415,063**	**273,811,083**	**262,207,103**	**250,603,123**	**238,999,143**	**2,202,770,413**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,293,437,245**	**268,522,896**	**256,918,916**	**245,314,937**	**233,710,957**	**222,106,977**	**188,956,932**	**169,064,165**	**291,158,534**
Gjendja e arkes progresive	**-1,293,437,245**	**- 1,024,914,349**	**- 767,995,433**	**- 522,680,496**	**- 288,969,539**	**- 66,862,563**	**122,094,369**	**291,158,534**	**291,158,534**

1.13. Realizueshmëria Ekonomike e Projektit

1.13.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto)

NPV, si metoda standarte për vlerësimin e projekteve afatgjata përmes analizës së vlerës në kohë të parasë, paraqet shumën e fluksit të arkës së projektit (Cash Floë) të skontuar. Çdo investues, kur vendos ndërmarrjen e një investimi analizon të ardhurat e gjeneruara nga projekti krahasuar më të ardhurat e mundshme nëse paratë e investuara do të përdoreshin në një tjetër mënyrë. Përgjithësisht, këto analiza kryhen duke marrë për bazë normën e interesit në rast të investimit të parave, për shembull, në bono thesari apo obligacione qeveritare, të cilat kanë risk thuajse zero.

Formula klasike për llogaritjen e NPV-së, nëse investimi bëhet brenda një viti, është:

$$NPV = \sum_{t=1}^{T} \frac{C_t}{(1+r)^t} - C_0$$

ku:

C_0 - përfaqëson paranë e shpenëzuar për kryerjen e investimit fillestar;

C_t – përfaqëson të ardhurat nga investimi i kryer;

t – përfaqëson kohëzgjatjen e projektit;

r – përfaqëson normën e pritshme të skontimit.

Open Procurement Albania

Për të parë realizueshmërinë ekonomike të projektit, është testuar modeli financiar me disa norma të mundëshme skontimi. Nga kjo analizë, ka rezultuar se konçensionarët e mundshëm do të kenë interes në këtë projekt vetëm në rast se kosto e tyre oportune është më e ulët se 5.79%. Me fjalë të tjera, për çdo normë skontimi mbi 5.79% ky projekt nuk paraqet leverdisshmëri ekonomike nga ana e koncensionarit.

	NPV						
norma e skontimit e parashikuar	**5%**	**5.79%**		**6%**		**7%**
NPV	**33,046,353**	**175,770**	**-**	**8,253,735**	**-**	**46,707,899**

1.13.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit)

IRR-ja është një metodë që përdoret për të matur fitimin e investimeve të mundshme. IRR-ja është një normë skontimi që e bën vlerën aktuale neto (NPV) të të gjithë fluksit të arkës (cash floë) të një projekti të barabartë me zero. Sipas teorisë ekonomike, çdo projekt me një IRR më të madhe se kosto e tij kapitale është fitimprurës, e rrjedhimisht investitorët kanë interes të investojnë në të. Në bazë të analizës financiare, IRR-ja e këtij projekti është në masën 5.79%.

Open Procurement Albania

Tabela 135 Norma e brendshme e ktimit e projektit

				IRR					
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,293,437,245**	**268,522,896**	**256,918,916**	**245,314,937**	**233,710,957**	**222,106,977**	**188,956,932**	**169,064,165**	**291,158,534**

IRR **5.79%**

1.13.3. Periudha e Vetëshlyerjes

Periudha e vetëshlyerjes paraqet kohën që nevojitet në mënyrë që një kapitali i investuar të kompensohet nga të ardhurat nga projekti. Përgjithësisht, periudha e vetëshlyerjes llogaritet duke pjesëtuar koston e investimit me të ardhurat vjetore. Por, duke qenë se në këtë projekt të ardhurat vjetore përbëhën nga këste zbritëse, periudha e vetëshlyerjes është vlerësuar duke analizuar fluksin e arkës për të përcaktuar vitin e fundit në të cilën ky fluks është negativ.

Periudha e Vetëshlyerjes		
Viti i fundit i gjendjes se arkes negative		5
Gjendja e arkes kumulative ne vitin e fundit negativ	-	66,862,563
Gjendja e arkes pozitive krijuar ne vitin vijues		188,956,932
PBP (periudha e veteshlyerjes)		5.35

Nga sa u përshkrua më sipër, periudha e vetëshlyerjes për këtë projekt arrihet në 5.35 vite. Megjithatë, duke parë që pagesat nga ana e Bashkisë Tiranë do të jenë vjetore, atëherë periudha e vetëshlyerjes nuk do të jetë 5.35 vite, por do të jetë 6 vite.

1.13.4. Përshtatshmëria financiare

Sipas VKM nr, 575, datë 10.07.2013, neni 7, pika 10, përshtatmëria financiare e një projekti "tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar."

Në bazë të analizës financiare të mësipërme, ky projekt është ekonomikisht i realizueshëm dhe kjo realizueshmëri, në mënyrë të thuket, jepet nga vlerat e mëposhtme:

- NPV = 5.79% > 0
- IRR = 5.79% > se interesi i depozitave apo bonove të thesarit
- PBP = 6 vite < 7 vite (kohëzgjatja e konçensionit)

Open Procurement Albania

1.14. Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve

Analiza e risqeve ka si synim parësor të saj identifkimin dhe vlerësimin e gamës së risqeve që mund të ndikojnë projektin. Në këtë mënyrë, zhvillohet një strategji për menaxhimin e riskut në mënyrë që të garantohet realizimi i projektit me sukses. Në përputhje me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", më poshtë vijon një analizë e risqeve që prekin këtë projekt.

1.14.1. Analiza cilësore e risqeve

Risku i trojeve

Përshkrimi i riskut: Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e 17 shkollave do të jenë kryesisht me pronësi shtet, ndërsa trojet në pronësi private do të shpronësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pastaj do të vihen në dispozicion të koncensionarit. Rrjedhimisht, ky risk ka probablitet të ulët, thuajse zero, për të ndikuar mbi projektin. Përsa u përket lejeve të nevojshme, ky risk nuk ekziston pasi Bashkia Tiranë është vetë organi përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve. Së fundi, përsa u përket standarteve mjedisore, trojet e përzgjedhura janë parcela në ndodhura në zona ku nuk ndikohet asnjë standart mjedisor, ndaj edhe ky risk vlerësohet zero.

Menaxhimi i riskut: Ky risk vlerësohet me probabilitet zero dhe cilësohet si risk i mbajtur nga Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë do të kryejë të gjitha procedurat për shpronësimin e trojeve private jashtë kësaj skeme PPP-je dhe përpara kohës së përcaktuar për nisjen e punimeve. Në rast se ndonjë prej trojeve të përzgjedhura do të ketë konflikt pronësie çka do ta bënte shpronësimin të pamundur, pranë ZRPP është kërkuar informacion edhe për sheshe alternative, të cilat mund të përdoren. Përsa u përket kushteve gjeologjike dhe standarteve mjedisore, është kryer një studim mjedisor që është pjesë e këtij studimi fizibiliteti, i cili ka arritur në përfundimin se me ndërtimin e këtyre objekteve nuk preket asnjë standart mjedisor. Për më tepër, gjatë marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet edhe një studim mjedisor më i detajuar nga ana e koncensionarit.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë

Përshkrimi i riskut: Kostimi i ndërtimit dhe mobilimit të shkollave të reja është bazuar në një metodologji të shpjeguar gjërësisht më sipër, e cila merr për bazë koston e shkollave të ndërtuara nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit. Kësisoj, mundësia që kosto e ndërtimit të jetë më e lartë sesa kostoja e përllogaritur është thuajse zero. Ndërtimi dhe vënia në punë e shkollave varen në një shkallë të caktuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe plotësimi i parakushteve për marrjen e kësaj lejeje, si leja mjedisore, lidhja me rrjetin elektrik apo ujësjellësin, miratimi i projekteve për mbrojtjen nga zjarri, etj. Koncensionari ka detyrën të bëjë projektimin, të përgatisë dokumentacionin për pajisje me leje ndërtimi si edhe të ndërtojë objektet shkollore. Nga ky prizëm, risku i vonesave në paisje me leje ndërtimi, i vonesave në nisjen e punimeve e, rrjedhimishit, i vënies në punë është i mundshëm.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi koncensionarin. Koncensionari ka detyrimin të përgatisë dokumentat dhe të pajiset me leje ndërtimi. Në rast se koncensionari nuk do të përgatisë projektin në kohë, do të neglizhojë aplikimin për leje ndërtimi duke mos aplikuar në kohë apo

duke pasur mangësi në dokumentacion apo nuk do t'i kryejë punimet në kohë, atëherë ai do të mbajë përgjegjësi për mos nisjen e punimeve në afat dhe do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve që do të bëhën në kontratën konçensionare. Gjithashtu, meqenëse konçensionari është përgjegjës si për hartimin ashtu edhe për zbatimin e projektit, çdo vonesë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa vjen si rezultat i forcës madhore, do të jetë përgjegjësi e tij për të cilën do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve në kontratën konçensionare.

Risku i funksionimit

Përshkrimi i riskut: Mundësia që shkollat e reja të mos funksionojnë pasi të jenë ndërtuar lidhet me kryerjen e punimeve jo cilësore nga ana e koncensionarit, çka do ta bënte zhvillimin e mësimit në godinat e reja të pamundur. Ky risk ka probabilitet të ulët pasi kryerja e punimeve do të mbikqyret nga mbikqyrësi teknik dhe situacionet financiare do të mbikqyren nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket riskut që kostoja e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa pritej, probabiliteti është thuajse zero, pasi kostoja vjetore e mirëmbajtjes është llogaritur duke u bazuar në shpenzimet vjetore të Bashkisë Tiranë për mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, të cilat janë ndërtuar para shumë viteve. Sipas standarteve inxhinierike, kostoja e mirëmbajtjes së objekteve të sapondëruara është me e ulët se ajo e objekteve të ndërtuara kohë më parë.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtij risku është i ulët dhe ai cilësohet si një risk i transferuar tek koncensionari. Në rast se cilësia e ndërtimit do të jetë e tillë që do ta bëjë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të mbajë përgjegjësi dhe do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë derisa cilësia e punimeve të jetë në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Në rast se, për shkak të punimeve të kryera gjatë ndërtimit, gjatë peiudhës 7 vjeçare të zgjatjes së kontratës, godinat shkollore do të shfaqin probleme që do ta bëjnë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë për ta bërë shkollën sërish funksionale. Në rast se kostoja e mirëmbajtjes do të rezultojë më e lartë se parashikimi, kjo do të vijë si pasojë e pasaktësive në projektim ose ndërtim. Rrjedhimisht, risku bie mbi konçensionarin, i cili ka përgjegjësinë të projektojë dhe ndërtojë shkollat.

Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare

Përshkrimi i riskut: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej apo të ardhurat e gjeneruara janë më të ulëta se sa parashikimi. Duke qenë se objektet që do të ndërtohen janë godina shkollore të cilat nuk mund të kenë përdorim të ndryshëm e nuk mund të gjenerojnë të ardhura, ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin në fjalë.

Menaxhimi i riskut: Mundësia që projekti të ndikohet nga ky risk është zero pasi ai nuk aplikohet mbi të.

Risqet ekonomike dhe financiare

Përshkrimi i riskut: Meqenëse ky projekt përfshin transaksione financiare të shtrira në kohë, ekziston mundësia që ai të ndikohet nga risqet ekonomike e financiare. Rritja e paparashikuar e normave të interesit mund të rrisë kostot e financimit të projektit nga ana e koncensionarit. Nga

ana tjetër, ndryshimet në kursin e këmbimit valutor mund të kënë ndikim përkeqësues në financat e koncencionarit në rast se të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë në monedha të ndryshme, për shembull koncensionari ka marrë kredi në Euro apo Dollarë për financimin e projektit, ndërkohë që Bashkia e Tiranë ia kryen pagesat vjetore në Lekë. Së fundi, duke qenë se ky projekt përfshin pagesa periodike për një periudhë 7 vjeçare, ekziston mundësia që të ardhurat e koncensionarit të preken nga inflacioni.

Menaxhimi i riskut: Duke qenë se Shqipëria konsiderohet një vend me një situatë makroekonomike të qendrueshme, probabiliteti që projekti të ndikohet nga ky risk mbetet i ulët. Risku i normave të interesit apo i normave të këmbimit valutor është një risk që bie mbi konçensionarin dhe duhet të llogariten në parashikimet e tij financiare. Risku i inflacionit është një risk që ndahet mes Bashkisë Tiranë dhe konçensionarit. Meqenë se politika e Bankës së Shqipërisë është mbajtja e inflacionit nën 3% dhe kohëzgjatja e projektit është vetëm 7 vjet, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, në përcaktimin e marzhit të fitimit si të lidhur me normën e interesit për obligacionet 7 vjeçare, Bashkia e Tiranës garanton për konçensionarin të njëjtën mbrojtje ndaj risqeve ekonomike e financiare që garanton edhe Qeveria e Shqipërisë për blerësit e obligacioneve.

Risqet e pronësisë së aseteve

Përshkrimi i riskut: Ky riskt lidhet me mundësinë që teknologjia të vjetërohet apo që vlera e aseteve të jetë e ndryshme në fund të kontratës. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtim godinash shkollore, të cilat do të mirëmbahen nga konçensionari për një periudhë 7 vjeçare, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të mirëmbajtjes jo cilësore, në fund të kontratës cilësia dhe vlera e aseteve të jetë më e ulët nga parashikimi.

Menaxhimi i riskut: Ky risk transferohet te konçensionari. Mirëmbajtja e godinave shkollore dhe mobiljeve e pajisjeve të tyre do të bëhet në përputhje me standartet në fuqi dhe do të mbikqyret nga autoriteti kontraktor. Në rast se konçensionari nuk do t'i mirëmbajë shkollat sipas përcaktimit të mësipërm, në kontratën e konçensionit do të parashikohen dispozita që e detyrojnë atë të shlyejë dëmin e shkaktuar. Në rast se në fund të kontratës, vlera e aseteve do të jetë e ndryshme nga sa është dakordësuar, në kontratën e koncensionit do të përcaktohen dispozita që do të detyrojnë koncensionarin të shlyjë dëmin.

Risku politik

Përshkrimi i riskut: Risku që vendimet politike të ndikojnë mbi projektin është evident. Duke qenë një projekt i nisur nga Bashkia e Tiranës, një organ i qeverisjes lokale, suksesi i këtij projekti varet nga dakordësia me qeverisjen qendrore. Gjithashtu, ekziston mundësia që si rezultat i zgjedhjeve lokale të ardhshme, një ndryshim i mundshëm në kreun e Bashkisë Tiranë mund të sjellë ndryshimin e prioriteteve, e për rrjedhojë bllokimin e projektit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi autoritetin kontraktor, Bashkinë Tiranë. Për të siguruar dakordësinë e institucioneve të qeverisjes qendrore, me miratimin e studimit të fizibilitetit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket riskut të ndikimit negativ të projektit si rezultat i

ndryshimeve në drejtimin e Bashkisë Tiranë, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që pengojnë prishjen e kontratës për arsye jo të ligjshme nga ana e autoritetit kontraktor.

Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor

Përshkrimi i riskut: Ndryshimet e mundshme në kuadrin legjislativ mund ta ndikojnë projektin si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Duke qenë se projekti lidhet me ndërtimin e godinave shkollore, mundësia që ai të afektohet nga ndryshimet ligjore lidhet vetëm me standartet dhe manualet e ndërtimit. Ndaj, ky risk ka një probabilitet të ulët që të ndodhë. Përsa u përket ndryshimeve të ligjeve fiskale, ndikimi negativ apo pozitiv ndjehet vetëm në financat e konçensionarit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Në mënyrë që efektet e tij të jenë sa më minimale, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që e mbrojnë atë nga ndryshimet diskriminuese në ligj – gjithmonë, nëse diskriminimi provohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, konçensionari do të jetë i detyruar të zbatojë çdo ndryshim ligjor që vjen si rezultat i politikave të qeverisë.

Risku i forcës madhore

Përshkrimi i riskut: Risqet e forcës madhore si fatkeqësitë natyrore, trazirat civile apo luftërat bien si mbi konçensionarin ashtu edhe mbi autoritetin kontraktor. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria është antare e NATO dhe me perspektivën e qartë të integrimit në BE, probabiliteti i risqeve si luftërat apo trazirat është thuajse zero. Nga ana tjetër, probabiliteti që projekti të ndikohet nga tërmetet apo fatkeqësitë e tjera natyrore ka gjithashtu pak gjasa që të ndodhë, siç ka rezultuar edhe nga analiza e mësipërme e ndikimit mjedisor të projektit.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtyre risqeve është shumë i ulët dhe bie mbi të dyja palët. Në kontratën konçensionare do të parashikohen klauzolat e forcës madhore të cilat do garantojnë që të çdo ndikim negativ mbi projektin të ndahet ndërmjet palëve.

1.14.2. Analiza sasiore e risqeve

Kjo analizë synon të prioritizojë risqet që mund të ndikojnë projektin duke përllogaritur probabilitetin e tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi arritjen e objektivave të projektit. Vlerësimi sasior është bazuar në probabilitetin e ndodhjes të secilit risk dhe në ndikimin e mundshëm mbi koston dhe afatet e projektit.

Ndikimi i risqeve mbi koston e projektit është llogaritur duke u bazuar mbi peshën specifike që zë secili prej tyre në koston e projektit. Ndërsa, ndikimi mbi afatin e përfundimit të punimeve është përllogaritur duke u bazuar në afatet ligjore për kryerjen e procedurave të caktuara që mund të nevojitet të ndiqen për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Më poshtë vijon një analizë sasiore mbi ndikimin që mund të ketë secili risk në koston dhe afatet e realizimit të projektit.

Risku i trojeve. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 0-5%. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është zero pasi shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për ndërtimin e shkollave do të kryhet nga Bashkia e Tiranës me një fond të veçantë jashtë skemës financiare të këtij projekti. Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e shkollave janë prona shtetërore dhe prona private. Në rast se përdorimi i ndonjërit prej këtyre trojeve është i pamundur, do të përdoret një prej trojeve alternative të përzgjedhura për të cilat është marrë informacion edhe pranë ZRPP. Rrjedhimisht, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve lidhet me marrjen në dorëzim të pronës shtet, në rast se nuk është pronë e Bashkisë Tiranë, ose shpronësimin e pronave private. Ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur 3 – 6 muaj.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 5-10%. Kostimi i ndërtimit të shkollave është bërë në përputhje me manualet udhëzuese të MAS dhe në bazë të kostove të ndërtimit të shkollave nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit dhe çmimet janë indeksuar sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit të INSTAT. Ndaj, ndikimi maksimal që ky risk të ketë në kosto është më i vogël se 5%. Nga ana tjetër, afati i punimeve mund të mos respektohet si rezultat i mos marrjes në kohë të lejes së ndërtimit apo lejeve të tjera nga ana e konçensionarit apo edhe nga kryerja e punimeve më ngadalë sesa është parashikuar në kalendarin e punimeve. Në rast se projektimi vonohet apo nuk plotësohet dokumentacioni për pajisjen me lejet e nevojshme, ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur nga 3 deri në 12 muaj.

Risku i funksionimit. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur nga 0-5%. Duke qenë se ky projekt lidhet me ndërtimin e shkollave të reja, ekziston mundësia që cilësia e ndërtimit të jetë e ulët, çka do të bënte që të kërkoheshin punime shtesë përtej afatit të përcaktuar. Ndikimi i këtij risku në afatin e punimeve është përllogaritur nga 1 deri në 3 muaj, ndërsa ndikimi mbi koston totale të projektit është përllogaritur 5-10%. Ekziston edhe mundësia që kosto e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa është përllogaritur, por krahasuar me koston totale të projektit ndikimi i kësaj kostoje është thuajse i papërfillshëm.

Risku i kërkesës dhe risqet e tjera tregtare. Ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin dhe munësia që ai të ndikojë koston apo afatet e realizimit të tij është zero.

Risqet ekonomike dhe financiare. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i ulët, 0-5%, duke marrë në konsideratë se nuk kemi të bëjmë me një konçension afat-gjatë ku konçensionari i nxjerr të ardhurat nga operimi i objektit të konçensionit. Duke qenë se të ardhurat e konçensionarit janë të garantuara nga Bashkia Tiranë dhe të mbrojtura nga inflacioni, ndikimi i riskut mbi koston totale të projektit është i ulët, 5% - 10%. Nga ana tjetër, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve, nuk parashikohet më i lartë se 12 muaj.

Risqet e pronësisë së aseteve. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur 0 – 5%. Ndikimi i tij mbi koston totale të projektet lidhet me koston e mirëmbajtjes, në rast se kjo e fundit rezulton më e lartë se parashikimet dhe me amortizimin e godinave më shpejt se sa është parashikuar në kontratën e koncensionit. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është llogaritur të jetë maksimimumi 5%. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku nuk i ndikon aspak afatet e realizimit të punimeve.

Open Procurement Albania

Risku politik. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i mesëm i ulët dhe është llogaritur 10 - 20%. Ndodhja e këtij risku mund të bllokojë punimet në mes ose mund të ndërpresë pagesat periodike për konçensionarin, duke rritur koston e financimit të projektit dhe duke vonuar realizimin e punimeve. Për këto arsye, ndikimi i mundshëm i këtij risku mbi kosto është përllogaritur 20 – 30% ndërsa ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve është përllogaritur nga 16 deri në 24 muaj.

Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor. Ky riskt ka një probabilitet ndodhjeje që varion nga 5 deri në 15%. Ndryshime të mundshme ligjore, si për shembull në standartet që duhet të ndjekë ndërtimi i shkollave të reja mund të rrisin ndjeshëm koston e projektit. Prandaj edhe impakti i mundshëm mbi kosto është llogaritur të jetë i mesëm, nga 20 deri në 40%. Gjithashtu, ndryshime të mundshme ligjore mund të çojnë në ribërjen e projekteve apo në vonesa të tjera, çka do të ndikonte negativitsh afatin e realizimit të punimeve. Ndaj, ndikimi mbi afatin e punimeve është llogaritur nga 12 deri në 16 muaj.

Risku i forcës madhore. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është shumë i ulët, nga 0 deri në 5%. Megjithatë, në rast të ndodhjes ndikimi mbi koston apo afatin e punimeve do të ishtë i mesëm i lartë. Kësisoj, ndikimi mbi koston është përllogaritur nga 30% deri në 50% ndërsa ndikimi mbi afatin e punimeve nga 12 deri në 24 muaj.

Tabela 136 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve

Nr.	Risku	Probabiliteti i ndodhjes	Ndikmi mbi kosto	Ndikimi mbi afatin e punimeve
1	Risku i trojeve	0% - 5%	0%	3 – 6 muaj
2	Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	5% - 10%	0% -5 %	3 – 12 muaj
3	Risku i funksionimit	0% - 5%	5% - 10%	1 – 3 muaj
4	Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	-	-	-
5	Risqet ekonomike dhe financiare	0% - 5%	5% - 10%	6 – 12 muaj
6	Risqet e pronësisë së aseteve	0% - 5%	0% - 1%	-
7	Risku Politik	10% - 20%	20% - 30%	16 – 24 muaj
8	Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	5% - 15%	20% - 40%	12 – 16 muaj
9	Risku i forcës madhore	0% - 5%	30% - 50%	12 – 24 muaj

Open Procurement Albania

Tabela 137 Analiza e ndjeshmërisë

1.15. Analiza e ndjeshmërisë

Faktori kryesor që mund të ndryshojë gjatë procesit të tenderimit, është Marzhi i fitimit. Njëkohësisht, në varësi të projekteve që do të miratohen, detajimi i kostove përkatëse do të bëhet përkatësisht, bazuar mbi projektet faktike të miratuara. Kosto direkte do të përllogaritet bazuar në volume faktike të realizuara, të cilat në asnjë rast nuk mund të jenë më të larta sesa kosto e parashikuar e këtij projekti.

Gjithësesi për efekte të analizës së ndjeshmërisë, do të llogarisim sikur secila nga kostot ulet dhe rritet me 5% dhe 10% dhe marzhi i fitimit ulet dhe rritet përkatësisht me 5% dhe 10%:

	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 10%	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 5%	Modeli Baze	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 5%	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 10%
Norma e Sensitivitetit	10%	5%	0	-5%	-10%
Flukse dalese nga Investimet	- 7,267,445,188	- 6,937,106,771	- 6,606,768,353	- 6,276,429,936	-5,946,091,518
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	- 1,275,711,645	- 1,217,724,752	- 1,159,737,859	- 1,101,750,966	-1,043,764,073
Të Ardhurat	10,274,681,048	9,786,000,321	9,197,517,960	8,713,446,063	8,188,265,320
Fitimi Para taksave	1,731,524,215	1,631,168,798	1,431,011,748	1,335,265,161	1,198,409,729
Tatim Fitimi 15%	- 259,728,632	- 244,675,320	- 214,651,762	- 200,289,774	- 179,761,459
Fitimi neto	1,471,795,583	1,386,493,478	1,216,359,986	1,134,975,387	1,018,648,270
NPV me 5.79%	110,223,600	81,672,242	170,329	- 23,634,170	- 68,587,789
IRR	6.38%	6.25%	5.79%	5.64%	5.34%
Norma e Vetëshlyerjes	5.20	5.28	5.35	5.43	5.51

Open Procurement Albania

8.3 Loti 3

8.3.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 3

Loti 3 përfshin 4 shkolla, nga të cilat 2 në Njësinë Administrative 2 , një në Njësinë Administrative 5 dhe një në Njësinë Administrative Farkë. Shpërndarja e shkollave të përfshira në Lotin 3 tregohen në hartën e mëposhtme:

Harta 121 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 3



8.3.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 3

SHESHI 2/6

Harta 122 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA:

Sheshi i propozuar nr. **2/6** për ndërtimin e një shkollë 9 vjeçare dhe një shkolle të mesme ndodhet në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, në njësinë administrative nr 2. Aksesohet nga rruga "e Elbasanit" dhe rruga " Haxhi Aliaj".

TË DHËNA TEKNIKE: Sheshi ka një sipërfaqe prej 5425 m^2.

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:
- Është në një zonë relativisht të qetë dhe lehtësisht e aksesueshme.
- Është një zonë në zhvillim e sipër, me ndërtesa të ulëta 2-3 katëshe.
- Infrastruktura rrugore është e mirë.

Figura 15 Foto të sheshit 2/6

SHESHI 5/1

Harta 123 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr.5/1 për shkollë 9-vjeçare ndodhet pranë zonës së liqenit. Aksesohet nga rruga Hasan Alla dhe Autostrada Tiranë-Elbasan.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 5/1 : 3269 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Ndodhet pranë kopshtit botanik, nje zonë me intensitet të larte banimi.
- Akses i lehtë.

Figura 16 Foto të sheshit 5/1

SHESHI F3

Harta 124 Ortofoto te sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr.**F3**

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi F3 : 8340 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:

- Akses i vështirë
- Sheshi relativisht i pjerrët
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Figura 17 Foto të sheshit F3

Open Procurement Albania

8.3.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 3

Sheshi 2/6



Tabela 138 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/ m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet	Ndert.te paligjshëm	8190	12/289	855.00	66969			0.0
2	Truall Shtet		8190	12/290	4570.00	66969			0.0
					5425.00				0.0

Shkolla që do të ndërtohet në këtë zonë do të prekë gjithsej 5425 metra katrorë pronë, të përbërë nga 2 prona shtetërore. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Sheshi 5/1

Harta 126 Harta treguese e pronave



Tabela 139 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Atësia	Mbiemër	Zona Kadast.	NR. Pasuri së	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
4	Shtet			8270	8/700	141.00	66969			9,442,629.0
8	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/935	358.00	66969			23,974,902.0
9	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/920	149.00	66969			9,978,381.0
10	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/922	82.50	66969			5,524,942.5
11	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/937	294.00	66969			19,688,886.0
12	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/923	74.00	66969			4,955,706.0
13	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/510	436.00	66969			29,198,484.0
14	Shtet			8270	8/667	77.00	66969			5,156,613.0
15	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/509	202.00	66969			13,527,738.0
16	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/224	519.00	66969			34,756,911.0
17	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/505	95.00	66969			6,362,055.0
18	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/511	285.00	66969			19,086,165.0
19	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/503	244.00	66969			16,340,436.0
20	Sabri	Shaqir	Pinari	8270	8/507	74.00	66969			4,955,706.0
21	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/441	191.00	66969			12,791,079.0
22	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/925	47.50	66969			3,181,027.5
23	Bashkpronarët		Pinari	8270	8/929	212.00	66969			14,197,428.0
						3269.00				218,921,661.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8270 do të prekë gjithsej 3269 metra katrorë pronë, të përbërë nga 23 prona, nga të cilat 22 prona private dhe 1 pronë shntetërore. Pasuria me nr. 8/667 është pronë shtetërore. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Sheshi F3

Harta 127 Harta treguese e pasurive



Tabela 140 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Shtet Rruge		3292	350	822.00	448			0.0
2	Harta e Paqarte	Nuk ka nr.pasurie	3292		1675.00	448			750,400.0
3	Isuf Alla	Ullishte	3292	141/2	4554.00	448			2,040,192.0
4	Harta e Paqarte		3292	141/3	1289.00	448			577,472.0
					8340.00				3,368,064.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8292 do të prekë gjithsej 8,340 metra katrorë pronë, të përbërë nga 4 prona, nga të cilat 8 objekte në pronësi private, 1 objekt, me nr. 12/16 në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe 1 objekt tjetër për të cilin ende nuk ka informacion. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Open Procurement Albania

8.3.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 3

Në Lotin 3 është parashikuar ndërtimi i 4 shkollave gjithsej. Përkatësisht në Njësië 2, Njësinë 5 dhe Njësinë Farke. Më konkretisht, në NJA 5 është parashikuar të ndërtohet një shkollë e ciklit arsimor bazë të tipit 2. Në NJA 2 është parashikuar ndërtimi i një shkolle të ciklit arsimor bazë e tipit 2 dhe nje tjetër e ciklit të mesëm të lartë, pra e tipit 4. Ndërsa në NJA Farkë ëahtë parashikuar ndërtimi i një shkolle të ciklit arsimor bazë e tipit 1. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen më në detaj dallimet mes tipeve të shkollave sipas vendndodhjes, ciklit arsimor, nr e klasave dhe nxënësve për klasë, etj,.

Tabela 141 - Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

8.3.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 3

2. Analiza ekonomike dhe financiare

Analiza ekonomike dhe financiare e këtij studimi fizibiliteti, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, ka si objektiv kryesor të saj që të përcaktojë vlerën e parasë së projektit si dhe të bëjë një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes si edhe të çdo të ardhure që pritet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Open Procurement Albania

2.1. Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

Ligji nr. 125/2013 rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private. Në këtë lloj marrëdhënieje, partneri privat merr përsipër që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë /të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtaz. Ndër fushat e zbatimit të këtij ligji është edhe arsimi.[49]

Nga analiza e të dhënave rezulton se për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit të shkollave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne, Bashkia Tiranë duhet të ndërtojë 17 shkolla të reja, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Kosto totale e ndërtimit dhe mobilimit të këtyre shkollave llogaritet në 7.6 miliard lekë. Një shifër e tillë është financiarisht e papërballueshme për Bashkinë e Tiranës, buxheti total vjetor i së cilës është 10 miliard lekë, ndërsa investimet për ndërtimin e shkollave të reja gjatë viteve të fundit kanë qenë jo më shumë se 500 milion lekë.

[49] Neni 4, pika dh), Ligji 125/2013

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin "Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje" (PFNM), ose ndërkombëtarisht i njohur me termin "Design, Build, Finance & Operate (DBFO)", kontraktorët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Kontraktori, i cili mund të jetë një kompani e vetme apo një konsorcium është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e objektit për një periudhë të caktuar kohore, e cila propozohet të jetë 7 vjet. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre. Githashtu, integrimi i të gjitha kontratave të projektit në një të vetme redukton kostot e ndryshme transaksionale dhe rrit efiçencën e menaxhimit të projektit.
Më së shumti ky model PPP-je është përdorur për ndërtimin e projekteve infrastrukturore madhore të tilla si ndërtimi i autostradave, hidrocentraleve, impianteve të menaxhimit të mbetjeve, etj,. Kjo për shkak se përmasat e mëdha të projekteve të tilla kërkojnë fonde të konsiderueshme, organizim sa më efektiv të burimeve kapitale dhe njerëzore, cilësi të lartë projektimi dhe ndërtimi, siguri maksimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për këtë arsye modele të tilla si PFNM apo të ngjashme, janë parë si nga më të suksesshmet për të zhvilluar projekte që garantojnë realizueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e investimit të kryer. Megjithatë përdorimi i kësaj forme të PPP nuk është kufizuar vetëm tek projektet e mëdha të infrastrukturës publike të përmendura më sipër. Në shumë vende të OECD-së, por më gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar, kjo metodologji është përdorur gjithashtu për projekte të shërbimeve publike të tilla si ndërtimi i shkollave të reja.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj nga vende të ndryshme të cilat kanë zbatuar me sukses këtë model për projekte të infrastrukturës arsimore:

Kanada[50]**:** Programi "Alberta Schools Alternative Procurement". Në vitin 2007 krahina e Albertës në Kanada shpalli fazën e parë të programit i cili parashikonte ndërtimin e 18 godinave të reja shkollore (kopshte dhe shkolla 9-vjeçare) të cilat kanë përunduar ndërtimin në vitin 2010. Pas përfundimit të ndërtimeve, jetëgjatësia e kontratës e cila do vijojë me pjesën e mirëmbajtjes

[50] "Flexible and alternative approaches to providing school infrastructure in Alberta, Canada" – OECD, 2010

është përcaktuar rreth 30 vjet. Faza e dytë e programit përfshinte ndërtimin e 10 shkollave të tjera 9-vjeçare sipas të njëjtit model dhe 4 gjimnazeve nëpërmjet modelit të thjeshtë të kontratës Projektim-Ndërtim të cilat kanë përfunduar në vitin 2013.

Greqi[51]: Programi "Macedonia Schools and Attica Schools". Duke përdorur mekanizmin DBFM operatorët privatë projektuan ndërtimin e 51 shkollave me një vlerë totale prej 269 milion Euro dhe me kontrata 25 vjeçare.

Mbretëri e Bashkuar[52]: Programi "Building Schools for the future". Ky program është një program afat-gjatë investimesh i cili po kontribuon në ndërtimin e një numri të konsiderueshëm shkollash në gjithë territorin e MB-së. Shumica e shkollave janë ndërtuar nëpërmjet skemës Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje, por në këtë rast shpesh herë është përfshirë edhe elementi i menaxhimit të shkollës nga subjekti privat për një periudhë të caktuar. Zakonisht kohëzgjatja totale e kontratës arrin deri në 30 vjet. Konsorciumi privat paguhet rregullisht nga fondet publike bazuar në performancën e tij gjatë periudhës së kontratës. Nëse konsorciumi nuk arrin performancën e synuar pagesa reduktohet. Në fund të periudhës së kontratës shkolla i kthehet qeverisë.

Zelandë e Re[53]: Projekti i Ministrisë së Arsimit të Zelandës së Re për ndërtimin e dy shkollave në Hobsonville, Auckland. Ky projekt parashikonte ndërtimin e një shkolle të re të ciklit të ulët dhe një shkolle të ciklit të mesëm të ulët në rajonin periferik të Hobsonville në qytetin Auckland. Sektori privat ishte pjesërisht përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objekteve, sëbashku me sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre si dhe menaxhimin e shërbimeve të përbashkëta. Ndërtimi i këtyre shkollave ka përfunduar me sukses në vitin 2014.

Nën këtë prizëm, projekti i ndërtimit të shkollave të reja të Tiranës e sheh të nevojshme aplikimin e të njëjtës qasje për përmirësimin e shërbimit arsimor në gjithë territorin e Bashkisë. Numri i madh i shkollave që do të ndërtohen, kufizimet financiare, koha e shkurtër e zbatimit të projektit si dhe nevoja për garantimin e cilësisë maksimale të ndërtesave theksojnë nevojën për ngritjen e një partneriteti public privat efektiv dhe të suksesshëm.

2.2.Supozimet kryesore

Për efekt të analizës ekonomike e financiare të këtij studimi fizibiliteti, janë bërë supozimet si më poshtë:

- Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për ndërtimin e objekteve arsimore dhe vënien në funksion të tyre, ndërsa Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për këtë qëllim.

[51] "The role and impact of public-private partnerships in education", Fq. 82 – Banka Botërore, Mars 2009 .http://www.ungei.org/resources/files/Role_Impact_PPP_Education.pdf
[52] Ibidem (dmth: marrë nga i njëjti dok i Bankës Botërore në referencën e mësipërme dhe në të njëjtën faqe)
[53] "Mayoral Position Paper on Public Private Partnerships" – Ernst and Young, Nëntor 2013.

- Objektet arsimore do të jenë të ndërtuara e funksionale maksimalisht 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Pas ndërtimit vënien në funksion të shkollave, koncesionari do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për një periudhë 7 vjeçare dhe për çdo problematikë për administrimin dhe reziqet e aseteve për këtë periudhe.
- Pas ndërtimit të objekteve, Bashkia Tiranë do t'i paguajë koncesionarit një shumë të caktuar vjetore deri në shlyerjen e plotë të shumës së investuar. Të ardhurat për këto pagesa do të sigurohen nga të ardhurat vjetore nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore dhe nga transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave.

2.3.Analiza e kostove

Bazuar në studimin teknik, është arritur në përfundimin se në total do të ndërtohen 17 shkolla, prej të cilave 10 shkolla 9 vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e reja do të projektohen e ndërtohen sipas modeleve në përputhje me standartet e specifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes udhëzuesit" Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar. Referuar standarteve të sipër-përmendura, janë përcaktuar 4 tipe kryesore shkollash, me të dhëna operacionale si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tipi 1 i shkollave, është me 20 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,938 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 4 klasash, me nje sipërfaqe prej 874 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 5,812 m2. **Tipi 2** i shkollave, është përsëri 9 vjeçar, me 30 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 6,588 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 6 klasash, me nje sipërfaqe prej 1,310 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 7,898 m2. **Tipi 3** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat rurale me 20 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,041 m2. **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4001 m2.

Nga analiza sasiore e kryer dhe e shpjeguar më sipër për **Loti 3** janë gjithsej **4 shkolla**, nga të cilat, 2 shkolla nga Tipi 2, 1 shkollë e Tipit 3 dhe 1 shkollë të mesme nga Tipi 4. Përkatësisht këto shkolla do të ndërtohen në njësitë administrative dhe me të dhënat si më poshtë:

Tabela 142 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 3

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	nxënës për klasë	Nxënës për shkolle	Sipërfaqe totale shkolla	Klasa kopësh ti	Nxënës për klasë kopështi	nxënës për kopësht	Sipërfaqe totale kopësht	Siperfaqe totale ndertimi
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
2	NJA 02	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
3	NJA 05	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
4	NJA Farke	Tipi 3	9-vjeçar	20	24	480	4,041	4	24	96	874	4,915
Totali				101		2,910	21,217	16	72	384	3,494	**24,711**

Duke i permbledhur sipas tipologjisë së shkollave, në total kemi këto të dhëna operacionale:

Tabela 143 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 3

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Nr nxënës për klasë	Nxënës për shkollë	Nr klasa kopështi për shkollë	Nr nxënës për klasë kopështi	Nxënës për kopësht	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Total Nxënës në shkolla	Total Nxënës në Kopështe	Nr Total i nxënësve
Tipi 2	2	30	30	900	12	24	144	13,176	2,620	15,796	1,800	288	2,088
Tipi 3	1	20	24	480	4	24	96	4,041	874	4,915	480	96	576
Tipi 4	1	21	30	630	-	-	-	4,001	-	4,001	630	-	630
Grand To	**4**	**71**				**48**	**240**	**21,217**	**3,494**	**24,711**	**2,910**	**384**	**3,294**

Për të analizuar sa më mirë vlerën e parasë së projektit, kemi bërë grupimin e shpenzimeve në 4 kategori kryesore, duke u bazuar dhe në standartet e kontabilitetit si dhe në kërkesat e VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, paragrafi 3-6:

- Kostot e drejtpërdrejta të investimeve;
- Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes;

Për efekt të analizave të mëposhtme të gjitha çmimet dhe vlerat do të jenë pa TVSH, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

2.3.1. Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Gjatë analizës dhe në përputhje dhe me VKM të sipërcituar, u identifikuan këto kosto të drejtëpërdrejta të investimeve:

25. Kosto e Shpronësimit të Truallit;
26. Kosto e Ndërtimit;
27. Kosto e Studim Projektimit;
28. Kosto e Supervizimit;

29. Kosto e Kolaudimit;
30. Oponenca teknike;
31. Kosto për Mobilje dhe Orendi;
32. Kosto e pajisjeve të laboratorëve.

2.3.1.1.Kosto e Shpronësimit të Truallit

Nga përcaktimi i gjurmës se ku do të ndërtohen këto shkolla, ka rezultuar se do të shpronësohen në nga privatët në total **10,781 m2**, të cilat sipas përllogaritjeve nga të bëra, parashikohet që në total vlera e shpronësimit të shkojë në **221,887,911** lekë. Nga ana tjetër, për tokën shtet, do të ndiqen procedurat përkatëse për të marrë nën administrim pronat përkatëse.

Nr rendor i tabeles	Adresa	Tipi	Sheshi	Shpronesimi ne Vlere	m2 te shpronesuar	mesatar per m2
3	NJA 05	Tipi 2	5/1	218,519,847	3,263	66,969
4	NJA Farke	Tipi 3	F3	3,368,064	7,518	448
Grand Total				**221,887,911**	**10,781**	**20,581**

Me daljen e VKM për këtë qëllim dhe plotësimin e dokumentave financiarë dhe ligjorë në përputhje me VKM dhe me aktet normative në fuqi, çdo i shpronësuar do të likujdohet nga Bashkia Tiranë me anë të fondit që do të përcaktohet për këtë qëllim.

2.3.1.2.Kostot e Ndërtimit

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 228,785,770 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 276,314,618 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 305,233,020 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 71,238,892 lekë. Rrjedhimisht, kosto e

përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 376,471,912 lekë.

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 187,207,732 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 234,736,581 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë dhe këto shkolla nuk kanë ambjente kopështi.

Tabela 145 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 3

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopështi për shkollë	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
Tipi 2	2	30	6	13,176	2,620	15,796	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	752,943,823
Tipi 3	1	20	4	4,041	874	4,915	46,332	54,381	187,207,732	47,528,848	234,736,581	234,736,581
Tipi 4	1	21	-	4,001	-	4,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	185,349,833
Grand To	**4**	**71**	**10**	**21,217**	**3,494**	**24,711**	**138,995**	**163,143**	**677,790,585**	**118,767,740**	**796,558,325**	**1,173,030,237**

Në total, do të ndërtohen **2 shkolla të tipit 2** me kosto ndërtimi 376,471,912 lekë për shkollë, **1 shkolla të tipit 3** me kosto ndërtimi 234,736,581 lekë për shkollë dhe **1 shkolla të tipit 4** me kosto ndërtimi 185,349,833 lekë për shkollë. Rrjedhimisht, kostoja total e ndërtimit për **Loti 3** shkon në **1,173,030,237**lekë. Kjo është një kosto që do të mbulohet nga koncensionari.

Open Procurement Albania

2.3.1.3. Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit

Bazuar dhe në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostot e tjera direkte të investimit janë:

- Studim projektimi;
- Mbikqyrja e punimeve;
- Kolaudimi;
- Oponenca teknike;
- Mbrojtja ndaj zjarrit;
- Leja mjedisore;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

a 146 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 3

Duke marrë parasysh të dhënat e analizuara në kapitullin respektiv mbi kostot, rezulton se kostot e tjera të drejtpërdrejta të investimit janë si më poshtë vijon:

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Tot Sipërfaq e ndërtimi	Kosto Studim Projektim	Kosto Mbikqyrje	Kosto kolaudimi	Oponenca teknike	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
Tipi 2	2	15,796	20,220,768	8,355,808	301,178	501,350	100,000	60,000
Tipi 3	1	4,915	6,638,188	2,703,942	93,917	208,967	50,000	30,000
Tipi 4	1	4,001	5,345,869	2,182,240	76,855	184,846	50,000	30,000
Grand To	**4**	**24,711**	**32,204,825**	**13,241,990**	**471,950**	**895,163**	**200,000**	**120,000**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0.

2.3.1.4.Kosto e mobilimit

Për të vënë në përdorim shkollat, nevojitet pajisja e secilës prej tyre me, pajisjet e nevojshme IT si edhe laboratoret e nevojshme. Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara, referuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24,167 lekë. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tabela 147 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit

Tipi shkollës	Nr. klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

Në koston e mobilimit për arsimin bazik janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth 27,916 lek. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 148 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmijë	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana juaj, kontratë blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 149 Kosto për pajisjen e Laboratorëve

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator
1	Laborator Shkencat natyrore	186,998
2	Laborator Kimie	223,125
3	Laborator Fizike	1,183,602
4	Laborator Biologjie	632,467
5	Laborator IT	3,869,658
II	Shkolla e Mesme	-
1	Laborator Kimie	528,469
2	Laborator Fizike	1,294,500
3	Laborator Biologjie	651,657

Open Procurement Albania

4	**Laborator IT**	3,869,658

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Tabela 150 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	**Arsimi Bazik (Tipi 1)**	6,095,850
2	**Arsimi Bazik (Tipi 2)**	7,279,450
3	**Arsimi Bazik (Tipi 3)**	5,743,950
4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e **4 shkollave është 115,330,917** pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 151 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 3

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Kosto e mobilimit te shkollave	Kosto e mobilimit të kopështeve	Total Kosto Mobilimi	Kosto Laboratori	Total kosto pajisje, mobilje dhe orendi
Tipi 2	2	43,500,000	8,040,000	51,540,000	14,558,900	66,098,900
Tipi 3	1	11,600,000	2,680,000	14,280,000	5,743,950	20,023,950
Tipi 4	1	15,225,000	-	15,225,000	13,983,067	29,208,067
Grand To	**4**	**70,325,000**	**10,720,000**	**81,045,000**	**34,285,917**	**115,330,917**

2.3.1.5.Kosto direkte e Investimit

Në përfundim, kosto direkte e investimit të këtij projekti është **1,557,382,992 lekë**. Nga këto, **221,887,911** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga koçesionari është **1,335,495,081** lekë, ku kosto e ndërtimit është **1,173,030,237** lekë pa TVSH, Kosto e Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **162,464,845** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Tabela 152 Kosto direkte investimi për Lotin 3

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,557,382,992**
A.1	**Kostot e Truallit**	**221,887,911**
A.2	Kostot e Projektimit	32,204,825
A.3	- Ndertim + instalime	1,173,030,237
A.4	- Oponenca teknike	895,163
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	13,241,990
A.9	- Kosto Kolaudimi	471,950
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	81,045,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	34,285,917

2.3.2 Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Bazuar dhe nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose 351,755 lekë pa TVSH. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat për **Loti 3** është **41,155,393** lekë në vit. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Për më shumë detaje, shih tabelat më poshtë.

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtjes për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
Tipi 2	2	12,663,198	25,326,396
Tipi 3	1	8,442,132	8,442,132
Tipi 4	1	7,386,865	7,386,865
Grand Total	**4**	**10,288,848**	**41,155,393**

ɔela 154 Kosto mirëmbajtje 7 vjeçare për Lotin 3

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë **288,087,751** lekë pa tvsh. Nga të cilat **189,682,199** lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve, dhe **98,405,552** lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një pa TVSH.

B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**288,087,751**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**189,682,199**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	43,857,912
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve	110,815,999
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi	13,872,810
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)	21,135,478
B.2	**Staf Mirembajtje**	**98,405,552**
B.2.1	Staf Roje	14,475,328
B.2.2	Staf Sanitare	62,468,042
B.2.3	Staf Sekretare	12,511,996

Open Procurement Albania

Tabela 155 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 3

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	Lyerje per klase	Riparim suvatim + hidroizolim per klase	Riparime dhe mirembajtje e Nderteses	Riparime Orendi shkollore	Riparime Pajisje PC	Materiale Pastrimi	Lëndë djegëse për ngrohje dhe ujë të ngrohtë	Mirembajtje kondicionim, impiante uji dhe MNZSH	Sherbim roje	Sherbim pastrimi	Sherbim sekretarie	Total kosto mirembajtjeje
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
2	NJA 02	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
3	NJA 05	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
4	NJA Farke	Tipi 3	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
Totali i Mirembajtjes				**117**	**2,678,257**	**2,746,933**	**840,226**	**1,981,830**	**3,019,354**	**990,727**	**9,782,711**	**5,057,419**	**3,346,502**	**8,924,006**	**1,787,428**	**41,155,393**

Open Procurement Albania

2.4. Analiza e të ardhurave të PPP

2.4.1. Tarifa e përdorimit të shkollave

Tarifa e përdorimit të shkollave (në vazhdim "Tarifa"), duhet të përllogaritet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulimin e kostove të koncensionarit si dhe të garantojë një marzh minimal fitimi për koncensionarin, në mënyrë që nga njëra anë kjo PPP të jetë atraktive dhe njëkohësisht të jetë dhe zgjidhja më e mire ekonomike krahasuar me skenarë të tjerë të mundshëm. Tarifa paguhet për gjithë periudhën e mirëmbajtjes dhe administrimit të shkollave nga ana e koncensionarit, pra për 7 vite. Kjo tarifë në vetvete paguhet çdo vit nga Bashkia Tiranë përmes burimeve të financimit të detajuara si më poshtë. Përmes kësaj skeme, jo vetëm që sigurohet ndërtimi i 17 shkollave në kohë rekord, duke zgjidhur minimalisht çështjen e arsimimit me turne, dhe mbipopullimit të klasave, por duke qënë se të gjitha risqet për mirembajtjen dhe përdorimin me kujdes të asetit do të jenë në ngarkim të koncensionarit, dhe të lidhura dhe me pagesat, kjo do të bëjë që të kemi ndërtime cilësore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk përllogaritet marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se koncesionari vlerat e investuara për këtë qëllim, do të mbulohet në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë, si dhe për pjesën e mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme për këtë periudhë.

Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse[54], përkatësisht rezultet e obligacioneve 7 vjecare nga viti 2015 deri në 15.09.2016.

Tabela 156 Marzhi i fitimit

ISIN	Dt.Ankandi	Ankandi	Muaji	Datë Emetim	Datë Maturim	Shuma e shpallur (fillestare)	Shuma e shpallur (nd. strukture)	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Prorata Konkurues	Prorata Jo Konkuruese	Yieldi Uniform i Pranuar
AL0017NF7Y23	13.09.2016	7vjeçar/7years(fix)	Shtator	15.09.2016	15.09.2023	3,000,000		2,309,000	2,309,000			4.89%
AL0016NF7Y23	01.06.2016	7vjeçar/7years(fix)Rihapje	Qershor	03.06.2016	16.03.2023	2,000,000		3,141,400	2,000,000	4.40%		4.00%
AL0016NF7Y23	11.03.2016	7vjeçar/7years(fix)	Mars	16.03.2016	16.03.2023	3,000,000		8,247,000	2,999,900	76.48%		4.90%
AL0015NF7Y22	14.12.2015	7vjeçar-fiks	Dhjetor	16.12.2015	16.12.2022	2,500,000		5,288,600	2,500,000	67.70%	100.00%	6.79%
AL0014NF7Y22	14.09.2015	7vjeçar-fiks	Shtator	16.09.2015	16.09.2022	1,000,000		1,430,600	1,000,000	100.00%	100.00%	7.78%
AL0013NF7Y22	12.06.2015	7vjeçar-fiks	Qershor	16.06.2015	16.06.2022	3,000,000		2,953,500	2,953,500	100.00%	100.00%	7.80%
AL0012NF7Y22	12.03.2015	7vjeçar-fiks	Mars	16.03.2015	16.03.2022	2,500,000		2,815,800	2,500,000	80.98%	77.92%	7.81%
										Yieldi Mesatar i pranuar		6.28%

[54] http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise/rezultatet-e-ankandeve/2016

Marzhi i fitimit do të jetë objekt tenderimi i konkurentëve në këtë PPP, por ndërkohë është i domosdoshëm për të kuptuar sa do të jetë vlera e përgjithshme e kësaj PPP. Marzhi i fitimit, do të llogaritet, për vlerën e mbetur të investimit direkt çdo vit, dhe mbi kostot vjetore të mirëmbatjes. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, sigurohet që skema e financimit të jetë atraktive për konkurentët e mundshëm, dhe, nga ana tjetër, kosto totale e projektit të mos dalë më e lartë sesa mënyrat tradicionale të financimit.

Bazuar në përllogaritjet e kryera, tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit me marzhin prej 6.28% do të ishte si më poshtë:

Tabela 157 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,335,495,081										
2	1	1,335,495,081	6.28%	190,785,012	1,144,710,070	83,869,091	274,654,103	41,155,393	2,584,559	43,739,952	86,453,650	**318,394,054**
3	2	1,144,710,070	6.28%	190,785,012	953,925,058	71,887,792	262,672,804	41,155,393	2,584,559	43,739,952	74,472,351	**306,412,756**
4	3	953,925,058	6.28%	190,785,012	763,140,046	59,906,494	250,691,505	41,155,393	2,584,559	43,739,952	62,491,052	**294,431,457**
5	4	763,140,046	6.28%	190,785,012	572,355,035	47,925,195	238,710,207	41,155,393	2,584,559	43,739,952	50,509,754	**282,450,158**
6	5	572,355,035	6.28%	190,785,012	381,570,023	35,943,896	226,728,908	41,155,393	2,584,559	43,739,952	38,528,455	**270,468,859**
7	6	381,570,023	6.28%	190,785,012	190,785,012	23,962,597	214,747,609	41,155,393	2,584,559	43,739,952	26,547,156	**258,487,561**
8	7	190,785,012	6.28%	190,785,012	-	11,981,299	202,766,310	41,155,393	2,584,559	43,739,952	14,565,857	**246,506,262**
Grand total				**1,335,495,081**		**335,476,364**	**1,670,971,446**	**288,087,751**	**18,091,911**	**306,179,662**	**353,568,275**	**1,977,151,107**

Albania

Për të garantuar suksesin ekonomik të skemës, është menduar që koncensionari të paguhet përmes tarifave vjetore zbritëse. Kjo mënyrë pagimi do të bëntë që koncesnionari të mos vendosej në vështirësi financiare të mëdha gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës së koncensionit. Kësisoj, vitin e parë kësti do të jetë 318,394,054 lekë dhë pas çdo viti do të ulet gradualisht, deri në 1,977,151,107 lekë në vitin e fundit.

Tabela 158 Shuma e kestit vjetor

Nr rendor	Viti	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	
2	1	**318,394,054**
3	2	**306,412,756**
4	3	**294,431,457**
5	4	**282,450,158**
6	5	**270,468,859**
7	6	**258,487,561**
8	7	**246,506,262**
Grand total		**1,977,151,107**

Open Procurement Albania

2.4.2 Burimi i Financimit.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti për **Loti 3** është **2,199,039,018** lekë nga të cilat, **221,887,911** janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe **1,977,151,107** lekë është vlera e koncensionit:

Tabela 159 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 3

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**221,887,911**	**1**	**221,887,911**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**1,335,495,081**	**1**	**1,335,495,081**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,335,495,081	1	1,335,495,081
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**41,155,393**	**7**	**288,087,751**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	41,155,393	7	288,087,751
4	**Marzhi i Fitimit**	**353,568,275**	**1**	**353,568,275**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	353,568,275	1	353,568,275
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4+5)			**2,199,039,018**

Tabela 160 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	221,887,911	1,977,151,107	2,199,039,018
Totali	**221,887,911**	**1,977,151,107**	**2,199,039,018**

Open Procurement Albania

Këto shpenzime do të mbulohen përmes të ardhurave të Bashkisë, dhe Granteve të Kushtëzuara që Ministria financave do të japë për këtë projekt.

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për këtë projekt, do të gjenerohen nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila është vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për qytetin e Tiranës".

Tabela 161 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore

E m ë r t i m i	PLANI VITI 2016	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018
Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	**870 000 000**	**940 000 000**	**1 000 000 000**
Familjarët	320 000 000	340 000 000	350 000 000
Subjektet Tregtare	550 000 000	600 000 000	650 000 000

Të ardhurat nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore janë planifikuar të jenë 870 milionë lekë në vitin 2016, ndërkohë që këto të ardhura parashikohet të rriten në 940 milionë lekë në vitin 2017 dhe 1 miliard lekë në vitin 2018. Kjo taksë e përkohëshme është vendosur për një periudhë 7 vjeçare dhe për vitet 2019-2022, të ardhurat vjetore parashikohet të jenë rreth 1

miliard lek. Të ardhurat nga transferta specifike nga Ministria e Financave do të jenë në masën 700 milionë lek në vit. Në këtë mënyrë, fondi në dispozicion të Bashkisë Tiranë për kryerjen e pagesave periodike parashikohet të jetë rreth 1 miliard e 700 milion lekë në vit.

Open Procurement Albania

2.5.Analiza Financiare

Tabela 162 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,557,382,992**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**1,557,382,992**
A.1	**Kostot e Truallit**	**221,887,911**								**221,887,911**
A.2	Kostot e Projektimit	32,204,825								32,204,825
A.3	- Ndertim + instalime	1,173,030,237	-							1,173,030,237
A.4	- Oponenca teknike	895,163								895,163
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	120,000								120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000								200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	13,241,990								13,241,990
A.9	- Kosto Kolaudimi	471,950								471,950
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	81,045,000	-	-	-	-	-	-	-	81,045,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	34,285,917								34,285,917
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**288,087,751**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**27,097,457**	**27,097,457**	**27,097,457**	**27,097,457**	**27,097,457**	**27,097,457**	**27,097,457**	**189,682,199**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	6,265,416	6,265,416	6,265,416	6,265,416	6,265,416	6,265,416	6,265,416	43,857,912
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		15,830,857	15,830,857	15,830,857	15,830,857	15,830,857	15,830,857	15,830,857	110,815,999
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		1,981,830	1,981,830	1,981,830	1,981,830	1,981,830	1,981,830	1,981,830	13,872,810
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		3,019,354	3,019,354	3,019,354	3,019,354	3,019,354	3,019,354	3,019,354	21,135,478
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**14,057,936**	**14,057,936**	**14,057,936**	**14,057,936**	**14,057,936**	**14,057,936**	**14,057,936**	**98,405,552**
B.2.1	Staf Roje		3,346,502	2,788,752	2,323,960	1,936,633	1,613,861	1,344,884	1,120,737	14,475,328
B.2.2	Staf Sanitare		8,924,006	8,924,006	8,924,006	8,924,006	8,924,006	8,924,006	8,924,006	62,468,042
B.2.3	Staf Sekretare		1,787,428	1,787,428	1,787,428	1,787,428	1,787,428	1,787,428	1,787,428	12,511,996
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**1,557,382,992**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**41,155,393**	**1,845,470,743**

C.	**Të Adhurat**	**221,887,911**	**318,394,054**	**306,412,756**	**294,431,457**	**282,450,158**	**270,468,859**	**258,487,561**	**246,506,262**	**2,199,039,018**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	221,887,911								**221,887,911**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		318,394,054	306,412,756	294,431,457	282,450,158	270,468,859	258,487,561	246,506,262	**1,977,151,107**
D	**Fitimi (humbja)**	(1,335,495,081)	277,238,661	265,257,363	253,276,064	241,294,765	229,313,466	217,332,168	205,350,869	**353,568,275**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(1,335,495,081)	(1,058,256,420)	(792,999,057)	(539,722,993)	(298,428,228)	(69,114,762)	148,217,406	353,568,275	**353,568,275**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(22,232,611)	(30,802,630)	**(53,035,241)**

Open Procurement Albania

Tabela 163 Fluksi i arkës së projektit

Fluksi i Arkës									
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Flukse dalese nga Investimet	- 1,557,382,992	-	-	-	-	-	-	-	- 1,557,382,992
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	-	- 41,155,393	- 41,155,393	- 41,155,393	- 41,155,393	- 41,155,393	- 41,155,393	- 41,155,393	- 288,087,751
Flukse dalese nga Taksat	-	-	-	-	-	-	- 22,232,611	- 30,802,630	- 53,035,241
Totali i flukseve dalese	**-1,557,382,992**	**- 41,155,393**	**- 41,155,393**	**- 41,155,393**	**- 41,155,393**	**- 41,155,393**	**- 63,388,004**	**- 71,958,023**	**- 1,898,505,984**
Flukse hyrese nga Operimet	**221,887,911**	**318,394,054**	**306,412,756**	**294,431,457**	**282,450,158**	**270,468,859**	**258,487,561**	**246,506,262**	**2,199,039,018**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,335,495,081**	**277,238,661**	**265,257,363**	**253,276,064**	**241,294,765**	**229,313,466**	**195,099,557**	**174,548,239**	**300,533,034**
Gjendja e arkes progresive	**-1,335,495,081**	**- 1,058,256,420**	**- 792,999,057**	**- 539,722,993**	**- 298,428,228**	**- 69,114,762**	**125,984,795**	**300,533,034**	**300,533,034**

2.6.Realizueshmëria Ekonomike e Projektit

2.6.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto)

NPV, si metoda standarte për vlerësimin e projekteve afatgjata përmes analizës së vlerës në kohë të parasë, paraqet shumën e fluksit të arkës së projektit (Cash Floë) të skontuar. Çdo investues, kur vendos ndërmarrjen e një investimi analizon të ardhurat e gjeneruara nga projekti krahasuar më të ardhurat e mundshme nëse paratë e investuara do të përdoreshin në një tjetër mënyrë. Përgjithësisht, këto analiza kryhen duke marrë për bazë normën e interesit në rast të investimit të parave, për shembull, në bono thesari apo obligacione qeveritare, të cilat kanë risk thuajse zero.

Formula klasike për llogaritjen e NPV-së, nëse investimi bëhet brenda një viti, është:

$$NPV = \sum_{t=1}^{T} \frac{C_t}{(1+r)^t} - C_0$$

ku:

C_0 - përfaqëson paranë e shpenëzuar për kryerjen e investimit fillestar;

C_t – përfaqëson të ardhurat nga investimi i kryer;

t – përfaqëson kohëzgjatjen e projektit;

r – përfaqëson normën e pritshme të skontimit.

Open Procurement Albania

Për të parë realizueshmërinë ekonomike të projektit, është testuar modeli financiar me disa norma të mundëshme skontimi. Nga kjo analizë, ka rezultuar se konçensionarët e mundshëm do të kenë interes në këtë projekt vetëm në rast se kosto e tyre oportune është më e ulët se 5.79%. Me fjalë të tjera, për çdo normë skontimi mbi 5.79% ky projekt nuk paraqet leverdisshmëri ekonomike nga ana e koncensionarit.

	NPV						
norma e skontimit e parashikuar	**5%**	**5.79%**		**6%**		**7%**
NPV	**34,046,422**	**109,440**	**-**	**8,593,533**	**-**	**48,295,201**

2.6.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit)

IRR-ja është një metodë që përdoret për të matur fitimin e investimeve të mundshme. IRR-ja është një normë skontimi që e bën vlerën aktuale neto (NPV) të të gjithë fluksit të arkës (cash floë) të një projekti të barabartë me zero. Sipas teorisë ekonomike, çdo projekt me një IRR më të madhe se kosto e tij kapitale është fitimprurës, e rrjedhimisht investitorët kanë interes të investojnë në të. Në bazë të analizës financiare, IRR-ja e këtij projekti është në masën 5.79%.

Open Procurement Albania

Tabela 164 Norma e brendshme e kthimit e projektit

				IRR					
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,335,495,081**	**277,238,661**	**265,257,363**	**253,276,064**	**241,294,765**	**229,313,466**	**195,099,557**	**174,548,239**	**300,533,034**
IRR	**5.79%**								

2.6.3. Periudha e Vetëshlyerjes

Periudha e vetëshlyerjes paraqet kohën që nevojitet në mënyrë që një kapitali i investuar të kompensohet nga të ardhurat nga projekti. Përgjithësisht, periudha e vetëshlyerjes llogaritet duke pjesëtuar koston e investimit me të ardhurat vjetore. Por, duke qenë se në këtë projekt të ardhurat vjetore përbëhën nga këste zbritëse, periudha e vetëshlyerjes është vlerësuar duke analizuar fluksin e arkës për të përcaktuar vitin e fundit në të cilën ky fluks është negativ.

Periudha e Vetëshlyerjes		
Viti i fundit i gjendjes se arkes negative		5
Gjendja e arkes kumulative ne vitin e fundit negativ	-	69,114,762
Gjendja e arkes pozitive krijuar ne vitin vijues		195,099,557
PBP (periudha e veteshlyerjes)		5.35

Nga sa u përshkrua më sipër, periudha e vetëshlyerjes për këtë projekt arrihet në 5.35 vite. Megjithatë, duke parë që pagesat nga ana e Bashkisë Tiranë do të jenë vjetore, atëherë periudha e vetëshlyerjes nuk do të jetë 5.35 vite, por do të jetë 6 vite.

2.6.4. Përshtatshmëria financiare

Sipas VKM nr, 575, datë 10.07.2013, neni 7, pika 10, përshtatmëria financiare e një projekti "tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar."

Në bazë të analizës financiare të mësipërme, ky projekt është ekonomikisht i realizueshëm dhe kjo realizueshmëri, në mënyrë të thuket, jepet nga vlerat e mëposhtme:

- NPV = 5.79% > 0
- IRR = 5.79% > se interesi i depozitave apo bonove të thesarit
- PBP = 6 vite < 7 vite (kohëzgjatja e konçensionit)

Open Procurement Albania

2.7.Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve

Analiza e risqeve ka si synim parësor të saj identifkimin dhe vlerësimin e gamës së risqeve që mund të ndikojnë projektin. Në këtë mënyrë, zhvillohet një strategji për menaxhimin e riskut në mënyrë që të garantohet realizimi i projektit me sukses. Në përputhje me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", më poshtë vijon një analizë e risqeve që prekin këtë projekt.

2.7.1. Analiza cilësore e risqeve

Risku i trojeve

Përshkrimi i riskut: Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e 17 shkollave do të jenë kryesisht me pronësi shtet, ndërsa trojet në pronësi private do të shpronësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pastaj do të vihen në dispozicion të koncensionarit. Rrjedhimisht, ky risk ka probablitet të ulët, thuajse zero, për të ndikuar mbi projektin. Përsa u përket lejeve të nevojshme, ky risk nuk ekziston pasi Bashkia Tiranë është vetë organi përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve. Së fundi, përsa u përket standarteve mjedisore, trojet e përzgjedhura janë parcela në ndodhura në zona ku nuk ndikohet asnjë standart mjedisor, ndaj edhe ky risk vlerësohet zero.

Menaxhimi i riskut: Ky risk vlerësohet me probabilitet zero dhe cilësohet si risk i mbajtur nga Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë do të kryejë të gjitha procedurat për shpronësimin e trojeve private jashtë kësaj skeme PPP-je dhe përpara kohës së përcaktuar për nisjen e punimeve. Në rast se ndonjë prej trojeve të përzgjedhura do të ketë konflikt pronësie çka do ta bënte shpronësimin të pamundur, pranë ZRPP është kërkuar informacion edhe për sheshe alternative, të cilat mund të përdoren. Përsa u përket kushteve gjeologjike dhe standarteve mjedisore, është kryer një studim mjedisor që është pjesë e këtij studimi fizibiliteti, i cili ka arritur në përfundimin se me ndërtimin e këtyre objekteve nuk preket asnjë standart mjedisor. Për më tepër, gjatë marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet edhe një studim mjedisor më i detajuar nga ana e koncensionarit.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë

Përshkrimi i riskut: Kostimi i ndërtimit dhe mobilimit të shkollave të reja është bazuar në një metodologji të shpjeguar gjërësisht më sipër, e cila merr për bazë koston e shkollave të ndërtuara nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit. Kësisoj, mundësia që kosto e ndërtimit të jetë më e lartë sesa kostoja e përllogaritur është thuajse zero. Ndërtimi dhe vënia në punë e shkollave varen në një shkallë të caktuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe plotësimi i parakushteve për marrjen e kësaj lejeje, si leja mjedisore, lidhja me rrjetin elektrik apo ujësjellësin, miratimi i projekteve për mbrojtjen nga zjarri, etj. Koncensionari ka detyrën të bëjë projektimin, të përgatisë dokumentacionin për pajisje me leje ndërtimi si edhe të ndërtojë objektet shkollore. Nga ky prizëm, risku i vonesave në paisje me leje ndërtimi, i vonesave në nisjen e punimeve e, rrjedhimishit, i vënies në punë është i mundshëm.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi koncensionarin. Koncensionari ka detyrimin të përgatisë dokumentat dhe të pajiset me leje ndërtimi. Në rast se koncensionari nuk do të përgatisë projektin në kohë, do të neglizhojë aplikimin për leje ndërtimi duke mos aplikuar në kohë apo

duke pasur mangësi në dokumentacion apo nuk do t'i kryejë punimet në kohë, atëherë ai do të mbajë përgjegjësi për mos nisjen e punimeve në afat dhe do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve që do të bëhën në kontratën konçensionare. Gjithashtu, meqenëse konçensionari është përgjegjës si për hartimin ashtu edhe për zbatimin e projektit, çdo vonesë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa vjen si rezultat i forcës madhore, do të jetë përgjegjësi e tij për të cilën do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve në kontratën konçensionare.

Risku i funksionimit

Përshkrimi i riskut: Mundësia që shkollat e reja të mos funksionojnë pasi të jenë ndërtuar lidhet me kryerjen e punimeve jo cilësore nga ana e koncensionarit, çka do ta bënte zhvillimin e mësimit në godinat e reja të pamundur. Ky risk ka probabilitet të ulët pasi kryerja e punimeve do të mbikqyret nga mbikqyrësi teknik dhe situacionet financiare do të mbikqyren nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket riskut që kostoja e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa pritej, probabiliteti është thuajse zero, pasi kostoja vjetore e mirëmbajtjes është llogaritur duke u bazuar në shpenzimet vjetore të Bashkisë Tiranë për mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, të cilat janë ndërtuar para shumë viteve. Sipas standarteve inxhinierike, kostoja e mirëmbajtjes së objekteve të sapondëruara është me e ulët se ajo e objekteve të ndërtuara kohë më parë.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtij risku është i ulët dhe ai cilësohet si një risk i transferuar tek koncensionari. Në rast se cilësia e ndërtimit do të jetë e tillë që do ta bëjë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të mbajë përgjegjësi dhe do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë derisa cilësia e punimeve të jetë në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Në rast se, për shkak të punimeve të kryera gjatë ndërtimit, gjatë peiudhës 7 vjeçare të zgjatjes së kontratës, godinat shkollore do të shfaqin probleme që do ta bëjnë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë për ta bërë shkollën sërish funksionale. Në rast se kostoja e mirëmbajtjes do të rezultojë më e lartë se parashikimi, kjo do të vijë si pasojë e pasaktësive në projektim ose ndërtim. Rrjedhimisht, risku bie mbi konçensionarin, i cili ka përgjegjësinë të projektojë dhe ndërtojë shkollat.

Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare

Përshkrimi i riskut: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej apo të ardhurat e gjeneruara janë më të ulëta se sa parashikimi. Duke qenë se objektet që do të ndërtohen janë godina shkollore të cilat nuk mund të kenë përdorim të ndryshëm e nuk mund të gjenerojnë të ardhura, ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin në fjalë.

Menaxhimi i riskut: Mundësia që projekti të ndikohet nga ky risk është zero pasi ai nuk aplikohet mbi të.

Risqet ekonomike dhe financiare

Përshkrimi i riskut: Meqenëse ky projekt përfshin transaksione financiare të shtrira në kohë, ekziston mundësia që ai të ndikohet nga risqet ekonomike e financiare. Rritja e paparashikuar e normave të interesit mund të rrisë kostot e financimit të projektit nga ana e koncensionarit. Nga

ana tjetër, ndryshimet në kursin e këmbimit valutor mund të kënë ndikim përkeqësues në financat e koncencionarit në rast se të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë në monedha të ndryshme, për shembull koncensionari ka marrë kredi në Euro apo Dollarë për financimin e projektit, ndërkohë që Bashkia e Tiranë ia kryen pagesat vjetore në Lekë. Së fundi, duke qenë se ky projekt përfshin pagesa periodike për një periudhë 7 vjeçare, ekziston mundësia që të ardhurat e koncensionarit të preken nga inflacioni.

Menaxhimi i riskut: Duke qenë se Shqipëria konsiderohet një vend me një situatë makroekonomike të qendrueshme, probabiliteti që projekti të ndikohet nga ky risk mbetet i ulët. Risku i normave të interesit apo i normave të këmbimit valutor është një risk që bie mbi konçensionarin dhe duhet të llogariten në parashikimet e tij financiare. Risku i inflacionit është një risk që ndahet mes Bashkisë Tiranë dhe konçensionarit. Meqenë se politika e Bankës së Shqipërisë është mbajtja e inflacionit nën 3% dhe kohëzgjatja e projektit është vetëm 7 vjet, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, në përcaktimin e marzhit të fitimit si të lidhur me normën e interesit për obligacionet 7 vjeçare, Bashkia e Tiranës garanton për konçensionarin të njëjtën mbrojtje ndaj risqeve ekonomike e financiare që garanton edhe Qeveria e Shqipërisë për blerësit e obligacioneve.

Risqet e pronësisë së aseteve

Përshkrimi i riskut: Ky riskt lidhet me mundësinë që teknologjia të vjetërohet apo që vlera e aseteve të jetë e ndryshme në fund të kontratës. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtim godinash shkollore, të cilat do të mirëmbahen nga konçensionari për një periudhë 7 vjeçare, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të mirëmbajtjes jo cilësore, në fund të kontratës cilësia dhe vlera e aseteve të jetë më e ulët nga parashikimi.

Menaxhimi i riskut: Ky risk transferohet te konçensionari. Mirëmbajtja e godinave shkollore dhe mobiljeve e pajisjeve të tyre do të bëhet në përputhje me standartet në fuqi dhe do të mbikqyret nga autoriteti kontraktor. Në rast se konçensionari nuk do t'i mirëmbajë shkollat sipas përcaktimit të mësipërm, në kontratën e konçensionit do të parashikohen dispozita që e detyrojnë atë të shlyejë dëmin e shkaktuar. Në rast se në fund të kontratës, vlera e aseteve do të jetë e ndryshme nga sa është dakordësuar, në kontratën e koncensionit do të përcaktohen dispozita që do të detyrojnë koncensionarin të shlyjë dëmin.

Risku politik

Përshkrimi i riskut: Risku që vendimet politike të ndikojnë mbi projektin është evident. Duke qenë një projekt i nisur nga Bashkia e Tiranës, një organ i qeverisjes lokale, suksesi i këtij projekti varet nga dakordësia me qeverisjen qendrore. Gjithashtu, ekziston mundësia që si rezultat i zgjedhjeve lokale të ardhshme, një ndryshim i mundshëm në kreun e Bashkisë Tiranë mund të sjellë ndryshimin e prioriteteve, e për rrjedhojë bllokimin e projektit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi autoritetin kontraktor, Bashkinë Tiranë. Për të siguruar dakordësinë e institucioneve të qeverisjes qendrore, me miratimin e studimit të fizibilitetit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket riskut të ndikimit negativ të projektit si rezultat i

ndryshimeve në drejtimin e Bashkisë Tiranë, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që pengojnë prishjen e kontratës për arsye jo të ligjshme nga ana e autoritetit kontraktor.

Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor

Përshkrimi i riskut: Ndryshimet e mundshme në kuadrin legjislativ mund ta ndikojnë projektin si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Duke qenë se projekti lidhet me ndërtimin e godinave shkollore, mundësia që ai të afektohet nga ndryshimet ligjore lidhet vetëm me standartet dhe manualet e ndërtimit. Ndaj, ky risk ka një probabilitet të ulët që të ndodhë. Përsa u përket ndryshimeve të ligjeve fiskale, ndikimi negativ apo pozitiv ndjehet vetëm në financat e konçensionarit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Në mënyrë që efektet e tij të jenë sa më minimale, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që e mbrojnë atë nga ndryshimet diskriminuese në ligj – gjithmonë, nëse diskriminimi provohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, konçensionari do të jetë i detyruar të zbatojë çdo ndryshim ligjor që vjen si rezultat i politikave të qeverisë.

Risku i forcës madhore

Përshkrimi i riskut: Risqet e forcës madhore si fatkeqësitë natyrore, trazirat civile apo luftërat bien si mbi konçensionarin ashtu edhe mbi autoritetin kontraktor. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria është antare e NATO dhe me perspektivën e qartë të integrimit në BE, probabiliteti i risqeve si luftërat apo trazirat është thuajse zero. Nga ana tjetër, probabiliteti që projekti të ndikohet nga tërmetet apo fatkeqësitë e tjera natyrore ka gjithashtu pak gjasa që të ndodhë, siç ka rezultuar edhe nga analiza e mësipërme e ndikimit mjedisor të projektit.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtyre risqeve është shumë i ulët dhe bie mbi të dyja palët. Në kontratën konçensionare do të parashikohen klauzolat e forcës madhore të cilat do garantojnë që të çdo ndikim negativ mbi projektin të ndahet ndërmjet palëve.

2.7.2. Analiza sasiore e risqeve

Kjo analizë synon të prioritizojë risqet që mund të ndikojnë projektin duke përllogaritur probabilitetin e tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi arritjen e objektivave të projektit. Vlerësimi sasior është bazuar në probabilitetin e ndodhjes të secilit risk dhe në ndikimin e mundshëm mbi koston dhe afatet e projektit.

Ndikimi i risqeve mbi koston e projektit është llogaritur duke u bazuar mbi peshën specifike që zë secili prej tyre në koston e projektit. Ndërsa, ndikimi mbi afatin e përfundimit të punimeve është përllogaritur duke u bazuar në afatet ligjore për kryerjen e procedurave të caktuara që mund të nevojitet të ndiqen për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Më poshtë vijon një analizë sasiore mbi ndikimin që mund të ketë secili risk në koston dhe afatet e realizimit të projektit.

Risku i trojeve. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 0-5%. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është zero pasi shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për ndërtimin e shkollave do të kryhet nga Bashkia e Tiranës me një fond të veçantë jashtë skemës financiare të këtij projekti. Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e shkollave janë prona shtetërore dhe prona private. Në rast se përdorimi i ndonjërit prej këtyre trojeve është i pamundur, do të përdoret një prej trojeve alternative të përzgjedhura për të cilat është marrë informacion edhe pranë ZRPP. Rrjedhimisht, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve lidhet me marrjen në dorëzim të pronës shtet, në rast se nuk është pronë e Bashkisë Tiranë, ose shpronësimin e pronave private. Ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur 3 – 6 muaj.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 5-10%. Kostimi i ndërtimit të shkollave është bërë në përputhje me manualet udhëzuese të MAS dhe në bazë të kostove të ndërtimit të shkollave nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit dhe çmimet janë indeksuar sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit të INSTAT. Ndaj, ndikimi maksimal që ky risk të ketë në kosto është më i vogël se 5%. Nga ana tjetër, afati i punimeve mund të mos respektohet si rezultat i mos marrjes në kohë të lejes së ndërtimit apo lejeve të tjera nga ana e koncensionarit apo edhe nga kryerja e punimeve më ngadalë sesa është parashikuar në kalendarin e punimeve. Në rast se projektimi vonohet apo nuk plotësohet dokumentacioni për pajisjen me lejet e nevojshme, ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur nga 3 deri në 12 muaj.

Risku i funksionimit. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur nga 0-5%. Duke qenë se ky projekt lidhet me ndërtimin e shkollave të reja, ekziston mundësia që cilësia e ndërtimit të jetë e ulët, çka do të bënte që të kërkoheshin punime shtesë përtej afatit të përcaktuar. Ndikimi i këtij risku në afatin e punimeve është përllogaritur nga 1 deri në 3 muaj, ndërsa ndikimi mbi koston totale të projektit është përllogaritur 5-10%. Ekziston edhe mundësia që kosto e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa është përllogaritur, por krahasuar me koston totale të projektit ndikimi i kësaj kostoje është thuajse i papërfillshëm.

Risku i kërkesës dhe risqet e tjera tregtare. Ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin dhe munësia që ai të ndikojë koston apo afatet e realizimit të tij është zero.

Risqet ekonomike dhe financiare. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i ulët, 0-5%, duke marrë në konsideratë se nuk kemi të bëjmë me një koncension afat-gjatë ku koncensionari i nxjerr të ardhurat nga operimi i objektit të koncensionit. Duke qenë se të ardhurat e koncensionarit janë të garantuara nga Bashkia Tiranë dhe të mbrojtura nga inflacioni, ndikimi i riskut mbi koston totale të projektit është i ulët, 5% - 10%. Nga ana tjetër, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve, nuk parashikohet më i lartë se 12 muaj.

Risqet e pronësisë së aseteve. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur 0 – 5%. Ndikimi i tij mbi koston totale të projektet lidhet me koston e mirëmbajtjes, në rast se kjo e fundit rezulton më e lartë se parashikimet dhe me amortizimin e godinave më shpejt se sa është parashikuar në kontratën e koncensionit. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është llogaritur të jetë maksimimumi 5%. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku nuk i ndikon aspak afatet e realizimit të punimeve.

Open Procurement Albania

Risku politik. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i mesëm i ulët dhe është llogaritur 10 - 20%. Ndodhja e këtij risku mund të bllokojë punimet në mes ose mund të ndërpresë pagesat periodike për konçensionarin, duke rritur koston e financimit të projektit dhe duke vonuar realizimin e punimeve. Për këto arsye, ndikimi i mundshëm i këtij risku mbi kosto është përllogaritur 20 – 30% ndërsa ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve është përllogaritur nga 16 deri në 24 muaj.

Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor. Ky riskt ka një probabilitet ndodhjeje që varion nga 5 deri në 15%. Ndryshime të mundshme ligjore, si për shembull në standartet që duhet të ndjekë ndërtimi i shkollave të reja mund të rrisin ndjeshëm koston e projektit. Prandaj edhe impakti i mundshëm mbi kosto është llogaritur të jetë i mesëm, nga 20 deri në 40%. Gjithashtu, ndryshime të mundshme ligjore mund të çojnë në ribërjen e projekteve apo në vonesa të tjera, çka do të ndikonte negativitsh afatin e realizimit të punimeve. Ndaj, ndikimi mbi afatin e punimeve është llogaritur nga 12 deri në 16 muaj.

Risku i forcës madhore. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është shumë i ulët, nga 0 deri në 5%. Megjithatë, në rast të ndodhjes ndikimi mbi koston apo afatin e punimeve do të ishtë i mesëm i lartë. Kësisoj, ndikimi mbi koston është përllogaritur nga 30% deri në 50% ndërsa ndikimi mbi afatin e punimeve nga 12 deri në 24 muaj.

Tabela 165 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve

Nr.	Risku	Probabiliteti i ndodhjes	Ndikmi mbi kosto	Ndikimi mbi afatin e punimeve
1	Risku i trojeve	0% - 5%	0%	3 – 6 muaj
2	Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	5% - 10%	0% -5 %	3 – 12 muaj
3	Risku i funksionimit	0% - 5%	5% - 10%	1 – 3 muaj
4	Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	-	-	-
5	Risqet ekonomike dhe financiare	0% - 5%	5% - 10%	6 – 12 muaj
6	Risqet e pronësisë së aseteve	0% - 5%	0% - 1%	-
7	Risku Politik	10% - 20%	20% - 30%	16 – 24 muaj
8	Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	5% - 15%	20% - 40%	12 – 16 muaj
9	Risku i forcës madhore	0% - 5%	30% - 50%	12 – 24 muaj

Open Procurement Albania

2.8.Analiza e ndjeshmërisë

Faktori kryesor që mund të ndryshojë gjatë procesit të tenderimit, është Marzhi i fitimit. Njëkohësisht, në varësi të projekteve që do të miratohen, detajimi i kostove përkatëse do të bëhet përkatësisht, bazuar mbi projektet faktike të miratuara. Kosto direkte do të përllogaritet bazuar në volume faktike të realizuara, të cilat në asnjë rast nuk mund të jenë më të larta sesa kosto e parashikuar e këtij projekti.

Gjithësesi për efekte të analizës së ndjeshmërisë, do të llogarisim sikur secila nga kostot ulet dhe rritet me 5% dhe 10% dhe marzhi i fitimit ulet dhe rritet përkatësisht me 5% dhe 10%:

	shpenzimet rriten me 10%	shpenzimet rriten me 5%	Modeli Baze	shpenzimet ulen me 5%	shpenzimet ulen me 10%
Norma e Sensitivitetit	10%	5%	0	-5%	-10%
Flukse dalese nga Investimet	- 7,267,445,188	- 6,937,106,771	- 6,606,768,353	- 6,276,429,936	-5,946,091,518
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	- 1,275,711,645	- 1,217,724,752	- 1,159,737,859	- 1,101,750,966	-1,043,764,073
Të Ardhurat	10,274,681,048	9,786,000,321	9,197,517,960	8,713,446,063	8,188,265,320
Fitimi Para taksave	1,731,524,215	1,631,168,798	1,431,011,748	1,335,265,161	1,198,409,729
Tatim Fitimi 15%	- 259,728,632	- 244,675,320	- 214,651,762	- 200,289,774	- 179,761,459
Fitimi neto	1,471,795,583	1,386,493,478	1,216,359,986	1,134,975,387	1,018,648,270
NPV me 5.79%	110,223,600	81,672,242	170,329	- 23,634,170	- 68,587,789
IRR	6.38%	6.25%	5.79%	5.64%	5.34%
Norma e Vetëshlyerjes	5.20	5.28	5.35	5.43	5.51

Open Procurement Albania

8.4 Loti 4

8.4.1 Vendndodhja e shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 4

Loti 1 përfshin 4 shkolla, nga të cilat 2 në Njësinë Administrative 8, 1 në Njësinë Administrative 2 dhe 1 në Njësinë Administrative Dajt. Shpërndarja e shkollave të përfshira në Lotin 4 tregohen në hartën e mëposhtme:

Harta 128 Vendodhja e shkollave të përfshira në Lotin 4

8.4.2 Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 4

SHESHI 2/3

Figura 18 – Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA :

Sheshi i propozuar nr.**2/3** për shkolë 9-vjeçare ndodhet pranë Drejtorisë së Higjienës. Aksesohet nga rruga Mihal Grameno.

TË DHENA TEKNIKE : Sheshi 2/3 : 4093 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshte një zonë ne pronesi të subjekteve private, e rrethuar.
- Ka pjerrësi të konsiderueshme
- Ndodhet ne zonë me intensitet të lartë.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme.
- Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore.
-

SHESHI D2

Harta 129 Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA : Sheshi i propozuar nr.**D2** ndodhet pranë Lumit Lana . Aksesohet nga rruga "Dalip Troji".

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi D2 : 14900 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Akses i vështirë
- Sheshi ndodhet pranë zonës së Kinostudios
- Problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore

Figura 20 Foto të sheshit D2

SHESHI 8/1

Harta 130 Ortofoto e sheshit

VENDODHJA : Sheshi i propozuar nr. **8.1** ndodhet pranë rrugës " 5 Maji" në njësinë 8.

TË DHËNA TEKNIKE : Sheshi 8.1 Sipërfaqe – 17520 m2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT :

- Eshtë një zonë e qetë relativisht.

- Aksesi në shesh është i lehte. Problematike mund te jete infrastruktura rrugore. Paraqet shumë aspekte pozitive, pasi ndodhet në një zonë me intensitet të lartë banimi.

Figura 21 - Foto nga sheshi 8/1

Open Procurement Albania

8.4.3 Statusi ligjor i shesheve të shkollave të përfshira në Lotin 4

Sheshi 2/3

Harta 131 Harta treguese e pronave



Tabela 167 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Shtet	Pasuri e okupuar	8190	6/471	13.50	66969			0.0
2	Nuk ka informacion	Ndërtesë	8190	6/246 - ND	0.00	66969		32113	0.0
3	Shtet	Sek.D kufiz. Ne administr.te trajtimit të studenteve	8190	6/678	1539.00	66969			0.0
4	Shtet	Sek.D kufiz. Ne administr.te trajtimit të studenteve	8190	6/679	2522.00	66969			0.0
5	Shtet		8190	6/473	19.00	66969			0.0
					4093.50				0.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8190 do të prekë gjithsej 4093.5 metra katrorë pronë, të përbërë nga 5 prona. 4 prej tyre janë pronë shtetërore, ndërsa për pasurinë nr. 6/246 ende nuk ka informacion për gjendjen ligjore, por në varësi të zonës është përcaktuar se çmimi i objektit do të jetë 32,113 për metër katror. 1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

Sheshi D2

Harta 132 Ortofoto e sheshit

Komisioni i vlerësimit të PPP-së nuk ka arritur të marrë informacion për statusin ligjor të pronave që preken nga propozimi i parcelës me kodin D2 brenda afateve të hartimit të studimit të fizibilitetit. Me qëllim planifikimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e shpronësimeve për këtë projekt, komisioni ka supozuar që pronat e përfshira në këtë parcelë janë tokë truall dhe prona private, mbi bazën e të cilave ka bërë edhe përllogaritjen e kostove të shpronësimit. Këto kosto do rishikohen në momentin që do të merret informacioni i plotë nga ZVRPP dhe në çdo rast para nisjes së procedurave të tenderimit.

Open Procurement Albania

Tabela 168- Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasuriës	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Nuk ka informacion				14,900	3,560			53,044,000
					14,900				53,044,000

Sheshi 8/1

Harta 133 Harta treguese e pronave



Tabela 169 Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti

Nr	EMER	Shënim në Sek. E	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. prekur (m²)	Çmimi Truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj.lek/m²	Vlera në lekë
1	Truall Shtet		8340	3/20	17.510	30158			0.0
3	Nuk ka informacion	Objekt	8340	3/152 - ND	10.00	30158			301,580.0
					17.520				301,580.0

Shkolla që do të ndërtohet në zonën kadastrale 8340 do të prekë gjithsej 17,520 metra katrorë katrorë pronë, të përbërë nga 2 prona, nga të cilat 1 objekt pronë shtetërore, me nr. 3/20 dhe 1 tjetër pronë për të cilin ende nuk ka informacion me nr. 3/152. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

8.4.4 Tipologjitë e shkollave të përfshira në Lotin 4

Në Lotin 4 është parashikuar ndërtimi i 4 shkollave gjithsej. Përkatësisht në Njësië administrative nr. 2, Njësinë administrative Dajt dhe Njësinë Administrative Nr. 8. Më konkretisht, në NJA 2 është parashikuar të ndërtohet një shkollë e ciklit arsimor bazë e tipit 2. Në NJA Dajt është parashikuar ndërtimi i një shkolle të tipit 4 të ciklit të mesëm të lartë. Ndërsa në NJA 8 ëahtë parashikuar ndërtimi i dy shkollave, përkatësisht një shkollë e tipit 1 të arsimit bazë dhe një e tipit 4, pra të ciklit të mesëm të lartë. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen më në detaj dallimet mes tipeve të shkollave sipas vendndodhjes, ciklit arsimor, nr të klasave, nxënësve për klasë, etj,.

Tabela 170 – Tipet e shkollave

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	I mesëm i lartë	21	30	630	6.35	4000.5

8.4.5 Analiza ekonomike-financiare për Lotin 4

Open Procurement Albania

1. Analiza ekonomike dhe financiare

Analiza ekonomike dhe financiare e këtij studimi fizibiliteti, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, ka si objektiv kryesor të saj që të përcaktojë vlerën e parasë së projektit si dhe të bëjë një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes si edhe të çdo të ardhure që pritet të realizohet gjatë kohëzgjatjes së projektit.

1.1. Modeli ekonomik i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

Ligji nr. 125/2013 rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private. Në këtë lloj marrëdhënieje, partneri privat merr përsipër që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë /të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtaz. Ndër fushat e zbatimit të këtij ligji është edhe arsimi.[55]

[55] Neni 4, pika dh), Ligji 125/2013

Nga analiza e të dhënave rezulton se për t´i dhënë fund problemit të mbipopullimit të shkollave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne, Bashkia Tiranë duhet të ndërtojë 17 shkolla të reja, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Kosto totale e ndërtimit dhe mobilimit të këtyre shkollave llogaritet në 7.6 miliard lekë. Një shifër e tillë është financiarisht e papërballueshme për Bashkinë e Tiranës, buxheti total vjetor i së cilës është 10 miliard lekë, ndërsa investimet për ndërtimin e shkollave të reja gjatë viteve të fundit kanë qenë jo më shumë se 500 milion lekë.

Nisur nga sa më sipër, për t´i dhënë zgjidhje problemit në fjalë Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë metoda inovative të prokurimit dhe financimit të projektit të propozuar. Për të garantuar realizueshmërinë e projektit të ndërtimit të shkollave është menduar të përdoret një qasje më inovative dhe më kosto-efektive duke kombinuar projektimin, financimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në një kontratë të vetme prokurimi. Pikërisht për shkak të përmasave të konsiderueshme të projektit në fjalë, kjo metodologji do të sjellë jo vetëm lehtësi përgjatë procesit të zhvillimit, por do të sigurojë më shumë qëndrueshmëri pas përfundimit të tij.

Në modelin "Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje" (PFNM), ose ndërkombëtarisht i njohur me termin "Design, Build, Finance & Operate (DBFO)", kontraktorët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Kontraktori, i cili mund të jetë një kompani e vetme apo një konsorcium është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e objektit për një periudhë të caktuar kohore, e cila propozohet të jetë 7 vjet. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet në bazë të përmbushjes së disa prej standardeve të caktuara performancës lidhur me gjendjen fizike të godinave, cilësinë, kapacitetin etj. Ky model i cili shtrihet përtej fazës së projektimit dhe ndërtimit, në mënyrë të natyrshme nxit projektuesit/ndërtuesit që të sigurojnë që në fillim një plan sa më cilësor ndërtimi me qëllim që gjatë fazës së mirëmbajtjes të kenë sa më pak kosto duke qenë se përgjegjësia bie sërisht mbi konsorciuimin e tyre. Githashtu, integrimi i të gjitha kontratave të projektit në një të vetme redukton kostot e ndryshme transaksionale dhe rrit efiçencën e menaxhimit të projektit.
Më së shumti ky model PPP-je është përdorur për ndërtimin e projekteve infrastrukturore madhore të tilla si ndërtimi i autostradave, hidrocentraleve, impianteve të menaxhimit të mbetjeve, etj,. Kjo për shkak se përmasat e mëdha të projekteve të tilla kërkojnë fonde të konsiderueshme, organizim sa më efektiv të burimeve kapitale dhe njerëzore, cilësi të lartë projektimi dhe ndërtimi, siguri maksimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për këtë arsye modele të tilla si PFNM apo të ngjashme, janë parë si nga më të suksesshmet për të zhvilluar projekte që garantojnë realizueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e investimit të kryer. Megjithatë përdorimi i kësaj forme të PPP nuk është kufizuar vetëm tek projektet e mëdha të infrastrukturës publike të përmendura më sipër. Në shumë vende të OECD-së, por më gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar, kjo metodologji është përdorur gjithashtu për projekte të shërbimeve publike të tilla si ndërtimi i shkollave të reja.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj nga vende të ndryshme të cilat kanë zbatuar me sukses këtë model për projekte të infrastrukturës arsimore:

Kanada[56]**:** Programi "Alberta Schools Alternative Procurement". Në vitin 2007 krahina e Albertës në Kanada shpalli fazën e parë të programit i cili parashikonte ndërtimin e 18 godinave të reja shkollore (kopshte dhe shkolla 9-vjeçare) të cilat kanë përunduar ndërtimin në vitin 2010. Pas përfundimit të ndërtimeve, jetëgjatësia e kontratës e cila do vijojë me pjesën e mirëmbajtjes është përcaktuar rreth 30 vjet. Faza e dytë e programit përfshinte ndërtimin e 10 shkollave të tjera 9-vjeçare sipas të njëjtit model dhe 4 gjimnazeve nëpërmjet modelit të thjeshtë të kontratës Projektim-Ndërtim të cilat kanë përfunduar në vitin 2013.

Greqi[57]: Programi "Macedonia Schools and Attica Schools". Duke përdorur mekanizmin DBFM operatorët privatë projektuan ndërtimin e 51 shkollave me një vlerë totale prej 269 milion Euro dhe me kontrata 25 vjeçare.

Mbretëri e Bashkuar[58]: Programi "Building Schools for the future". Ky program është një program afat-gjatë investimesh i cili po kontribuon në ndërtimin e një numri të konsiderueshëm shkollash në gjithë tërritorin e MB-së. Shumica e shkollave janë ndërtuar nëpërmjet skemës Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje, por në këtë rast shpesh herë është përfshirë edhe elementi i menaxhimit të shkollës nga subjekti privat për një periudhë të caktuar. Zakonisht kohëzgjatja totale e kontratës arrin deri në 30 vjet. Konsorciumi privat paguhet rregullisht nga fondet publike bazuar në performancën e tij gjatë periudhës së kontratës. Nëse konsorciumi nuk arrin performancën e synuar pagesa reduktohet. Në fund të periudhës së kontratës shkolla i kthehet qeverisë.

Zelandë e Re[59]: Projekti i Ministrisë së Arsimit të Zelandës së Re për ndërtimin e dy shkollave në Hobsonville, Auckland. Ky projekt parashikonte ndërtimin e një shkolle të re të ciklit të ulët dhe një shkolle të ciklit të mesëm të ulët në rajonin periferik të Hobsonville në qytetin Auckland. Sektori privat ishte pjesërisht përgjegjës për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objekteve, sëbashku me sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre si dhe menaxhimin e shërbimeve të përbashkëta. Ndërtimi i këtyre shkollave ka përfunduar me sukses në vitin 2014.

Nën këtë prizëm, projekti i ndërtimit të shkollave të reja të Tiranës e sheh të nevojshme aplikimin e të njëjtës qasje për përmirësimin e shërbimit arsimor në gjithë territorin e Bashkisë. Numri i madh i shkollave që do të ndërtohen, kufizimet financiare, koha e shkurtër e zbatimit të projektit si dhe nevoja për garantimin e cilësisë maksimale të ndërtesave theksojnë nevojën për ngritjen e një partneriteti public privat efektiv dhe të suksesshëm.

1.2.Supozimet kryesore

[56] "Flexible and alternative approaches to providing school infrastructure in Alberta, Canada" – OECD, 2010
[57] "The role and impact of public-private partnerships in education", Fq. 82 – Banka Botërore, Mars 2009 .http://www.ungei.org/resources/files/Role_Impact_PPP_Education.pdf
[58] Ibidem (dmth: marrë nga i njëjti dok i Bankës Botërore në referencën e mësipërme dhe në të njëjtën faqe)
[59] "Mayoral Position Paper on Public Private Partnerships" – Ernst and Young, Nëntor 2013.

Për efekt të analizës ekonomike e financiare të këtij studimi fizibiliteti, janë bërë supozimet si më poshtë:

- Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për ndërtimin e objekteve arsimore dhe vënien në funksion të tyre, ndërsa Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për këtë qëllim.
- Objektet arsimore do të jenë të ndërtuara e funksionale maksimalisht 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
- Pas ndërtimit vënien në funksion të shkollave, koncesionari do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për një periudhë 7 vjeçare dhe për çdo problematikë për administrimin dhe reziqet e aseteve për këtë periudhe.
- Pas ndërtimit të objekteve, Bashkia Tiranë do t'i paguajë koncesionarit një shumë të caktuar vjetore deri në shlyerjen e plotë të shumës së investuar. Të ardhurat për këto pagesa do të sigurohen nga të ardhurat vjetore nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore dhe nga transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave.

1.3.Analiza e kostove

Bazuar në studimin teknik, është arritur në përfundimin se në total do të ndërtohen 17 shkolla, prej të cilave 10 shkolla 9 vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e reja do të projektohen e ndërtohen sipas modeleve në përputhje me standartet e specifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit përmes udhëzuesit" Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore". Këto modele shkollash ofrojnë mundësinë e ezaurimit të nevojave të parashikuara për klasa të arsimit parauniversitar, duke respektuar parashikimet ligjore dhe teknike për përcaktimin e klasave paralele sipas secilit cikël mësimor. Në të njëjtën kohë, për shkollat 9-vjeçare janë parashikuar edhe ambiente të ciklit parashkollor, si pjesë e institucionit arsimor 9-vjeçar. Referuar standarteve të sipër-përmendura, janë përcaktuar 4 tipe kryesore shkollash, me të dhëna operacionale si më poshtë:

Tipi 1 i shkollave, është me 20 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,938 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 4 klasash, me nje sipërfaqe prej 874 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 5,812 m2. **Tipi 2** i shkollave, është përsëri 9 vjeçar, me 30 klasa për nxënës parashkollorë dhe shkollorë dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 6,588 m2. Gjithashtu kësaj shkolle do t'i bashkohet dhe një kopësht prej 6 klasash, me nje sipërfaqe prej 1,310 m2. Në total, sipërfaqja e ndërtimit për këtë tip shkolle është 7,898 m2. **Tipi 3** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat rurale me 20 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4,041 m2. **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa dhe një sipërfaqe ndërtimi shkolle prej 4001 m2.

Nga analiza sasiore e kryer dhe e shpjeguar më sipër për **Loti 4** janë gjithsej **4 shkolla**, nga të cilat, 1 shkollë nga Tipi 1, 1 shkollë nga Tipi 2, 2 shkolla të mesme nga Tipi 4. Përkatësisht këto shkolla do të ndërtohen në njësitë administrative dhe me të dhënat si më poshtë:

Tabela 171 Të dhëna të detajuara për secilën shkollë në Lotin 4

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	nxënës për klasë	Nxënës për shkolle	Sipërfaqe totale shkolla	Klasa kopështi	Nxënës për klasë kopështi	nxënës për kopësht	Sipërfaqe totale kopësht	Siperfaqe totale ndertimi
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	30	30	900	6,588	6	24	144	1,310	7,898
2	NJA 08	Tipi 1	9-vjeçar	20	30	600	4,938	4	24	96	874	5,812
3	NJA 08	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
4	NJA Dajt	Tipi 4	i mesëm i lartë	21	30	630	4,001	0	0	0	0	4,001
Totali				92		2,760	19,527	10	48	240	2,184	**21,711**

Duke i permbledhur sipas tipologjisë së shkollave, në total kemi këto të dhëna operacionale:

Tabela 172 Të dhëna të përmbledhura për shkollat e propozuara sipas tipologjive të shkollave në Lotin 4

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Nr nxënës për klasë	Nxënës për shkollë	Nr klasa kopështi për shkollë	Nr nxënës për klasë kopështi	Nxënës për kopësht	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Total Nxënës në shkolla	Total Nxënës në Kopështe	Nr Total i nxënësve
Tipi 1	1	20	30	600	4	24	96	4,938	874	5,812	600	96	696
Tipi 2	1	30	30	900	6	24	144	6,588	1,310	7,898	900	144	1,044
Tipi 4	2	21	30	630	-	-	-	8,001	-	8,001	1,260	-	1,260
Grand To	**4**	**71**				**48**	**240**	**19,527**	**2,184**	**21,711**	**2,760**	**240**	**3,000**

Procurement Albania

Për të analizuar sa më mirë vlerën e parasë së projektit, kemi bërë grupimin e shpenzimeve në 4 kategori kryesore, duke u bazuar dhe në standartet e kontabilitetit si dhe në kërkesat e VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçension/partneritet publik privat", neni 7, paragrafi 3-6:

- Kostot e drejtpërdrejta të investimeve;
- Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes;

Për efekt të analizave të mëposhtme të gjitha çmimet dhe vlerat do të jenë pa TVSH, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

1.3.1 Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Gjatë analizës dhe në përputhje dhe me VKM të sipërcituar, u identifikuan këto kosto të drejtëpërdrejta të investimeve:

33. Kosto e Shpronësimit të Truallit;
34. Kosto e Ndërtimit;
35. Kosto e Studim Projektimit;
36. Kosto e Supervizimit;
37. Kosto e Kolaudimit;
38. Oponenca teknike;
39. Kosto për Mobilje dhe Orendi;
40. Kosto e pajisjeve të laboratorëve.

1.3.1.1.Kosto e Shpronësimit të Truallit

Nga përcaktimi i gjurmës se ku do të ndërtohen këto shkolla, ka rezultuar se do të shpronësohen në nga privatët në total **14,910 m2**, të cilat sipas përllogaritjeve nga të bëra, parashikohet që në

Nr rendor i tabeles	Adresa	Tipi	Sheshi	Shpronesimi ne Vlere	Siperfaqje ne m2 te shpronesuar	Cmimi mesatar per m2
2	NJA 08	Tipi 1	8/1	150,790	5	30,158
3	NJA 08	Tipi 4	8/1	150,790	5	30,158
4	NJA Dajt	Tipi 4	D2	53,044,000	14,900	3,560
Grand Total				**53,345,580**	**14,910**	**3,578**

total vlera e shpronësimit të shkojë në **53,345,580** lekë. Nga ana tjetër, për tokën shtet, do të ndiqen procedurat përkatëse për të marrë nën administrim pronat përkatëse.

Me daljen e VKM për këtë qëllim dhe plotësimin e dokumentave financiarë dhe ligjorë në përputhje me VKM dhe me aktet normative në fuqi, çdo i shpronësuar do të likujdohet nga Bashkia Tiranë me anë të fondit që do të përcaktohet për këtë qëllim.

1.3.1.2.Kostot e Ndërtimit

Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 228,785,770 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e

përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 276,314,618 lekë.

- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 305,233,020 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 71,238,892 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 376,471,912 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 187,207,732 lekë dhe kësaj vlere i shtohet dhe kostoja e ndërtimit të kopështit prej 47,528,848 lekë. Rrjedhimisht, kosto e përgjithshme e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 duke përfshirë dhe ambjentet e kopështit është 234,736,581 lekë.
- Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë dhe këto shkolla nuk kanë ambjente kopështi.

Tabela 174 Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 4

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopështi për shkollë	Sip ndërtimi shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
Tipi 1	1	20	4	4,938	874	5,812	46,332	54,381	228,785,770	47,528,848	276,314,618	276,314,618
Tipi 2	1	30	6	6,588	1,310	7,898	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	376,471,912
Tipi 4	2	21	-	8,001	-	8,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	370,699,665
Grand To	**4**	**71**	**10**	**19,527**	**2,184**	**21,711**	**138,995**	**163,143**	**719,368,623**	**118,767,740**	**838,136,363**	**1,023,486,195**

Në total, do të ndërtohen **1 shkolla të tipit 1** me kosto ndërtimi 276,314,618 lekë për shkollë, **1 shkolla të tipit 2** me kosto ndërtimi 376,471,912 lekë për shkollë dhe **1 shkolla të tipit 4** me kosto ndërtimi 185,349,833 lekë për shkollë. Rrjedhimisht, kostoja total e ndërtimit për **Loti 4** shkon në **1,023,486,195 lekë**. Kjo është një kosto që do të mbulohet nga koncensionari.

Open Procurement Albania

1.3.1.3. Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit

Bazuar dhe në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostot e tjera direkte të investimit janë:

- Studim projektimi;
- Mbikqyrja e punimeve;
- Kolaudimi;
- Oponenca teknike;
- Mbrojtja ndaj zjarrit;
- Leja mjedisore;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Duke marrë parasysh të dhënat e analizuara në kapitullin respektiv mbi kostot, rezulton se kostot e tjera të drejtpërdrejta të investimit janë si më poshtë vijon:

Tabela 175 Kostot e drejtpërdrejta të investimit për Lotin 4

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Tot Sipërfaq e ndërtimi	Kosto Studim Projektim	Kosto Mbikqyrje	Kosto kolaudimi	Oponenca teknike	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
Tipi 1	1	5,812	4,481,127	3,140,921	110,526	223,183	50,000	30,000
Tipi 2	1	7,898	10,110,384	4,177,904	150,589	250,675	50,000	30,000
Tipi 4	2	8,001	10,691,738	4,364,479	153,710	369,692	100,000	60,000
Grand To	**4**	**21,711**	**25,283,249**	**11,683,304**	**414,825**	**843,550**	**200,000**	**120,000**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0.

1.3.1.4.Kosto e mobilimit

Për të vënë në përdorim shkollat, nevojitet pajisja e secilës prej tyre me, pajisjet e nevojshme IT si edhe laboratoret e nevojshme. Mobilimi i shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë do të realizohet në bazë të ligjit 69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin "Për projektimin e ndërtesave shkollore" (Normat dhe Standartet).

Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambjenteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth 24,167 lekë. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit i jemi referuar ofertave të marra nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS.

Konkretisht sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tabela 176 Kosto mobilimi të shkolave sipas tipit

Tipi shkollës	Nr. klasave	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/nxënës	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

Në koston e mobilimit për arsimin bazik janë përfshirë të tre nivelet që parashikohen për këto tipe.

Për mobilimin e kopshteve të reja, i jemi referuar eksperiencës së më parshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit i jemi referuar cmimeve të tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth 27,916 lek. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikologes, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet.

Si përfundim, kosto e mobilimit sipas tipologjisë së kopshte do të jetë si më poshtë:

Tabela 177 Kosto mobilimi kopështesh sipas tipit

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nx. total	Kosto/fëmijë	Kosto totale
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

Përsa i përket kostove për pajisjet laboratorike, i jemi referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana juaj, kontratë blerje "Laboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitar" realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, nga e cila rezulton se vlera për laborator pa TVSH është sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 178 Kosto për pajisjen e Laboratorëve

I	Shkolla Arsimi Bazik	Vlera/ laborator
1	Laborator Shkencat natyrore	186,998
2	Laborator Kimie	223,125
3	Laborator Fizike	1,183,602
4	Laborator Biologjie	632,467
5	Laborator IT	3,869,658
II	Shkolla e Mesme	-
1	Laborator Kimie	528,469
2	Laborator Fizike	1,294,500
3	Laborator Biologjie	651,657

Open Procurement Albania

4	**Laborator IT**	3,869,658

Sipas tipologjisë së shkollave të përcaktuara në bazë të standarteve të projektimit për objektet e arsimit parauniversitar, të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në të cilën përcaktohet sasia e laboratërve për cdo tip, kemi tabelën, si më poshtë:

Tabela 179 Kosto për pajisjen e Laboratorëve sipas tipit të shkollës

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	**Arsimi Bazik (Tipi 1)**	6,095,850
2	**Arsimi Bazik (Tipi 2)**	7,279,450
3	**Arsimi Bazik (Tipi 3)**	5,743,950
4	**Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)**	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e **4 shkollave është 114,741,433** pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 180 Kosto mobilimi dhe pajisje laboratorësh për shkollat e Lotit 4

Tipi	Nr i shkollave sipas tipit	Kosto e mobilimit te shkollave	Kosto e mobilimit të kopështeve	Total Kosto Mobilimi	Kosto Laboratori	Total kosto pajisje, mobilje dhe orendi
Tipi 1	1	14,500,000	2,680,000	17,180,000	6,095,850	23,275,850
Tipi 2	1	21,750,000	4,020,000	25,770,000	7,279,450	33,049,450
Tipi 4	2	30,450,000	-	30,450,000	27,966,133	58,416,133
Grand To	**4**	**66,700,000**	**6,700,000**	**73,400,000**	**41,341,433**	**114,741,433**

1.3.1.5.Kosto direkte e Investimit

Në përfundim, kosto direkte e investimit të këtij projekti është **1,230,118,136 lekë**. Nga këto **53,345,580** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga koncesionari është **1,176,772,556** lekë, ku kosto e ndërtimit është **1,023,486,195** lekë pa TVSH, Kosto e Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **153,286,361** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Tabela 181 Kosto direkte investimi për Lotin 4

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,230,118,136**
A.1	**Kostot e Truallit**	**53,345,580**
A.2	Kostot e Projektimit	25,283,249
A.3	- Ndertim + instalime	1,023,486,195
A.4	- Oponenca teknike	843,550
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	11,683,304
A.9	- Kosto Kolaudimi	414,825
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	73,400,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	41,341,433

1.3.2 Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Bazuar dhe nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose 351,755 lekë pa TVSH. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat për **Loti 4** është **35,879,060** lekë në vit. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Për më shumë detaje, shih tabelat më poshtë.

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtjes për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
Tipi 1	1	8,442,132	8,442,132
Tipi 2	1	12,663,198	12,663,198
Tipi 4	2	7,386,865	14,773,731
Grand Total	**4**	**8,969,765**	**35,879,060**

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë **251,153,420** lekë pa tvsh. Nga të cilat **165,363,968** lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve,

dhe **85,789,452** lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një viti pa TVSH.

Open Procurement Albania

Tabela 183 Kosto e detajuar e mirëmbajtjes për Lotin 4

Nr i shkollave	Adresa	Tipi	Cikli	nr klasash për shkollë	Lyerje per klase	Riparim suvatim + hidroizolim per klase	Riparime dhe mirembajtje e Nderteses	Riparime Orendi shkollore	Riparime Pajisje PC	Materiale Pastrimi	Lëndë djegëse për ngrohje dhe ujë të ngrohtë	Mirembajtje kondicionim, impiante uji dhe MNZSH	Sherbim roje	Sherbim pastrimi	Sherbim sekretarie	Total kosto mirembajtjeje
1	NJA 02	Tipi 2	9-vjeçar	36	824,079	845,210	258,531	609,794	929,032	304,839	3,010,065	1,556,129	1,029,693	2,745,848	549,978	12,663,198
2	NJA 08	Tipi 1	9-vjeçar	24	549,386	563,474	172,354	406,529	619,355	203,226	2,006,710	1,037,419	686,462	1,830,565	366,652	8,442,132
3	NJA 08	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
4	NJA Dajt	Tipi 4	i mesëm i l	21	480,713	493,039	150,810	355,713	541,935	177,823	1,755,871	907,742	600,654	1,601,745	320,820	7,386,865
Totali i Mirembajtjes				**102**	**2,334,891**	**2,394,762**	**732,505**	**1,727,749**	**2,632,257**	**863,711**	**8,528,517**	**4,409,032**	**2,917,463**	**7,779,903**	**1,558,270**	**35,879,060**

Open Procurement Albania

1.4. Analiza e të ardhurave të PPP

1.4.1. Tarifa e përdorimit të shkollave

Tarifa e përdorimit të shkollave (në vazhdim "Tarifa"), duhet të përllogaritet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulimin e kostove të koncensionarit si dhe të garantojë një marzh minimal fitimi për koncensionarin, në mënyrë që nga njëra anë kjo PPP të jetë atraktive dhe njëkohësisht të jetë dhe zgjidhja më e mire ekonomike krahasuar me skenarë të tjerë të mundshëm. Tarifa paguhet për gjithë periudhën e mirëmbajtjes dhe administrimit të shkollave nga ana e koncensionarit, pra për 7 vite. Kjo tarifë në vetvete paguhet çdo vit nga Bashkia Tiranë përmes burimeve të financimit të detajuara si më poshtë. Përmes kësaj skeme, jo vetëm që sigurohet ndërtimi i 17 shkollave në kohë rekord, duke zgjidhur minimalisht çështjen e arsmimit me turne, dhe mbipopullimit të klasave, por duke qënë se të gjitha risqet për mirembajtjen dhe përdorimin me kujdes të asetit do të jenë në ngarkim të koncensionarit, dhe të lidhura dhe me pagesat, kjo do të bëjë që të kemi ndërtime cilësore në dobi të komunitetit.

Duke qënë se kostoja direkte investimit, pra ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave është përllogaritur në bazë të preventivave, të cilat përfshijnë dhe marzhin e fitimit të kontraktorit, atëhërë mbi këtë zë nuk përllogaritet marzh fitimi shtesë. Por nga ana tjetër, duke qënë se koncesionari vlerat e investuara për këtë qëllim, do të mbulohet në harkun kohor të 7 viteve, minimalisht, duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë, si dhe për pjesën e mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme për këtë periudhë.

Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse[60], përkatësisht rezultet e obligacioneve 7 vjecare nga viti 2015 deri në 15.09.2016.

Tabela 184 Marzhi i fitimit

ISIN	Dt.Ankandi	Ankandi	Muaji	Datë Emetim	Datë Maturim	Shuma e shpallur (fillestare)	Shuma e shpallur (nd. strukture)	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Prorata Konkurues	Prorata Jo Konkuruese	Yieldi Uniformi i Pranuar
AL0017NF7Y23	13.09.2016	7vjeçar/7years(fix)	Shtator	15.09.2016	15.09.2023	3,000,000		2,309,000	2,309,000			4.89%
AL0016NF7Y23	01.06.2016	7vjeçar/7years(fix)Rihapje	Qershor	03.06.2016	16.03.2023	2,000,000		3,141,400	2,000,000	4.40%		4.00%
AL0016NF7Y23	11.03.2016	7vjeçar/7years(fix)	Mars	16.03.2016	16.03.2023	3,000,000		8,247,000	2,999,900	76.48%		4.90%
AL0015NF7Y22	14.12.2015	7vjeçar-fiks	Dhjetor	16.12.2015	16.12.2022	2,500,000		5,288,600	2,500,000	67.70%	100.00%	6.79%
AL0014NF7Y22	14.09.2015	7vjeçar-fiks	Shtator	16.09.2015	16.09.2022	1,000,000		1,430,600	1,000,000	100.00%	100.00%	7.78%
AL0013NF7Y22	12.06.2015	7vjeçar-fiks	Qershor	16.06.2015	16.06.2022	3,000,000		2,953,500	2,953,500	100.00%	100.00%	7.80%
AL0012NF7Y22	12.03.2015	7vjeçar-fiks	Mars	16.03.2015	16.03.2022	2,500,000		2,815,800	2,500,000	80.98%	77.92%	7.81%
										Yieldi Mesatar i pranuar		6.28%

[60] http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise/rezultatet-e-ankandeve/2016

Marzhi i fitimit do të jetë objekt tenderimi i konkurentëve në këtë PPP, por ndërkohë është i domosdoshëm për të kuptuar sa do të jetë vlera e përgjithshme e kësaj PPP. Marzhi i fitimit, do të llogaritet, për vlerën e mbetur të investimit direkt çdo vit, dhe mbi kostot vjetore të mirëmbatjes. Në këtë mënyrë, nga njëra anë, sigurohet që skema e financimit të jetë atraktive për konkurentët e mundshëm, dhe, nga ana tjetër, kosto totale e projektit të mos dalë më e lartë sesa mënyrat tradicionale të financimit.

Bazuar në përllogaritjet e kryera, tarifa vjetore që do t'i paguhet koncesionarit me marzhin prej 6.28% do të ishte si më poshtë:

Open Procurement Albania

Tabela 185 Tarifa vjetore qe do t'i paguhet koncesionarit për Lotin 4

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,176,772,556										
2	1	1,176,772,556	6.28%	168,110,365	1,008,662,191	73,901,317	242,011,682	35,879,060	2,253,205	38,132,265	76,154,522	**280,143,947**
3	2	1,008,662,191	6.28%	168,110,365	840,551,826	63,343,986	231,454,351	35,879,060	2,253,205	38,132,265	65,597,191	**269,586,616**
4	3	840,551,826	6.28%	168,110,365	672,441,461	52,786,655	220,897,020	35,879,060	2,253,205	38,132,265	55,039,860	**259,029,285**
5	4	672,441,461	6.28%	168,110,365	504,331,096	42,229,324	210,339,689	35,879,060	2,253,205	38,132,265	44,482,529	**248,471,954**
6	5	504,331,096	6.28%	168,110,365	336,220,730	31,671,993	199,782,358	35,879,060	2,253,205	38,132,265	33,925,198	**237,914,623**
7	6	336,220,730	6.28%	168,110,365	168,110,365	21,114,662	189,225,027	35,879,060	2,253,205	38,132,265	23,367,867	**227,357,292**
8	7	168,110,365	6.28%	168,110,365	-	10,557,331	178,667,696	35,879,060	2,253,205	38,132,265	12,810,536	**216,799,961**
Grand total				**1,176,772,556**		**295,605,266**	**1,472,377,822**	**251,153,420**	**15,772,435**	**266,925,855**	**311,377,701**	**1,739,303,677**

Open Procurement Albania

Për të garantuar suksesin ekonomik të skemës, është menduar që koncensionari të paguhet përmes tarifave vjetore zbritëse. Kjo mënyrë pagimi do të bëntë që koncesnionari të mos vendosej në vështirësi financiare të mëdha gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës së koncensionit. Kësisoj, vitin e parë kësti do të jetë 280,143,947 lekë dhë pas çdo viti do të ulet gradualisht, deri në 1,739,303,677 lekë në vitin e fundit.

Tabela 186 Shuma e kestit vjetor

Nr rendor	Viti	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	
2	1	**280,143,947**
3	2	**269,586,616**
4	3	**259,029,285**
5	4	**248,471,954**
6	5	**237,914,623**
7	6	**227,357,292**
8	7	**216,799,961**
Grand total		**1,739,303,677**

Open Procurement Albania

1.4.2 Burimi i Financimit.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti për **Loti 4** është **1,792,649,257** lekë nga të cilat, **53,345,580** janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe **1,739,303,677** lekë është vlera e koncensionit:

Tabela 187 Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 4

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**53,345,580**	**1**	**53,345,580**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**1,176,772,556**	**1**	**1,176,772,556**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,176,772,556	1	1,176,772,556
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**35,879,060**	**7**	**251,153,420**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	35,879,060	7	251,153,420
4	**Marzhi i Fitimit**	**311,377,701**	**1**	**311,377,701**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	311,377,701	1	311,377,701
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4+5)			**1,792,649,257**

Procurement Albania

Tabela 188 Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	53,345,580	1,739,303,677	1,792,649,257
Totali	**53,345,580**	**1,739,303,677**	**1,792,649,257**

Këto shpenzime do të mbulohen përmes të ardhurave të Bashkisë, dhe Granteve të Kushtëzuara që Ministria financave do të japë për këtë projekt.

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për këtë projekt, do të gjenerohen nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore, e cila është vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për qytetin e Tiranës".

Tabela 189 Parashikimet e të ardhurave që do të gjenerohen nga taksa e përkohëshme për Infrastrukturën arsimore

E m ë r t i m i	PLANI VITI 2016	PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018
Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	**870 000 000**	**940 000 000**	**1 000 000 000**
Familjarët	320 000 000	340 000 000	350 000 000
Subjektet Tregtare	550 000 000	600 000 000	650 000 000

Të ardhurat nga Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore janë planifikuar të jenë 870 milionë lekë në vitin 2016, ndërkohë që këto të ardhura parashikohet të rriten në 940 milionë lekë në vitin 2017 dhe 1 miliard lekë në vitin 2018. Kjo taksë e përkohëshme është vendosur për një periudhë 7 vjeçare dhe për vitet 2019-2022, të ardhurat vjetore parashikohet të jenë rreth 1 miliard lek. Të ardhurat nga transferta specifike nga Ministria e Financave do të jenë në masën 700 milionë lek në vit. Në këtë mënyrë, fondi në dispozicion të Bashkisë Tiranë për kryerjen e pagesave periodike parashikohet të jetë rreth 1 miliard e 700 milion lekë në vit.

Open Procurement Albania

1.5.Analiza Financiare

Tabela 190 Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**1,230,118,136**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**1,230,118,136**
A.1	**Kostot e Truallit**	**53,345,580**								**53,345,580**
A.2	Kostot e Projektimit	25,283,249								25,283,249
A.3	- Ndertim + instalime	1,023,486,195	-							1,023,486,195
A.4	- Oponenca teknike	843,550								843,550
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	120,000								120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	200,000								200,000
A.8	- Kosto Supervizimi	11,683,304								11,683,304
A.9	- Kosto Kolaudimi	414,825								414,825
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	73,400,000	-	-	-	-	-	-	-	73,400,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	41,341,433								41,341,433
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**251,153,420**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**23,623,424**	**23,623,424**	**23,623,424**	**23,623,424**	**23,623,424**	**23,623,424**	**23,623,424**	**165,363,968**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	5,462,158	5,462,158	5,462,158	5,462,158	5,462,158	5,462,158	5,462,158	38,235,106
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		13,801,260	13,801,260	13,801,260	13,801,260	13,801,260	13,801,260	13,801,260	96,608,820
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		1,727,749	1,727,749	1,727,749	1,727,749	1,727,749	1,727,749	1,727,749	12,094,243
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		2,632,257	2,632,257	2,632,257	2,632,257	2,632,257	2,632,257	2,632,257	18,425,799
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**12,255,636**	**12,255,636**	**12,255,636**	**12,255,636**	**12,255,636**	**12,255,636**	**12,255,636**	**85,789,452**
B.2.1	Staf Roje		2,917,463	2,431,219	2,026,016	1,688,347	1,406,956	1,172,463	977,052	12,619,516
B.2.2	Staf Sanitare		7,779,903	7,779,903	7,779,903	7,779,903	7,779,903	7,779,903	7,779,903	54,459,321
B.2.3	Staf Sekretare		1,558,270	1,558,270	1,558,270	1,558,270	1,558,270	1,558,270	1,558,270	10,907,890
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**1,230,118,136**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**35,879,060**	**1,481,271,556**

C.	**Të Adhurat**	**53,345,580**	**280,143,947**	**269,586,616**	**259,029,285**	**248,471,954**	**237,914,623**	**227,357,292**	**216,799,961**	**1,792,649,257**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	53,345,580								**53,345,580**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		280,143,947	269,586,616	259,029,285	248,471,954	237,914,623	227,357,292	216,799,961	**1,739,303,677**
D	**Fitimi (humbja)**	(1,176,772,556)	244,264,887	233,707,556	223,150,225	212,592,894	202,035,563	191,478,232	180,920,901	**311,377,701**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(1,176,772,556)	(932,507,670)	(698,800,114)	(475,649,889)	(263,056,995)	(61,021,432)	130,456,800	311,377,701	**311,377,701**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(19,568,520)	(27,138,135)	**(46,706,655)**

Open Procurement Albania

Tabela 191 Fluksi i arkës së projektit

Fluksi i Arkës									
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Flukse dalese nga Investimet	- 1,230,118,136	-	-	-	-	-	-	-	- 1,230,118,136
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	-	- 35,879,060	- 35,879,060	- 35,879,060	- 35,879,060	- 35,879,060	- 35,879,060	- 35,879,060	- 251,153,420
Flukse dalese nga Taksat	-	-	-	-	-	-	- 19,568,520	- 27,138,135	- 46,706,655
Totali i flukseve dalese	**-1,230,118,136**	**- 35,879,060**	**- 35,879,060**	**- 35,879,060**	**- 35,879,060**	**- 35,879,060**	**- 55,447,580**	**- 63,017,195**	**- 1,527,978,211**
Flukse hyrese nga Operimet	**53,345,580**	**280,143,947**	**269,586,616**	**259,029,285**	**248,471,954**	**237,914,623**	**227,357,292**	**216,799,961**	**1,792,649,257**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,176,772,556**	**244,264,887**	**233,707,556**	**223,150,225**	**212,592,894**	**202,035,563**	**171,909,712**	**153,782,766**	**264,671,046**
Gjendja e arkes progresive	**-1,176,772,556**	**- 932,507,670**	**- 698,800,114**	**- 475,649,889**	**- 263,056,995**	**- 61,021,432**	**110,888,280**	**264,671,046**	**264,671,046**

1.6.Realizueshmëria Ekonomike e Projektit

1.6.1. NPV (Net Present Value – Vlera Aktuale Neto)

NPV, si metoda standarte për vlerësimin e projekteve afatgjata përmes analizës së vlerës në kohë të parasë, paraqet shumën e fluksit të arkës së projektit (Cash Floë) të skontuar. Çdo investues, kur vendos ndërmarrjen e një investimi analizon të ardhurat e gjeneruara nga projekti krahasuar më të ardhurat e mundshme nëse paratë e investuara do të përdoreshin në një tjetër mënyrë. Përgjithësisht, këto analiza kryhen duke marrë për bazë normën e interesit në rast të investimit të parave, për shembull, në bono thesari apo obligacione qeveritare, të cilat kanë risk thuajse zero.

Formula klasike për llogaritjen e NPV-së, nëse investimi bëhet brenda një viti, është:

$$NPV = \sum_{t=1}^{T} \frac{C_t}{(1+r)^t} - C_0$$

ku:

C_0 - përfaqëson paranë e shpenëzuar për kryerjen e investimit fillestar;

C_t – përfaqëson të ardhurat nga investimi i kryer;

t – përfaqëson kohëzgjatjen e projektit;

r – përfaqëson normën e pritshme të skontimit.

Open Procurement Albania

Për të parë realizueshmërinë ekonomike të projektit, është testuar modeli financiar me disa norma të mundëshme skontimi. Nga kjo analizë, ka rezultuar se konçensionarët e mundshëm do të kenë interes në këtë projekt vetëm në rast se kosto e tyre oportune është më e ulët se 5.79%. Me fjalë të tjera, për çdo normë skontimi mbi 5.79% ky projekt nuk paraqet leverdisshmëri ekonomike nga ana e koncensionarit.

	NPV						
norma e skontimit e parashikuar	**5%**		**5.79%**		**6%**		**7%**
NPV	**29,884,696**	**-**	**15,136**	**-**	**7,682,796**	**-**	**42,661,484**

1.6.2. IRR (Internal Rate of Return – Norma e Brendshme e Kthimit)

IRR-ja është një metodë që përdoret për të matur fitimin e investimeve të mundshme. IRR-ja është një normë skontimi që e bën vlerën aktuale neto (NPV) të të gjithë fluksit të arkës (cash floë) të një projekti të barabartë me zero. Sipas teorisë ekonomike, çdo projekt me një IRR më të madhe se kosto e tij kapitale është fitimprurës, e rrjedhimisht investitorët kanë interes të investojnë në të. Në bazë të analizës financiare, IRR-ja e këtij projekti është në masën 5.79%.

Open Procurement Albania

Tabela 192 Norma e brendshme e kthimit e projektit

				IRR					
Viti	**Viti 0**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Grand total**
Gjendja e Arkes ne fund te periudhes	**-1,176,772,556**	**244,264,887**	**233,707,556**	**223,150,225**	**212,592,894**	**202,035,563**	**171,909,712**	**153,782,766**	**264,671,046**
IRR	**5.79%**								

1.6.3. Periudha e Vetëshlyerjes

Periudha e vetëshlyerjes paraqet kohën që nevojitet në mënyrë që një kapitali i investuar të kompensohet nga të ardhurat nga projekti. Përgjithësisht, periudha e vetëshlyerjes llogaritet duke pjesëtuar koston e investimit me të ardhurat vjetore. Por, duke qenë se në këtë projekt të ardhurat vjetore përbëhën nga këste zbritëse, periudha e vetëshlyerjes është vlerësuar duke analizuar fluksin e arkës për të përcaktuar vitin e fundit në të cilën ky fluks është negativ.

Periudha e Vetëshlyerjes		
Viti i fundit i gjendjes se arkes negative		5
Gjendja e arkes kumulative ne vitin e fundit negativ	-	61,021,432
Gjendja e arkes pozitive krijuar ne vitin vijues		171,909,712
PBP (periudha e veteshlyerjes)		5.35

Nga sa u përshkrua më sipër, periudha e vetëshlyerjes për këtë projekt arrihet në 5.35 vite. Megjithatë, duke parë që pagesat nga ana e Bashkisë Tiranë do të jenë vjetore, atëherë periudha e vetëshlyerjes nuk do të jetë 5.35 vite, por do të jetë 6 vite.

1.6.4. Përshtatshmëria financiare

Sipas VKM nr, 575, datë 10.07.2013, neni 7, pika 10, përshtatmëria financiare e një projekti "tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar."

Në bazë të analizës financiare të mësipërme, ky projekt është ekonomikisht i realizueshëm dhe kjo realizueshmëri, në mënyrë të thuket, jepet nga vlerat e mëposhtme:

- NPV = 5.79% > 0
- IRR = 5.79% > se interesi i depozitave apo bonove të thesarit
- PBP = 6 vite < 7 vite (kohëzgjatja e konçensionit)

Open Procurement Albania

1.7.Analiza Cilësore dhe Sasiore e Risqeve

Analiza e risqeve ka si synim parësor të saj identifkimin dhe vlerësimin e gamës së risqeve që mund të ndikojnë projektin. Në këtë mënyrë, zhvillohet një strategji për menaxhimin e riskut në mënyrë që të garantohet realizimi i projektit me sukses. Në përputhje me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", më poshtë vijon një analizë e risqeve që prekin këtë projekt.

1.7.1. Analiza cilësore e risqeve

Risku i trojeve

Përshkrimi i riskut: Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e 17 shkollave do të jenë kryesisht me pronësi shtet, ndërsa trojet në pronësi private do të shpronësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pastaj do të vihen në dispozicion të koncensionarit. Rrjedhimisht, ky risk ka probablitet të ulët, thuajse zero, për të ndikuar mbi projektin. Përsa u përket lejeve të nevojshme, ky risk nuk ekziston pasi Bashkia Tiranë është vetë organi përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve. Së fundi, përsa u përket standarteve mjedisore, trojet e përzgjedhura janë parcela në ndodhura në zona ku nuk ndikohet asnjë standart mjedisor, ndaj edhe ky risk vlerësohet zero.

Menaxhimi i riskut: Ky risk vlerësohet me probabilitet zero dhe cilësohet si risk i mbajtur nga Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë do të kryejë të gjitha procedurat për shpronësimin e trojeve private jashtë kësaj skeme PPP-je dhe përpara kohës së përcaktuar për nisjen e punimeve. Në rast se ndonjë prej trojeve të përzgjedhura do të ketë konflikt pronësie çka do ta bënte shpronësimin të pamundur, pranë ZRPP është kërkuar informacion edhe për sheshe alternative, të cilat mund të përdoren. Përsa u përket kushteve gjeologjike dhe standarteve mjedisore, është kryer një studim mjedisor që është pjesë e këtij studimi fizibiliteti, i cili ka arritur në përfundimin se me ndërtimin e këtyre objekteve nuk preket asnjë standart mjedisor. Për më tepër, gjatë marrjes së lejes së ndërtimit do të hartohet edhe një studim mjedisor më i detajuar nga ana e koncensionarit.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë

Përshkrimi i riskut: Kostimi i ndërtimit dhe mobilimit të shkollave të reja është bazuar në një metodologji të shpjeguar gjërësisht më sipër, e cila merr për bazë koston e shkollave të ndërtuara nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit. Kësisoj, mundësia që kosto e ndërtimit të jetë më e lartë sesa kostoja e përllogaritur është thuajse zero. Ndërtimi dhe vënia në punë e shkollave varen në një shkallë të caktuar nga marrja e lejes së ndërtimit dhe plotësimi i parakushteve për marrjen e kësaj lejeje, si leja mjedisore, lidhja me rrjetin elektrik apo ujësjellësin, miratimi i projekteve për mbrojtjen nga zjarri, etj. Koncensionari ka detyrën të bëjë projektimin, të përgatisë dokumentacionin për pajisje me leje ndërtimi si edhe të ndërtojë objektet shkollore. Nga ky prizëm, risku i vonesave në paisje me leje ndërtimi, i vonesave në nisjen e punimeve e, rrjedhimishit, i vënies në punë është i mundshëm.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi koncensionarin. Koncensionari ka detyrimin të përgatisë dokumentat dhe të pajiset me leje ndërtimi. Në rast se koncensionari nuk do të përgatisë projektin në kohë, do të neglizhojë aplikimin për leje ndërtimi duke mos aplikuar në kohë apo

duke pasur mangësi në dokumentacion apo nuk do t'i kryejë punimet në kohë, atëherë ai do të mbajë përgjegjësi për mos nisjen e punimeve në afat dhe do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve që do të bëhën në kontratën konçensionare. Gjithashtu, meqenëse konçensionari është përgjegjës si për hartimin ashtu edhe për zbatimin e projektit, çdo vonesë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa vjen si rezultat i forcës madhore, do të jetë përgjegjësi e tij për të cilën do të dëmshpërblejë autoritetin kontraktor sipas përcaktimeve në kontratën konçensionare.

Risku i funksionimit

Përshkrimi i riskut: Mundësia që shkollat e reja të mos funksionojnë pasi të jenë ndërtuar lidhet me kryerjen e punimeve jo cilësore nga ana e koncensionarit, çka do ta bënte zhvillimin e mësimit në godinat e reja të pamundur. Ky risk ka probabilitet të ulët pasi kryerja e punimeve do të mbikqyret nga mbikqyrësi teknik dhe situacionet financiare do të mbikqyren nga autoriteti kontraktor. Përsa i përket riskut që kostoja e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa pritej, probabiliteti është thuajse zero, pasi kostoja vjetore e mirëmbajtjes është llogaritur duke u bazuar në shpenzimet vjetore të Bashkisë Tiranë për mirëmbajtjen e shkollave ekzistuese, të cilat janë ndërtuar para shumë viteve. Sipas standarteve inxhinierike, kostoja e mirëmbajtjes së objekteve të sapondëruara është me e ulët se ajo e objekteve të ndërtuara kohë më parë.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtij risku është i ulët dhe ai cilësohet si një risk i transferuar tek koncensionari. Në rast se cilësia e ndërtimit do të jetë e tillë që do ta bëjë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të mbajë përgjegjësi dhe do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë derisa cilësia e punimeve të jetë në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit. Në rast se, për shkak të punimeve të kryera gjatë ndërtimit, gjatë peiudhës 7 vjeçare të zgjatjes së kontratës, godinat shkollore do të shfaqin probleme që do ta bëjnë të pamundur zhvillimin e mësimit, koncensionari do të ketë detyrimin të kryejë punime shtesë për ta bërë shkollën sërish funksionale. Në rast se kostoja e mirëmbajtjes do të rezultojë më e lartë se parashikimi, kjo do të vijë si pasojë e pasaktësive në projektim ose ndërtim. Rrjedhimisht, risku bie mbi konçensionarin, i cili ka përgjegjësinë të projektojë dhe ndërtojë shkollat.

Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare

Përshkrimi i riskut: Ky risk lidhet me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej apo të ardhurat e gjeneruara janë më të ulëta se sa parashikimi. Duke qenë se objektet që do të ndërtohen janë godina shkollore të cilat nuk mund të kenë përdorim të ndryshëm e nuk mund të gjenerojnë të ardhura, ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin në fjalë.

Menaxhimi i riskut: Mundësia që projekti të ndikohet nga ky risk është zero pasi ai nuk aplikohet mbi të.

Risqet ekonomike dhe financiare

Përshkrimi i riskut: Meqenëse ky projekt përfshin transaksione financiare të shtrira në kohë, ekziston mundësia që ai të ndikohet nga risqet ekonomike e financiare. Rritja e paparashikuar e normave të interesit mund të rrisë kostot e financimit të projektit nga ana e koncensionarit. Nga

ana tjetër, ndryshimet në kursin e këmbimit valutor mund të kënë ndikim përkeqësues në financat e koncencionarit në rast se të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë në monedha të ndryshme, për shembull koncensionari ka marrë kredi në Euro apo Dollarë për financimin e projektit, ndërkohë që Bashkia e Tiranë ia kryen pagesat vjetore në Lekë. Së fundi, duke qenë se ky projekt përfshin pagesa periodike për një periudhë 7 vjeçare, ekziston mundësia që të ardhurat e koncensionarit të preken nga inflacioni.

Menaxhimi i riskut: Duke qenë se Shqipëria konsiderohet një vend me një situatë makroekonomike të qendrueshme, probabiliteti që projekti të ndikohet nga ky risk mbetet i ulët. Risku i normave të interesit apo i normave të këmbimit valutor është një risk që bie mbi konçensionarin dhe duhet të llogariten në parashikimet e tij financiare. Risku i inflacionit është një risk që ndahet mes Bashkisë Tiranë dhe konçensionarit. Meqenë se politika e Bankës së Shqipërisë është mbajtja e inflacionit nën 3% dhe kohëzgjatja e projektit është vetëm 7 vjet, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, në përcaktimin e marzhit të fitimit si të lidhur me normën e interesit për obligacionet 7 vjeçare, Bashkia e Tiranës garanton për konçensionarin të njëjtën mbrojtje ndaj risqeve ekonomike e financiare që garanton edhe Qeveria e Shqipërisë për blerësit e obligacioneve.

Risqet e pronësisë së aseteve

Përshkrimi i riskut: Ky riskt lidhet me mundësinë që teknologjia të vjetërohet apo që vlera e aseteve të jetë e ndryshme në fund të kontratës. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtim godinash shkollore, të cilat do të mirëmbahen nga konçensionari për një periudhë 7 vjeçare, probabiliteti i këtij risku është i ulët. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të mirëmbajtjes jo cilësore, në fund të kontratës cilësia dhe vlera e aseteve të jetë më e ulët nga parashikimi.

Menaxhimi i riskut: Ky risk transferohet te konçensionari. Mirëmbajtja e godinave shkollore dhe mobiljeve e pajisjeve të tyre do të bëhet në përputhje me standartet në fuqi dhe do të mbikqyret nga autoriteti kontraktor. Në rast se konçensionari nuk do t'i mirëmbajë shkollat sipas përcaktimit të mësipërm, në kontratën e konçensionit do të parashikohen dispozita që e detyrojnë atë të shlyejë dëmin e shkaktuar. Në rast se në fund të kontratës, vlera e aseteve do të jetë e ndryshme nga sa është dakordësuar, në kontratën e koncensionit do të përcaktohen dispozita që do të detyrojnë koncensionarin të shlyjë dëmin.

Risku politik

Përshkrimi i riskut: Risku që vendimet politike të ndikojnë mbi projektin është evident. Duke qenë një projekt i nisur nga Bashkia e Tiranës, një organ i qeverisjes lokale, suksesi i këtij projekti varet nga dakordësia me qeverisjen qendrore. Gjithashtu, ekziston mundësia që si rezultat i zgjedhjeve lokale të ardhshme, një ndryshim i mundshëm në kreun e Bashkisë Tiranë mund të sjellë ndryshimin e prioriteteve, e për rrjedhojë bllokimin e projektit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi autoritetin kontraktor, Bashkinë Tiranë. Për të siguruar dakordësinë e institucioneve të qeverisjes qendrore, me miratimin e studimit të fizibilitetit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket riskut të ndikimit negativ të projektit si rezultat i

ndryshimeve në drejtimin e Bashkisë Tiranë, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që pengojnë prishjen e kontratës për arsye jo të ligjshme nga ana e autoritetit kontraktor.

Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor

Përshkrimi i riskut: Ndryshimet e mundshme në kuadrin legjislativ mund ta ndikojnë projektin si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Duke qenë se projekti lidhet me ndërtimin e godinave shkollore, mundësia që ai të afektohet nga ndryshimet ligjore lidhet vetëm me standartet dhe manualet e ndërtimit. Ndaj, ky risk ka një probabilitet të ulët që të ndodhë. Përsa u përket ndryshimeve të ligjeve fiskale, ndikimi negativ apo pozitiv ndjehet vetëm në financat e konçensionarit.

Menaxhimi i riskut: Ky risk bie mbi konçensionarin. Në mënyrë që efektet e tij të jenë sa më minimale, në kontratën konçensionare do të parashikohen dispozita që e mbrojnë atë nga ndryshimet diskriminuese në ligj – gjithmonë, nëse diskriminimi provohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, konçensionari do të jetë i detyruar të zbatojë çdo ndryshim ligjor që vjen si rezultat i politikave të qeverisë.

Risku i forcës madhore

Përshkrimi i riskut: Risqet e forcës madhore si fatkeqësitë natyrore, trazirat civile apo luftërat bien si mbi konçensionarin ashtu edhe mbi autoritetin kontraktor. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria është antare e NATO dhe me perspektivën e qartë të integrimit në BE, probabiliteti i risqeve si luftërat apo trazirat është thuajse zero. Nga ana tjetër, probabiliteti që projekti të ndikohet nga tërmetet apo fatkeqësitë e tjera natyrore ka gjithashtu pak gjasa që të ndodhë, siç ka rezultuar edhe nga analiza e mësipërme e ndikimit mjedisor të projektit.

Menaxhimi i riskut: Probabiliteti i këtyre risqeve është shumë i ulët dhe bie mbi të dyja palët. Në kontratën konçensionare do të parashikohen klauzolat e forcës madhore të cilat do garantojnë që të çdo ndikim negativ mbi projektin të ndahet ndërmjet palëve.

1.7.2. Analiza sasiore e risqeve

Kjo analizë synon të prioritizojë risqet që mund të ndikojnë projektin duke përllogaritur probabilitetin e tyre dhe ndikimin e mundshëm mbi arritjen e objektivave të projektit. Vlerësimi sasior është bazuar në probabilitetin e ndodhjes të secilit risk dhe në ndikimin e mundshëm mbi koston dhe afatet e projektit.

Ndikimi i risqeve mbi koston e projektit është llogaritur duke u bazuar mbi peshën specifike që zë secili prej tyre në koston e projektit. Ndërsa, ndikimi mbi afatin e përfundimit të punimeve është përllogaritur duke u bazuar në afatet ligjore për kryerjen e procedurave të caktuara që mund të nevojitet të ndiqen për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Më poshtë vijon një analizë sasiore mbi ndikimin që mund të ketë secili risk në koston dhe afatet e realizimit të projektit.

Risku i trojeve. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 0-5%. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është zero pasi shpronësimet e trojeve private që do të përdoren për ndërtimin e shkollave do të kryhet nga Bashkia e Tiranës me një fond të veçantë jashtë skemës financiare të këtij projekti. Trojet e përzgjedhura për ndërtimin e shkollave janë prona shtetërore dhe prona private. Në rast se përdorimi i ndonjërit prej këtyre trojeve është i pamundur, do të përdoret një prej trojeve alternative të përzgjedhura për të cilat është marrë informacion edhe pranë ZRPP. Rrjedhimisht, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve lidhet me marrjen në dorëzim të pronës shtet, në rast se nuk është pronë e Bashkisë Tiranë, ose shpronësimin e pronave private. Ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur 3 – 6 muaj.

Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë. Probabiliteti i këtij risku është i ulët, 5-10%. Kostimi i ndërtimit të shkollave është bërë në përputhje me manualet udhëzuese të MAS dhe në bazë të kostove të ndërtimit të shkollave nga Bashkia Tiranë gjatë 3 viteve të fundit dhe çmimet janë indeksuar sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit të INSTAT. Ndaj, ndikimi maksimal që ky risk të ketë në kosto është më i vogël se 5%. Nga ana tjetër, afati i punimeve mund të mos respektohet si rezultat i mos marrjes në kohë të lejes së ndërtimit apo lejeve të tjera nga ana e konçensionarit apo edhe nga kryerja e punimeve më ngadalë sesa është parashikuar në kalendarin e punimeve. Në rast se projektimi vonohet apo nuk plotësohet dokumentacioni për pajisjen me lejet e nevojshme, ndikimi mbi afatin e punimeve është përllogaritur nga 3 deri në 12 muaj.

Risku i funksionimit. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur nga 0-5%. Duke qenë se ky projekt lidhet me ndërtimin e shkollave të reja, ekziston mundësia që cilësia e ndërtimit të jetë e ulët, çka do të bënte që të kërkoheshin punime shtesë përtej afatit të përcaktuar. Ndikimi i këtij risku në afatin e punimeve është përllogaritur nga 1 deri në 3 muaj, ndërsa ndikimi mbi koston totale të projektit është përllogaritur 5-10%. Ekziston edhe mundësia që kosto e mirëmbajtjes të rezultojë më e lartë sesa është përllogaritur, por krahasuar me koston totale të projektit ndikimi i kësaj kostoje është thuajse i papërfillshëm.

Risku i kërkesës dhe risqet e tjera tregtare. Ky risk nuk aplikohet fare mbi projektin dhe munësia që ai të ndikojë koston apo afatet e realizimit të tij është zero.

Risqet ekonomike dhe financiare. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i ulët, 0-5%, duke marrë në konsideratë se nuk kemi të bëjmë me një konçension afat-gjatë ku konçensionari i nxjerr të ardhurat nga operimi i objektit të konçensionit. Duke qenë se të ardhurat e konçensionarit janë të garantuara nga Bashkia Tiranë dhe të mbrojtura nga inflacioni, ndikimi i riskut mbi koston totale të projektit është i ulët, 5% - 10%. Nga ana tjetër, ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve, nuk parashikohet më i lartë se 12 muaj.

Risqet e pronësisë së aseteve. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është përllogaritur 0 – 5%. Ndikimi i tij mbi koston totale të projektet lidhet me koston e mirëmbajtjes, në rast se kjo e fundit rezulton më e lartë se parashikimet dhe me amortizimin e godinave më shpejt se sa është parashikuar në kontratën e koncensionit. Ndikimi i tij mbi koston e projektit është llogaritur të jetë maksimimumi 5%. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku nuk i ndikon aspak afatet e realizimit të punimeve.

Risku politik. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është i mesëm i ulët dhe është llogaritur 10 - 20%. Ndodhja e këtij risku mund të bllokojë punimet në mes ose mund të ndërpresë pagesat periodike për konçensionarin, duke rritur koston e financimit të projektit dhe duke vonuar realizimin e punimeve. Për këto arsye, ndikimi i mundshëm i këtij risku mbi kosto është përllogaritur 20 – 30% ndërsa ndikimi mbi afatin e realizimit të punimeve është përllogaritur nga 16 deri në 24 muaj.

Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor. Ky riskt ka një probabilitet ndodhjeje që varion nga 5 deri në 15%. Ndryshime të mundshme ligjore, si për shembull në standartet që duhet të ndjekë ndërtimi i shkollave të reja mund të rrisin ndjeshëm koston e projektit. Prandaj edhe impakti i mundshëm mbi kosto është llogaritur të jetë i mesëm, nga 20 deri në 40%. Gjithashtu, ndryshime të mundshme ligjore mund të çojnë në ribërjen e projekteve apo në vonesa të tjera, çka do të ndikonte negativitsh afatin e realizimit të punimeve. Ndaj, ndikimi mbi afatin e punimeve është llogaritur nga 12 deri në 16 muaj.

Risku i forcës madhore. Probabiliteti i ndodhjes së këtij risku është shumë i ulët, nga 0 deri në 5%. Megjithatë, në rast të ndodhjes ndikimi mbi koston apo afatin e punimeve do të ishtë i mesëm i lartë. Kësisoj, ndikimi mbi koston është përllogaritur nga 30% deri në 50% ndërsa ndikimi mbi afatin e punimeve nga 12 deri në 24 muaj.

Tabela 193 Tabele permbledhese e impaktit te risqeve

Nr.	Risku	Probabiliteti i ndodhjes	Ndikmi mbi kosto	Ndikimi mbi afatin e punimeve
1	Risku i trojeve	0% - 5%	0%	3 – 6 muaj
2	Risku i projektimit, ndërtimit dhe vënies në punë	5% - 10%	0% -5 %	3 – 12 muaj
3	Risku i funksionimit	0% - 5%	5% - 10%	1 – 3 muaj
4	Risku i kërkesës dhe risqe të tjera tregtare	-	-	-
5	Risqet ekonomike dhe financiare	0% - 5%	5% - 10%	6 – 12 muaj
6	Risqet e pronësisë së aseteve	0% - 5%	0% - 1%	-
7	Risku Politik	10% - 20%	20% - 30%	16 – 24 muaj
8	Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor	5% - 15%	20% - 40%	12 – 16 muaj
9	Risku i forcës madhore	0% - 5%	30% - 50%	12 – 24 muaj

Open Procurement Albania

1.8.Analiza e ndjeshmërisë

Faktori kryesor që mund të ndryshojë gjatë procesit të tenderimit, është Marzhi i fitimit. Njëkohësisht, në varësi të projekteve që do të miratohen, detajimi i kostove përkatëse do të bëhet përkatësisht, bazuar mbi projektet faktike të miratuara. Kosto direkte do të përllogaritet bazuar në volume faktike të realizuara, të cilat në asnjë rast nuk mund të jenë më të larta sesa kosto e parashikuar e këtij projekti.

Gjithësesi për efekte të analizës së ndjeshmërisë, do të llogarisim sikur secila nga kostot ulet dhe rritet me 5% dhe 10% dhe marzhi i fitimit ulet dhe rritet përkatësisht me 5% dhe 10%:

	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 10%	Te ardhurat dhe shpenzimet rriten me 5%	Modeli Baze	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 5%	Te ardhurat dhe shpenzimet ulen me 10%
Norma e Sensitivitetit	10%	5%	0	-5%	-10%
Flukse dalese nga Investimet	- 7,267,445,188	- 6,937,106,771	- 6,606,768,353	- 6,276,429,936	-5,946,091,518
Flukse dalese nga Mirëmbajtja	- 1,275,711,645	- 1,217,724,752	- 1,159,737,859	- 1,101,750,966	-1,043,764,073
Të Ardhurat	10,274,681,048	9,786,000,321	9,197,517,960	8,713,446,063	8,188,265,320
Fitimi Para taksave	1,731,524,215	1,631,168,798	1,431,011,748	1,335,265,161	1,198,409,729
Tatim Fitimi 15%	- 259,728,632	- 244,675,320	- 214,651,762	- 200,289,774	- 179,761,459
Fitimi neto	1,471,795,583	1,386,493,478	1,216,359,986	1,134,975,387	1,018,648,270
NPV me 5.79%	110,223,600	81,672,242	170,329	- 23,634,170	- 68,587,789
IRR	6.38%	6.25%	5.79%	5.64%	5.34%
Norma e Vetëshlyerjes	5.20	5.28	5.35	5.43	5.51

Open Procurement Albania

9. Rezultatet e Studimit të Fizibilitetit

Në Bashkinë Tiranës gjenden gjithsej 191 shkolla publike. Nga llogaritjet e bëra rezulton se 61 shkolla kanë më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal dhe 57 shkolla e zhvillojnë mësimin me dy turne. Në total, në Bashkinë Tiranë janë 14,292 nxënës mbi kapacitetin maksimal të infrastrukturës arsimore dhe 14,919 nxënës që e zhvillojnë mësimin gjatë turnit të dytë. Nga kjo situatë janë ravijëzuar tre probleme shumë të mprehta më të cilët përballen nxënësit e Tiranës dhe familjet e tyre: zhvillimi i mësimit me dy turne, numri i lartë i nxënësve për klasë dhe vështirësia e askesit në shkolla, sidomos në lagjet e zhvilluara rishtazi e me dëndësi të lartë në të cilat nuk gjendet asnjë shkollë.

Zgjidhja e këtyre problemeve dhe garantimi i mundësisë që nxënësit ta zhvillojnë mësimin normalisht është jo vetëm e nevojshme, por edhe e domosdoshme. Ky projekt synon zgjidhjen e problemeve të sipërpërmendura përmes ndërtimit të 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jënë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Më ndërtimin e këtyre shkollave të reja, në Tiranë nuk do të ketë më shkolla të mbushura mbi kapacitetin e tyre normal apo shkolla që e zhvillojnë mësimin me dy turne. Rrjedhimisht, ky projekt nuk zgjidh vetëm një problem të së tashmes, por garanton edhe zhvillimin e qëndrueshëm të gjeneratave të ardhshme, të cilët do mund të përfitojnë një arsim publik më cilësor.

Hartimi dhe zbatimi i këtij projekti është një element i rëndësishëm i programit politik të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për mandatin 2015-2019. Ky angazhim politik është reflektuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, ku theksohet se një nga prioritetet kryesore të kësaj PBA-je është eleminimi i mësimit me dy turne. Për jetësimin e këtij prioriteti, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015, u vendos edhe Taksa e Përkohëshme për Infrastrukturën Arsimore. Në Relacionin që shoqëron ketë Vendim të Këshillit Bashkiak thuhet shprehimisht se të ardhurat e sigurara nga kjo taksë do të përdoren vetëm me synimin për t´i dhënë fund mësimit me dy turne përmes ndërtimit të shkollave të reja.

Gjithashtu, ky projekt është në përputhje si me procesin e planifikimit kombëtar e sektorial ashtu edhe me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës, si Plani i Përgjithshëm Vendor i vitit 2013 apo Plani i Përgjithshëm i vitit 2016 Tirana 030. Ai është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim 2015-2020 dhe Strategjinë për Arsimin Parauniviersitar 2014-2020, të cilat kanë përcaktuar si një objektiv të rëndësishëm në politikat e Qeverisë lidhur me arsimin parauniversitar, përmirësimin e shërbimit "Arsim cilësor për të gjithë" nëpërmjet azhornimit dhe krijimit të infrastrukturës në kopshtet dhe shkollat e reja dhe ekzistuese, në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë aksesin për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Ndërtimi i këtyre 17 shkollave të reja përmes një skeme koncensioni/partneriteti publik privat, ku shkollat e reja projektohen, financohen, ndërtohen dhe mirëmbahen nga koncensionari për një periudhë kohore 7 vjeçare është teknikisht dhe ekonomikisht i realizueshëm dhe financiarisht i përshtashëm. Vendndodhja e shkollave të reja është përcaktuar në përputhje me

rregullat e përgjithshme të planifikimit urban duke respektuar standartet e Ministrisë së Arsimit për sa u përket rrezeve të mbulimit të objekteve arsimore. Përzgjedhja e terreneve ku do ndërtohen shkollat është bërë duke i dhënë përparësi pronës publike. Aty ku nuk ka patur pronë publike të disponueshme, janë përzgjedhur prona private, por gjithmonë duke u kujdesor që mbi këto troje të mos ketë shtepi banimi apo aktivitete të tjera ekonomike, në mënyrë që impakti social apo ekonomik i shpronësimit të mbahet në minimum.

Kosto totale e projektit është përllogaritur në mënyrë të tillë që shkollat e reja të ndërtohen në përputhje me standartet më të larta bashkëkohore dhe, njëkohësisht, që projekti të gjenerojë fitimin e mjaftueshëm, sipas legjislacionit në fuqi, për t'u bërë atraktiv për sektorin privat.

Kosto e ndërtimit të shkollav dhe kopshteve është përcaktuar sipas preventivave të projekteve të realizuara nga Bashkia Tiranë gjatë viteve të shkuara, të cilat janë indeksuar me "Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa), 1994-2015" të INSTAT. Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m2. llogaritu gjithashtu edhe kostot e tjera të projektit, si kosto e mobilimit, kosto e mirëmbajtjes, studim projektimi, mbikqyrja e punimeve, kolaudimi, oponenca teknike, mbrojtja ndaj zjarrit dhe leja mjedisore.

Në total, kosto direkte e investimit për ndërtimin e 17 shkollave të reja është përllogaritur 7,743,692,163 lekë. Duke qenë se koncensionari do të paguhet me këste vjetore nga Bashkia Tiranë për një periudhë 7 vjeçare, atëherë ai do duhet të rimbursohet për vlerën në kohë të parasë. Për këtë arsye si marzh fitimi kemi marrë si tavan normën mesatare të obligacioneve të qeverisë shqiptare, për obligacione 7 vjeçare fikse, e cila është përllogaritur 6,28%. Pas 7 vjetësh, në përfundim të kontratës, kosto totale e skemës së koncensionit/partneritetit publik privat do të jetë 9,730,273,007 lekë.

Ky projekt është jo vetëm fitimprurës, e rrjedhimisht, atraktiv, për sektorin privat, por edhe lehtësisht i realizueshëm brenda mundësive buxhetore të Bashkisë Tiranë. Këstet vjetore që do t'i paguhen koncensionarit do të mbulohen nga të ardhurat nga Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore dhe transferta e kushtëzuar nga Ministria e Financave. Në këtë mënyrë, ky koncension/partneritet publik privat nuk e vendos aspak në vështirësi kapacitetin financiar të Bashkisë Tiranë, duke bërë të mundur që fondi i invesimeve dhe gjithë zërat e tjerë të buxhetit të mbeten të paprekur. Kësisoj, Bashkia Tiranë mund të investojë pa asnjë shtrengesë financiare në sektorët e tjerë si infrastruktura rrugore, shërbimet publike, strehimi, kujdesi social, etj.

Nga ana tjetër, analiza e impaktit në mjedis dhe impaktit social të projektit ka treguar se ai nuk ka asnjë ndikim negativ, si në mjedis ashtu edhe në shoqëri. Zonat ku janë parashikuar projektet, nga vendndodhja e tyre në zona urbane, kanë një florë dhe faunë jo shumë të pasur. Ato ndahen në dy grupe të mëdha. Grupi i parë përbëhet nga sheshet që ndodhen në zona të urbanizuara, mbi të cilat janë ndërtuar objekte ekzistuese ose janë hedhur shtresa betoni. Grupi i dytë përbëhet

sheshet që ndodhen në zonat të urbanizuara apo sub-urbane në të cilat bimësia është më e pranishme, por sërish mbetet në nivelin e barishteve e shkurreve të rralla. Rrjedhimisht, është vlerësuar se ky projekt nuk paraqet ndikime negative në mjedis, përveç ndotjes së ajrit dhe zhurmave gjatë fazës së punimeve.

Përsa i përket ndikimit social, projekti jo vetëm që nuk paraqet asnjë aspekt negtativ, por përkundrazi, ai paraqet një sërë ndikimiesh pozitive duke zgjidhur disa probleme të mprehta sociale. Ndërtimi i këtyre objekteve të reja shkollore do t'i japë fund njëherë e përgjithmonë problemit të mprehtë social të mbipopullimit të klasave dhe zhvillimit të mësimit me dy turne. Po njësoj zgjidhet edhe problemi i largësisë së shkollave nga qendrat e banimit çka i detyronte fëmijët të kryenin udhëtime të gjata për në shkollë. Ndërtimi i këtyre shkollave do të ndikojë në gjithë komunitetin përreth. Të konceptuara si qendra komunitare, këto ambiente do të jenë në përdorim nga komuniteti dhe pas orarit zyrtar mësimor duke u kthyer kështu në shtysë për ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella midis pjestarëve të komunitetit.

Së fundi, realizimi i këtij projekti nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncension/PPP është më e dobishme krahasuar me mundësinë e dhënies përmes një kontrate prokurimi publik. Për ndërtimin 17 shkollave të reja përmes metodave tradicionale të prokurimit, Bashkia Tiranë mund të përdorë tre mënyra: prokurimin e drejtpërdrejt të menjëherëshëm të 17 shkollave të reja, prokurimin e 17 shkollave të reja duke e shtrirë në një periudhë 3 vjeçare dhe prokurimin e një apo disa shkollave në vit sipas mundësive të veta financiare.

Duke pasur parasysh koston totale të projektit, dy mundësitë e para janë dukshëm përtej mundësive financiare të Bashkisë Tiranë. Pra, përmes këtyre dy metodave tradicionale të prokurimit, projekti është financiarisht i parealizueshëm. Mundësia e tretë e sipër-përmendur nuk e realizon plotësisht projektin pasi përmes saj mund të ndërtohen vetëm 14 nga 17 shkollat që nevojiten. Gjithashtu, edhe 14 shkollat që mund të ndërtohen, nuk ndërtohen menjëherë por përgjatë 9 viteve të ardhshme.

Në ndryshim nga tre mundësitë e prokurimit tradicional të projektit, me skemën e propozuar të koncensionit/partneritetit publik privat, projekti është jo vetëm i realizueshëm menjëherë dhe me fizibilitet, por edhe pa kosto shtesë për buxhetin e Bashkisë Tiranë duke qenë se ai nuk e prek fare fondin e investimeve për vitet e ardhshme. Përmes kësaj skeme, Bashkia Tiranë e zgjidh brenda dy viteve të ardhshme problemin e mbipopullimit dhe të zhvillimit të mësimit me dy turne.

Në përfundim, ky projekt është i nevojshëm pasi sjell një përmirësim të rëndësishëm në cilësine e arsimit në Tiranë, është teknikisht dhe ekonomikisht i realizueshëm dhe, ç'është më e rëndësishme, financiarisht i përshtashëm. Gjithashtu, duke parë mundësitë buxhetore dhe kapacitetin finaciar të Bashkisë Tiranë, projekti është i realizushëm vetëm përmes një kontrate koncensioni/partneriteti publik privat pasi përmes metodave tradicionale të prokurimit, projekti

Open Procurement Albania

ose nuk mund të realizohet fare, ose mund të realizohet pjesërisht dhe në një periudhë afat-gjatë.

Open Procurement Albania